

# ENVER HOXHA

VEPRA

26



**PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!**

# **ENVER HOXHA**

**VEPRA**

BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT  
QËNDROR TË PARTISË SË PUNËS TË  
SHQIPERISE



**ENVER HOXHA**



INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH

# ENVER HOXHA

VËLLIMI

26

DHJETOR 1963 - MAJ 1964

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»  
TIRANË, 1978



## PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 26-TË

*Komunistët dhe punonjësit e vendit tonë po marrin në duar një vëllim të ri të Veprave të shokut Enver Hoxha, vëllimin e 26-të, i cili përmbledh materiale të periudhës dhjetor 1963 — maj 1964. Shumica e këtyre materialeve botohen për herë të parë.*

*Në fjalimet, artikujt, diskutimet, bisedat dhe letrat e shokut Enver Hoxha, të shkruara ose të mbajtura gjatë kësaj periudhe, shkëlqen si gjithnjë vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë sonë, si në trajtimin e problemeve të brendshme, ashtu edhe të atyre ndërkom-bëtare.*

*Në planin e brendshëm, dokumentet e këtij vëllimi pasqyrojnë politikën parimore të Partisë sonë në të gjitha fushat e ndërtimit socialist të vendit. Orientimet kryesore që jepen në këto dokumente përbëjnë një program të madh pune për anëtarët e Partisë dhe masat punonjëse jo vetëm për kohën që janë shkruar, por edhe për sot. Kjo duket në të gjitha materialet, por veçanërisht në fjalën e mbylljes në Plenumin e 11-të të KQ të PPSH «Forcimi i Partisë duhet të jetë një preokupim i përditshëm i të gjithë anëtarëve të saj», në fjalën e mbylljes në Plenumin e 12-të të KQ të PPSH «Të je-*

tojmë mirë me situatat, të kuptojmë thellë vështirësitë dhe detyrat që rrjedhin prej tyre» dhe në fjalën në Konferencën e 8-të të Partisë të rrethit të Korçës «Socializmi nuk ndërtohet pa njerëz të mësuar, luftarakë dhe energjikë». Në këto e të tjera shkrime, komunistët, kuadrot dhe gjithë punonjësit e vendit, të çdo profili qofshin, gjejnë një përvojë të çmuar, armatosen me ide e mendime revolucionare për kapërcimin e vështirësive dhe marrin forca të reja për të vazhduar me vetëmohim luftën për ndërtimin e plotë të socializmit.

Në këtë vëllim botohen një numër diskutimesh të mbajtura në Byronë Politike e në Sekretariatën e KQ të PPSH. Tematika e këtyre diskutimeve është e larmishme dhe shpreh kujdesin e udhëheqjes së Partisë për t'u marrë me problemet më themelore të kohës e të fushave të ndryshme. Theksi vihet sidomos në forcimin e rolit udhëheqës të Partisë në terren e në ushtri, në revolucionarizimin e jetës së brendshme të saj, në udhëheqjen e masave me anë të shembullit pararojë të komunistit, në përmirësimin e punës ideopolitike me anëtarët e Partisë dhe punonjësit, çështje këto të një rëndësie të dorës së parë dhe me një vlerë të madhe aktuale. Krahas këtyre problemeve, në këtë vëllim, lexuesi gjen edhe një varg çështjesh e detyrash të tjera, që kanë të bëjnë me kuadrin dhe organizimin e punës, me zhvillimin e mëtejshëm të industrisë, të minierave, të bujqësisë, të shkencës, të arsimit, të kulturës, me thellimin e luftës kundër fesë, me forcimin e punës së Partisë në lagje, me ngritjen e nivelit teknik etj.

Materialet që botohen në këtë vëllim përshkohen nga domosdoshmëria e zbatimit konsekuent të pari-

meve bazë të marksizëm-leninizmit. Vëmendje e veçantë i kushtohet parimit të mbështetjes në forcat e veta si një nevojë objektive për ndërtimin e socializmit në vendin tonë në kushtet e rrethimit të egër imperialisto-revizionist. E bazuar fort në këtë parim shumë të rëndësishëm, PPSH orientonte për rritjen e rendimenteve në bujqësi, që të ecej drejt sigurimit të bukës në vend në një kohë sa më të shkurtër, për prodhimin e pjesëve të ndërrimit, që të shkurtohej importimi i tyre etj. Parimi i mbështetjes në forcat e veta ishte orientimi themelor për hartimin dhe zbatimin e pesëvjeçarit të katërt. Në këtë kuadër shtroheshin edhe detyra konkrete për përgatitjen e kuadrove e të specialistëve të degëve të ndryshme të ekonomisë e të kulturës. Në fjalën e mbajtur me rastin e shpërndarjes së tesarave të reja të Partisë dhe në materiale të tjera vihet në dukje se realizimi i detyrave në të gjithë sektorët e ekonomisë nuk mund të arrihet si duhet pa përgatitur njerëz me horizont e njohuri të gjera arsimore e shkencore, duke mos lënë pas dore edhe përgatitjen e teknikëve të mesëm e të ulët. Në lidhje me këtë jepen edhe një sërë porosish konkrete për profilin e shkollave profesionale, siç janë ato të ndërtimit, të bujqësisë etj.

Në planin e jashtëm, dokumentet e këtij vëllimi u bëjnë një analizë marksiste-leniniste problemeve të zhvillimit botëror. Në shumë materiale pasqyrohet vazhdimi me konsekuencë i luftës së pashembullt që ka bërë Partia jonë në arenën ndërkombëtare për demaskimin e politikës agresive të imperializmit me atë amerikan në krye dhe të revizionizmit modern, veçanërisht atij hrushovian e titist, për mbrojtjen e atdheut tonë

socialist dhe të marksizëm-leninizmit. Edhe një herë demaskohen me argumente pikëpamjet reaksionare të revizionistëve sovjetikë, të cilët, të ndodhur në pozita të vështira e diskredituese para opinionit të brendshëm dhe të jashtëm, kërkonin të pushohej polemika. Dokumentet e këtij vëllimi e bëjnë të qartë taktikën djallëzore të Hrushovit dhe të klikës së tij, që synonin të fitonin kohë dhe, në momentin e përshtatshëm, të goditnin përsëri vijën e drejtë të Partisë sonë. Por PPSH, siç theksohet edhe në materialet e këtij vëllimi, e mbështetur në parimet marksiste-leniniste, qëndroi si kurdoherë konsekuente në rrugën e saj revolucionare për t'i çjerrë maskën klikës tradhtare hrushoviane.

Në disa biseda me të huaj, në artikuj e materiale të tjera, dalin në pah kontradiktat që ekzistojnë në kampin e revizionistëve dhe demaskohet vija e renegatit Hrushov për t'u bashkuar me socialdemokracinë. Artikulli «Revizionistët modernë në rrugën e degjenerimit socialdemokrat e të shkrirjes me socialdemokracinë», argumenton me fakte tradhtinë e revizionistëve modernë dhe afrimin e tyre gjithnjë e më shumë me imperializmin. Kjo është edhe një nga provat që vërteton se sa të drejtë ka pasur e ka Partia jonë që lufton me vendosmëri si kundër imperializmit amerikan, ashtu dhe kundër socialimperializmit sovjetik dhe gjithë reaksionit e revizionizmit të cdo natyre. Ky mësim i Partisë sonë, i vërtetuar në jetë, hedh poshtë çdo «teori» që mundohet ta paraqesë imperializmin amerikan më pak agresor, se na paska ndërruar natyrë, na qenka dobësuar etj.

Si të gjitha vëllimet e tjera, edhe vëllimi i 26-të i

*Veprave të shokut Enver Hoxha është një pasuri e madhe për komunistët, kuadrot dhe mbarë punonjësit e vendit tonë. Studimi dhe përvetësimi i këtyre materialeve do t'u shërbejnë kalitjes së mëtejshme politike dhe ideologjike të komunistëve e të masave, mobilizimit të tyre për të realizuar detyrat e mëdha në kushtet e sotme të rrethimit imperialisto-revizionist, mbrojtjes së atdheut tonë socialist.*



## FORCIMI I PARTISË DUHET TË JETË NJË PREOKUPIM I PËRDITSHËM I TË GJITHË ANËTARËVE TË SAJ

*Fjala e mbylljes në Plenumin e 11-të  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

14 dhjetor 1963

Plenumi që bëmë, ka qenë i nevojshëm dhe do të shërbejë shumë për forcimin e mëtejshëm të punës së Partisë.

Sikurse me të drejtë u theksua, ne kemi suksese në punën tonë, po kemi edhe të meta. Dhe të metat nuk janë të tëra të bazës, këto ndahen në të gjithë Partinë, në bazë dhe në udhëheqje. Prandaj shumë drejt iu bë këtu kritikë udhëheqjes së organizatave-bazë, të organeve të pushtetit, të komiteteve të Partisë në rrethe. Por nuk mungoi, dhe ishte gjithashtu shumë e drejtë, e arsyeshme dhe e nevojshme, edhe kritika ndaj udhëheqjes, domethënë ndaj nesh, shokëve të qendrës, qoftë

---

<sup>1</sup> Më 13-14 dhjetor zhvilloi punimet Plenumi i 11-të i KQ të PPSH, i cili dëgjoi, diskutoi dhe aprovoi njëzëri raportin e Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi forcimin e mëtejshëm të Partisë».

ndaj aparatit të Komitetit Qendror ashtu dhe të Qeverisë. Dhe, kur u kritikua aparati i Komitetit Qendror, kuptohet vetvetiu nuk u kritikuan drejtorët, shefat a instruktorët e tjerë, por të gjithë ne që punojmë këtu, që nga unë e deri te sekretarët e tjerë të Komitetit Qendror. Kur u kritikuan ministrat dhe organet e tjera qeveritare, u kritikua edhe Qeveria dhe të gjithë shoqët që punojnë atje. Kritika që u bë ka një anë shumë pozitive dhe marksiste, se, në këtë Plenum, në frymë marksiste-leniniste, u theksuan të meta, të cilat ne duhet t'i korrigjohmë.

Po këto janë vallë gabime vije në ideologji, janë shtrembërime parimore politike ose organizative? Ne jemi të bindur që gabime e shtrembërime të kësaj natyre nuk ka në Partinë tonë, sepse Partia jonë qëndron e fortë, i mbron, i ruan të pastra parimet bazë të marksizëm-leninizmit, qofshin ato ideologjike, ose organizative. Dhe, duke qëndruar mbi këto baza të forta teorike dhe organizative, Partia ka ditur dhe është orientuar kurdoherë drejt në përcaktimin e politikës së përgjithshme të saj të brendshme dhe të jashtme të zhvillimit të ekonomisë sonë, të ndërtimit të socializmit, sepse busullën e ka pasur kurdoherë të qartë.

Ndërtimi i Partisë dhe organizimi i punës për ndërtimin e socializmit, zbatimi i një forme ose i një tjetre, zbatimi sot i një taktike të ndryshme politike nga e djeshmja etj., të gjitha këto bëhen në bazë të situatave që krijohen, se Shqipëria nuk rron e izoluar, ajo ka të bëjë me shtete miq dhe armiq, që ndjekin politikë të ndryshme ndaj saj. Ka nga ata që dje hiqeshin marksist-leninistë, por që ishin tradhtarë dhe janë në fuqi.



Ata kanë ndryshuar gjithë orientimin politik, organizativ e ideologjik dhe janë futur në luftë të hapët me marksizëm-leninizmin, kurse Partia jonë, duke qëndruar kurdoherë fort në parimet bazë të marksizëm-leninizmit, ka ditur që, sipas situatave, edhe taktikat t'i adaptojë në rrugë marksiste-leniniste, që t'u përshtaten interesave të ndërtimit të socializmit dhe të popullit tonë, interesave të pavarësisë dhe të sovranitetit të vendit tonë, internacionalizmit proletar dhe luftës kundër imperializmit dhe revizionizmit modern. Ky është një sukses i madh për Partinë tonë dhe do të vazhdohet në këtë rrugë, se Partia jonë është një Parti revolucionare që ka qëndruar, qëndron dhe do të qëndrojë kurdoherë pararojë e klases punëtore dhe e gjithë masave punonjëse në Shqipëri, se mbështetet fuqimisht në lidhjet e ngushta me masat e popullit. Kjo është një nga armët vendimtare **leniniste-staliniane**. E theksoj leniniste-staliniane se dihet që Stalini ka thënë: «kuadrot vendosin gjithçka»<sup>1</sup>. Sipas mendimit të Partisë sonë një tezë e tillë është e drejtë. Në asnjë rast në veprat e Stalinit nuk gjen që t'u kundërvihen kuadrot masave. Përkundrazi, atje do të gjesh të fortë tezën që partia duhet të lidhet sa më ngushtë me masat, të mbështetet tek ato, se, po të shkëputet prej tyre, ka vdekur. Bile J. V. Stalini, për ta theksuar këtë çështje, ka sjellë si figurë atë të Anteut. Prandaj në qoftë se thuhet që Stalini është shprehur që «kuadrot vendosin gjithçka», duke lënë mënjanë masat, kjo është e gabuar.

---

1 Këtë parullë J. V. Stalini e ka hedhur në kushte të caktuara për zgjidhjen e detyrave të mëdha në industri, në bujqësi,

Po partia pse quhet pararojë e klasës punëtore? Se në parti bëjnë pjesë njerëzit më të ndërgjegjshëm të klasës punëtore, ata të cilëve ajo u ka besuar drejtimin në bazë të ideologjisë së saj, partia ka besim të plotë tek anëtarët e saj dhe këta janë kuadro. Kur themi Partia kuptojmë se në radhët e saj bëjnë pjesë njerëzit më të ngritur nga masat, nga botëkuptimi marksist-le-

në transport dhe në ushtri, për realizimin me sukses të planit të dytë pesëvjeçar në vitet 30.

Pra parulla «kuadrot vendosin gjithçka» nuk është një parim as një parullë strategjike, por një parullë taktike.

Ja ç'thotë Stalini lidhur me këtë çështje:

*«Më parë thoshim se «teknika vendos gjithçka». Kjo parullë na ndihmoi që të zhduknim zinë në teknikë dhe të krijonim një bazë teknike shumë të gjerë në të gjitha degët e veprimtarisë për t'i pajisur njerëzit tanë me një teknikë të dorës së parë. Kjo është një gjë shumë e mirë. Po kjo nuk është aspak e mjaftueshme. Për ta vënë teknikën në lëvizje dhe për ta shfrytëzuar atë deri në fund, duhen njerëz që ta zotërojnë teknikën, duhen kuadro të aftë që ta përvetësojnë dhe ta shfrytëzojnë këtë teknikë sipas të gjitha rregullave të artit... Sikur në uzinat dhe në fabrikat tona të mrekullueshme, në sovkozet dhe në kolkozet tona, në transportin tonë, në Ushtrinë tonë të Kuqe të kishte një numër të mjaftueshëm kuadros të aftë që ta zotërojnë këtë teknikë, vendi ynë do të arrinte një efekt tri dhe katër herë më të madh se sot. Ja pse sot theksin duhet ta vëmë mbi njerëzit, mbi kuadrot, mbi punonjësit që zotërojnë teknikën. Ja pse parulla e vjetër «teknika vendos gjithçka», që pasqyron një periudhë tashmë të kapërcyer, kur kishim zi në teknikë, sot duhet të zëvendësohet me një parullë të re, me parullën «kuadrot vendosin gjithçka». Kjo është kryesorja sot».*

J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 7-8.

ninist dhe nga ndërgjegjja komuniste. Teza e N. Hrushovit që thotë se jemi «parti e gjithë popullit», është një bluf. Kjo do të thotë për revizionistët, partia e një klase të re borgjeze, kapitaliste që formohet në kushtet e reja. Ajo është një parti që do të sjellë në fuqi Kerenskë të rinj, që kanë dalë dhe po krijojnë atje një shtresë.

Cila është ajo parti marksiste-leniniste që nuk lufton për kuadrot? Ne u hodhëm në Luftën Nacionalçlirimtare, por, po të mos kishim krijuar Partinë, në qoftë se populli nuk do të kishte besim te një grusht njerëzish që filluan të bënin punën e Partisë, në qoftë se në masën e madhe të popullit që u hodh me armë në dorë kundër armiqve, nuk do të shquheshin njerëz, individë, kuadro që fituan besimin e popullit dhe të partizanëve, që i udhëhoqën në betejat e lavdishme, në qoftë se këta njerëz, të dalë nga gjiri i popullit që drejtuan ushtrinë tonë të lavdishme dhe çliruan vendin me luftë, pra, po të mos ishin të gjithë këta faktorë, a mund të merrej me mend të krijohej një situatë e tillë në vendin tonë? Si mund të mendohet që të ecet përpara pa kuadro? Në qoftë se Partia sot, nesër, pasnesër do të mendojë për të drejtuar, për shembull, kombinatin metalurgjik pa përgatitur më parë kuadro, kjo vepër nuk do të bëhet kurrë. Si mund të ndërtohet socializmi, si mund të drejtohen gjithë këto vepra pa kuadro?

Në jetën ose në veprat e tij, J. V. Stalini nuk ka thënë që kuadrove t'u shtrohet fusha me flori, t'u bëhen favore e të borgjezohen. Rëndësi ka çështja që të gjithë kuadrot të jetojnë dhe të punojnë me frymën revolucionare të Partisë, të mos shkëputen nga masat,

të luftojnë me këmbëngulje gjithë presionin e mentaliteve borgjeze dhe mikroborgjeze që ata sjellin nga jeta e tyre dhe që ekzistojnë akoma gjatë ndërtimit të socializmit dhe do të ekzistojnë edhe në fazën e kalimit për në komunizëm. Është çështje tjetër dhe do të ishte shumë e dëmshme që t'u bëhen kuadrove favore të tilla që i vënë ata në pozita të privilegjuara, të jenë mbi masat, të sillen me arrogancë ndaj tyre, t'i nënvleftësojnë ato.

Në këto çështje ne jemi të bindur se vija jonë është e drejtë, marksiste-leniniste. Partia dhe kuadrot tanë nuk e kanë harruar kurrë çështjen e madhe të masave. Masat krijojnë bollëkun, ato ndryshojnë situatat, çajjnë malet. Po masat udhëhiqen nga Partia, nga kuadrot që edhe këta kanë dalë nga masat. Është detyrë e Partisë që këta kuadro t'i ruajë të pastër si popullin, si klasën punëtore dhe fshatarësinë tonë revolucionare, të kaliten të thjeshtë, jo megalomanë, as grabitës, as shfrytëzues. Në këtë drejtim Partia jonë ka bërë dhe bën një punë kolosale.

Le të kthehemi tani në çështjen tonë. Puna e Partisë është e shumanshme, e madhe, e rëndë, por e lavdishme. Dhe, kur flasim për punën e Partisë, këtu nuk duhet vënë kufi. Nuk mund të ketë dualitet në çështjen e drejtimit të Partisë. Partia është në aparatet e saj, në pushtet, në dikastere, në ushtri, në drejtësi e kudo. Partia vendos. Të gjithë anëtarët e Partisë në ballë të luftës së masave zbatojnë interesat dhe dëshirat e mëdha të popullit, i cili nën udhëheqjen e Partisë ka krijuar mundësi për një jetë më të mirë, për të ecur përpara. Në bazë të punës së Partisë duhet të ngjallet te

njerëzit ndërgjegjja e madhe socialiste revolucionare, patriotike. Kjo bëhet dhe do të bëhet më mirë prej të gjithëve, qoftë nga ai që punon në aparatit e Partisë, ashtu edhe nga ai që punon në uzinë, në ndërmarrje, në Qeveri ose në ministri etj. Për këtë qëllim duhet bërë një punë e vazhdueshme me frymë revolucionare nga secili në specialitetin që i ka caktuar Partia. Ky specialitet nuk duhet të shfrytëzohet në asnjë mënyrë për interesin personal, subjektiv.

Partia i ka besuar anëtarit të vet që të gjithë diturinë ta vërë me thjeshtësi në interes të masave kudo që të punojë, që të jetë më luftëtar dhe më i sakrificës nga çdo njeri tjetër. Si ai që punon në pushtet ashtu edhe ai që punon në Parti nuk mund të thotë se puna e tij i vlen më shumë Partisë. «Puna ime është shumë më e vlefshme», mund të thotë një punonjës i aparatit të Partisë, ose një punonjës i pushtetit apo i ndonjë ndërmarrjeje mund të thotë se «këtë çështje e nxora unë», «unë e realizova këtë detyrë, se ata të Partisë kanë vetëm fjalë, mbajnë vetëm konferenca». Ata që mendojnë kështu janë në rrugë të gabuar, mendojnë në rrugë subjektive. Nga këto dy raste del se nuk e kupton as njëri, as tjetri ç'është roli drejtues, unik, universal i Partisë, në të gjitha hallkat e saj. Këtë çështje është mirë ta kuptojnë të gjithë shokët e Partisë dhe në veçanti shokët që Partia i ka zgjedhur, se njerëzit në administratë janë të emëruar.

Në Parti, në komitetet e Partisë ose në organizatat-bazë komunistët i zgjedhin udhëheqësit e tyre për të kryer një detyrë jashtëzakonisht të madhe. Se cila është kjo, ne e kemi sqaruar, po le ta themi edhe një herë:

Shokët e Partisë duhet të merren me çështje ekonomike, sepse e gjithë puna që i ngarkohet punëtorit të Partisë pa këtë nuk ka asnjë bazë, qëndron në hava. Çështja është që punëtori i Partisë, instruktori ose sekretari, të merren me çështjet ekonomike, jo vetëm nëpërmjet shifrave e statistikave, ato mund të kërkohen brenda pak minutave dhe për to Partia ka caktuar njerëz të veçantë. Puna është të jesh në dijeni të detyrave ekonomike që të janë caktuar, të metodës së organizimit të tyre nëpërmjet punës ideologjike, politike, organizative, inkurajimit, anës teknike, që anëtari i Partisë duhet të dijë të bëjë që në ndërmarrjet e vogla e gjer te më të mëdhatë si punëtor partie. Pra, ai ka detyra jashtëzakonisht të mëdha, në radhë të parë, të ngrejë punën politike e ideologjike, të forcojë hallkat organizative të caktuara nga Partia dhe pushteti e nëpërmjet këtyre hallkave të influencojë në shpirtin e komunistëve. Kjo është një punë kolosale. Atëherë përse punëtorët e Partisë s'pостоjnë pushtetin, shokët e tyre, të cilët janë po aq besnikë dhe të zotë sa edhe ata që punojnë në aparatet e Partisë? Fare mirë një kryetar komiteti ekzekutiv mund të bëhet sekretar partie, se i ka të gjitha cilësitë e sekretarit, ashtu sikurse një sekretar, kur të duash, mund ta bësh fare mirë kryetar të komitetit ekzekutiv. Të gjithë këta janë kuadro që i ka krijuar e i ka edukuar forca e Partisë, ata janë në gjendje ta bëjnë punën e tyre, bile shumë mirë. Por ata kanë nevojë për ndihmën e Partisë, se pa ndihmën e Partisë, pa mobilizimin e saj dhe të masave prej saj nuk mund të bëhet si duhet asnjë punë. Këtë e ka të qartë çdo punonjës partie. Prandaj, duke marrë parasysh

këtë detyrë të madhe që ka caktuar Partia, veçanërisht e kam fjalën për punëtorët e Partisë, nuk është e lejueshme dhe e pranueshme që komitetet e Partisë dhe aktivet e Partisë të merren për të caktuar sa teneqe uji duhen grumbulluar për të ujitur vreshtat, sa kazma e lopata për të hapur gropat etj.

E ndërpreva këtu një shok duke diskutuar dhe ndërhyra kur tha «me dashje pa dashje merremi edhe ne». Po përse të ngjasin këto gjëra dhe të lëmë mënjanë çështjen e madhe, pa të cilën nuk ecën pushteti? Kërkojnë një mobilizim të madh ndërtimi i industrisë, i bujqësisë, puna në ushtri, në organet e drejtësisë etj., sepse pa këtë mobilizim që e bën Partia, asgjë s'realizohet mirë. Çdo sektor do të ecë në rrugën e Partisë vetëm në rast se njerëzit janë të kalitur si duhet nga çdo pikëpamje. Këtë kalitje do ta bëjë Partia, organizatibazë, vetë anëtarët e Partisë, gjë që arrihet me një punë të vazhdueshme ideopolitike. Nuk duhet të harrojmë kurrë se presioni i mbeturinave borgjeze, presioni kapitalist e tani edhe presioni i madh revizionist, influencon mbi njerëz të pakalitur si duhet, qofshin këta me parti ose pa parti, domethënë në këto forma lufta e klasës vazhdon, ajo duhet të bëhet me ashpërsinë më të madhe kundër këtij presioni, ashtu sikurse e ka bërë gjer tani Partia.

Unë do t'ju bëj një kritikë juve, shokë sekretarë. Ne e dimë që punoni e lodheni, por në rast se ju dhe shokët tuaj keni parasysh në gjithë kompleksitetin punën politike e ideologjike, forcimin e hallkave organizative dhe mobilizimin e masave, duhet të lini sa më parë gjërat e vogla, t'u hyni thellë problemeve dhe të

punoni me njerëzit. Kështu bëhej në kohën e luftës. Eksperienca është eksperiencë. Unë gjatë kohës së luftës për një kohë kam qenë në Tiranë, ku kisha bashkëpunëtorë shokun Gogo Nushi, shoqen Fiqret Shehu e të tjerë. E dimë që atëherë kohët ishin shumë të vështira, sepse të ndiqte armiku, por nga ne nuk lihej organizatë-bazë pa vajtur, nuk lihej familje pa marrë kontakt. Udhëheqja e Partisë e ndiqte hap pas hapi jetën e njerëzve, dinte ç'mendonte njëri dhe ç'mendonte tjetri. Partia dinte gjithashtu që nuk ishin të tërë florinj, kishte njerëz me lakra në kokë, kishte heronj, kishte njerëz të bindur e të disiplinuar, njerëz të besueshëm, por kishte edhe intrigantë, llafazanë, frikamanë etj., etj. Në ato kohë të vështira Partia bëri durim të madh me këta njerëz. Merrni historinë e Anastas Lulës, një kohë të gjatë u përpoq Partia për ta ndrequr, por, kur pa se po bëhej e rrezikshme veprimtaria e tij me shokë, i dha grushtin. Po nga puna e kujdesi i Partisë shumë njerëz u ndreqën, u kalitën.

Tani kohët kanë ndryshuar, Partia është në pushet, prandaj detyrat tona sot janë të mëdha. Mirëpo edhe kuadrot janë të shumtë, ata tani kanë bërë përparime të mëdha, pra dhe mundësitë tona janë kolosale. Pa krahasoni një herë veten, sa nivel të ulët kulturoro-arsimor kishit atëherë, por shpirtin e kishit revolucionar, atëherë luftonit kundër armiqve pa kompromis dhe mobilizonit popullin për t'i futur në shpirt ldetë e komunizmit. Kjo punë këmbëngulëse bëri që Partia të ecte përpara. Prandaj, si në kohën e luftës kjo praktikë pune të ruhet e gjallë edhe sot, të mos harrohet metoda e mirë e punës, rëndësia e madhe e nje-



riut për ne, se njeriu do të ngrrejë fabrikat, do të bëjë shpikje, kanale etj. Po njeriu është njeri, ai ka edhe vështirësi në jetë, ka ndjenja, ka të mira dhe të meta. Ne e dimë fare mirë kush do t'i kanalizojë të gjitha këto gjëra në rrugë të drejtë. Vetëm një punë e drejtë, e përditshme, kolektive e individuale e Partisë me këta njerëz do të bëjë që çdo gjë të shkojë mirë. Po të meta kemi akoma dhe për këtë faji, në radhë të parë, u bie njerëzve që punojnë në aparatet e Partisë.

Të bëhet në Parti një jetë luftarake, e gjallë. Sekretari i parë mund të japë menjëherë shumë shifra e statistika, të tëra i ka në kokë. Mos vallë kjo tregon se e zotëron ekonominë? Mirë, e pranojmë për një çast, por kjo është krejtësisht e pamjaftueshme në qoftë se nuk keni në dorë si duhet ata që i krijojnë këto shifra. Ju nuk bëni si duhet një punë shkencore partie, prandaj nuk i keni si duhet në dorë njerëzit dhe nën hundën tonë ngjasin gjëra jo të mira, shumë prej të cilave mund të evitoheshin.

Në diskutimet e shokëve mbi çështje partie nuk u prek nëse ekzistojnë ose jo pikëpamje të ndryshme të komunistët. Por mos do të thotë kjo se nuk ka të tilla? Është e pamundur të mos ketë, por sigurisht këto nuk janë antagonistë. Pikëpamje të ndryshme antarët e Partisë dhe populli i shprehin, prandaj kjo duhet të na bëjë të jemi të kujdesshëm dhe t'i sqarojmë. Mirë, po një punë e tillë nuk bëhet sa duhet nga punëtorët e Partisë. Prandaj ta forcojmë punën ideologjike e politike, në format e organizuara të Partisë, por dhe në forma jo të organizuara, por që janë kurdoherë

forma partie dhe që ajo i ka vënë vazhdimisht në zbatim, sepse edhe armiku punon në këtë drejtim.

Të kemi kurdoherë parasysh detyrën që veprimtaria e revizionistëve dhe e të gjithë armiqtve duhet demaskuar e luftuar. Mund të gabohem, por a janë të informuar shokët sekretarë të komiteteve të Partisë dhe ata që venë në organizatat-bazë nëse lexohen e studiohen nga komunistët artikujt teorikë që boton Partia jonë në «Zërin e popullit»? Po t'i pyesësh sekretarët për një gjë të tillë, del se nuk janë të informuar. Duhet thënë se për t'i punuar këta artikuj, ata që i përgatitin, rrinë disa ditë a javë, kurse sekretari i komitetit të Partisë nuk i kushton një ditë këtij artikulli, me qëllim që të përgatitë një referat për këtë apo atë organizatë-bazë ose grup partie, për t'ua bërë më të qartë problemin komunistëve. Kjo nuk lejohet. Ju keni besim që njerëzit e lexojnë nëpër organizatat-bazë. Besim duhet të kemi, por kjo nuk është e mjaftueshme. Ju keni gjithashtu besim kur thoni se keni një shok specialist që merret me këtë çështje në kabinetin e Partisë. Edhe kjo është e drejtë, sepse ata shokë punojnë, por edhe kjo nuk është e mjaftueshme. Duhet të interesohet për këtë sekretari i parë edhe sekretarët e tjerë dhe jo të interesohen për lopatat etj., punë këto që i janë ngarkuar pushtetit t'i zgjidhë. Cila është më me rëndësi? Sigurisht e para. Ka më shumë rëndësi të na thoni që duhanin e kemi realizuar kaq për qind, apo se keni punuar një referat mbi një artikull të Partisë sonë, se në takim u ngritën këto çështje, dhe ua kemi shpjeguar kështu etj. Jo se nuk na interesojnë shifrat e pambukut, të duhanit etj., edhe këto na duhen, por ju duhet të na flisni

në radhë të parë për punën me njerëzit. Një praktikë e tillë vihet re në të gjithë shokët që punojnë në aparatet e Partisë, gjë që duhet korigjuar.

Të gjithë flasin t'u shtohen organikat, në pushtet e në Parti. Por kjo mund të mos jetë e nevojshme në qoftë se komitetet e Partisë dhe Komiteti Qendror (se edhe këtu ka të tilla pretendime), organizojnë punën më mirë se gjer tani dhe vënë përpara përgjegjësisë punëtorët e aparateve të Partisë dhe anëtarët e Partisë, për detyrat që kanë. Përgjegjësi për këtë të kemi të dy palët. Përpara Partisë kemi përgjegjësi për punën që na ka caktuar, pastaj kemi përgjegjësi dhe si punëtorë partie kur plani nuk është realizuar. Po edhe shokët e pushtetit kanë përgjegjësi përpara Qeverisë, ministrisë, drejtorisë së ndërmarrjes kur nuk merren masa për realizimin e detyrave. Në qoftë se ne dimë të ndajmë mirë punën në rrugën marksiste-leniniste, t'i japim secilit përgjegjësi e kompetencë për atë që u është ngarkuar, në bazë të të cilave të kryejnë detyrën, duke u mbështetur nga Partia në rrugë partie, në frymë revolucionare, së bashku me masat, atëherë do të dalim në konkluzionin se kuadrot e aparateve të Partisë i kemi të shumtë, prandaj duhet t'i shkurtojmë.

A është e domosdoshme që instruktori i zonës të vejë çdo muaj ose në dy muaj një herë në të gjitha organizatat-bazë? Nuk është e domosdoshme. Ai duhet të vejë në ato organizata-bazë që kanë dobësi. Po si bëhet që të mos vejë çdo muaj në çdo organizatë-bazë? Kjo bëhet kur instruktori të dijë mirë gjendjen e çdo organizate, me të mirat e me të këqijat e saj, jo vetëm të dijë nëse kanë apo nuk kanë që e vegla pune, që edhe

këto ai duhet t'i dijë, por kryesisht ai duhet të njohë shpirtin e njerëzve, të komunistëve, vendosmërinë e tyre, forcën organizative dhe, kur të vejë atje, të ndihet vajtja e tij, ta bazojë punën e vet në argumente të mira ekonomike, politike, ideologjike dhe teknike, atje ai të punojë me shokët e organizatës-bazë dija ditë, t'i mobilizojë mirë në punë, t'u japë dija udhëzime, të thërresë njërin dhe tjetrin, të bisedojë edhe me ata që kanë lakra në kokë dhe, pasi të ketë bërë një punë të mirë, në këtë organizatë mund të rrijë edhe dy muaj pa shkuar.

Pastaj ne ndjekim parimin që organizata-bazë të ketë iniciativë, por në qoftë se atë e mban vazhdimisht nën tutelën e instruktorit të komitetit të Partisë, ky, sikur ezhderha të jetë, nuk përballon dot vajtjen vazhdimisht në çdo organizatë, pastaj largohemi edhe nga zhvillimi i iniciativës të organizatës-bazë. Në këtë drejtim ne kemi shumë të meta që duhet t'i rregullojmë. Format i kemi, instruktorët i mbajmë, po ç'llogari u kërkojmë, ç'instruktazhe e udhëzime u japim atyre? Ne duhet të njohim se këto nuk janë të thella, të plota, nuk janë për ta një ushqim që i përmban të gjitha kaloritë e nevojshme. Ne jemi në gjendje ta bëjmë më mirë punën, po duhet të lëmë mënjanë ato që nuk na përkasin, të dimë të ndajmë mirë punën, pastaj të dimë t'i mësojmë që edhe ata të mësojnë të tjerët, të krijojmë një sintezë të tillë pune që të jetë më e qartë dhe mobilizuese për masat e Partisë.

Ne shkojmë në bazë kurdoherë gjatë fushatave. Me këtë nuk jemi në kundërshtim, duhet vajtur edhe gjatë

fushatave, por kur bëhet një fushatë, lihet përshtypja sikur bëhet diçka e re. Ne kemi rreth 20 vjet që bëjmë fushata. A duhet vallë kurdoherë t'i venë shumë të deleguar organizatës-bazë për ta nxjerrë nga balta? Kjo nuk është e drejtë. Kjo nuk do të thotë as që të mos vemi fare në bazë. Tani organizata-bazë nuk është në atë gjendjen e mëparshme; duhet të kemi më shumë besim tek ajo, po ky besim të jetë real, i bazuar, marksist-leninist. Edhe kjo punë nuk bëhet si era dhe vetëm me një fjalë, jo. Puna e Partisë është një punë e vështirë, e lodhshme. Prandaj neve na besojnë anëtarët e Partisë që na kanë zgjedhur dhe ne kemi përgjegjësi të madhe përpara popullit. Këtë duhet ta bëjmë, në qoftë se duam ta forcojmë mirë punën. Me këtë nuk dua të them se nuk jemi duke bërë gjë, por punimet e këtij Plenumi duhet të sjellin një kthesë të madhe në të gjitha aspektet e punës së Partisë.

/ Shokë, drejtimin burokratik duhet ta luftojmë dhe këtë luftë ta bëjmë më parë lart, se rreziku ekziston, pastaj ta çojmë në bazë gjer në fund. Nuk e kam fjalën vetëm në çështjen e letrave dhe të shkresave, se burokratizëm ka edhe në këtë drejtim. Të gjithë i kemi të qarta parimet ideologjike, politike, organizative. Duhet të jesh sekretar dogmatik, burokrat, në qoftë se kapesh vetëm pas formave, duke i konsideruar ato të pandryshueshme, kur në praktikë ato, edhe pse i ka vendosur Komiteti Qendror, kanë filluar të mos justifikohen.

Në këtë drejtim shokët e Partisë, që janë të lidhur me masat, të krijojnë forma të reja, prandaj jo të the-

mi në telefon, të vihët apo jo në zbatim kjo formë. Kur jep rezultate, të vihët menjëherë në zbatim. Ja, për shembull, për çështjen e bukës ne duhet të bëjmë kursime të mëdha, jo në kuptimin që të mbetet populli pa bukë. Populli nuk ka mbetur dhe kurrë nuk do të mbetet pa bukë. Por, sipas planifikimit, buka për frymë të popullsisë në vit na duket se është llogaritur tepër. Shtoi kësaj pastaj sasinë e orizit e të fasules. Shoku Mehmet, të cilit Byroja Politike i ngarkoi detyrën për ta ndjekur vetë këtë problem, shkoi një herë në kooperativën bujqësore të Zharrëzës, bisedoi me shokët e kësaj kooperative, ndërmjet të tjerash, edhe për këtë çështje. Komiteti Qendror ka marrë një vendim për çështjen e furrave. Këtë e bëmë se u nisëm nga disa arsye. Mirëpo shokët e kryesisë dhe të Partisë të kooperativës së Zharrëzës nuk vepruan në mënyrë të ngurtë. Kryetari i kooperativës i tha shokut Mehmet se kanë bërë diçka, jashtë vendimit, dhe me atë kanë arritur të harxhojnë për frymë një aq drithë sa lejon vendimi, po shumë më pak. Shumë mirë kanë vepruar shokët e Zharrëzës, ata edhe mbi komitetin e Partisë kaluan. Po si, edhe me ç'lugë duhet të hanë do t'u themi ne kooperativave? Ata duhet të veprojnë si e kuptojnë vetë më mirë. Shembulli i Zharrëzës na vë në pozita bindëse që disa herë ne e teprojmë me udhëzimet tona. Prandaj çdo kooperative bujqësore duhet të bëjë furrën e vet dhe të ekonomizojë bukën, kështu që fshatarët kooperativistë që nuk e bëjnë bukën, të mos kërkojnë drithë nga shteti, por nga kooperativa e vet. Faktet tregojnë se fshati

harxhon për frymë më pak bukë sesa llogaritet në planet tona. Kjo tregon se për shkak të llogarive të gabuara ne detyrohemi të importojmë çdo vit sasira të mëdha drithi. Tani ne kemi më shumë mjete të mekanizuara, më shumë tokë, është shtuar ujitja.

Pra, të mos jemi burokratë, kur një gjë është e mirë dhe e dobishme për ta vënë në jetë, është pozitive që del nga baza. Prandaj të jemi kurdoherë plot iniciativë në rrugë të drejtë, por t'i edukojmë njerëzit të jenë të matur, se edhe iniciativa e tepruar është e dëmshme. Njerëzit e edukuar mirë nga Partia shohin interesin e përgjithshëm, në radhë të parë, pastaj interesin personal.

Revizionizmi, për të cilin u fol, është sëmundje e tmerrshme dhe nga lufta që bëjmë kundër tij, të përfitojmë. Të mos e thjeshtojmë çështjen, po kur themi që të përfitojmë në bazë të mësimave të Leninit, të Stalinit, të eksperiencës sonë etj., kjo, mbi të gjitha, kërkon që të bëjmë një luftë kundër mbeturinave mikroborgjeze e borgjeze, kundër të gjitha shfaqjeve negative, disa herë armiqësore edhe të ndonjë anëtari të Partisë etj. Ne duhet të mos e harrojmë këtë, sepse revizionistët në këto mbeturina e bazojnë të gjithë punën e tyre. Ata dhe partitë e tyre kanë degjeneruar se nuk bazohen më në marksizëm-leninizmin, në parimet leniniste, në organizimin e partisë, të ekonomisë, të politikës. Titistët, hrushovianët, revizionistët çekë etj., punojnë me nxitim të madh për t'i degjeneruar partitë e tyre në parti borgjeze, kapitaliste dhe për t'i shndërruar krejtësisht vendet e tyre nga socialiste në vende kapitaliste; ata punojnë të krijojnë në vendet e tyre shtresa të borgjezisë së re që

përbëhen nga njerëz me pikëpamje të çoroditura jo me pikëpamje partie. Funkionarëve, në radhë të parë, regjimi i Hrushovit dhe i Titos u ka krijuar kushte jashtëzakonisht të favorshme. Me transformimet revizioniste tradhtarë në bujqësi, Hrushovi, u ka krijuar gjithashtu kushte jashtëzakonisht të favorshme, gjithë drejtuesve në kolkoze, inteligjencies e në radhë të parë intelektualëve të kalibrave të mëdhenj, jo vetëm brenda po edhe jashtë vendit, u ka dhënë privilegje jashtëzakonisht të shumta, për t'i pasur mbështetje në qëllimet e tij.

Në Jugosllavi e dini çështjen e drejtimit të fabrikave, kjo ka natyrë kapitaliste. Atje është krijuar brezi i kapitalistëve të rinj. I gjithë drejtimi i fabrikave, pra, është kapitalist, që në kushtet e sotme u jep një krodhë buke punëtorëve. Por kapitalistët e bazës janë mbështetje e kapitalistëve të qendrës. Këtë metodë pune dhe këtë krijim të kapitalistëve të rinj po e zbaton edhe N. Hrushovi në BS. Në industrinë e Bashkimit Sovjetik Hrushovi ka filluar dhe vazhdon të krijojë këshilla drejtimi nga udhëheqësit burokratë antimarksishtë të çoroditur, të shturur, që dalngadalë po bëhen mbështetje e restaurimit të kapitalizmit në BS. Edhe bujqësia në BS ka marrë dhe do të marrë edhe më shumë tatëpjetën. Në të gjitha drejtimit nuk ka asnjë fije punë partie me kriterë të shëndosha marksiste-leniniste, në vend sundon revizionizmi, masat po ushqehen vazhdimisht me një ideologji antimarksiste dhe me mënyrat e jetesës së Perëndimit. Kini parasysh se e gjithë propaganda demagogjike që bëhet në radio, në shtyp etj., mos



kujtoni se nuk influencon edhe në njerëzit tanë. Mos e harroni konferencën e Tiranës<sup>1</sup>, elementët antiparti, agjentë të legatës jugosllave dhe revizionistë, që u ngritën kundër Partisë. Ata akuzonin njerëzit e udhëheqjes së Partisë dhe të pushtetit se gjoja rronin në luks. Po në vendin tonë nuk ka një gjë të tillë dhe në qoftë se ka individë me tendenca të tilla, Partia duhet t'i shërojë, t'i edukojë. Kjo është një detyrë e rëndësishme, se, po të na zërë gjumi, atëherë kemi bërë krimin më të madh. Ne duhet të punojmë për sot, për mot e për shekuj. Guri ynë ka një vend të mirë, se është në themele bazë, mbi këtë themel të shëndoshë të mbështetemi, që në të ardhmen ta kemi Partinë tonë të pastër. Përgjegjësia jonë në këtë çështje është e madhe, prandaj shfaqjet e huaja duhen luftuar nga të gjithë ne. Partia jonë nuk ecën në rrugën e revizionistëve.

Sikur ne të mbështeteshim në parimet e revizionistëve ose të atyre të konferencës së Tiranës dhe të shtonim rrogat, puna do të ishte ndryshe. Por ne nuk shikonim ndonjë gjë anormale në rrogat. Detyra jonë, dhe, në radhë të parë, e anëtarëve të Partisë është e duhet të jetë të bëjmë kursime të drejta, të ruajmë pasurinë e popullit, sidomos ndërgjegjen e njerëzve. Po ruajtëm ndërgjegjen e njerëzve, ne do t'i kapërcejmë me sukses vështirësitë që do të hasim, dhe do të mundim t'i luftojmë me sukses më të madh se deri tani.

---

<sup>1</sup> Konferenca e 3-të e Partisë e qytetit të Tiranës për dhënie llogari e zgjedhje i zhvilloi punimet e saj prej 14-19 prill 1956.

Lidhur me sëmundjen e revizionizmit të mos harrojmë se në BS peshku u qelb nga koka. Tendenca për rehat, për të pasur më shumë dhe në mënyrë jo të drejtë, tendenca që «unë meritoj më shumë dhe më përpara nga tjetri», të kemi parasysh që nuk shfaqen te klasa punëtore dhe fshatarësia revolucionare, por te njerëzit e administratës dhe te intelektualët. Prandaj Partia jo vetëm të punojë me forcë të madhe, vigjilencë e drejtësi me klasën punëtore dhe prej saj të frymëzohet, por të punojë me kujdes, sidomos me kuadrot e zyrave, me ata që drejtojnë, me gjithë intelektualët. Mua nuk më pëlqen dhe nuk më duket e mirë as shprehja që kam dëgjuar aty-këtu, kur pyetet një kryetar kooperative: «Sa kokë dele ka kooperativa «jote»?». Pse «jotja»? thuaj: «Sa kokë dele ka kooperativa?». Kjo ka rëndësi të madhe, se po të bjerë fara në një tokë jo të mirë, ngjasin gjëra të këqija. Shumë varet natyrisht nga udhëheqja e kooperativës. Po të mos jetë kryetari i mirë është keq për kooperativën, por në qoftë se është i mirë vetëm kryetari, ai nuk ka ç'të bëjë. Prandaj forca e Partisë, e kolektivit është çdo gjë, çdo pikëpamje tjetër është e gabuar. Te ne ka dhe kryetarë kooperativash që u rritet mendja. Mundet që kryetarët e kooperativave marrin shumë edhe këtë duhet ta shohim veçanërisht, ka pastaj edhe kryetarë që nuk shkojnë të futin këmbët në llucë, nuk zënë me dorë kazmë e lopatë. Te një kryetar i tillë, dashur pa dashur, mund të krijohet pikëpamja e pronës private, sikur kooperativa të ishte e tij dhe ai të ishte bajraktari. Po t'i thuash kryetarit se «këtu je ti që ecin punët», se «si ti nuk ka njeri tjetër», me këtë nënvleftësohet

kolektivi dhe pastaj kryetari flet me arrogancë, i rriteb mendja, bëhet prepotent, mendon se vetëm ai është i ditur, se atij nuk ka kush i del përpara. Në qoftë se një gjë e tillë ngjet një herë te një njeri i klasës punëtore, dy herë te fshatari i varfër, tek ata që janë me origjinë intelektuale mund të ndodhë dhjetë herë.

Prandaj me të tërë të bëhet një punë e gjerë ideologjike për të rrënjosur ndjenjat dhe interesat e përgjithshme të kolektivit që zbukuron individin. Kolektivi punon në lidhje të ngushtë dhe nën drejtimin e Partisë, prandaj çdo njeri duhet të ecë me kolektivin, jashtë kolektivit nuk ka gjë, çfarëdo interesi jashtë kolektivit duhet zhdukur, veçanërisht për intelektualët.

Çështja e pranimeve në Parti që shtrohet në raport, nuk është një orientim i ri. Mos kujtoni se tani me këtë orientim ne duhet të lëmë mënjanë pranimin nga radhët e klasës punëtore dhe t'i futemi vetëm fshatarësisë. Nuk është kështu. Partia e Punës e Shqipërisë është parti e klasës punëtore dhe e masave punonjëse. Nga parimi ne nuk lëvizim. Nga këto masa, pas klasës punëtore, më revolucionarja ka qenë dhe është fshatarësia jonë. Këtë të mos e harrojmë dhe kur theksojmë këtë nuk shkelim në dërrasë të kalbur, nuk shkelim parimin. Me këtë fshatarësi revolucionare ne fituam luftën. Klasa jonë punëtore në atë kohë ishte e vogël, por Partia me ideologjinë e saj e mobilizoi këtë fshatarësi revolucionare në luftë, ajo mbushi radhët e Partisë dhe të klasës punëtore. Mos harroni gjithashtu se, kur filluam të ndërtojmë industrinë tonë, kanë ardhur për të punuar me dhjetëra mijëra fshatarë, të cilët Partia

i edukoi me frymën e klasës punëtore, i bëri punëtorë të devotshëm, i futi në klasën punëtore. Ky proces vazhdon edhe sot.

Kur themi që duhet të plotësojmë më mirë detyrën në fshatra, kemi parasysh se fshati ka rëndësi të jashtëzakonshme për ne. Prandaj atje duhet të kemi një organizatë partie të fortë, revolucionare, nga radhët e fshatarësisë, t'i japim Partisë gjak të ri. Kjo nuk do të thotë të lëmë jashtë elementët e klasës punëtore, as intelektualët, as, për shembull, punonjësit e tregtisë. Po cilado kategori ka një kufi. Kur themi të pranojmë në parti elementë të inteligjencies, është e drejtë, ne duhet ta kemi dhe ta zbatojmë këtë orientim. Për djalin e një kuadri që është intelektual, rreziqet janë më të mëdha nga të atij që e ka babanë punëtor edhe pse nuk është komunist. Ai mund të bëhet djalë i mirë, në qoftë se punon mirë Partia me të, sepse te djali i atij mund të mbijnë më lehtë lakra në kokë, kurse te djali i punëtorit ka mundësi të mbijnë më pak. Prandaj për këtë kategori Partia jonë në Statutin e saj ka vënë disa kufizime që nuk duhet t'i harrojmë. Kjo nuk do të thotë t'u mbyllim derën intelektualëve dhe nuk ua kemi mbyllur, por, në radhë të parë, ne duhet të pranojmë elementë të klasës punëtore dhe elementë revolucionarë nga radhët e fshatarësisë sonë kooperativiste.

Duhet të mbajmë parasysh se në kooperativat bujqësore kemi një punë jashtëzakonisht të madhe përpara. Në organizatat-bazë të fshatit ekzistojnë mjaft dobësi dhe të meta. Neve duhet të na tërheqë vërejtjen çështja përse nuk bëhen pranime në Parti, në

këtë ose në atë fshat. Thanë mirë shokët, dhe është e drejtë, që atje ku nuk bëhen pranime ajo organizatë-bazë është si uji i ndenjtur ku ka mushkonja, linden sëmundje. Në organizatën-bazë, ku nuk bëhen pranime, nuk mund të ketë frymë të shëndoshë, atje krijohet një ndjenjë rehatie, krijohen tarafe, lind pikëpamja, te disa njerëz, se ata janë të zotë, të pazëvendësueshëm dhe se nuk kanë nevojë për të tjerë. Të tillë njerëz që mendojnë kështu e kanë gabim.

Prandaj në organizatat-bazë në ndërmarrje, në administratë, në fshatra apo në lagje duhet të vijnë vazhdimisht njerëz të rinj, se të rinjtë sjellin në Parti vullnetin, energjinë e tyre të madhe, dashurinë dhe besimin e pastër për Partinë. Anëtarët e vjetër të Partisë duhet t'i edukojnë, t'i kalitin komunistët e rinj për të nesërmen. I është dashur mbi 20 vjet kudhrës së Partisë për të na bërë marksistë dhe që të punojmë pak a shumë mirë e pa gabime. Për të rinjtë nuk do të duhen kaq vjet, por duhet që të vjetrit të mendojnë për të nesërmen, të përgatitin kuadro.

Çështja e pranimeve në Parti ka rëndësi të madhe. Kjo nuk duhet bërë shabllon dhe me fushata. Parimi i pranimeve në Parti që është caktuar në Statut, duhet të ruhet, por edhe kjo nuk është mjaft, se të gjitha çështjet nuk mund të vihen në Statut. Do të bënim gabim në qoftë se tani do të niseshim nga këto që thamë dhe, o burra, të bëjmë pranime në fshat. Çështjen e duhet ta shohim organizatë më organizatë. Ne shohim se organizata-bazë e një kooperative është luftarake, atje ka kritikë e autokritikë, të rinj e të vjetër janë në ballë të luftës, nuk ka sëmundje, atëherë aty

përse të shpejtohem të pranojmë të rinj në Parti vetëm pse kemi direktivë? Po të kemi një organizatë të tillë, ajo duhet të krijojë aty një aktiv pa parti, nga i cili në çdo moment mund të futen elementë të rinj në Parti. Ndërsa në një tjetër organizatë-bazë, ku nuk bëhen pranime prej kohësh, organizata-bazë të marrë mundimin të punojë me njerëzit më të mirë, me kooperativistët më revolucionarë për të pranuar elementë të rinj, «që të turbullojnë atje ujët e ndenjur». Këtë nuk do ta bëjë sekretari i organizatës që është mësuar me atë gjendje, po anëtarët e Partisë dhe me një punë të gjallë të komitetit të Partisë, me qëllim që në organizatë të vijnë njerëz të rinj dhe të krijohet kështu një frymë e shëndoshë marksiste-leniniste.

Kështu, pra, në qoftë se në një organizatë-bazë fshati mund të duhen dy-tre anëtarë partie të rinj, le të futen. Ose në një fshat tjetër, ku fshatarët janë shumë konservatorë në drejtim të gruas, të punohet që të pranohen në Parti gra të reja për të shkundur konservatorizmin ndaj gruas te komunistët dhe te gjithë fshati. Në një fshat tjetër çështja e gruas është përpara, atje nuk e bëjmë një gjë të tillë në mënyrë të veçantë.

Prandaj, që të bëhet një punë e shëndoshë partie për sot e për mot, duhet ta zbërthejmë, ta bëjmë, «copë-copë» çdo direktivë, ta shohim në të tëra aspektet, pastaj t'i futemi punës në mënyrë të organizuar.

Kështu do të kemi kurdoherë me të vërtetë një Parti marksiste-leniniste ashtu si e duam ne dhe populli ynë, që të përballojë me sukses, si deri tani, këto situata që jetojmë, për ndërtimin e socializmit në kushtet e luf-

tës sonë kundër imperializmit dhe revizionizmit. Varet shumë nga puna që do të bëjë gjithë Partia kudo që punon, varet shumë nga metoda për përmirësimin e punës nga ana e punëtorëve të Partisë, e komiteteve të Partisë, por varet edhe nga organizimi i punës nga organet e pushtetit, nga ndërmarrja, ministria, Këshilli i Ministrave. Edhe nga ana e pushtetit duhet të merren masa serioze që gjëra të tilla si tani, të mos na ngjasin, t'i edukojmë njerëzit që janë në pushtet të marrin përgjegjësi të plotë përpara Partisë dhe Qeverisë. Ligjet e vendimet të zbatohen rreptësisht dhe të kërkohet llogari e plotë në rrugë partie e shtetërore për të gjithë njerëzit.

Nuk duhen lejuar presione ndaj Partisë. Këto presione bëhen për shkak të metodës së punës dhe të marrjes përsipër nga ana e komiteteve të Partisë për të zgjidhur çdo gjë. Në qoftë se, për shembull, kolektivi i Fabrikës së Sheqerit në Maliq nuk e kryen punën, organizata e Partisë të ndërhyjë atje duke mobilizuar totalisht njerëzit dhe, ata që drejtojnë fabrikën të marrin përgjegjësinë që u është ngarkuar. Në qoftë se atje nuk punohet mirë, nuk përjashtohet që të ndërhyjë edhe Komiteti Qendror, që të qortojë Qeverinë dhe kjo të bëjë që drejtorit të fabrikës t'i vihen këmbët në një këpucë nga ministria. Dhe drejtori i fabrikës, kur ka një problem dhe nuk i përgjigjet ministri, t'i drejtohet Kryeministrit. Kështu do të dihen më mirë ç'masa duhen marrë, ndryshe nuk ecën puna.

I kam kërkuar shokut Mehmet, dhe ai e ka bërë, një raport për metodën e punës në dikastere. Tani ministri-

të tona punojnë mirë, njerëzit janë të mobilizuar, ndryshe nuk do të na jepte fryte puna e tyre, nuk do të na realizoheshin planet. Këto plane realizohen me punë, po nga lart ka shumë gjëra që nuk parashikohen ose nuk dërgohen me kohë. Për këtë gjenden shumë arsye, përveç atyre të importit, për shkak të një burokratizmi shumë të theksuar, të dëmshëm. Ku konsiston ky burokratizëm? Në çështjen e ndihmës që i jepet bazës. Ka tri lloj ndihmash:

Ndihma e parë është ajo nëpërmjet revizoreve. Kjo është e domosdoshme, por Partia dhe pushteti në lidhje me këtë çështje duhet të bëhen të aftë, të ndër-gjegjshëm, të rreptë. Nuk duhet pritur që të vijë një herë në rreth revizori dhe të duket sikur zbuloi çdo gjë. Partia nga ana e saj nuk duhet ta flejë mendjen, se kështu, pas tre muajsh do të zbulohen vjedhje të tjera.

Forma e dytë është ndihma me ekipe. Kjo është një ndihmë më e mirë, më e efektshme, që duhet të jepet nga ana e Partisë dhe e pushtetit, por të keni parasysh që ekipet duhet të planifikohen. Kur vete ekipi në bazë, nuk duhet të vejë për të parë një rreth, pa pasur mirë të gjitha të dhënat e situatës dhe pa parashikuar masat për çështjet që di ai. Jo të caktohet në vija të përgjithshme në ç'drejtime do të ndihmohet rrethi, për shembull, do t'i bëhet një kontroll në përgjithësi sektorit të tregtisë në Korçë, por për këtë duhet të dokumentohen mirë të gjitha, pra ekipi të dijë mirë situatën e rrethit ku vete dhe përse vete. Pastaj gjatë punës mund të dalin edhe gjëra të tjera dhe me vajtjen e ekipit të merren masa që të meta në tregti të mos ndodhin, jo vetëm në Korçë, por në gjithë rrjetin e tregtisë së ven-



dit. Nuk duhet të vemi në çdo rreth për të parë të gjitha gjërat. Prandaj në bazë të shkojmë në mënyrë të studiuar, me ekipe, ta kemi situatën mirë në dorë, të dimë ku vemi dhe masat që duhet të marrin ministrinë t'i kemi të qarta. Pastaj të marrim masa në vend dhe nga ana e Partisë të caktohen ekipe për të parë punën e organizatave, kritikën dhe autokritikën. Pa studiuar mirë problemet, më mirë mos shkó fare, se do të shkosh veresie, atje duhet të shkosh me qëllim që të rregullosh gjendjen.

Ndihma tjetër është ajo e dërgimit nga ana e ministrive të njerëzve të shkëputur. Kjo formë, siç praktikohet tani, nuk është e mirë. Më ra mua në mendje dhe ngrehu ti shko në Durrës ose në Vlorë, dërgo njerëz nga të katër anët pa ekipe dhe për punë që mund të kryhen edhe me telefon, ose me anën e ndonjë shoku të ministrisë që ndodhet atje. Një formë e tillë ndihme nuk kontrollohet, dhe nuk mbahet parasysh se bëhen shpenzime të mëdha, sepse vajtje të tilla hanë shumë dieta. Pastaj kështu të shkëputur njerëzit shkojnë si era, asgjë nuk zgjidhin. Vete, për shembull, në bazë një nga ministria dhe kur atje i ngrenë një problem, përgjigjet: Do ta shohim. Mirëpo, po shkove në bazë duhet të japësh përgjigje. Të mos venë fluturimthi njerëzit në rrethe. Gjërave të tilla Qeveria t'u vërë fre dhe sa më parë të gjenden metoda të tjera ndihme. Pa lejen e ministrit ose të zëvendësministrit dhe pa u paraqitur një problem i rëndësishëm asnjë njeri të mos bëjë këmbë poshtë. Kështu edhe shpenzimet do të pakësohen, edhe shokët e rretheve nuk do t'i pengojmë.

Nuk ka shok në rrethet që të mos thotë se u shkojnë shumë veta çdo ditë nga qendra. Po ç'bëjnë gjithë këta njerëz? Ç'mund të bëjnë tre veta që shkojnë menjëherë në Fabrikën e Taninit? Ata rrinë nga 3-4 ditë për të analizuar taninin, kurse, po të jenë me të vërtetë specialistë, mjafton vetëm njëri prej tyre të qëndrojë një ditë të shohë gjendjen dhe të kthehet e t'i raportojë ministrit ç'duhet bërë. Lëre pastaj Ministrinë e Ndërtimit që për një çështje dërgon 4-5 ekipe. Ne duhet të marrim masa të rrepta në këtë drejtim se kështu, siç është vepruar, angazhojmë edhe shumë njerëz të bazës, të cilëve u presim iniciativën, i mbajmë të ngritur, fundi dhe i shfaqësojmë me këtë formë pune, se thonë pastaj që erdhi zëvendësministri, drejtori, shefi nga lart e s'bënë dot gjë, prandaj unë nuk kam ç'të bëj. Këtu luan rol administrata, po luan më shumë rol edhe Partia.

Ne themi dhe do të themi që organizata-bazë të bëhet luftarake. Po si problemi që thamë ka me qindra, të gjitha këto të shtrohen në organizatat-bazë, atje të kritikohen ashpër çështje të tilla se pengojnë punën dhe jo të diskutohen gjëra të vogla. Jo hajde të të kritikojmë se sot të pamë që pive tri gota raki, që i fole me zamërim gruas etj. Edhe kjo të bëhet, por jo vetëm kjo, jo të merret organizata e bashkimeve profesionale me çështjen pse ai tjetri nuk e paska marrë gruan në kinema. Po ai mund të ketë arsyet e veta në atë rast. Nuk është, pra, kjo kryesorja me të cilën duhet të merret organizata-bazë, po të marrë më mirë problemin, për të cilin i zien koka Partisë, kurse atij që s'e mori gruan në kinema, dhe kjo paska bërë përshtypje, t'i shkohet

një vizitë shoqërore në shtëpi dhe t'i thuhet hajde të shkojmë në kinema, merre dhe gruan.

Prandaj çështjet më të rëndësishme të shtrihen në organizatën-bazë dhe do të shikojmë pastaj si ajo do të bëhet luftarake, si do të merren vendimet, se ka lloj-lloj formash. Nuk e kemi të keq drejtimin e Partisë në ndërmarrje, në fabrika etj., përkundrazi e kemi shumë të mirë. Në drejtimin e fabrikave Partia merr pjesë direkte, se plani që vjen atje diskutohet edhe me anëtarët e Partisë, edhe me punëtorët dhe Partia nga ana e vet mobilizon masat për realizimin e tij. Prandaj, që të na ecë çdo gjë si duhet, organizata-bazë e Partisë duhet të mobilizojë njerëzit, t'i edukojë ata, të goditen tek ata të metat, duhet që ajo të bëhet vazhdimisht luftarake. Jo vetëm sekretari i organizatës-bazë, por edhe komiteti i Partisë dhe sekretarët e komiteteve të Partisë duhet të interesohen shumë për këtë problem, ata duhet të jenë si specialistë. Duhet të jetë i tillë, në radhë të parë, sekretari i komitetit të Partisë që merret me industrinë, që, kur të vejë në fabrikë, t'u thotë shokëve të Partisë të kombinatit të tekstilit, fjala vjen, që ju keni punuar shumë gabim se bezja ka dalë kështu e kështu, t'u theksojë që të jenë më të kujdesshëm, më të ndërgjegjshëm, pra, t'u flasë në mënyrë që t'i mobilizojë njerëzit dhe jo vetëm të marrë shifra. Prandaj në këto drejtime, shokë, duhet të bëhen përpjekje.

Pastaj çështja e letrave, si në Parti ashtu edhe në pushtet, është një problem i madh. Çdo ditë edhe unë marr shumë letra, lëre pastaj sekretarët e tjerë të Komitetit Qendror. Këto letra kanë shumë rëndësi. Një

orë çdo ditë unë lexoj letrat që më vijnë. Të gjithë e kuptojmë rëndësinë e tyre, por shkak u që na vijnë gjithë këto letra është se nuk e bëjnë si duhet detyrën e tyre njerëzit e Partisë dhe të pushtetit, në ministri e në ndërmarrje. Ka edhe letra që janë të pabazuara, po ka gjëra që duhet të ndreqen dhe në fakt ndreqen kur u vete në bazë nga ana jonë letra që na drejtohet. Po pse, pasi të vijë te ne, të ndreqet puna? Këta njerëz kanë shkuar më parë në bazë, po nuk gjejnë zgjidhje për çështjen. Kjo duhet të na bëjë të mendojmë.

Në ministritë ka njerëz të tepërt që duhen shkurtuar. Një shembull të vogël: Gjatë 9 muajve në 17 distrikte kanë hyrë dhe kanë dalë mijëra letra, sidomos në Ministrinë e Bujqësisë dhe në atë të Industrisë. Po përse kaq shumë letra e shkresa? Duhet të kemi parasysh se, atyre që i shkruajnë ato, sa kohë u kanë. Tri të katërtat e këtyre letrave duhet të zgjidhen nga Partia dhe pushteti. Pastaj sa njerëz duhet që t'i lexojnë ato letra, të na bëjnë edhe neve shënimet përkatëse e së fundi t'u jepet përgjigje të interesuarve. Tri të katërtat e këtyre letrave duhet të evitohen, prandaj të marrim masa që të luftojmë burokratizmin që pengon veprimtarinë e punonjësve, krijimtarinë e tyre. Të luftohet burokratizmi i letrave. Po të kemi më pak njerëz, më mirë do të na ecin punët. Në këtë drejtim ne duhet të bëjmë përmirësime.

Besoj se ky Plenum do të na shërbejë shumë. Punën ne duhet ta vëmë më mirë në vijë, kjo është e domosdoshme, e nevojshme për atdheun tonë dhe në përgjithësi për fitoren e çështjes sonë marksiste-leniniste,

sepse Partia jonë ka një përgjegjësi të madhe në arenën ndërkombëtare.

Ju jeni në dijeni të të gjitha çështjeve dhe e dini se lufta kundër revizionizmit po shtohet, po forcohet. Ato grupe e parti që gjer dje mbanin pozita akoma jo të avancuara, tani janë forcuar, siç e dini janë krijuar parti të reja. Nga ana tjetër, revizionistët e ndiejnë veten gjithnjë e më të dobët, në radhë të parë Titoja dhe të gjithë ata që e ndjekin, veçanërisht në vendet ish-socialiste të Evropës dhe në shumë parti revizioniste të vendeve kapitaliste.

Puna e Hrushovit për ne është e qartë, ai është tradhtar, agjent i kapitalizmit dhe veçanërisht i imperializmit amerikan. Lufta parimore e Partisë sonë po e demaskon grupin e tij tradhtar revizionist dhe po ia çjerr maskën këtij renegati. Ka në botë njerëz që nuk e kanë kuptuar akoma fytyrën e këtij tradhtari, po ne mund të themi se shumica e atyre që nuk e kanë kuptuar nuk do të thotë se janë me të.

Ka pastaj njerëz që janë me Hrushovin, janë pasuesit e tij. Por në mes të këtyre njerëzve, miq të Hrushovit, ka lëkundje të madhe, kontradikta të shumta, ka midis tyre që nuk janë dakord për të gjitha çështjet me politikën e Hrushovit, me taktikën dhe me masat që merr ai. Por edhe këta janë të rrezikshëm, vetëm se situatat në vendet e tyre tani janë të tilla që detyrohen të mos e ndjekin Hrushovin qorrazi, bile t'i bëjnë edhe kundërshtime për të kundërbalancuar hovin revolucionar të komunistëve të shëndoshë dhe të masave të popullit. Një nga këta është edhe Gomulka, revizionist me

damkë, por që ka dhe kontradikta të shumta me Hrushovin.

Kontradikta ekonomike kanë në mes tyre të gjithë revizionistët. Mbledhjet e Këshillit të Ndihmës Ekonomike Reciproke bëhen, po ato pak rezultate japin në jetë. Pjesëtarët e KNER-it shkojnë si macja me miun. Siç po shohim e dëgjojmë, ata nuk bien dakord me njëri-tjetrin, delegacione të shumta shkojnë nga një vend në tjetrin, sepse asnjë nuk zbaton vendimet e përbashkëta, për shkak se këto vendime janë ndërtuar në rrugë kapitaliste, në rrugën e përfitimit sa më shumë të secilit për veten e tij. I madhi kërkon të marrë thelën më të majme, kurse i vogli nganjëherë e kundërshton këtë.

Çështja e bukës ka qenë arsyeja kryesore e kontradiktave midis tyre. Për këtë problem ka pasur kundërshtime të rrepta nga të gjithë kundër Hrushovit, i kanë thënë këtij përse i la pa bukë, përse nuk i njoftoi që nuk kishte drithë, po i mbajti me llafe dhe për këtë tani ndodhen në situata të vështira. Çështja tjetër është ajo e ushqimeve. Zhivkovi pat marrë angazhim t'i furnizonte të tjerët me produkte ushqimore, kurse miqtë do ta furnizonin Bullgarinë me najlon a silon etj., po puna nuk ecën sipas planeve. Për sende ushqimore në BS dhe në vendet e ish-demokracisë popullore të Evropës ka shumë vështirësi. Ky është rezultat i politikës revizioniste që ndjekin udhëheqësit e këtyre vendeve. Hrushovi arsyeton se, që të ketë populli mish, duhet të shtohen oborret kolkoziane gjer në 2 hektarë, nesër do të thotë 4 hektarë dhe do të krijojë kështu kapitalistët e mëdhenj të bujqësisë. Kështu as çështja e mishit dhe as ajo e bukës nuk do të zgjidhen.

Një kohë Hrushovi pat thënë se fajin për disfatat në bujqësi e kishin SMT-të, i prishi edhe ato dhe tani është kapur pas plehut kimik. Brenda 7 vjetëve me 40 miliardë dollarë ai ka premtuar se do të ngrejë fabrika për prodhimin e plehrave kimike dhe fondet do t'i sigurojë me kredi nga SHBA. Shtetet e Bashkuara të Amerikës mund t'ia japin këto «ndihma» klikës së Hrushovit, por do t'i thonë: «Kur do të m'i kthesh?». Amerikanët, pra, nuk japin asgjë po nuk të morën shpirtin, po nuk të zhveshën lëkurën, po nuk u siguruan që në vendin tënd të vendoset kapitalizmi. N. Hrushovi pastaj këto shpallje të bujshme i bën për të gënjyer popujt. Dhe disa gjëra ai do t'i bëjë, do të marrë edhe kredi, po këto veprime do të çojnë në rrugën e vendosjes së kapitalizmit në BS dhe në vendet e demokracisë popullore.

Vija jonë është e drejtë, prandaj ecim vazhdimisht përpara, gjejmë kudo përkrahje të madhe. Ka parti komuniste e punëtore që janë në pozita të mira kundër revizionizmit modern, Hrushovit, Titos etj., por që nuk kanë dalë akoma hapur. Në Angli, për shembull, po duket që ka shokë të mirë, të vendosur, që po mbajnë qëndrim kundër revizionistëve hrushovianë etj. Kështu lufta atje vazhdon. Në Amerikën Latine puna është në ngritje, bëhen aksione.

Njerëzit kudo kanë shpresa të mëdha në forcën e marksizëm-leninizmit, te partitë që janë në pozita të shëndosha marksiste-leniniste, të cilat do të shtohen çdo vit e më shumë, në forcën e marksistë-leninistëve revolucionarë në të gjithë botën. Ne jemi të bindur se revizionizmi do të demaskohet, se marksizëm-leninizmi do të fitojë. Proletariati botëror me partitë e vërteta

marksiste-leniniste do t'i bëjnë varrin imperializmit dhe revizionizmit modern. E ardhmja është e komunizmit.

Këto kisha për të thënë.

*Pasi u vendos që të mos merret ndonjë vendim i veçantë dhe u aprovua raporti, shoku Enver Hoxha tha:*

Me kaq e mbyllim, shokë, këtë Plenum të Komitetit Qendror, shkoni në krye të detyrës dhe luftoni për të vënë në zbatim ato që diskutuam dhe aprovuam! Ju urojmë me këtë rast Vitin e Ri gëzuar e me suksese edhe më të mëdha në punë!

*Botuar për herë të parë,  
me shkurtime, në librin:  
Enver Hoxha «Në ndihmë  
të Ushtrisë Popullore»,*

*vëll. II, f. 469.*

*Tiranë, 1975*

*Botohet, me ndonjë shkurtim,  
sipas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*



**PARTIA KA TE RINIA NJË MBËSHTETJE DHE  
FORCË KOLOSIALE, BURIMIN E PASHTERSHËM  
TË RADHËVE TË SAJ**

*Nga biseda me delegacionin e rinisë dhe një  
piktor kinez*

**16 dhjetor 1963**

*Pasi takohet përzemërsisht me miqtë kinezë, shoku Enver Hoxha interesohet e i pyet për shëndetin e tyre, si e kaluan kohën në vendin tonë dhe ç'përshtypje kanë për rininë tonë.*

*Duke e falënderuar shokun Enver për këtë takim të ngrohtë, mysafirët kinezë thanë se kudo që ishin nëpër Shqipëri, vunë re se rinia është shumë e vendosur, besnike ndaj Partisë së Punës dhe në jetën e saj ajo ka grumbulluar një eksperiencë të madhe revolucionare. Pastaj fjalën e mori*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Në emër të Partisë sonë, më lejoni, të dashur miq, t'ju falënderoj për ardhjen tuaj në Shqipëri dhe për kontaktet e gjera që morët me rininë tonë. Ju lutemi t'i transmetoni gjithë rinisë

kineze dhe udhëheqjes së saj përshëndetjet më të zjarrta të Partisë, të popullit dhe të rinisë sonë.

Partia jonë ka te rinia një mbështetje të fuqishme. Pa rininë nuk mund të përfytyrohet jeta dhe e ardhmja. Partia dhe populli ynë punojnë që rinia të jetë kurdoherë revolucionare. Gjëja më e bukur në tablone të jetës, në jetën e një populli është rinia, jo vetëm në kuptimin e ngushtë fizik dhe të moshës, por edhe nga ndjenjat, nga fryma e saj revolucionare, e cila e bën rininë të zbatojë çdo detyrë, sado e vështirë që të jetë.

Partia jonë e Punës vazhdimisht është kujdesur e kujdeset për edukimin e rinisë me parimet e marksizëm-leninizmit, me vetitë më të mira të popullit, të klasës punëtore, të fshatarësisë revolucionare. Rinia e sheh vazhdimisht kujdesin e madh të Partisë, ajo e ndien këtë kujdes në të gjitha drejtimet. Prandaj, siç thotë populli ynë, rinia është e lidhur me Partinë si mishi me thoin. Partia ka te rinia një forcë kolosale, burimin e saj të pashtershëm, që sjell energji e gjak të ri në dejet e Partisë, ashtu si një lumë i kulluar që rrjedh, përshkon e gjallëron fushat pjellore. Kështu e konsideron rininë Partia jonë.

Ju, rinia kineze, keni trashëguar cilësitë e larta të popullit tuaj, keni dhënë shembuj të shkëlqyer në revolucion dhe në ndërtimin e socializmit. Edhe rinia jonë ka traditat e saj të mrekullueshme, të cilat i zhvillon dhe i pasuron vazhdimisht. Ajo ka zbatuar kurdoherë me një heroizëm të pashembullt vijën dhe direktivat e Partisë sonë, si në luftë ashtu dhe gjatë ndërtimit të socializmit. Të rejat dhe të rinjtë e vendit tonë kanë bërë mrekullira

dhe do të vazhdojnë të bëjnë të tilla edhe në të ardhmen. Në këtë fushë ne e shohim edhe më qartë vijën e drejtë të Partisë sonë. Është vendimtare çështja e ndërtimit të socializmit nga ana materiale, por për ndërtimin e tij ka rëndësi të jashtëzakonshme formimi i njeriut të ri. Dhe në këtë çështje, Partia jonë ka bërë, bën dhe do të bëjë vazhdimisht kujdes të madh.

Në fytyrën e rinisë heroike të vendit tonë, në organizatën e saj, ne shohim punën e lavdishme frytdhënëse të Partisë sonë të tipit leninist-stalinian.

Organizata e rinisë sonë u ka qëndruar kurdoherë besnike mësimëve të Partisë dhe ka treguar një frymë të lartë revolucionare me gjithë rrethimin e egër kapitalisto-revizionist, me gjithë luftën e madhe që armiqtë imperialistë e revizionistë po i bëjnë Shqipërisë, popullit dhe vetë rinisë sonë për ta infektuar, për ta goditur, për ta penguar nga rruga e drejtë me lloj-lloj mënyrash. Dihet se midis rinisë sonë dhe rinisë sovjetike në kohën e Stalinit ekzistonte një miqësi dhe bashkëpunim reciprok. Ky bashkëpunim vazhdoi për një kohë edhe pas ardhjes në fuqi të Hrushovit, derisa ky tradhtar veproi i maskuar. Megjithatë, kur Partia i tregoi rinisë sonë që Hrushovi me kompani janë deviatorë, armiq të marksizëm-leninizmit, agjentë të imperializmit, të rinjtë dhe të rejat e vendit tonë, me një qartësi të madhe politike, u hodhën në sulme të drejta marksiste-leniniste kundër revizionistëve hrushovianë, këtyre armiqtë të revolucionit e të socializmit, të Partisë dhe të atdheut tonë, qëndruan të gjithë bllok rreth Partisë, vepruan me një frymë të shëndoshë partie.

Rininë tonë ne e kemi të palodhur dhe të vendosur të kryejë çdo detyrë. Aksione të shumta i ka ngarkuar dhe i ngarkon asaj Partia dhe ajo punon kudo me entuziazëm, me disiplinë e me vetëmohim. Kjo është një kënaqësi e madhe për ne, po nuk na vë në gjumë, vazhdimisht bëjmë kujdes për edukimin klasor revolucionar të rinisë, që kjo të qëndrojë kurdoherë e pastër nga influencat e huaja dekadente, në çdo fushë. Nëpërmjet 15 radiostacioneve të fuqishme, armiqët tanë të jashtëm japin dhjetëra e dhjetëra emisione, me të cilat ditë e natë synojnë të helmojnë rininë e vendit tonë. Por më kot. Propaganda e tyre armiqësore e dekadente borgjezo-revizioniste nuk ka zënë e nuk do të zërë kurrë vend në rininë tonë. Kjo u detyrohet punës së drejtë, të palodhur dhe kujdesit të veçantë që tregon Partia jonë për rininë, e cila këtë kujdes ia shpërblen Partisë me punën dhe me qëndrimet e saj të drejta revolucionare. Por, natyrisht, në këtë drejtim ne kemi akoma shumë për të bërë.

Ajo klasë që ka rininë me vete, ka fitoren. Prandaj revizionistët modernë në punën e tyre armiqësore kanë në program, në radhë të parë, degjenerimin moral, politik e ideologjik të rinisë. Përpyekje të mëdha bëhen nga revizionistët modernë në BS dhe në vendet e ashtuquajtura të demokracisë popullore të Evropës për ta degjeneruar rininë. Dhe brenda një kohe të shkurtër ne shohim se në këto vende rinia po futet gjithnjë e më shumë në rrugën e degjenerimit, të kriminalitetit. Në radhët e saj po zhvillohen veset e këqija të moralit borgjez, rinia atje po shmanget nga rruga e drejtë që mëson marksizëm-leninizmi. Për

edukimin e rinisë sonë ne kemi akoma për të bërë një luftë shumë të madhe, për ta mbajtur rininë kurdoherë të pastër, ta kalitim dhe të mos e lejojmë të futet në rrugën e keqe, në të cilën është futur rinia në vendet kapitalisto-revizioniste nga borgjezia, mikro-borgjezia dhe tradhtarët e marksizëm-leninizmit. Për këtë qëllim Partia ka vënë si detyrë të dorës së parë edukimin e rinisë e të të gjithë popullit me frymë patriotike, revolucionare, internacionaliste marksiste-leniniste.

Rinia është ndihmësja e afërt e Partisë. Ajo e ka ndihmuar Partinë në çdo fushë, pra edhe në lëmin e edukimit të punonjësve, të prindërve, motrave e vëllezërve. Gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare prindërit lidheshin shpirtërisht me fëmijët e tyre, që kishin marrë armët, se këta ishin gjaku i tyre. Dashuria që kishin ata për fëmijët e tyre luftëtarë mori një kuptim të madh politik e ideologjik. Të rinjtë ishin rritur e ishin ushqyer me traditat patriotike të prindërve të tyre. Ata me luftën kundër pushtuesve fashistë rritën në zemrat e prindërve shqiptarë, më shumë se përpara, dashurinë për atdheun, kalitën më tepër ndjenjën e përhershme të patriotizmit të zjarrtë të të gjithë popullit tonë, futën në zemrën dhe në mendjen e njerëzve të kaluar nga moshja dashurinë e madhe për Partinë e Punës, për atë që luftoi dhe lufton për t'ia bërë gjithnjë e më të lumtur jetën popullit.

Rinia vazhdimisht i ka dhënë e i jep Partisë një ndihmë jashtëzakonisht të fuqishme për zbatimin e vijës së drejtë në të gjithë kompleksitetin e saj. Tani askush nuk thotë më si dikur «e more, punë të rinjsh janë këto», «punë kalamajsh». Tani rinia me punën e

saj, e udhëhequr nga Partia, imponohet kudo, në fabrika, në fshat, në fushën e arsimit, të kulturës. Në çështjen shumë të rëndësishme të emancipimit të gruas në vendin tonë, rinia, duke punuar në rrugë të drejtë, u dha e u jep një ndihmë të madhe Partisë e klasës punëtore dhe, njëkohësisht, nën udhëheqjen e Partisë, zhdukuri e po zhduk shumë zakone të këqija, shumë mbeturina të vjetra feudale, fetare, borgjeze e mikroborgjeze. Kudo, në saje të punës së tyre shembullore e të kujdesit të vazhdueshëm që tregon Partia për ta, imponohet sot personaliteti i të rinjve, prandaj tani në vendin tonë edhe pleqtë kanë respekt për të rinjtë. Në këtë prizëm e shikojmë ne, partitë marksiste-leniniste, çështjen e rinisë. Këtë rini ne duam ta kalitim akoma më shumë, ta forcojmë, ta ngremë në një shkallë edhe më të lartë.

Rinia jonë ka për të mësuar edhe nga ju, shokë, sepse rinia juaj ka virtyte të shquara, siç është sidomos ndjenja e lartë e punës. Ndjenja e punës dhe thjeshtësia që shihet në masat e rinisë suaj janë karakteristika të popullit kinez, të cilat ai i ka trashëguar dhe i ka çuar më përpara brez pas brezi.

Ne tregojmë një kujdes të madh për të forcuar miqësinë midis rinisë të të dy vendeve tona. Në këtë drejtim përpiqemi të mësojmë edhe nga eksperiencia e rinisë kineze. Partia na mëson që të udhëhiqemi kurdoherë nga një frymë e lartë patriotike dhe internacionaliste, nga idetë e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, prandaj ta mbrojmë e ta zbatojmë kurdoherë drejt marksizëm-leninizmin se ai na lidh aq fort me njëri-tjetrin.

Ne do t'i zbatojmë detyrat tona, sepse populli dhe rinia jonë kanë cilësi shumë të çmuara. Rinia jonë ka të zhvilluara ndjenjat patriotike, dashurinë ndaj atdheut, besnikërinë ndaj marksizëm-leninizmit, ndaj Partisë dhe Komitetit Qendror të saj. Ajo është një rini e thjeshtë, punëtore e trime. Këto janë thesare për rininë, për Partinë dhe për mbarë popullin tonë.

Ne duam të falënderojmë gjithashtu nga zemra piktorin kinez për ardhjen e tij në Shqipëri. Ne kemi veçanërisht respekt për piktorët kinezë që janë të njohur për talentin e finesën e tyre. Ne përshëndetim piktorët kinezë që vizitojnë Shqipërinë, që njihen nga afër me jetën e popullit dhe të rinisë sonë, me punën tonë për ndërtimin e socializmit dhe na japin përshtypjet që marrin në gjuhën e bukur të pikturës, duke shprehur ndjenjat e miqësisë për vëllanë e tyre, popullin shqiptar. Këto ndjenja, të shprehura në pikturë, ju ia bëni të njohura popullit të madh kinez. Ne kemi pasur rastin të takohemi në Shqipëri dhe me piktorë të tjerë kinezë dhe dëshirojmë që edhe paskëtaj në të gjitha stinët e vitit të vizitojnë vendin tonë piktorë nga Kina, sepse mendojmë që ata do të gjejnë kurdoherë ngjyra të ndryshme karakteristike të vendit, të punës, të njerëzve dhe të kulturës së popullit tonë. Këto, të paraqitura në pikturë, kemi bindjen se do t'i pëlqejnë popullit vëlla kinez, ashtu sikurse na pëlqejnë edhe neve zakonet, karakteristikat dhe ngjyrat e vendit tuaj të shprehura në pikturën e pasur të popullit kinez.

Ne, shqiptarët, nuk dimë t'i lexojmë hieroglifet tuaja, po, kur marrim një pikturë kineze, e kuptojmë

menjëherë përmbajtjen e saj. Në të duket vija e bukur që shpreh fisnikërinë e shpirtit të artistit, që është bukuria e shpirtit të popullit kinez e reflektuar në veprat e artit. Kina në shekuj ka pasur piktorë të famshëm dhe realistë, të lidhur me jetën e popullit, që kanë shprehur talentet e tyre jo në vija të trasha, po në detaje dhe me një elegancë të madhe. Në çdo pikturë kineze shikon një pasqyrim real dhe të gjallë të jetës në fshat dhe në qytet. Po të vëresh pikturat e dinastive të ndryshme, do të shikosh edhe mënyrat e ndryshme të të jetuarit, qoftë jetën e feudalëve, qoftë atë të fshatarëve.

Piktura e re kineze i ka trashëguar, i ruan dhe i zhvillon më tej traditat e artit të vjetër kinez të pikturës. Ajo ka krijuar vepra me vlerë që shprehin në mënyrë të qartë e me ngjyra të gjalla episodet e luftës heroike shumëvjeçare të popullit kinez.

Edhe në kohën e kaluar, në Perëndim pikturat kineze kanë pasur një vlerë të madhe artistike dhe kërkoheshin shumë. Muzetë e Francës dhe të Anglisë janë të mbushura me vepra të artit kinez, tablo, qeramikë ose punime të ndryshme prej druri ose kocke, që imperialistët i kanë grabitur nëpër pallatet e perandorëve kinezë. Këto kanë vlerë të madhe artistike, prandaj edhe i kanë grabitur imperialistët anglezë, francezë, gjermanë, amerikanë etj. Në të njëjtën kohë, kapitalistët e imperialistët, për arsye të njohura politike, nuk lejonin që me veprën e Leonardo da Vinçit ose të ndonjë piktori tjetër të njohur evropian, të barazohej, ashtu si e meritonte, edhe zotësia, zgjuarsia dhe bukuria në shekuj e penelit kinez. Po së



vërtetës vuri kufi sa të duash, ajo çan dhe do të çajë, ajo do të dalë në dritë.

Piktorët e vendit tonë janë formuar pothuajse të gjithë gjatë viteve të pushtetit popullor. Le të marrim, për shembull, shokun Foto Stamo, që ndodhet me ne në këtë takim. Ai është një luftëtar i vjetër. Kur ishte i ri, ka bërë një shkollë artesh, po, kur u pushtua al-dheu, iu desh të merrte pushkën e të luftonte dhe vetëm pas Çlirimit filloi nga profesioni i tij si piktor. Si Fotoja kemi edhe shumë piktorë të tjerë. Ne jemi të kënaqur prej tyre se bëjnë përpjekje të mëdha në punë, janë të lidhur fort me Partinë dhe masat e ajo që ka rëndësi shumë të madhe, në radhët e piktorëve, skulptorëve, kompozitorëve e artistëve të tjerë ka një gjendje të shëndoshë moralo-politike. Kjo na ngroh zemrën. Por ne gjithashtu as nuk mund të themi se piktorët, skulptorët, kompozitorët dhe artistët tanë kanë arritur sferat e larta të artit. Ata kanë hedhur vetëm hapat e parë. Detyra e tyre është që paskëtaj të mësojnë më shumë nga traditat tona, nga arti dhe kultura përparimtare botërore. Njerëzit tanë duhet të kenë një sedër të shëndoshë socialiste, joborgjeze, për të bërë një tablo sa më të bukur, jo për të marrë të holla, por që, kur të shkojë, fjala vjen, vepra e një piktori shqiptar në Kinë, punëtori ose fshatari i thjeshtë kinez të thotë: «Sa e bukur qenka Shqipëria!», «Sa të fortë janë partizanët!», «Sa të çiltër janë shqiptarët!», të ngjallë kështu një dashuri të drejtë e të madhe për Shqipërinë tonë, të pasqyrohen, pra, në këto vepra artistike fisnikëria dhe virtytet që trashëgon populli dhe kalit Partia jonë. Po të veprohet kështu, atëherë ne

mund të themi se artistët tanë ia kanë arritur qëllimit. Ky duhet të jetë një satisfaksion i madh për piktorët tanë, pra të shihet prej tyre jo interesi personal, po në radhë të parë interesi i përgjithshëm i popullit dhe i Partisë.

Ne jemi të bindur se piktorët tanë do të bëjnë përpjekje në këtë drejtim, se janë në rrugë të drejtë partie dhe japin kontributin e tyre për ndërtimin e socializmit.

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura në këtë  
takim që gjenden në AQP*

## ZGJIDHJA E PROBLEMEVE TË FUQISË PUNËTORE KËRKON NJË PUNË MË TË ORGANIZUAR

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**7 shkurt 1964**

Siç u shprehën edhe shokët në diskutimet e tyre, nuk është çështja që për problemin e sigurimit, sistemit dhe përdorimit të fuqisë punëtore s'është bërë asgjë. Partia ka punuar edhe në këtë drejtim dhe rezultatet janë të mëdha. Të metat që ekzistojnë, ne jemi në gjendje t'i kuptojmë e të marrim masat e nevojshme për forcimin e mëtejshëm të punës. Për këto çështje janë nxjerrë edhe ligje e urdhëresa. Sigurisht, këto ligje e urdhëresa duhet t'i përmirësojmë vazhdimisht, siç na mëson eksperienca, po mendoj që nga ana e Partisë, problemi që diskutojmë të shikohet më thellë si një problem i madh politik, shoqëror dhe ekonomik.

---

1 Një nga pikat e rendit të ditës që u diskutua në këtë mbledhje ishte edhe ajo mbi disa probleme që lindin nga sigurimi, sistemimi dhe përdorimi i fuqisë punëtore.

Çështjet që kanë të bëjnë me sigurimin, sistemin dhe përdorimin e fuqisë punëtore Partia duhet t'i marrë më mirë në dorë. E themi këtë se vihet re që vetë sekretarët e parë të komiteteve të Partisë të rretheve nuk janë si duhet në krye të zgjidhjes së këtij problemi kaq të madh. Nuk është çështja se një njeri, për shembull, nga Kastrati u martua në Shkodër, ose dhjetë policë, pasi kryen tre vjet shërbim, duan të vendosen definitivisht në këtë qytet, por është një problem shumë i madh. Sot në një rreth, për shembull, ka gati një mijë forca të lira, mot do të ketë më shumë, pas pesë vjetësh akoma më shumë. Atëherë, çfarë do të bëjmë me këta njerëz dhe si do ta organizojmë punën me ta? Po të mos e shohim këtë çështje në dinamikën e vet, do të ndodhemi para vështirësish të mëdha. Vërtet ne jemi në rrugë të drejtë marksiste-leniniste, po fakti është se popullsia dhe industria rriten. Mirëpo industria jonë nuk zhvillohet me atë ritëm sa të thithë të gjithë njerëzit që shtohen. Nga ana tjetër, bujqësia përparon dhe kërkon krahë pune, krahas kësaj ne po shtojmë edhe mekanizimin. Ky është një problem që nuk zgjidhet në një ditë dhe me dekrete, po kërkon një punë të zgjuar e të vazhdueshme nga ana e Partisë.

Sekretarët e komiteteve të Partisë të rretheve që janë në këtë mbledhje le të pyesin ndërgjegjen e tyre se ç'kanë bërë, për shembull, për forcimin e disiplinës, vendosjen e normave në punë, për zbatimin e urdhëresave që ka nxjerrë Qeveria lidhur me sigurimin, sistemin dhe përdorimin e fuqisë punëtore, a e kanë organizuar si duhet punën e Partisë në këto drejtime? Në mund të themi se për këto çështje nuk bëhet si

duhet një punë e organizuar. Këtë dua ta argumentoj duke filluar që këtu lart, nga organizimi i agjitacionit dhe i propagandës së Partisë.

Dihet se agjitacioni e propaganda e Partisë bëhen edhe nëpërmjet gazetës «Zëri i popullit» dhe revistës «Rruga e Partisë» etj. Me anë të këtyre organeve jepen direktiva të bazuara në vendimet me karakter ideologjik, politik dhe shtetëror, që janë të lidhura me zhvillimin e vendit tonë. Në qoftë se këto direktiva nuk dalin në mënyrë të organizuar, nuk botohen në kohën e duhur në organet e Komitetit Qendror, të cilat duhet t'i marrin e t'i studiojnë çdo komunist e sekretar i organizatës dhe në bazë të tyre të bëhet një punë shkencore, atëherë ne nuk do të kemi përmirësime. Kjo punë nuk duhet bërë kur t'i teket ndonjërit për të shkruar, fjala vjen, mbi rëndësinë e bukës, ose mbi normat apo mbi disiplinën. Mënyra si ne pasqyrojmë direktivat e Komitetit Qendror, të Byrosë Politike apo të Qeverisë në shtypin tonë qendror është e tillë që jo vetëm organizatat-bazë nuk i ndihmojmë si duhet, po as udhëheqjet e komiteteve të Partisë, të cilat kanë detyrë të dorës së parë organizimin e mirë të punës për zbatimin e vendimeve të Komitetit Qendror, Byrosë Politike dhe të Qeverisë. Kjo nuk bëhet si duhet. Po a do të vazhdojmë kështu ne? Jo, në asnjë mënyrë nuk duhet të vazhdojmë. Në qoftë se Drejtoria e Agjitacionit dhe e Propagandës pranë KQ nuk e organizon punën në mënyrë të tillë që problemet e marra në shqyrtim nga Byroja Politike të ngrihen në shtyp në kohën e duhur, atëherë ajo nuk e bën mirë punën e saj. Pse i paguan «Zëri i popullit» ata që shkruajnë «përralla»?

Honorare t'u jepen atyre që punojnë me të vërtetë për të armatosur, për shembull, kryetarët e komiteteve ekzekutive, sekretarët e komiteteve të Partisë dhe drejtorët e ndërmarrjeve etj. me kuptim ideologjik të problemeve dhe me udhëzime konkrete për organizimin e mirë të punës në ekonomi.

Organizimi i punës nuk mund të bëhet me dekrete. Është fakt se në disa raste po na shturet disiplina. Kjo vjen se punëtori nuk është akoma i ndërgjegjshëm, po krahas punës që zhvillon Partia për rritjen e ndërgjegjes duhen edhe sanksione. Nuk është e vërtetë që rregullat e Bashkimeve Profesionale të ne lejojnë që disa punëtorë të hyjnë e të dalin nga puna kur të duan dhe në këto raste të mos merren masa deri në përjashtimin e tyre nga puna. Kur një punëtor nuk punon, një qëndrim të tillë nuk e lejon as organizata profesionale. Edhe ligje të tilla në vendin tonë nuk ekzistojnë, po edhe në qoftë se ka ndonjë dispozitë me karakter liberal, atë mund ta përmirësojmë. Çështja është që të dyja anët, edhe edukimi edhe sanksionet duhet të ecin paralelisht. Organizatat-bazë i diskutojnë rrallë këto probleme, ka sekretarë të tyre që shpesh nuk dinë si t'i shtrojnë, po kur ata armatosen mirë, për shembull, për çështjen e mekanizimit, esencën e së cilës e kanë lexuar në shtyp, atëherë dinë edhe si t'i shtrojnë në organizatë. Kështu duhet të veprojnë edhe sekretari i komitetit të Partisë të rrethit, i cili është i detyruar që kur vete në fabrikë të mos shkojë formalisht, por të ndihmojë efektivisht organizatën-bazë që ajo të ketë një frymë me të vërtetë politike dhe ideologjike. Prandaj që këtej nga lart trajtimi i problemeve në shtypin

qendror më duket se nuk pasqyrohet në nivelin e duhur. Kjo hallkë na çalon dhe si pasojë janë të dobëta edhe hallka të tjera. Prandaj këtë çështje ta marrim seriozisht në dorë, të luftojmë për të përmirësuar punën në organet e shtypit, sepse kështu do të ndihmohet kurdoherë edhe baza. Në qoftë se komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive do të punojnë duke u bazuar në udhëzimet e dhëna nga Byroja Politike ose Qeveria edhe nëpërmjet shtypit, atëherë do të kemi një mobilizim më të madh edhe në bazë.

Për sa u përket normave, disiplinës etj., këto gjithashtu nuk i shtrojmë për herë të parë. Për çështje të tilla bëhet luftë e vazhdueshme, prandaj kemi edhe suksese, por duhet të luftohet akoma më shumë, duke përmirësuar metodën e punës. Unë nuk e di se si ti, shoku sekretar [i Shkodrës] do të raportosh në Komitetin e Partisë mbi problemet që po diskutojmë këtu, sa ti dhe shokët e tu do të vrisni mendjen që t'i zbërtheni e t'i zbatoni si duhet këto probleme, si do t'i shtroni e do t'i ndiqni në ndërmarrjet e rrethit tuaj. Kjo kërkon një punë shumë të vëmendshme, që ka më tepër rëndësi sesa bredhja poshtë e lart e disa sekretarëve, të cilët thonë pesë fjalë aty-këtu ose bëjnë mbledhje për çdo problem.

Për këto çështje mendoj se nuk do të ishte keq të zhvillonim një fushatë të tërë gjashtëmuajore, me qëllim që organizatat-bazë të mobilizohen më shumë. Që ky mobilizim të mos bëhet në erë, të përgatitemi mirë për këtë fushatë. Për çdo problem Partia duhet të përgatitet në mënyrë të organizuar. Të gjithë komunistët, duke filluar që nga sekretari i parë i komitetit të Par-

tisë, të gjithë shokët e pushtetit, është e domosdoshme të kenë të qartë në vija të përgjithshme se ku duhet të bjerë çekani në këta gjashtë muaj të fushatës. Duke ditur këtë, shokët do të mund të gërshetojnë si duhet problemin me gjendjen konkrete të rrethit dhe të ndër-marrjes dhe t'i qëndrojnë atij gjashtë muaj mbi kokë.

Rëndësinë e disiplinës, të punës me norma, vendosjen e normave teknike etj., gjatë kësaj kohe t'i ndjekë edhe shtypi. E them këtë sepse në shtyp, sidomos kohët e fundit, shohim pak gjëra të tilla, rrallë ka çështje ekonomike të planit, më shumë shihen artikuj, që në tri të katërtat e tyre përmbajnë më shumë fraza dhe detyra të përgjithshme. Këtë fushatë shtypi ta shoqërojë me artikuj bazë, të cilët duhet të punohen në organizatat e Partisë. Detyrat duhet të kombinohen mirë dhe të mos fillojmë tani o burra të bëhen mbledhje nga të katër anët. Kjo do të ishte burokratike. Në qoftë se do të bëhen çdo natë mbledhje për këto çështje, atëherë do të dëmtohet puna. Duhet të veprohet në mënyrë të zgjuar që edhe puna të bëhet, edhe njerëzit të mos lodhen e t'i kuptojnë drejt problemet. Mbledhje ne kemi shumë, janë mbledhjet e Partisë, të rinisë, të bashkimeve profesionale, të gruas etj. Në të shumtat e tyre bëhen më tepër referate politike, ndonjë informacion politik dhe vetëm aty-këtu zhvillohet ndonjë kritikë personale. Mirëpo në punë kemi edhe të meta, të cilat duhet t'i kritikojmë e të mobilizohemi gjithnjë e më mirë për të forcuar punën.

Çështja tjetër është ajo e afateve, të cilat janë të domosdoshme, sepse planifikimi i fuqisë punëtore du-



het të përfundojë në kohën e duhur, prandaj nga ana e Qeverisë të bëhet një fushatë, ku të rishikohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me këtë problem dhe të dilet me konkluzione. Jo vetëm të hidhen poshtë kërkesat pa vend për fuqi punëtoare, po të shihet se ç'do të bëhet me forcat e lira të punës.

Edhe për pasaportizimin dhe lëvizjen e fuqisë punëtoare nuk është hera e parë që diskutojmë. Ne do ta shtrojmë vazhdimisht këtë çështje, po duhet të insistojmë të tërë që ky problem të zgjidhet drejt. Ne flasim gjithnjë për këto gjëra, por ka prej tyre që s'ecin si duhet. Përse nuk vete qytetari për të punuar në fshat, në kooperativën bujqësore, në fermë, por pranon të qëndrojë pa punë, në një kohë që kjo te ne nuk mungon? Duhet të jemi realistë, sepse në ndërgjegjen e njerëzve ka mentalitete që janë të rrënjosura gjatë jetës, prandaj të luftohet akoma më shumë nga Partia për çrrënjosjen e tyre, duke rrënjosur ideologjinë e Partisë. Kjo do të arrihet nëpërmjet punës bindëse të Partisë. Po nuk u mobilizua Partia për të bindur njerëzit, me dekrete është e zorshme të bëhen këto punë. Rregullat për pasaportizim janë të drejta dhe duhet t'i zbatojmë, bile të jemi shumë të rreptë në zbatimin e tyre. Masat për pasaportizim pengojnë ardhjen e njerëzve nga fshati në qytet dhe shkeljen e tyre nuk duhet ta lejojnë as Qeveria as dikasteret. Shinasiu<sup>1</sup> thotë se nuk i marr unë punëtorët nga fshati, po i marrin ndërmarrjet. Atëherë mirë, le të zbatohet urdhëresa e Qeverisë, t'i jepet urdhër drejtorit të ndërmarrjes

---

<sup>1</sup> Shoku Shinasi Dragoti, në atë kohë ministër i Ndërtimit.

«21 dhjetori» të mos e shkelë urdhëresën dhe t'i kërko-  
het plotësimi i planit të ndërtimeve pa marrë punëtorë  
nga fshati. Në qoftë se nuk ka punëtorë, i thuaj t'i drej-  
tohet sekretarit të parë të Komitetit të Partisë të  
Tiranës.

Për pasaportizimin, pra, të gjithë jemi dakord që  
t'i forcojmë rregullat e ardhjes në qytete, sepse nuk  
mund të ecim më si gjer tani. Jo vetëm ata, të cilët ka-  
në pesë vjet që janë vendosur në qytete, po duhet të  
bëjmë përpjekje që të largohen nga qytetet edhe ata  
që kanë ardhur më parë nga fshatrat. Kjo sigurisht do  
të sjellë shqetësime, po ne duhet të veprojmë, se është  
shumë e arsyeshme, sado që do të ketë edhe njerëz që  
mund të mos e kuptojnë këtë masë. Ky është një pro-  
blem i madh shoqëror për të cilin duhet të punojë Par-  
tia. Po kjo nuk kërkon një punë të vogël, përkundrazi,  
që të realizohet kërkohet një punë shumë e madhe.  
Vlera e sekretarit të komitetit të Partisë të rrethit  
do të ngrihet shumë, në qoftë se do të arrihet që ai ta  
bëjë këtë punë në mënyrë marksiste-leniniste, duke  
bindur të shkojnë në fshat jo vetëm ata që janë vendo-  
sur gjer pesë vjet përpara në qytet, po edhe me të vjet-  
rit, të cilët të kthehen e të punojnë në ferma e koope-  
rative bujqësore. Atëherë shokët drejtues të Partisë  
në rrethe do të meritojnë lëvdatat e Komitetit Qe-  
ndror. Është më me vend të merresh me këtë punë sesa  
me statistika, natyrisht edhe këto s'duhën lënë pas  
dore, por kjo që po diskutojmë është një çështje e ma-  
dhe shoqërore, sepse nuk është fort e lehtë t'i thuash  
atij që ka 7 vjet në qytet, të vejë tani në fshat.

Të marrim si shembull Korçën. Në këtë rreth, as

në planin perspektiv pesëvjeçar nuk është parashikuar të ndërtohet ndonjë objekt industrial, ndërsa qysh tani atje ka shumë forca të lira. Po pas 4-5 vjetësh sa do të bëhen këto? Atëherë, çfarë ka menduar për këtë problem Komiteti i Partisë? Për zgjidhjen e këtij problemi mbeten disa rrugë, siç janë: të mos venë më në qytetin e Korçës nga fshatrat e këtij rrethi, Partia të punojë me të gjitha forcat, që një pjesë e qytetarëve të venë në ferma, qoftë edhe në punët me karakter sezonal, prandaj të krijohet bindje te njerëzit që të punojnë në këta sektorë, bile të vendosen definitivisht. Në fillim mund të dalin njerëz që duke banuar në qytet mund të shkojnë të punojnë si punëtorë me mëditje në fermë ose në kooperativat bujqësore, prandaj të vazhdojë puna që ata të binden e të vendosen atje definitivisht. Në qoftë se do të arrijmë që grupe të konsiderueshme njerëzish nga Korça do të pranojnë të shkojnë në fermë, atëherë një pjesë e investimeve që është për ndërtim banesash në këtë qytet, të spostohet për ndërtime në fermë.

Një pjesë e forcave të lira të qyteteve mund të shkojnë në fshat, pranë familjeve të tyre që punojnë në kooperativat bujqësore. Ky është një problem i madh. Po të vazhdojmë, duke marrë si shembull Korçën, mendoj që Komiteti i Partisë dhe ai ekzekutiv i këtij rrethi të bëjnë një studim kooperativë me kooperativë, të bisedojnë jo vetëm me kryetarët e kooperativave, po edhe me asamblëtë, duke ua shpjeguar atyre politikisht këtë çështje për tani dhe në perspektivë, t'u thuhet sa qytetarë mund të pranohen familjarisht ose sa krahë pune mund të punojnë në kooperativë. Një

kooperativë mund të thotë dy familje, një tjetër tri ose pesë etj., gjithsej në rreth, ta zëmë mund të sistemo-hen 100 familje qytetare. Atëherë mund të themi se e kemi zgjidhur më mirë problemin. Ata që venë në fshat janë një shembull i mirë për propagandën e Partisë, sepse kanë dashuri për bujqësinë. Por kjo nuk arrihet me një mbledhje, përkundrazi kërkon një luftë të gjatë. Sadopak të bëhet në fillim do të konsidero-het një sukses mjaft i madh, sepse kjo punë do të pengojë të shkojnë në qytet edhe familje të tjera fshatare.

Një rrugë tjetër për të sistemuar në punë qytetarë është që ata të venë në qendra pune ku shteti ka nevojë për fuqi punëtore, por kjo të bëhet në mënyrë të organizuar, duke u larguar nga rrethi i tyre të përcjellë me ceremoni. Po edhe kjo nuk është e lehtë, po fundi i fundit, ai që do të vejë të bëhet shofer në Laç, shpejt do të shohë se si do të rritet e do të zbukurohet ky qytet i ri. Kështu, shumë korçarë kanë shkuar nga Bili-shti dhe kanë mbushur ferma e kooperativa bujqësore në rrethe të tjera. Në qoftë se zhvillohet nga ana e Partisë dhe e shtetit një punë e organizuar, e koordinuar, e shoqëruar me një veprimtari të mirë propagandistike, mund të ikin një pjesë njerëzish, për shembull, edhe nga Korça. Për të vendosur njerëz në punë është edhe një rrugë tjetër: të shtosh prodhimin e artizanatit.

Në teori, shokë, të gjithë e kuptojmë se pa punën e Partisë nuk kryhet dot asgjë. Për shembull, për t'i kthyer në fshat ata që kanë disa vjet në qytet, kjo është e pamundur, po nuk u bë aksion i vetë organizatave-bazë të Partisë. Mirëpo duhen zbrazur ose lehtësuar qytetet patjetër, sepse po na fryhen dita-ditës gjith-

një e më shumë. Por puna e Partisë duhet bërë në mënyrë sistematike, e organizuar, që direktivat e saj të futen thellë në ndërgjegjen e njerëzve. Po ta bëjmë mirë punën bindëse të Partisë, atëherë e kemi përgatitur terrenin dhe populli do të bëjë siç ka bërë kurdoherë, ashtu siç thotë Partia.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## KUADRI DHË ORGANIZIMI I PUNËS LUAJNË ROL TË MADH NË ZHVILLIMIN E SHKENCËS

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

8 shkurt 1964

Ashtu sikurse të gjithë shokët, edhe unë mendoj se nga kuadrot që punojnë në Universitetin e Tiranës janë bërë përpjekje të mëdha e të lavdërueshme në fushën e shkencës. Mund të themi se orientimet e punës së bërë janë të drejta ideologjikisht dhe politikisht. Në teorinë dhe në praktikën e punës shkencore nuk ekskludohen debatet, rrahja e mendimeve. Prej tyre, prej kundërshtimit të mendimeve në frymën shkencore marksiste-leniniste del në pah e vërteta. Debati jep rezultate të mëdha edhe në zhvillimin e shkencës. Shkenca nuk ka frikë nga polemika. Mund të bëhen

---

<sup>1</sup> Sipas rendit të ditës, në këtë mbledhje u diskutua mbi disa detyra të rëndësishme që i dalin Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë pas Konferencës së Studimeve Albanologjike dhe mbi disa masa organizative për përmirësimin e punës, si dhe mbi gjendjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të punës kërkimore-shkencore në fushën e shkencave ekonomike e juridike.

edhe polemika, po kur pikëpamjet mbështeten në fakte e dokumente. Mendimet e kundërta do të përplasen dhe çështjet do të sqarohen. Tani vendi ynë ka shkencëtarë të aftë e të pasionuar. Edhe te shumë nga ata që kanë kryer shkollën e vjetër, ideologjia marksiste-leniniste e Partisë sonë dhe zhvillimi i socializmit ka bërë që pikëpamjet e tyre të evoluojnë. Në merremi me probleme të tjera dhe jemi profanë për çështjet e shkencës, por Partia në këtë sektor ka shokë që njohin mirë edhe vijën e saj, edhe shkencat e veçanta. Prandaj këta shokë duhet t'i ndihmojnë ata që kanë metodë të vjetër pune, ose që gjejnë më shumë nga ana subjektive sesa nga ana shkencore.

Edhe unë jam i mendimit me tezën se pellazgët kanë ekzistuar, gjë që e provon edhe shkenca, e tha edhe Stefanaqi<sup>1</sup>. Po tani kjo çështje duhet të thellohet edhe më tepër.

Këtu janë bërë përpjekje të lavdërueshme që meritojnë përkrahje nga ana e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë dhe e Këshillit të Ministrave. Puna që është bërë gjer tani është e mirë. Shoku Munir Reso<sup>2</sup> zhvilloi këtu një tezë, po të tilla në lëmin e gjuhësisë ka shumë. Në vija të përgjithshme ne jemi dakord me këto materiale që na janë paraqitur si për çështjet e gjuhës e të historisë, ashtu dhe për çështje ekonomike dhe juridike.

Për sa u përket nevojave që na parashtrohen, më

---

1 Stefanaq Pollo, në atë kohë shef i sektorit të historisë e të letërsisë në Institutin e Historisë e të Gjuhësisë.

2 Në atë kohë instruktor në Drejtorinë e Arsimit-Kulturës të KQ të PPSH.

duket se këto janë modeste, por nuk mund të vendoset në mënyrë të veçantë për to, siç e tha me të drejtë edhe Ramizi. Mirë është vepruar që këto kërkesa i drejtohen Byrosë Politike. Mbi bazën e këtyre kërkesave, ajo do të ketë dora-dorës edhe një ide më të saktë për orientimin e përgjithshëm në të gjitha këto praktika të universitetit, si në drejtim të tematikës së referateve, ashtu dhe për çështje materiale, të kuadrit etj., të cilat duhen mbajtur parasysh në planin e katërt pesëvjeçar. Mendimi im është se kërkesat që na bëhen nuk janë të mëdha, por këto kërkesa mund të bëhen të mëdha në rast se nuk inkuadrohen dhe nuk studiohen bashkë me kërkesat e përgjithshme jo vetëm për kuadrin universitar dhe shkencor, po edhe për kuadrin që kërkon praktika. Këtej na del një detyrë e madhe. Të mos shkojmë më tutje, po të shohim çështjen në universitet, ku duhet të luftohet për ruajtjen e kontingjenteve dhe skartimet të jenë minimale.

Në materialin që na është paraqitur thuhet se vendimet e Byrosë Politike për disa kuadro, që janë kërkuar edhe më parë, nuk janë zbatuar. Kjo është e palejueshme. Po përse nuk janë zbatuar vendimet e Byrosë Politike? Çështja nuk është vetëm se kanë marrë kuadro sektorët e tjerë, që nevoja na ka detyruar t'ua japim, po duhet të mos harrojmë edhe faktin që kontingjentet e dala nga Universiteti i Tiranës nuk kanë arritur ato të planifikuarat. Prandaj, detyrë të madhe për këtë çështje ka Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, sepse në shkollat e mesme e shtatëvjeçare ka rënie, ka firo nga kontingjenti i nxënësve. Është edhe kjo një nga arsytet që nuk realizohet numri i kuadrove të



planifikuar për arsimin e lartë. Në përgjithësi kështu duhet ta shohim këtë çështje. Kjo është e para.

E dyta është çështja e devizës. Që të hedhim një hap më përpara në drejtim të plotësimit të nevojave të universitetit duhet patjetër devizë. Këtu diçka është bërë. Komiteti Qendror dhe Byroja Politike e kuptojnë mirë rëndësinë e problemeve që dolën për zhvillimin e mëtejshëm të shkencës. Tani duhet të caktojmë proporcionet dhe t'i japim universitetit ato që kemi mundësi. Në qoftë se shikojmë dëshirat e mëdha që ekzistojnë në këto çështje, mund të themi se nuk do t'ia dalim dot, por ato që janë brenda mundësive duhet të jepen, në asnjë mënyrë të mos hiqen, përkundrazi të përpiqemi t'i administrojmë në drejtimet më të domosdoshme.

Ne kemi biseduar mbi këto probleme dhe jemi shprehur se kuadri luan një rol të madh, po një rol të madh luan gjithashtu edhe organizimi. Universitetin ne e kemi ngritur, ai na përgatit kuadro për degët e ndryshme të shkencës dhe i hedh ata në jetë, duke punuar si inxhinierë, mjekë, agronomë, ekonomistë etj., të cilët shteti i ngarkon me punë në sektorë të caktuar. Por kjo nuk do të thotë që kuadrot tanë s'kanë mundësi dhe kohë të lirë të mendojnë për një punë shkencore. Një punë e tillë, duke qenë e lidhur shumë ngushtë me veprimtarinë konkrete në pushtet, nuk mund të bëhet në një vit ose në dy, për këtë të jemi realistë. Prandaj të mos kërkojmë prej tyre që menjëherë të na japin ndonjë gjë të madhe, sepse kjo është e zorshme, po ka mundësi që ata të frymëzohen dhe të

punojnë e të krijojnë duke kryer detyrën dhe barrën që u kërkohet.

Sikurse tha shoku Deko Rusi<sup>1</sup> në dikasteret qendrore ka mjaft shokë që mund dhe duhet të merren me studime, prandaj Partia me punën e saj t'i frymëzojë këta njerëz, t'i ndihmojë e t'u kërkojë edhe punë studimore. Në universitet është filluar nga puna studimore, po akoma jemi në fazën e parë. Më përpara nga sektorët e tjerë është Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë. Kjo ka një arsye dhe kjo arsye është ana organizative.

Me sa di unë, në universitetet e botës profesorët e lëndëve bazë, që mund të jenë edhe njerëz të mëdhenj e që kanë për detyrë të edukojnë dhe të nxjerrin kuadro të rinj, bëjnë njëkohësisht edhe një punë shkencore. Ka pastaj kuadro të tjerë, që janë me shumicë, por që nuk janë profesorë, të cilët bëjnë punë kërkimore e shkencore. Kjo ka rëndësi edhe për ne, se, nëpër institutet tona, gjer në njëfarë shkalle bëhet punë kërkimore-shkencore, në disa të tjera kjo është në embrion. Pedagogu që jep aty mësim ka krijuar edhe një bërthamë, rreth së cilës grumbullohen studentë. Ky është një fillim i mirë. Kjo bëhet kështu se ne nuk kemi kuadro të shumtë, po në të ardhmen ne duhet të punojmë në këtë drejtim dhe të arrijmë rezultate më të mëdha.

Shokët folën lidhur me nevojat si dhe për mundësitë e mëdha që kemi, për të bërë studime shkencore të veçanta. Po përse nuk bëhet sa duhet në këtë fushë? Është lehtë të themi se nuk punon ky apo ai specialist,

---

1 Dokan i Fakultetit Ekonomik të UT.

po çështjen duhet ta shikojmë drejt. Të marrim specialistët që kanë mundësi të bëjnë studime në drejtim të hidrocentraleve. Ku t'i bëjnë studimet këta specialistë? Duhet të kenë një laborator që tani nuk e kanë. Një laborator të thjeshtë që ka universiteti shërben vetëm së për praktikën mësimore të studentëve, kurse neve na duhet një laborator ku specialistët tanë të kryejnë punë studimore<sup>1</sup>. Laboratori për studiuesin është i nevojshëm dhe i domosdoshëm. Atje specialisti do të bëjë vëzhgime, studime, eksperimente. Prandaj ne duhet të fillojmë qysh tani të krijojmë sa është e mundur të tilla bërthama, ku kuadrot dhe njerëzit tanë të shkencës të venë të studiojnë disa çështje shkencore ekonomike, sidomos shkenca ekzakte dhe të aplikuara. Në qoftë se i krijojmë këto, atëherë kimisti, inxhinieri, ose kushdo që punon dhe ka një mendim për ta vënë në zbatim, do të vejë të punojë në laborator.

Natyrisht laboratorët nuk krijohen menjëherë, po duhet të mendojmë të fillojmë dhe të ecim në këtë drejtim. Nga ana tjetër, të mos harrojmë se duhen edhe libra të posaçëm. Mundet që në bibliotekën e universitetit të krijohet një sektor i veçantë për këtë qëllim. Në qoftë se do të fillohet, për shembull, studimi i zbatimit të radioaktivitetit, në vendin tonë, atëherë duhet të sillen një shumicë librash, që kanë të bëjnë me të. Një gjë e tillë do të na duhet patjetër. Ose, po të bëjmë studimin e çelikut, duhet të përgatiten kuadro

---

<sup>1</sup> Në zbatim të kësaj ideje të shokut Enver Hoxha, u krijua në Tiranë laborator i kërkimeve hidraulike. Modelimi i parë që u krye në këtë laborator ishte ai i Hidrocentralit të Vaut të Dejës.

për këtë sektor, njëkohësisht duhen sjellë edhe libra që t'i referohen çelikut. Kështu edhe për naftën etj. Del problemi, pra, që në Universitetin e Tiranës puna studimore-shkencore të organizohet më mirë.

Natyrisht, për këtë kërkohet edhe kohë, një gjë e tillë nuk bëhet as për një vit, as për pesë vjet, po masat që u thanë kanë rëndësi, sepse nëpërmjet tyre do të përgatiten kushtet e nevojshme për të krijuar Akademinë e Shkencave<sup>1</sup>. Kjo nuk është aspak e çuditshme. Duke marrë këto masa, do të vijë dita të krijohet edhe ne akademinë tonë. Kjo kërkon njerëz me praktikë shkencore 15-20-vjeçare. Por nuk është e thënë që në Akademi të mos ketë kuadro me moshë të re 25-30-vjeçare, por që janë të talentuar e me perspektivë. Tani për sa u përket bërthamave organizative këto janë brenda mundësive tona dhe të universitetit, por në të ardhmen të kemi parasysh forcimin dhe zgjerimin e tyre duke aktivizuar edhe bashkëpunëtorë të jashtëm.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

---

<sup>1</sup> Me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH, Nr. 4993, datë 10.10.1972, u krijua Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, si institucioni më i lartë i kërkimor shkencor me qendër në Tiranë.

**TË JETOJMË MIRË MË SITUATAT, TË KUPTOJMË  
THELLË VËSIITIRËSITË DHE DETYRAT  
QË RRJEDHIN PREJ TYRE**

*Fjala e mbylljes në Plenumin e 12-të  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**12 shkurt 1964**

Të dashur shokë,

Dëshiroj të them edhe unë disa fjalë në lidhje me zhvillimin e punimeve të këtij Plenumi. Ne mendojmë se edhe më mirë mund të ishin zhvilluar punimet, më shumë mund të ishin rrahur mendimet. Diskutimet e plotësuan edhe më tepër raportin e Byrosë Politike, megjithëse kishte mundësi të ishin në një nivel akoma më të lartë. Projektraportin e Byrosë Politike mund t'ua kishim dërguar juve, shokë të komiteteve të Partisë në rrethe, në mënyrë që të kishit një kohë edhe

---

<sup>1</sup> Ky Plenum u mbledh në datën 11-12 shkurt 1964, dëgjoi dhe shqyrtoi raportin e Byrosë Politike «Mbi përfundimet e plotësimit të planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1963 dhe masat për plotësimin e planit dhe të buxhetit për vitin 1964».

më të gjatë për të reflektuar. Një gjë të tillë ne do ta kemi parasysh për mbledhjet e ardhshme, që ju të njiheni që më parë me problemet e përgjithshme e të ndryshme, me mendimet e Byrosë Politike, që preokupojnë gjithë Partinë dhe shtetin tonë, në mënyrë që në bazë të raportit të zhvillohen diskutime për përmirësimin e mëtejshëm të punës, për të marrë masa për realizimin e planit në të gjitha drejtimit. Prandaj çështja e studimit me kohë të raportit ka rëndësi.

Duhet kuptuar se raportin e dërgojmë në rrethe jo vetëm për sekretarët e parë, po për gjithë byronë e komitetit të Partisë të rrethit dhe në qoftë se nuk ka mundësi që ai të bëhet objekt studimi i gjithë byrosë, të bëhet të paktën objekt studimi i shokëve kryesorë, sipas temës së raportit. Kur është, fjala vjen, një raport si ky që ka të bëjë me çështje ekonomike, atëherë sekretari që merret me sektorët ekonomikë, kryetari i komitetit ekzekutiv dhe sekretarët e tjerë, me një fjalë shokët kryesorë, sipas sektorëve, të thërriten për ta studiuar dhe për ta diskutuar. Përveç atyre të thërritet edhe ndonjë drejtor ndërmarrjeje ekonomike, ndonjë drejtor SMT-je etj., cilin të gjykojnë shokët e komitetit të Partisë, dhe bashkë me ta të zhvillohen diskutime. Kështu diskutimi i sekretarit të parë të rrethit mbi raportin në Plenum të jetë me përgjegjësi dhe i një niveli të lartë. Këtë e theksoj se në mjaft diskutime nuk ka sa duhet kritikë. Nuk duhet të ketë asnjë shok sekretar partie, kryetar komiteti ekzekutiv apo drejtor ndërmarrjeje që t'i trembet kritikës dhe autokritikës. Diskutimet janë në përgjithësi njëfarë dhënie llogarie, dhe kjo duhet të bëhet mirë, sepse anëtari i Plenumit du-

het t'i japë llogari Komitetit Qendror, si zbatohen detyrat në qendrën e tij të punës apo në gjithë rrethin. Pra në diskutimin që do të bëjë secili këtu, ka vend të jepet llogari, po ka vend gjithashtu edhe për kritikë kur ndonjë problem nuk ecën mirë.

Të gjithë jemi të qartë se në çdo punë nuk shkon çdo gjë vaj, se midis njerëzve dhe sektorëve ka mendime të ndryshme dhe këto ndihmojnë që puna të ecë përpara dhe të kemi rezultate. Por asnjë nga ne nuk mund të thotë se atje ku punon nuk mund të ketë vend për të bërë kritikë, po jo kritikë për kritikë. Kur bëhen diskutime të studiuara ngrihen edhe kritika, tregohen edhe shkaqet që kanë penguar në të vërtetë realizimin e planit në rreth, në fabrikë, në sektorin e bujqësisë apo të transportit etj. Kritika në çdo rast të bëhet me adresë, drejtpërsëdrejti.

Ka shumë kritika për të bërë, por ka gjithashtu edhe shumë gjëra që duhen zgjidhur nga vetë Partia dhe pushteti në bazë me përpjekje, pa qenë të domosdoshme të ngrihen këtu, megjithëse ka edhe probleme që duhet të ngrihen patjetër, këtu, në udhëheqje. Pastaj çështjet duhet të ngrihen jo në përgjithësi e të kalojnë pa lënë gjurmë, ato duhet të ngrihen drejtpërsëdrejti, sepse personi që kritikohet do të reflektojë e do të analizojë shkaqet e dobësive dhe do të premtojë se kjo dhe ajo për të cilën më kritikuan shokët nuk do të ndodhë më.

Kam përshtypjen se shokët, pasi marrin raportin, bëjnë gati diskutimin për Plenum qysh më parë dhe flenë mendjen, diskutimin e marrin në xhep dhe presin radhën t'u dalë emri ta lexojnë. Që duhet përga-

titur diskutimi, kjo është e domosdoshme, po në çdo diskutim duhet të lihet një marzh për kritikën që bëhen gjatë mbledhjes. Kështu, kur të ngrihesh për të diskutuar, duhet t'u përgjigjesh medoemos edhe kritikave, pra ta plotësosh diskutimin tënd edhe me disa gjëra që dalin gjatë mbledhjes.

Raporti i Byrosë Politike që iu paraqit Plenumit, përmban esencën e veprimtarisë së udhëheqjes. Po duhet thënë drejt se edhe nga ana jonë, e udhëheqjes, ka mungesa e gabime, prandaj nuk duhej përjashtuar kritika edhe për ne. Duhet të përpiqemi ta bëjmë më luftarake punën e Plenumit, se, në qoftë se nuk i themi këtu këto gjëra, në qoftë se nuk na skuqet faqja këtu, atëherë atje në bazë mund të mos na skuqet fare dhe të ecim me rutinën e vjetër.

Në raport dhe në diskutimet e shokëve u trajtuan shumë probleme. Natyrisht çështjet që u ngritën kanë të bëjnë me një zhvillim të mëtejshëm, të përhershëm dhe kanë qenë objekt i shumë plenumëve të Komitetit Qendror. Prandaj nuk është e domosdoshme që të prek shumë probleme, por dëshiroj të theksoj disa nga çështjet që u thanë nga shokët e Plenumit, nga të ftuarit dhe nga anëtarët e Byrosë Politike, që morën fjalën.

Për problemin e drithit nuk do të zgjatem, po dua të theksoj se bukën duhet ta prodhojmë në vend, prandaj të vëmë të gjitha forcat, dituritë dhe mjetet tona për këtë çështje. Bukën ne duhet ta prodhojmë jo vetëm në fushë, por të vëmë të gjitha forcat dhe zotësinë tonë që atë ta bëjmë edhe në zonat malore, për të ulur kontingjentet e drithërave, që i japim fshatarësisë së këtyre zonave. Të kemi parasysh edhe eventualitetin e rrezikut



të një lufte. Sikur të përfytyrojmë se do të na ngjasë një luftë, ne duhet të kemi parasysh se malësia do të jetë prapavija jonë, prandaj ajo duhet të prodhojë patjetër drithëra buke. Kështu duhet të punojmë që të mos ndodhemi në befasi. Me këtë rast dua të vë në dukje se orientimin që kanë tani malësitë për blektorinë nuk duhet ta lënë pas dore dhe të lëshohen vetëm pas drithit, po shokët e zonave malore të marrin masa që krahas blegtorisë të intensifikojnë punën edhe për prodhimin e drithërave të bukës. Në lidhje me këtë problem nuk do të hyj as në çështje të kodit agroteknik as në çështje të ujitjes etj. Vetëm desha të theksoja që prodhimin e bukës në malësi ne duhet ta shohim me seriozitetin më të madh me qëllim që të shtojmë kontingjentet e drithit, sidomos për kohë rreziku.

Tani në drejtim të bukës po marrim disa masa, të cilat, në radhë të parë, duhet të kuptohen mirë nga Partia, pastaj nga populli e veçanërisht nga fshatarësia. Këto masa që marrim nuk janë shtrënguese, kufizuese për fshatarësinë. Kjo është e qartë. Është gjithashtu e qartë çështja se ne fshatarësisë i japim afër dyfishin e drithit nga sa i marrim. Atëherë shteti, si drejtues i ekonomisë së vendit, ka plotësisht të drejtë dhe duhet të interesohet që fshatarësia ta trajtojë bukën në mënyrë ekonomike. Kjo nuk do të thotë që njeriu të na të rrijë pa ngrënë, por e gjithë fryma e kësaj mase, në teori dhe në praktikë, synon vetëm ta ekonomizojë dhe ta administrojë si duhet bukën, se buka është flori. Çështja është që kur shteti, domethënë klasa punëtore dhe gjithë punonjësit bëjnë sakrifica dhe sjellin nga

jashtë çdo vit sasi të konsiderueshme drithi, a nuk ka të drejtë ky shtet i popullit që të vërë rregull dhe të mos lejojë spekulimin me drithë? Kur them spekulim te ne ky nuk ekziston në një shkallë të lartë, por sidoqoftu ka disa nga ata që në kooperativa marrin drithë më shumë nga sa kanë nevojë për të ngrënë për veten e tyre dhe tepricën e shesin në treg me çmime të larta. Por këtë rregull që do të vendosë shteti nuk e bën në kurriz të atyre, që, sipas ligjit dhe Statutit të kooperativave bujqësore, e kanë të drejtë ta kenë, se ai është shpërblimi i punës së tyre. Tepricën që merr tani kooperativisti për ditët e punës që bën mendojmë ta marrë në të holla, që janë një mjet i njëlojtë sikurse edhe drithi. Spekulumimi me drithë ndodh se te fshatari ynë ka akoma mbeturina të vjetra. Edhe në kohën kur shteti të mos ketë nevojë të importojë drithë nuk do të jetë e drejtë të lejohet një gjë e tillë, po sidomos tani, derisa ne importojmë drithë, kjo është e palejueshme. Është e pranueshme nga të gjithë se masat që po marrim për këtë çështje, janë plotësisht të drejta.

Këto masa duhet të shpjegohen politikisht, ideologjikisht dhe ekonomikisht. Ekonomikisht ata që kanë futur shumë ditë-punë në kooperativë nuk humbasin asgjë. Partia për interesin e përgjithshëm dhe të vetë fshatarëve kërkon që një gjë e tillë të luftohet, se kudo, në çdo sektor, luftohet kundër çfarëdo spekulimi. Ekonomikisht, pra, fshatari nuk dëmtohet dhe me këto masa ne do të kemi zhdukur gjer në njëfarë shkalle tregun fshatar të misrit, dhe shteti do të ketë më shumë drithë në dispozicion.

Partia duhet të punojë shumë në këtë drejtim që në rast se një kooperativist nuk bën në kooperativë minimumin e ditëve të punës, nuk do të marrë bukë nga kooperativa aq sa do të marrë ai që e ka bërë këtë minimum, ose sa ai që e tejkalon atë. Prandaj kjo masë shërben njëkohësisht si nxitje për të bërë ditë-punë, për të prodhuar më shumë drithë. Shkallëzimet që janë vënë në shpërndarjen e drithit për frymë janë peshuar mirë, duke pasur kurdoherë parasysh ruajtjen e parimit socialist, sepse mund të ngjasë që ndonjë fshatar të mendojë që shteti dhe kooperativa ia kanë siguruar bukën, prandaj o burra t'i futet punës private apo oborrit kooperativist, mbasi bukën e blen kur të dojë dhe sa të dojë në furrë me çmim të lirë. Edhe këtë duhet t'ua shpjegojmë fshatarëve se mund të ketë nga ata që këtë masë që po marrim të mos e kuptojnë menjëherë. Këtë mos e harroni, shokë, të ruhet mirë ky shkallëzim, sepse të shkruar në letër mund ta kemi, po në qoftë se nuk zbatohet, atëherë bëhen hatëre, mund të ndodhin interpretime të gabuara, mund të zemërohet masa e anëtarëve të kooperativave etj.

Një çështje tjetër që lidhet me këtë masë është ajo e furrave. Furrat duhet të ngrihen kudo ku fshatrat janë të grumbulluara. Kjo ka rëndësi të madhe jo vetëm nga ana ekonomike, po edhe për të gjitha ato që thamë nga ana psikologjike. Në regjimin tonë çështja e bukës në qytete nuk është problem, secili vete në furrë blen bukë sa ka nevojë dhe e çon në shtëpi. Kështu qytetari e rregullon buxhetin e tij me të hollat që ka. Një rregull të tillë ne duhet ta krijojmë edhe në

fshat. Këtë masë në fshat ne e marrim edhe për arsye ekonomike, edhe për t'u siguruar një ushqim më të mirë fshatarëve, edhe për të liruar krahët e punës, për zhdukjen e mentalitetit, se «sot kam bukë, po nesër nuk kam». Me furrat do të krijohet gradualisht një mentalitet si në qytet. Duke çuar në fshat një frymë më të përparuar jetese, siç është edhe kjo e furrave, do të ndihmohet që të zhduken disa zakone e mbeturina të tilla si ato që janë sot në fshatin tonë. Kjo masë do të ndihmojë edhe në zhvillimin e mëtejshëm ekonomik, politik e ideologjik të fshatit. Prandaj duhet të bëjmë një punë të dendur ideopolitike që këto masa të kuptohen mirë nga fshatarët dhe të shoqërohen edhe me masat e drejta që do të përcaktohen në një urdhëresë të Qeverisë. Për të blerë bukën në fillim shteti do të japë edhe kredi, se, që të marrësh bukë në furrë, duhet të kesh të holla në xhep. Edhe kjo çështje do të shihet. Shteti kreditë do t'i japë me afate të shkurtra, në mënyrë që fshatari të blejë bukë me të holla në dorë, atje ku do të ketë furra, dhe misër, atje ku nuk do të ketë furra. Të gjitha këto gjëra duhet të përcaktohen në urdhëresë, por duke ruajtur parimet që thashë.

Prandaj çështjen e bukës ta marrim seriozisht se është në interesin e përgjithshëm dhe të çdo familjeje. Në këtë çështje nuk do të zgjatem, po në fillim do të ketë disa vështirësi. Mendoni, shokë, se ne po importojmë shumë drithë. Kini parasysh që të gjitha direktivat e Partisë populli ynë i ka përqaftuar. Mund të ketë disa njerëz në fshat, që të mos i kuptojnë dot menjëherë këto masa ashtu sikurse do t'i kuptojnë ato me

dhjetëra mijë fshatarë të tjerë. Pikërisht për këtë është atje Partia, që t'ua shpjegojë atyre me durim. Po kjo do të na ndihmojë se, sado që kursimi mund të jetë një sasi e vogël, duhet pasur parasysh se gurë-gurë bëhet muri.

Një problem tjetër i rëndësishëm është ai i lëvizjes së krahut të punës nga fshati në qytet. Ky është një problem shumë i madh politik, ekonomik dhe shoqëror, problem me rëndësi aktuale. Në qoftë se ne nuk jemi të zgjuar në zhvillimin e këtij procesi, do të gjendemi në vështirësi sikundër janë gjendur dhe janë në vështirësi vendet e ish-demokracisë popullore të Evropës, ku tani sundojnë revizionistët, të cilët, për shkak të vijës së tyre të gabuar, nuk kanë marrë masat me kohë për këtë problem.

Nuk dua të hyj në origjinën e dyndjes së qyteteve me popullsi, por do të theksoj se lufta na shkaktoi shumë vështirësi në këtë drejtim dhe ne nuk duhet të lejojmë më, përkundrazi duhet të punojmë që qytetet të lehtësohen. Problem me rëndësi sot është që të mos na boshatisen fshatrat se kështu dobësohet bujqësia. Ky është një problem i madh politik, ekonomik dhe shoqëror. Largimi nga fshati pa kriter do të thotë dobësim i ekonomisë socialiste jo vetëm në fshat, po i gjithë ekonomisë.

Në qershorin e vitit të kaluar ne bëmë një Plenum të veçantë për rritjen e mirëqenies në fshat<sup>1</sup>. Të gjithë e dimë rëndësinë e këtij problemi, po të mos harrojmë

---

1 Shih: «Dokumente kryesore të PPSH», vëll. IV, f. 296.

asnjëherë që në fshat duhet të përpiqemi për një jetë më të kulturuar e më të përparuar. Ta kemi parasysh që fshati ynë të bëhet i dashur, tërheqës, i bukur për kooperativistët, që ata të mos mendojnë për t'u larguar e për të jetuar në qytet, po të vendosen përgjithmonë në fshat.

Kur ndërmarrjet shtetërore kanë nevojë për krahë pune më shumë nga sa janë mundësitë e qytetit, atëherë sigurimi i krahut të nevojshëm të punës të bëhet nga fshati, por gjithnjë në mënyrë të organizuar dhe të studiuar. Këtë ta keni kurdoherë parasysh që të mos lojohen lëvizje të paorganizuara. Mund të krijojmë edhe artizanat në fshat, për ato punime që ka nevojë kooperativa bujqësore dhe kooperativistët, të cilët do të dalin më rrallë në qytet. Në qoftë se në fshat do të dërgojmë mobilje të mira, do të zhvillojmë punimin e sixhadeve, ose do t'i japim fshatit mundësi materiale që jetën banorët e tij ta bëjnë të mirë, atëherë përse të vijë fshatari në qytet? Në këtë rast nuk ka më asnjë arsye. Të gjitha masat që ka parashikuar Partia për fshatin kanë për qëllim që fshatari të bëjë jetë të kulturuar, ta dojë fshatin me gjithë shpirt, të qëndrojë në fshat. Kjo ka rëndësi të madhe për ne.

Kur diskutuam planin e këtij viti në Byronë Politike, ne e shkurtuam planin e fuqisë punëtore që do të sigurohet nga fshati, më pak se gjysmën, bile ka mundësi ta ulim akoma. Këtë masë nuk e morëm kot, por për shkak se pamë që kërkesat ishin të fryra dhe se nga komitetet ekzekutive çështja e krahut të punës që ka në dispozicion qyteti nuk është pasur parasysh sa duhet.

Duhet ta kuptojmë mirë se çështja e krahut të punës që kemi në qytete nuk është aq e lehtë për t'u zgjidhur. Përkundrazi ajo është mjaft e vështirë. Nuk mund të themi kategorikisht që shokët e Partisë dhe të pushtetit nëpër qytete nuk bëjnë përpjekjet e duhura për të nxjerrë punëtorë. Ne duhet të luftojmë me këmbëngulje tendencën që ekziston te disa njerëz për të gjetur punë të lehtë. Është fakt se po nuk u bë një punë këmbëngulëse, politike dhe ideologjike, kolektivisht dhe individualisht, nga Partia, nuk do të zgjidhet lehtë problemi i futjes së njerëzve të qytetit në punë. Në këtë çështje duhet të mbahen parasysh edhe kushtet e secilit, mosha, stazhi në punë etj. Komiteti Qendror ka dhënë direktivën që gratë të zëvendësojnë punën e burrave në disa procese të përshtatshme për to, pasi ka vende të tilla që mund të zëvendësohen. Po edhe kjo çështje duhet parë mirë se ka njerëz të moshuar që punojnë prej një kohe të gjatë në të njëjtin profesion. Në këtë rast nuk mund të bëhet zëvendësimi, se rendimenti që do të japë ky njeri në një punë më të vështirë nuk do të jetë i kënaqshëm. Këtë punë Partia duhet ta fillojë në radhë të parë me të rinjtë dhe të rejat. Ne kemi një numër të rinjsh e të rejash që punojnë në disa profesione, por jo prej shumë kohësh. Këta mund të binden për ta ndryshuar profesionin më lehtë se të tjerët. Disa mund ta kenë të vështirë ta bëjnë një gjë të tillë, sepse e tillë është psikologjia e tyre, po puna e Partisë është dhe duhet të jetë bindëse. Veç kjo punë nuk duhet të bëhet me fushata, po të punohet vazhdimisht, të përgatitemi dhe të dilet me rezultate që të jemi gati për vitin tjetër.

Një masë tjetër për lehtësimin e qyteteve është edhe kthimi i një pjese të punonjësve nga qyteti në fshat. Edhe kjo mund të bëhet po jo me dekret. Vetëm puna bindëse e Partisë mund ta bëjë një gjë të tillë, sidomos me rininë. Ne kemi ngritur dhe do ta zhvillojmë edhe më tej në të ardhmen industrinë. Qëllimi ynë është që të ngremë një industri me makineri sa më moderne, të automatizuar, që të punojë me sa më pak punëtorë. Në këto kushte vetëm rritja natyrore e popullsisë së qyteteve do të na nxjerrë vështirësi të mëdha për t'i vendosur në punë moshat e reja të qyteteve, se çdo vit tani po mbarojnë shkollën me mijëra të rinj e të reja, ndërsa në pension dalin më pak njerëz nga sa hyjnë në punë. Atëherë ç'do të bëjmë me gjithë këta njerëz? Ky sot nuk është ndonjë problem shumë i mprehtë, por, po të mos marrim masa me kohë, do të na bëhet një problem preokupant pas 6-7 ose 10 vjetësh. Atëherë ç'duhet bërë? Në qoftë se kemi forca të tilla ekonomike që Korça, për shembull, të ketë edhe 20 fabrika të tjera mbi ato të sotmet, mund të mos na lindë ky problem, po, në qoftë se atje nuk ka lëndë të parë, ne nuk mund të ngremë fabrika të reja. Atëherë e gjithë kjo forcë e re pune që shtohet çdo vit ku do të çohet? Mbeten disa rrugë ku mund të çohen gjithë këta njerëz.

Një nga këto rrugë është fshati, kooperativat bujqësore. Prandaj ne duhet të bëjmë një studim të mirë shkencor për çdo kooperativë, ku të shikohet nëse këto kanë apo nuk kanë nevojë për krahë pune. Po të bëhet kjo llogari me kujdes do të dalë me siguri se ato do të kenë nevojë. Atëherë ja një rezervë për lehtësimin e



qyteteve, ja si mund të lehtësohet ca, fjala vjen, qyteti i Korçës.

Një rrugë tjetër është që qytetarët të venë atje ku ka punë. Përpara njerëzit merrnin rrugët e kurbetit gjër në Amerikë, Australi etj., atëherë përse të mos venë nëpër krahinat e Shqipërisë? Por kjo punë duhet të bëhet në mënyrë të organizuar dhe problemin duhet ta shohim në perspektivë. Këtu u propozua që të mekanizohet nxjerrja e transportimi i torfës, u kërkuan kamionë, traktorë etj. Të gjitha këto janë gjëra të bukura, po ato ne i sjellim me plan dhe brenda mundësive tonë ekonomike. Edhe në të ardhmen ne do të sjellim mjete të tilla, por në qoftë se sjellim mekanizma për të gjithë sektorët, atëherë ku do ta shfrytëzojmë krahun e punës? Dikush tha se ka transportuar 10 mijë tonë torfë, po kur ke krahë pune përse nuk transporton edhe 10 mijë të tjera? Në qoftë se shkojmë sipas «teorisë së mekanizimit» atëherë çfarë do ta bëjmë krahun e tepërt të punës? Sipas kësaj «teorie» do të shtohet mirëqenia dhe do të lehtësohet puna. Po mos harroni se këtë «teori» e ka trumbetuar prej kohësh N. Hrushovi, po tani në BS nuk kanë bukë të hanë, prandaj importojnë miliona tonë drithë, kurse ne nuk jemi në gjendjen e tyre, se ndjekim një rrugë të drejtë marksiste-leniniste dhe kurrë nuk do të mbetemi pa bukë.

Nuk e kam fjalën vetëm për rrethin e Korçës, por edhe për të gjitha rrethet e tjera, se ky është një problem për gjithë vendin tonë. Në vend që të flasim për mekanizim të madh e kompleks, të mendojmë më mirë se fshati është burimi më i madh për forca pune, bile

mund të çojmë atje edhe nga qytetet. Nuk di nëse e dëgjuat me vërejtje ç'tha sekretari i Komitetit të Partisë të Rrethit të Lushnjës në diskutimin e tij. Atje i kanë vënë rëndësi pambukut, mirëpo për këtë arsye nuk u arritën forcat për ta prashitur misrin, kështu e prashitën vetëm një herë. Kjo do të thotë se fshati ka nevojë për krahë pune. Po të kesh krahë pune, do të jetë më mirë që pambukun ta prashitim jo tri herë sa e kanë prashitur në Lushnjë, po pesë herë dhe misrin jo një herë, po tri e më shumë. Në qoftë se dikush kërkon kombajna për të korrur e për të shirë gjithë sipërfaqen e të lashtave, kjo është një gjë shumë e mirë, mirëpo kjo do të nxirrte të tepërt edhe shumë krahë pune të fshatit, kurse çështja sot shtrohet që të mos mbushen qytetet me fshatarë dhe të bëhen investime të mëdha për banesa, shkolla, çerdhe, dyqane etj. Po të mos e kemi parasysh këtë ne do të kemi vështirësi për strehim e vende pune. Ne kemi perspektivë të madhe për të çuar njerëz nga qyteti në fshat, në radhë të parë të rinj e të reja të qytetit, ata që mbarojnë shkollat, sepse i riu ka vullnet të fortë dhe forcë fizike për të përballuar çdo vështirësi. Po vetë ai pa u nxitur nuk shkon, prandaj në këtë drejtim kërkohet puna bindëse edukative e Partisë e organizuar mirë. Një rol të rëndësishëm këtu do të luajë puna që do të bëjnë sekretarët e komiteteve të Partisë dhe kryetarët e komiteteve ekzekutive.

Dihet që pasaportizimi është një masë administrative e përkohshme, po në asnjë mënyrë nuk duhen bërë lëshime nga kjo masë. Atyre që do të vijnë të organizuar në qytet t'u jepet vetëm pasaportizim provizor.

Në qoftë se shteti, në një periudhë të caktuar, ka nevojë që disa fshatarë të vijnë të punojnë në ndërmarrjet ekonomike, atëherë t'u thuhet këtyre se shteti ka nevojë vetëm për një kohë të kufizuar dhe në këto raste ata duhet të vijnë vetëm të organizuar, jo individualisht dhe, si të mbarojnë kontratën, të kthehen përsëri në fshat dhe jo të na zënë vend në qytet si gjer tani, duke sjellë edhe nga 5-6 veta të tjerë me vete nga fshati. Një praktikë e tillë të fillohet qysh këtë vit, kurse për vitin e ardhshëm t'i futemi studimit.

Byroja Politike ka porositur që komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të rretheve të organizojnë punën që fshatarët t'i kuptojnë masat e Partisë dhe të Qeverisë për drithin dhe për fuqinë punëtore, ta kuptojnë drejt dhe politikisht ndalimin e ardhjes së tyre në qytet. Mendoj se, po të realizohen plotësisht këto detyra, udhëheqja e Partisë dhe e pushtetit në bazë e ka kryer mirë detyrën që ka.

Desha të them gjithashtu disa fjalë mbi disiplinën në punë, normat dhe respektimin e tyre, si vihen ato, si kapërcehen etj. Punonjësit tanë në përgjithësi punojnë mirë, prandaj kemi dhe rezultate, po kemi edhe mungesa, thyerje të disiplinës në punë, mosrespektim të orarit të punës dhe si pasojë na dalin qindra e mijëra orë të humbura. Këto bëjnë që të mos prodhohet sa duhet ose të merren në punë njerëz të tepërt, të thyhet disiplina shtetërore, të bëhen hatërcë etj. Zbatimi jo i drejtë i direktivave të Komitetit Qendror, të Qeverisë, të ministrive, të komiteteve të Partisë dhe të komiteteve ekzekutive të rretheve, vjen se ndër-gjegjja e mjaft njerëzve nuk është në lartësinë e duhur.

Prandaj ne themi se Partia, me gjithë punën e madhe që ka bërë gjer tani dhe që po vazhdon të bëjë, ka përpara një punë kolosale. Në qoftë se nuk vë dorë Partia për ngritjen e ndërgjegjes së njerëzve, dhe kjo të bëhet jo me fushata por me një punë edukative të përditshme e luftarake, duke i ndihmuar njerëzit individualisht, nuk mund të zgjidhen këto probleme të mëdha.

Partia nuk mund të lejojë shturje nën maskën e demokratizimit dhe liberalizimit, se ka një kufi në shtruarjen e çështjeve, në bindjen e njerëzve për atë që është vendosur. Në qoftë se një njeri nuk do që ta kuptojë rregullin që është vendosur në interesin e përgjithshëm, nuk duhen bërë më lëshime, prandaj të merren masa administrative. Për një njeri që vazhdimisht është i padisiplinuar, që hyn e del nga puna kur i do qejfi, që shkel ligjet dhe rregullat, që nuk bën kthesë edhe pasi këshillohet, duhet të merret masë. Nuk mund të lejohet të shkelen ligjet e shtetit dhe vendimet e Qeverisë. Prandaj duhet të punohet që këto të kuptohen mirë dhe të zbatohen drejt. Çështja nuk zgjidhet vetëm me anën e ligjeve, po edhe nëpërmjet punës edukuese të Partisë. Jo se komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive nuk janë interesuar, po duhet të jemi të ndërgjegjshëm që nuk bëhet, ashtu si duhet, një punë sistematike. Në këtë drejtim punojnë edhe bashkimet profesionale, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në edukimin e punëtorëve, por në rast se në punën e kësaj organizate nuk janë në pararojë komunistët, asgjë nuk mund të bëhet; në qoftë se sekretarët e komiteteve të Partisë ose kryetarët e komiteteve

ekzekutive nuk futen vetë personalisht në punën e edukimit të njerëzve, kudo ku punojnë dhe luftojnë, për t'i ndihmuar, për t'i kontrolluar, për të folur vetë me ta, nuk mund të arrijmë ato rezultate që dëshirojmë në fushën e edukimit të njerëzve. Ne e dimë që shokët e bazës punojnë, lodhen, por njëkohësisht ata kanë nevojë për një ndihmë më të kualifikuar, prandaj anëtarët e plenumit dhe sekretarët e komitetit të Partisë duhet të venë vetë më shpesh në bazë. Në qoftë se nuk gabohem, nëpër mbledhje ka sekretarë të parë që shkojnë më shumë si prakticienë. Që të shkosh t'u flasësh punonjësve nëpër mbledhje, kjo nuk duhet të konsiderohet një punë aq e lehtë dhe të merret me mendjelehtësi. Ky do të ishte gabim i madh. Çdo problem ka anën e vet politike, ideologjike dhe ekonomike, prandaj si sekretari i komitetit të Partisë ashtu dhe kryetari i komitetit ekzekutiv duhet ta shtrojnë meoemos problemin në këtë prizëm. Vajtja e tyre në një qendër pune duhet të vlejë për kolektivin e asaj qendre, të ndihet që atje ka shkuar sekretari i parë i komitetit të Partisë dhe fjala e tij për punëtorët do të shërbejë në mobilizimin e tyre në punë. Ju, shokë sekretarë të komiteteve të Partisë, mund të shkoni edhe çdo ditë në qendra pune të ndryshme dhe kjo nuk do të ishte e keqe, po duhet të shkoni edhe një herë në muaj apostafat atje dhe të shtroni një problem si duhet, të nxirrni konkluzione të shëndosha që t'u shërbejnë punonjësve për një kohë të gjatë. Edhe në fshatra shkojnë sekretarët e komiteteve të Partisë dhe flasin, po për këto probleme ata duhet të përgatiten më seriozisht, se kur janë të përgatitur për vete janë përgatitur edhe për popullin.

Kur folëm për normat, për ruajtjen e pasurisë kolektive theksuam që puna nuk duhet të ecë me ritmet dhe format e tanishme. Sekretarët e parë dhe ata që merren me sektorin e industrisë të mendojnë si duhet ta shtrojnë këtë problem dhe jo vetëm një herë. Në mbledhjen e Byrosë Politike u tha që kjo çështje të bëhet objekt diskutimi dhe në çdo fabrikë, në çdo komitet partie dhe byro të jetë në qendër të vëmendjes, në mënyrë që të pandërgjegjshmit ta kuptojnë, që, kur hyjnë në fabrikë, të respektojnë rregullat e saj, të mobilizohen për realizimin e normave, për shfrytëzimin racional të lëndës së parë, të jenë të disiplinuar dhe të mos dalin jashtë pa leje në kohën e punës etj. Megjithatë ta kemi të qartë se të tilla të meta nuk ndreqen menjëherë, po duhet punuar vazhdimisht në këtë drejtim.

Në kemi rezultate në lidhje me punën edukative me njerëzit, po kemi edhe të meta që u theksuan më lart. Atëherë çekani i Partisë duhet të godasë të metat që konstatohen. Në këtë drejtim duhet bërë një plan pune më i gjerë, më i studiuar dhe të luftohet që ai të vihet në zbatim. Çdo gjë të lidhet me detyrat e planit, jashtë tyre një punë e tillë do të ishte pa efekt.

Puna e Partisë duhet të shoqërohet edhe nga shtypi. Partia tani shtron me forcë problemin e ekonomizimit të bukës. Kjo është një detyrë e madhe, prandaj gazeta «Zëri i popullit» duhet ta ndjekë jetën e Partisë, t'ua japë si duhet lexuesve direktivat e Komitetit Qendror e të ndihmojë me artikujt e saj komitetet e Partisë, komitetet ekzekutive, drejtuesit e fabrikave, sekretarët e organizatave-bazë apo kryetarët e kooperativave

bujqësore, t'u sigurojë atyre material për t'i ndihmuar në punën e përditshme. Të gjithë këta që përmenda duhet të mësohen t'i lexojnë dhe t'i shfrytëzojnë mirë për punën e tyre kryeartikujt e gazetave dhe të jenë të përgatitur në çdo kohë. Nuk është e thënë që sekretarët e komiteteve të Partisë dhe shokët e kryesisë së komiteteve ekzekutive t'i dinë të gjitha gjërat. Në artikujt e «Zërit të popullit» pasqyrohet eksperiencia e madhe e Partisë dhe zërthehen direktivat e KQ të Partisë. Artikujt të tillë do të lexohen, me siguri, me interesim të madh. Kjo duhet bërë se suksese kemi, kuadro kemi, vetëm duhet organizim, t'i futemi pra edhe kësaj pune, të lodhemi pak më shumë, që planin ta realizojmë, me një punë më të thellë politike dhe edukative.

*Pasi foli për disa probleme të situatës ndërkombëtare dhe të luftës së PPSH kundër revizionizmit modern, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Autoriteti i Partisë sonë është rritur shumë dhe kjo na gëzon të gjithëve. Por në këto kushte edhe përgjegjësia e saj është rritur, prandaj çdo fjalë që duhet të themi ne, duhet ta masim mirë për të ndihmuar të gjitha partitë marksiste-leniniste që janë krijuar e do të krijohen më vonë. Për këtë qëllim Byroja Politike ka vendosur, dhe këtë mund ta themi këtu në Plenum, se në vendin tonë do të ngrihet një stacion radioje ndër më të fuqishmit në Evropë nëpërmjet të cilit fjala e Partisë sonë do të dëgjohet në skajet më të largëta të botës. Do të ndërtojmë gjithashtu një shtypshkronjë më të madhe nga kjo që kemi, për arsye se miqtë dhe shokët tanë duan të lexojnë shkrimet e Par-

tisë sonë, duan që ato të propagandohen nga të katër anët, duan të mësojnë nga botimet tona. Ata dëshirojnë të vijnë e të shohin ç'bëhet në vendin tonë, të kalojnë në kurse. Pikërisht për këtë qëllim ne po hapim kurse teorike për ata që duan të kalojnë në to. Kështu pra përgjegjësia jonë në këto momente është e madhe. Këtë autoritet të madh që ka fituar Partia jonë ta ruajmë, ta zhvillojmë, kjo na detyron të jemi shumë të matur dhe si kurdoherë t'u japim ndihmën tonë të tjerëve dhe ndihma jonë më e madhe për lëvizjen komuniste ndërkombëtare është ndihma marksiste-leniniste.

Forma të ndryshme po merr krijimi i partive të vendeve të veçanta, sipas situatës së çdo vendi.

Në Peru, partia, duke filluar që nga sekretari i parë, u pastrua nga revizionistët e tani është në pozita marksiste-leniniste. Kjo parti mori një sërë rezolutash. Në rezolutën e parë mbron Stalinin si dhe Partinë e Punës të Shqipërisë.

Në Brazil partia po forcohet dhe fiton influencë çdo ditë.

Ne e marrim me mend se këto parti jo vetëm do të forcohen, po do të bëjnë që të dobësohen partitë revizioniste që ekzistojnë krahas tyre, nga të cilat po shkëputen vazhdimisht forca të shëndosha. Duhet të ndahemi duke u shkëputur nga elementët tradhtarë që të bashkohemi me forcat e shëndosha dhe të krijohen e të forcohen parti të reja marksiste-leniniste. Në Amerikën Latine perspektivat revolucionare janë të mëdha.

Në ç'gjendje është Kuba? Ajo është në gjendje mjaft të vështirë të krijuar nga imperialistët amerikanë.



Ne duhet ta mbrojmë Kubën, por, sipas mendimit tonë, Kastroja nuk qëndron në pozita të drejta, përsëri ai u tregua solidar me Hrushovin. Faktet kanë treguar se ai është një demokrat revolucionar po jo marksist-leninist, siç e quan veten. Ai luftoi për lirinë e Kubës nga zgjedha e Batistës dhe e imperialistëve amerikanë, prandaj prej tij nuk mund të kërkohet më shumë nga sa është. Megjithatë në Kubë po zhvillohen disa ngjarje pozitive, siç është qëndrimi antiimperialist, antiamerikan. Nga sa dimë ne, udhëheqja është plotësisht dakord në një gjë, në mbrojtjen e lirisë së atdheut nga kërcënimi imperialist amerikan, kurse për çështjet e tjera nuk dimë si është. Gjithashtu, nga sa duket, element më revolucionar është Guevara. Për partinë dhe vendin tonë atje flasin me simpati, tregohet një interesim edhe më i madh se përpara.

Tani shokë të tjerë revolucionarë në botë na kërkojnë materiale, duan të dinë si është zhvilluar lufta jonë në disa nga ato drejtime që janë pak a shumë të njëllojta me Kubën. Ne do t'u japim të tilla materiale dhe do t'i ndihmojmë që të sqarohen në këto situata.

Shokët komunistë anglezë kanë filluar të organizohen rreth gazetës së tyre. Së shpejti edhe shokët marksistë-leninistë të Francës dhe të Italisë do të nxjerrin organin e tyre, kurse zviceranët e kanë nxjerrë dhe vazhdojnë ta forcojnë shtypin, kështu bëjnë edhe austriakët.

Në Cejlon u krijua partia e re marksiste-leniniste, e cila bëri kongresin dhe zgjodhi Komitetin Qendror. Ne kemi besim se partia që u krijua atje do të fitojë përkrahjen e klasës punëtore.

dhe. Franca ka kontradikta të mëdha me SHBA-në. Përçarja midis tyre vazhdon të thellohet. Dihet se në Francë sundon borgjezia kapitaliste, e cila ka zgjedhur në krye Dë Golin, përfaqësuesin e vet. Tani ka ardhur puna deri atje sa kapitalizmi francez e ka marrë veten dhe është forcuar në atë shkallë politike dhe ekonomike sa i bën ballë imperializmit amerikan dhe do që në Evropë dhe në botë, po sidomos në Evropë, Azi dhe Afrikë të dominojnë politika dhe madhështia e Francës. Po i intereson vallë lëvizjes nacionalçlirimtare, çështjes së paqes, luftës kundër luftës, kjo përçarje e madhe që po ndodh në kampin imperialist? Po, i intereson, ajo është në favorin tonë, sepse dobëson aleancën e NATO-s e cila në fakt tani është dobësuar. Franca nuk merr pjesë në NATO, ajo ka hequr bombarduesit andej, ka hequr pjesë të flotës së saj etj., në NATO ajo ka vetëm disa unitete dhe komanda që nuk kanë ndonjë peshë. Nga ana ekonomike Franca kërkon të sigurojë drejtimin në Evropë, prandaj i dha dudat Anglisë që nuk i bindet politikës ekonomike të saj.

Si konkluzion, lufta nacionalçlirimtare po merr hov të madh. Me këtë vërtetohet vija e drejtë e Partisë sonë dhe e partive të tjera që qëndrojnë në pozita marksiste-leniniste, kurse revizionistët po pësojnë disfata njëra pas tjetrës. Kampi imperialist vazhdimisht po dobësohet, në radhë të parë demaskohet imperializmi amerikan si xhandar ndërkombëtar. Në kampin imperialist përçarja e filluar do të zmadhohet edhe më tepër, kontradiktat e imperialistëve do të shtohen dhe nuk është çudi të vërtetohet parashikimi i Stalinit që në qoftë se bëhet ndonjë luftë tjetër botërore mund të ndodhë që

imperialistët t'i shpallin luftë njëri-tjetrit. Stalini nuk e ka thënë kot këtë, po në bazë të eksperiencës dhe të teorisë marksiste. Është fakt që kampi i imperialistëve është duke pësuar një dobësim të madh, kudo zien dhe gjendja shkon në dëm të imperializmit, në radhë të parë të imperializmit amerikan. Kjo vërteton vijën e drejtë politike të Partisë sonë dhe të të gjitha partive marksiste-leniniste.

Ne shohim gjithashtu edhe dobësimin e demaskimin e revizionistëve modernë, krijimin dhe forcimin e partive të reja, konstatojmë tronditje të mëdha ekonomike, politike e ideologjike në vendet ku sundojnë revizionistët, të cilët, në mos sot, nesër do të çojnë pajtjetër në ngjarje të rëndësishme në favor të marksizëm-leninizmit dhe të revolucionit botëror, në dëm të revizionistëve.

Çështja e drejtë e marksizëm-leninizmit, çështja e Partisë sonë ecën përpara. Koniunkturat janë shumë të favorshme për lëvizjen komuniste ndërkombëtare, për marksizëm-leninizmin. Prandaj në këto situata ne punojmë më me zell, me hov më të madh se shohim që rruga e Partisë sonë në të gjitha drejtimet ka qenë dhe është e drejtë dhe nuk ka si të jetë ndryshe. Edhe në çështjet ekonomike, në arsim e kulturë, në drejtim të lidhjeve miqësore me partitë e tjera marksiste-leniniste vija e Partisë sonë ka qenë dhe është e drejtë.

Për ne ka rëndësi të madhe ta ruajmë dhe ta forcojmë këtë vijë, ta pasurojmë atë me luftë të përditshme në të gjitha drejtimet, në radhë të parë në realizimin e planeve tona ekonomike. Të jetojmë mirë me situatat, të kuptojmë thellë vështirësitë dhe detyrat që

rrjedhin prej tyre. Dinamizmi dhe pjekuria e Partisë sonë na ndihmojnë që në të gjitha drejtimet të kemi parasysh kyçet kryesore, që planet tona të realizohen me sukses.

I urojmë Partisë suksese në punë! Të vëmë të gjitha forcat për të realizuar planet tona për interesin e popullit dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

*Botohet për herë të parë, me  
shkurtime, sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

# PARAGJYKIMET FETARE JANË SI SËMUNDJET NGJITËSE — KUNDËR TYRE DUHET LUFTUAR VAZHDIMISHT

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

14 shkurt 1964

Lufta kundër paragjyqimeve fetare është një problem i rëndësishëm dhe na preokupon, por megjithatë, në krahasim me vendet e tjera, mund të themi se feja te ne nuk është sinjifikative, nuk ka atë forcë të madhe ekonomike dhe propagandistike si në vende të tjera. Të mos flasim për veprimtarinë dhe shtypin fetar në Itali, por, po të shikojmë vetëm një katalog të përmuajshëm francez, në të cilin bëhet recension i librave, do të konstatojmë se në Francë, ku traditat antiklerikale dhe laike janë më të mëdha se në Itali, botohen çdo muaj 30-40 libra fetarë.

Sidoqoftë, edhe në vendin tonë çështja e luftës kun-

---

<sup>1</sup> Ky diskutim u zhvillua rreth raportit mbi luftën kundër paragjyqimeve fetare dhe propagandën ateiste-shkencore në rrethet Korçë e Shkodër.

dër fesë duhet të na preokupojë. Feja i ka hedhur rrënjët gjatë shumë shekujve, ajo ka ditur ta kombinojë punën e saj ideologjike, ka gjetur momentet më të rëndësishme të jetës së njeriut dhe, me anën e shpirtit, me anë të ndjenjave të njerëzve është orvatur të dominojë në epoka të ndryshme, natyrisht në mënyrë relative, se kjo ka ardhur duke u dobësuar. Feja ka vepruar në të gjithë jetën e njeriut, që nga lindja deri te vdekja. Ajo ka ditur të organizojë rrjetin e vet dhe të krijojë një traditë të thellë, duke u përpjekur të shpjegojë çdo gjë në mënyrë idealiste. Për këtë qëllim ka krijuar mitet, figurat dhe liturgjinë e saj, me të cilat ka pleksur jetën e njeriut. Ky është një sistem i tërë.

Në vendin tonë, si në të kaluarën edhe sot, sistemi i fesë, megjithëse i organizuar, nuk ka gjetur zbatim të plotë për shumë arsye që dihen. Prandaj, duke parë situatën si bëhet propaganda fetare, ne kemi shumë avantazhe për të zhvilluar luftën tonë ideologjike dhe shkencore. Po më parë duhet të dimë se ku konsistojnë paragjykimet fetare dhe cilat janë rreziqet e tyre.

Unë mendoj se rreziku kryesor, të cilin nuk duhet ta lejojmë, është, në radhë të parë, çështja e liturgjisë<sup>1</sup>. Në këtë çështje ne kemi një avantazh të dorës së parë. Te myslimanët kjo pothuaj nuk ekziston ose ka karakter fare të thjeshtë, ajo bëhet në gjuhën arabe që nuk e kupton njeri. Mendoj se feja myslimane në përgjithësi ka mbetur vetëm në simbole. Këto simbole duhet të përpiqemi të mos frekuentohen ose të frekuentohen sa më pak. Këtu ne kemi një terren shumë të favorshëm, na mbetet vetëm detyra që, kur rrëzohet

---

1 Tërësia e ceremonive dhe e lutjeve fetare.

ndonjë xhami, të bëjmë çmos që të mos ndërtohet më. Edhe ndërtimi i ndonjë institucioni fetar nuk mund të bëhet pa lejen e komitetit ekzekutiv, domethënë ve-prohet njëlloj si për ndërtimin e shtëpive dhe të çdo institucioni kulturor. Prandaj, në qoftë se në një fshat duan të ndërtojnë një institucion fetar, duhet të jetë e qartë që të marrin leje jo nga këshilli popullor i fshatit, por nga komiteti ekzekutiv i rrethit.

Liturgjia ortodokse është më e avancuar nga ajo myslimane, sepse përkthimi i ungjillit është bërë që në kohën e Fan Nolit etj., pastaj janë shkruar komentare pak a shumë fetarë, që tani nuk gjenden, po ungjilli i përkthyer ekziston. Pastaj ritet fetare, paraqitja në kishë etj., bashkë me disa gjëra të tjera janë më të komplikuar nga liturgjia e myslimanëve. Atëherë ç'duhet bërë?

Po të flasim për liturgjinë ortodokse, duhet të themi që të bëhen përpjekje për mosfrekuentimin e kishës, domethënë të bëhen përpjekje që gënjeshttrat e ndërtuara me një mijë forma, që nga kamillafet<sup>1</sup>, nga stolitë prej argjendi, thimjami etj., të demaskohen dhe të bëhen të neveritshme për njerëzit, të cilët të mos venë në kishë, por të largohen prej saj. Kjo ka rëndësi të madhe. Detyra jonë është që kur bie kambana, të kemi arritur që njerëzit të mos venë në kishë në asnjë mënyrë dhe, atje ku ka mundësi, të prishen këto institucione, natyrisht jo me fushata, por sipas rasteve. Disa kisha dhe xhami janë përdorur edhe për nevoja të tjera, por Shqipëria nuk ka pësuar

---

<sup>1</sup> Kamillaf quhet mbulesa e kokës së priftit dhe e murgut ortodoks.

gjë, as kundërrevolucion nuk është bërë. Megjithatë të bëjmë kujdes, sepse kemi të bëjmë me ndërgegjen e njerëzve. Ne ua kemi marrë pasurinë institucioneve fetare, po ato akoma kanë, natyrisht pa ndonjë vlerë të madhe ekonomike. Në qoftë se kisha këto pasuri do t'i përdorte si mjet korrumpimi për zhvillimin e fesë, kjo do të bëhej e rrezikshme nga ana ideologjike, po ajo tani ka ardhur në një shkallë të tillë sa që edhe bojë nuk i jep dot faltore, dhe paret i fut prifti në xhepin e tij. Jo vetëm këto, po ai mbledh të holla edhe nga besimtarët. Pra, nga ana ekonomike kisha nuk ka mundësi të bëjë asnjë punë.

Priftërinjtë kanë kulturë fetare më shumë nga hoxhallarët. Në këtë drejtim ata i ka ndihmuar përkthimi i ungjillit. Po kjo është një kulturë shumë e cekët, që konsiston vetëm në disa rite dhe në ato që prifti lexon në ungjill. Këtë ai e ka bërë mjet shfrytëzimi. Ndërsa hoxha di vetëm një bejt me të cilin gënjen edhe ai diçka, prifti ka edhe bejtin, edhe ritet, liturgjinë. Është e drejtë që nga ana administrative të bëhen të gjitha përpjekjet, me qëllim që fesë ortodokse të mos i jepet asnjë ndihmë materiale për zhvillimin e ideologjisë së saj. Në mënyra të ndryshme të ndalohej shtypja e librave fetarë, të ndalohej rënia e kampanave orë e pa orë, të mos hapen shkolla fetare etj. Kështu do të vijë një kohë që kisha të falimentojë fare.

Feja katolike është më e rrezikshme, traditat i ka më të thella, ka ndërtesa monumentale, si katedralet, ka njerëz me shkollë, po të tjerët që do të vijnë pas tyre do të jenë me kulturë më të ulët, domethënë procesi do të ndjekë rrugën e priftërinjve ortodoksë.



Ky proces, natyrisht, do njëfarë kohe. Por për katolikët flet edhe radio Vatikani, radio Roma etj., kurse radio Stambollin ose radio Algjerin nuk e dëgjon njeri, po edhe sikur këto të dëgjohej, asnjëri nuk i kupton.

Krahas njerëzve që janë me të vërtetë fetarë, ka edhe gjysmëfetarë, që janë më pak të rrezikshëm. Këta janë praktikantë, nuk janë fetarë, vetëm se tek ata zotëron forca e zakonisht. Me këta duhet ta organizojmë mirë punën e Partisë që të binden për kotësinë e besimeve fetare në lindje, sëmundje, martesë dhe vdekje etj. Feja ka organizuar për këto raste gëzimi e hidhërimi një sërë ritesh dhe botëkuptimesh të saj. Për shembull, kur lind fëmija thonë: «Shyqyr që na lindi djalë»! Nga pikëpamja e ideologjisë sonë kjo nuk është e drejtë, megjithatë nuk përbën ndonjë rrezik. Po si lind fëmija etj., feja nuk e shpjegon dot, ajo e vesh lindjen me një vello hyjnore. Tek ata që sundon forca e zakonisht, çështja është ndryshe. Unë njoh pleq që më parë agjëronin, po vitet e fundit, për shembull, nuk agjërojnë më. Edhe sot ka prej tyre që nuk dinë se kur është ramazani ose bajrami, megjithëkëtë te zoti besojnë. Te disa pleq janë zhdukur këto zakone, po nuk mund të themi se nuk ekzistojnë fare. Bile ka zakone që në momente të caktuara dalin përsëri. Prandaj duhen luftuar. Po si t'i luftojmë?

Ilaçi kundër zakoneve prapanike e besimeve fetare nuk janë vetëm broshurat ateiste, sepse këto broshura nuk kalojnë të gjitha në popull, po në masat e popullit kalon jeta e re socialiste, me gjithë shfaqjet e saj. Për shembull, më parë pagëzonin kalamanët e tyre të gjithë ortodoksët dhe katolikët, kurse tani vetëm disa

e bëjnë një gjë të tillë. Përse ndodh kjo? Sepse tani praktikohen zakone të tjera, që janë të kundërta me ato të fesë. Njerëzit që zbatojnë zakone të reja nuk i kanë dëgjuar të gjitha leksionet tona, po secili thotë: përse të vete në kishë, për të pagëzuar djalin duke e futur prifti në kazan me ujë të ftohtë dhe të më sëmuret? Po kështu edhe bajramin, të cilin nuk e besojnë shumë njerëz, këtë e tregojnë edhe fakti që ditën e bajramit venë pak njerëz në xhami. Ne duhet të luftojmë që në xhami të mos venë fare, po ka mbetur si traditë që, kur është bajram, ky të festohet në shtëpi dhe, sipas zakonisht, të bëhet njëfarë darke. Po si mund ta zhdukim këtë zakon? Edhe kjo, mendoj unë, mund të zhduket duke forcuar punën e Partisë, duke ngritur gjendjen ekonomike, duke aktivizuar njerëzit më të përparuar. Në qoftë se dikush feston ditëlindjen e fëmijës, festën e Republikës, 1 Majin, 28-29 Nëntorit, apo atë të Vitit të Ri, vjen vetvetiu që ai nuk do t'i kujtojë më festat fetare. Kështu, gradualisht, festat fetare do të braktisen. Njeriu i krijon vetë zakonet, dhe te ne janë krijuar tani plot zakone të reja, të cilat zëvendësojnë zakonet e vjetra. Edhe në këtë mënyrë luftohen mbeturinat fetare.

Lufta më e madhe e më frytdhënëse për zhdukjen e paragjykimëve fetare është puna, jeta, veprimtaria e përditshme, jo duke përgatitur vetëm leksione. Ka shumë njerëz që dalngadalë e kuptojnë edhe dëmin ekonomik që sjellin disa zakone të vjetra dhe besime fetare. Për forcë të zakonisht ka edhe ndonjë patriot që ther fshehtëzi dashin, duke e bërë «kurban» për bajram, megjithëse ai nuk beson te teqeja. Duhet të pu-

nohet që ai të mos shkojë as në teqe, as të therë fshehtazi dashin në shtëpinë e vet, prandaj t'i shtrohet çështja nga ana ekonomike, një herë, dy, dhe atëherë plaku dalngadalë nuk do ta praktikojë këtë zakon. Është më mirë kështu sesa t'i bëhet plakut një leksion kundër Muhametit. Edhe leksione të bëhen, të përmirësohen, bile po të kemi mundësi, këto edhe t'i shtypim, me qëllim që jo vetëm t'i dëgjojnë ata që venë në mbledhje, po t'i kenë njerëzit e t'i lexojnë edhe në shtëpi, pra të bëhen broshura popullore, antifetare.

Filmat që kemi parë dhe shohim herë pas here mbi formimin e tokës, mbi qëniet e gjalla etj., janë një gjë e mirë, prandaj të blejmë filma të tillë, mundet edhe me metrazh të shkurtër, sepse mendoj se kështu do të zëvendësohen shumë nga konferencat që bëhen te ne, sado të mira që të jenë këto.

Të kemi parasysh që jo çdo gjë ta fusim në këtë term kaq të rëndë «propagandë ateiste-shkencore». Ka shumë çështje që duhen shtruar nga ne në rrugë të zakonshme, të lidhura me anën ekonomike. Në qoftë se i zhdukim këto zakone, që janë bërë traditë shekullore, atëherë ky do të jetë një sukses i madh. Prandaj luftën kundër zakoneve prapanike ne do ta zhvillojmë në jetë. Kjo nuk mund të kufizohet vetëm në një broshurë, sepse me luftën kundër zakoneve prapanike dhe besimeve fetare nuk duhet të merren vetëm sektorët e propagandës së Partisë, por me këtë duhet të merren edhe shkrimtarët, poetët etj. dhe kjo të trajtohet në libra, romane, drama e komedi. Këto çështje nuk duhet t'i trajtojmë në mënyrë skematike, po propagandën antifetare ta zhvillojmë përditë, duke e shtruar

ar realisht, konkretisht, në mënyrë të gjithanshme, duke përdorur edhe shkrimet, të cilat, kur t'i lexojë fshatari, të jenë të kuptueshme për të. Kjo do të ishte një punë e rëndësishme, që do të pengonte zhvillimin e liturgjisë, do të influenconte në degradimin e institucioneve fetare. Kur në Shkodër, për shembull, ne kemi organizatën e Partisë, pushtetin, institucionet arsimore e kulturore, teatrin, radion etj., e një gjendje të shëndoshë moralo-politike në popull, përse t'i lëmë të livadhisin njerëz të tillë si Ernest Çoba<sup>1</sup>? Po të organizohet mirë puna, shumica e njerëzve do të largohet vetë nga kisha dhe më në fund do të venë atje vetëm disa pleq. Kështu ndodh sot në qytete, kjo perspektivë është edhe për fshatin.

Në luftë bëjmë të gjitha përpjekjet të zbulojmë efektivet e armikut, të njohim sa janë forcat e tij që duhet të përballojmë. Kështu bën edhe mjeku me një të sëmurë: ky lufton të bëjë diagnozën, përpiqet të njohë ç'sëmundje ka dhe atëherë di si të luftojë, përgatit kurat dhe merr masat për të zhdukur sëmundjen dhe komplikacionet eventuale të saj. Edhe mbeturinat dhe paragjykimet fetare janë si sëmundjet ngjitëse. Prandaj, ju, shokët e Shkodrës, për shembull, të keni një pasqyrë të qartë mbi këto sëmundje që ekzistojnë, të dini se ku janë më shumë e ku më pak, në cilat shtresa të popullsisë dhe çfarë ilaçi duhet të përdorni kundër tyre.

---

1 Prift katolik. Prova të shumta treguan se ai ishte armik. Në vitin 1977 gjykata popullore e Shkodrës e dënoi për tradhti ndaj atdheut dhe agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor.

Ka disa gjëra të parëndësishme, të cilat ose lihen mënjanë ose bëhet me to një punë e vogël, por ka edhe gjëra të tjera, për të cilat duhet vepruar në mënyrë të organizuar, të diferencuar, sipas fshatit, krahinës, moshës etj. Një punë të tillë, si kjo që diskutojmë, e bëni ju, shokë të rretheve? Si i ndiqni këto çështje? Duhet që këtë problem ta marrim më shtruar, po nuk dua të them më me ngadalë.

Dihet se bartësit kryesorë të mbeturinave, përveç armiqve, që veprojnë me qëllim, janë njerëzit e moshave të rritura, prandaj propaganda jonë ateiste nuk duhet zhvilluar e njëjlojtë me të tërë njerëzit, por të jetë e diferencuar, sepse tjetër është rinia, tjetër janë moshat e thyera. Me rininë është më e lehtë puna, po edhe me të duhet punuar, kurse me të kaluarit në moshë nevojitet një punë më e madhe, më e gjatë, më me durim, sepse ka më shumë vështirësi. Kështu, le të marrim, për shembull, familjen e një komunisti dhe ta zëmë se të gjithë pjesëtarët e saj agjërojnë. Po të arrihet me punën e Partisë që në këtë familje të agjërojnë vetëm gjyshja, ndërsa nëna, motra, gruaja etj., të heqin dorë nga ky, atëherë mund të themi se kemi arritur një sukses të madh. Pastaj me plakat duhen përdorur edhe disa mënyra pune që të preken nga ana sentimentale, duke e lidhur me shëndetin, ekonominë etj. Djali, për shembull, t'i thotë nënës: na moj nënë këta 500 lekë, dhe na bëj diçka të mirë për të ngrënë, bëma një herë qejfin dhe mos agjëro, mos ki frikë se nuk do të shkosh në xhehenem po s'agjërove. Ka, pra, një sërë metodash që duhen përdorur, po në asnjë mënyrë të mos përdoren metodat administrative.

analizat dhe atë që ke ta thonë në fund. Me anë të analizave ne do të kemi saktësi më të madhe në depistimin e disa sëmundjeve dhe do të bëjmë ekonomizim kohe dhe mjekësh. Nuk është e mjaftueshme që mjeku të të prekë, për shembull, barkun ose të të dëgjojë me vesh, të harxhojë më shumë kohë pa analiza dhe diagnozën të mos e bëjë dot të saktë. Me anë të analizave mjeku do t'i përcaktojë mirë diagnozën të sëmurit, pasi analiza është shumë më e saktë. Kur flas për analizat nuk kam parasysh ato që janë shumë të komplikuar dhe bëhen me mjete ultramoderne, po ka një gamë të madhe analizash, siç janë ato të gjakut etj., që duhen bërë domosdo. Për këtë qëllim mund të sjellim disa mjete shumë të nevojshme jo vetëm për Tiranën, po edhe për rrethet. Kështu do të ecim me perspektivë në drejtim të zhvillimit të laboratorëve në ndihmë të mjekësisë. Po lidhur me këtë, mendoj se është e nevojshme të hapim kurse jo vetëm për infermierë, por edhe për laborantë, pasi ka mjaft kërkesa.

Njëkohësisht është e domosdoshme të bëhet më shumë propagandë shëndetësore për probleme të ndryshme të mjekësisë dhe jo vetëm për disa sëmundje. Të bëhen diskutime të thella, që mjekëve t'u hapen horizonte në praktikë. Në të gjithë propagandën shëndetësore të bëhet më tepër e njohur edhe nevoja e madhe e analizave të sëmundjeve, rëndësia e tyre etj. Kështu, kur të kuptohet në popull se analiza ka 95 për qind siguri, sesa kur mjeku të viziton vetëm me vesh, atëherë ai që është i sëmurë do të kërkojë vetë t'i bëhen analiza. Pastaj edhe mjekët duhet ta kuptojnë nevojën e analizave. Ju, shokë të shëndetësisë, duhet të shikoni

sa analiza janë, në ç'drejtime bëhen etj. Të keni parasysh që kur shkon një njeri në spital për vizitë mjekësore, në radhë të parë t'i bëhen analizat. Po të vepronet kështu, do të jetë mjaft mirë, se me gjithë mjetet e mëdha dhe moderne që disponojmë sot, nuk mund të jemi qind për qind të sigurt në diagnostikimin e sëmundjes, kaq i komplikuar është organizmi i njeriut. Kjo është rruga më e mirë dhe sidomos për mjekët tanë të rinj, që nuk kanë një stazh të gjatë pune dhe që për të bërë diagnozën kanë vetëm veshin. Në qoftë se nëpërmjet dëgjimit e dikton sëmundjen, atëherë mjeku mundet të arrijë në disa konkluzione, po kjo nuk është e mundshme të diktohet kurdoherë, kurse analiza e tregon shumë më mirë. Kjo nuk do të thotë që ai të mos e përdorë edhe veshin, po analiza i tregon më qartë ç'ka i sëmurit. Prandaj këtë gjë ta shohim më gjerë nga ana shkencore.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## **SOCIALIZMI NUK NDËRTOHET PA NJERËZ TË MËSUAR, LUFTARAKË DHE ENERGJIKË**

*Fjala në Konferencën e 8-të të Partisë  
të rrethit të Korçës*

**1 mars 1964**

Të dashur shokë dhe shoqe,

Është e nevojshme që ne, udhëheqësit e Partisë, të takohemi herë pas here me masën e komunistëve, sepse mësojmë shumë nga takime të tilla, sidomos nga këto që bëhen gjatë konferencave të Partisë. Partia i konsideron shumë të vlefshme e frytdhënëse konferencat e Partisë në rrethe, se problemet që shtrohen në to kanë një rëndësi të madhe për gjithë punën e saj, jo vetëm për rrethet ku ato zhvillohen, por për gjithë vendin, sepse ato e çojnë punën përpara, i gjallërojnë dhe i armatosin njerëzit, i mësojnë e i kritikojnë për gabimet që vërtetohen dhe që nuk ka dyshim se vërtetohen e do të vërtetohen në veprimtarinë e tyre.

Me këtë rast, në emrin e të gjithë shokëve të Komitetit Qendror dhe timin, ju përshëndes dhe ju uroj



juve dhe nëpërmjet jush gjithë organizatën e Partisë të rrethit të Korçës për punën e saj të mirë, për rezultatet që ka arritur në të gjitha fushat e ekonomisë, në industri, në bujqësi, në arsim e kulturë, për punën që është bërë në drejtim të forcimit të organizatës së Partisë me një unitet të fortë politik, ideologjik dhe organizativ! Kjo është një çështje shumë e rëndësishme.

Pastërtia e radhëve të Partisë dhe ruajtja e shpirtit luftarak revolucionar në anëtarët e saj, ashtu si keni bërë ju, është jetike për Partinë.

Të gjithë dëgjuam këtu raportin që mbajti sekretari i Komitetit të Partisë, shoku Leka Shkurti, në emër të plenumit të komitetit të Partisë. Për mendimin tim, dhe besoj që edhe ju jeni dakord, ai përshkohej nga një frymë luftarake dhe ishte një raport pune i plotë, që pasqyronte si duhet, me të mirat e të metat, punën e organizatës së Partisë të rrethit të Korçës. Unë besoj gjithashtu se edhe sekretarit të parë të Komitetit të Partisë të Rrethit, shokut Pirro Kondi, që, për arsye sëmundjeje, nuk mori dot pjesë në punimet e kësaj konference, do t'i vijë mirë që konferenca mbaroi me sukses.

Organizata e Partisë e rrethit tuaj ka arritur mjaft rezultate në forcimin e rritjen e saj, në edukimin, mobilizimin dhe udhëheqjen e masave në ndërtimin e socializmit. Këtë e vërtetojnë sukseset që u përmendën këtu: uniteti i çeliktë në Parti, uniteti i popullit me Partinë, sukseset ekonomike që e nxorën rrethin nga njëfarë gjendje e mpirë në radhën e të përparuarve. Në industri u mbyllën të gjitha deficitet 3-vjeçare, në bujqësi u prodhua 20 për qind më tepër panxhar, ndo-

nëse këtu duhet bërë akoma më shumë etj. Vitin 1964 rrethi i Korçës e ka filluar mbarë.

Organizata e Partisë e rrethit tuaj ka ditur të vlerësojë seriozisht dobësitë e vërtetuara në të kaluarën, ka nxjerrë mësim nga kritikrat dhe ka luftuar me sukses vetëkënaqësinë.

Këto suksese janë arritur sepse është forcuar roli udhëheqës i Partisë që nga organizata-bazë, për të gjitha çështjet, sepse kuadrot janë vënë në pozita më luftarake dhe është rritur në ta ndjenja e përgjegjësisë për sektorët që drejtojnë; sepse është luftuar kundër metodave primitive të udhëheqjes, si vështrimi i gjërave në këmbë e në mënyrë burokratike; sepse janë forcuar më tej lidhjet me masat. Por s'duhet kënaqur me kaq. Duhet luftuar kundër të metave që u përmendën si në raport ashtu edhe në diskutime. Si konkluzion, mund të themi se duke u bazuar në raportin dhe në diskutimet e konferencës, bilanci i punës suaj del pozitiv.

Më pëlqyen shumë diskutimet që u bënë këtu. Ato ishin objektive, luftarake, u karakterizuan nga fryma e kritikës dhe e optimizmit. Shokët që diskutuan dhe që përfaqësojnë mendimin e komunistëve të rrethit të Korçës shohin qartë perspektivën. Ata kanë mësuar nga sukseset e të metat e punës së tyre dhe kjo është një bazë e shëndoshë për të ecur me besim përpara. Organizata e Partisë e rrethit tuaj, si kurdoherë, është treguar e gatshme dhe luftarake për kryerjen e detyrave që i janë ngarkuar.

Ju analizuat me hollësi rezultatet e punës. Sikur konferenca të zgjatej edhe ca, akoma më thellë e më gjerë do të rriheshin problemet. Si kudo, edhe konfe-

renca e rrethit tuaj u zhvillua pas një sërë mbledhjesh të tjera përgatitore, si ato të organizatave-bazë të Partisë, të byrosë dhe të plenumit të Komitetit të Partisë, në të cilat është bërë analiza e punës në detaje, pra konferenca është, si të thuash, sinteza e të gjitha këtyre diskutimeve. Megjithëse kishin dhënë emrin për të diskutuar 45-50 shokë dhe e morën fjalën vetëm rreth 30 prej tyre, mendoj se nga ana e diskutantëve u shprehën si duhet mendimet, u bë kritikë dhe autokritikë e punës së Partisë në rrethin e Korçës dhe u përcaktuan objektiva të rinj për të ardhmen.

Si ju, ashtu edhe ne në qendër, jemi të gëzuar që shokët e Partisë të rrethit të Korçës e kuptojnë drejt rëndësinë e madhe që ka në këto momente zbatimi i de-tyrave në lëmin ekonomik dhe po vënë të gjitha forcat për t'i kryer ato plotësisht, dhe në fakt keni realizime. Si ju ashtu edhe ne jemi të gëzuar për sukseset që janë arritur në ndërmarrjet e ndryshme industriale. Në shumicën e tyre plani është realizuar. Kjo është një gjë e mirë. Por nuk përjashtohet që në organizimin e punës të ketë edhe të meta subjektive ose boshllëqe të natyrës objektive. Sidoqoftë është fakt që me përpjekjet tuaja të mëdha shumica e ndërmarrjeve e kanë realizuar planin.

E gjithë Shqipëria pret shumë nga rrethi i Korçës, si rreth bujqësor, që ka qenë dhe është nga më të përparuarit në të gjithë vendin tonë, pavarësisht se nuk e ka marrë flamurin e garave midis rretheve. Sigurisht flamuri është një simbol i lavdishëm, që për ta marrë duhet të kesh siguruar disa të dhëna ekonomike, që juve ju kanë munguar. Kështu në bujqësi disa mosreali-

zime, sidomos në grurë ku keni pasur deficite, kanë ardhur edhe nga dimri i keq, nga kushtet e vështira atmosferike që u krijuan. Por shumë drejt u shtrua në raport edhe në diskutime se nuk ishin vetëm vështirësitë atmosferike që ndikuan në këto mosrealizime, por ka pasur edhe shkaqe subjektive. Një punë edhe më e madhe e më e kujdesshme duhej bërë në drejtim të parashikimit të vështirësive dhe të kapërcimit të tyre. Në qoftë se organizatat-bazë të Partisë në ndërmarrjet bujqësore e në kooperativat bujqësore do të ishin mobilizuar më tepër, një pjesë e deficiteve në prodhimet bujqësore do të ishin evituar. Për këto arsye nuk patët rezultatet që pritëshin nga ju në bujqësi. Edhe në industri, në arsim e kulturë, ashtu sikurse edhe vitet e kaluara, ju keni pasur suksese, por edhe këtu mund të ishte punuar më mirë që këto suksese të ishin edhe më të mëdha.

Sidoqoftë rëndësi të madhe ka qëndrimi që mbajtet ndaj të metave që keni pasur në punën tuaj. Çfarë qëndrimi mbajnë anëtarët e Partisë të rrethit të Korçës përpara realizimit jo të plotë të detyrave? Unë mund të them se qëndrimi juaj ka qenë ai i komunistëve të vërtetë. Ata shikojnë edhe anët e mira me gëzim, po shikojnë drejt edhe të metat e dobësitë, ata janë të mbujtur dhe nuk përkulen para vështirësive. Kjo është një shkollë e madhe për ta që i armatos për të ecur përpara.

Në fjalën time nuk do të them ndonjë gjë të re, po do të bëj disa sugjerime dhe do të ngre disa probleme. Ndonjë gjë tjetër të veçantë nuk kam.

Është kënaqësi e madhe kur shohim që Partia jonë është rritur kudo. Tani ajo ka shumë kuadro e specia-

listë, prandaj duhet të përgatitesh mirë për të dalë përpara tyre. Kjo është një gjë shumë e mirë, është një nga fitoret e mëdha të Partisë sonë. Socializmi nuk ndërtohet pa njerëz të mësuar, luftarakë dhe energjikë. Në këtë rrugë ka ecur dhe ecën Partia jonë. Ajo tashmë ka krijuar një numër të madh kuadros, njerëzish të mësuar që i janë përveshur punës me vrull revolucionar dhe dinë t'i zgjidhin mirë problemet që u ka ngarkuar Partia.

Diskutimet që u bënë në këtë konferencë, si ato të komunistëve të thjeshtë ashtu edhe ato të drejtuesve të Partisë e të pushtetit në rreth, qenë të mira, të dobishme.

Më la përshtypje të mirë diskutimi i drejtorit të fabrikës së birrës. Ai njohu gabimet e tij, po njëkohësisht vuri në dukje edhe disa çështje që nuk duhen neglizhuar jo vetëm nga ndërmarrja, po edhe nga qendra. Rregullat janë të mira dhe duhet t'i zbatojmë, po edhe qendra duhet më mirë të marrë disa masa, se pa ndërhyrjen e saj është vështirë të zgjidhen disa probleme nga rrethi ose nga dy rrethe së bashku. Në këtë drejtim nuk mungojnë dobësitë. Në qoftë se duam birrë të mirë duhet të luftojmë për cilësinë e saj. Për këtë qëllim duhen marrë disa masa. Që të kesh birrë të cilësisë së mirë duhet të kesh rezervuar që, kur të prodhosh mbi planin, të dish ku ta depozitosh, vetëm kështu plani do të ecë në mënyrë ritmike deri në shpërndarjen në afate të prodhimit. Prandaj vërejtjet e drejtorit duhet t'i keni parasysh edhe ju këtu, edhe ne atje në qendër. Po ka rëndësi çështja që drejtori shprehu besimin se gjatë këtij viti puna në këtë ndërmarrje do

të ecë përpara dhe është fakt se plani i dy muajve të parë të këtij viti u realizua.

Nga parku automobilistik nuk dëgjova të diskutonte ndonjë shok, po kur u përmend në raport kjo ndërmarrje, vura re se miku im i vjetër, drejtori i parkut, shoku Vangjo Dhimitri, e kishte ulur kokën, megjithëse mora vesh që dhe në park plani i dy muajve të parë të këtij viti është realizuar. Kur e takova jashtë, Vangjoja më tha vetë se e vret ndërgjegjja për sa ka ndodhur në ndërmarrjen e tij. Ky është qëndrim bolshevik që siguron se ndërmarrja do të ecë përpara. Transporti është një sektor me rëndësi të madhe, ai është si gjaku që kalon nëpër trupin e njeriut nëpërmjet dejeve, veçanërisht për vendin tonë ku transporti automobilistik është kryesori. Ju e dini se të gjitha mjetet e transportit i importojmë, prandaj kemi mjaft vështirësi për sigurimin e tyre. Kjo kërkon që këtyre vështirësive të mos u shtojmë të tjera që rrjedhin nga mungesa e disiplinës, nga mosmbajtja mirë e mjeteve, e pjesëve të këmbimit që sjellim nga jashtë, të cilat nuk i sigurojmë me lehtësi. Transporti ka rëndësi në jetën e vendit, se po nuk eci ai mirë, vështirësohet furnizimi i tregut, dëmtohet tregtia e jashtme, na prishen mallrat. Transporti luan një rol me rëndësi në zhvillimin e ekonomisë. Kur bëhen greva nga punëtorët e transportit në vendet kapitaliste paralizohet tërë jeta e vendit, sidomos jeta ekonomike.

Shoferët dhe mekanikët tanë janë dhe duhet të jenë kurdoherë në luftë me vështirësitë, në pararojë të punës. Tani te ne nuk ekzistojnë konceptet e vjetra për punën e shoferëve. Në radhët e tyre sot

kemi njerëz nga më të mirët që realizojnë detyrat dhe bëjnë sakrifica të mëdha në punë. Kur të tjerët, sado punë të rëndë që të bëjnë gjatë ditës, në mbrëmje kthehen e pushojnë pranë familjes, shumica e shoferëve tanë vazhdojnë të punojnë mbi timon dhe të kryejnë shërbime me përgjegjësi të madhe. Prandaj Partia ta kuptojë gjendjen në park, ta ndihmojë këtë dhe të zgjidhë disa probleme për koordinimin e transportimit të mallrave, të ngarkim-shkarkimit etj.

Le të marrim shembull NBSH-në e Maliqit, e cila edhe këtë vit doli me plan të realizuar dhe të tejkaluar. Ka disa vjet me radhë që Ndërmarrja Bujqësore në Maliq del me sukses dhe shquhet nga ndërmarrjet e tjera. Megjithatë shoku Ilo Prifti, Hero i Punës Socialiste, një nga shokët tanë më të mirë, bëri autokritikë në diskutimin e tij, ai nuk është i kënaqur nga rezultatet e arritura. Dhe ka shumë të drejtë, se ka mundësi dhe rezerva të tilla që NBSH-ja e Maliqit ta tejkalojë planin akoma më shumë, sidomos në drithëra. Punëtorët e Maliqit, me organizatën e Partisë në krye, të kenë parasysh investimet e mëdha që ka bërë shteti atje. Tani investimet në shkallë kryesore dhe vendimtare në Maliq kanë mbaruar, prandaj ndërmarrja t'i shfrytëzojë në maksimum mundësitë e krijuara dhe t'u vërë rëndësi të gjitha kulturave, edhe blegtorisë, që nga qumshti e gjer te mishi e shpendët, në mënyrë që ajo të bëhet me të vërtetë një pasqyrë, një shembull udhëheqës për gjithë sektorin e bujqësisë të rrethit të Korçës. Drejtuesit e NBSH-së së Maliqit të kenë parasysh se nuk kanë të bëjnë më me bujq të prapambetur dhe të paditur, prandaj atyre u duhet të punojnë më

shumë me punonjësit që të kryejnë detyrat e ngarkuara. Në krahasim me fushën e Korçës, kulturat bujqësore në Maliq tani janë stabilizuar shumë më mirë, sepse atje ka një forcë të madhe mekanike, një ndihmë më të madhe nga ana e shtetit, se ajo është një ekonomi krejt socialiste dhe ka më shumë kuadro. Për të gjitha këto NBSH-ja e Maliqit duhet të jetë shembull dhe kemi besim se do të ecë në këtë rrugë. Kryesore është se ne kemi besim më shumë te punëtorët dhe te komunistët që punojnë në këtë ndërmarrje, pra te njerëzit.

Në NBSH-në e Maliqit ne kemi punëtorë të tillë, si shoqen Hamide Pashollari, që me shembullin e saj të mirë nxit edhe të tjerët. Ajo foli këtu me aq zjarr e besim për brigadën e saj, si punon dhe si i ndihmon shoqet dhe shokët, si i ruan, si i ushqen dhe si i pastron bagëtitë. Jeta e saj është e lidhur ngushtë me brigadën. Derisa kemi njerëz të tillë me siguri çdo gjë do të na ecë si sahat dhe të tillë njerëz që mendojnë në çdo kohë për atë që u ka besuar Partia ne kemi shumë. Por askujt të mos i shkojë në mendje se vetëm ajo është atje. Shoqja Hamide e kupton vetë se forcën e saj e bën brigada, se puna e përbashkët e brigadave përbën forcën e ndërmarrjes dhe bashkimi i forcës të të gjitha ndërmarrjeve të vendit tonë përbëjnë forcën ekonomike të të gjithë Shqipërisë. Është pra kjo forcë e madhe revolucionare e ndriçuar nga marksizëm-leninizmi që shtyn përpara Shqipërinë dhe na forcon besimin për sukseset e tanishme dhe për të ardhmen.

Dua të them nja dy fjalë për uzinën mekanike. Në fillim ajo u krijua si uzinë mekanike e vogël, e pajisur me disa torno që u morën andej këtej. Por me krijimin



e kësaj uzine është bërë një punë e madhe sepse janë prodhuar mjaft makineri të vogla dhe me kosto të ulët. Partia këtë na këshillon vazhdimisht, të bëjmë përpjekje të mëdha për ekonomizime, sidomos të lëndëve që vijnë nga jashtë, sepse shteti shpenzon shumë për importimin e makinerive e të veglave të këmbimit të profileve të ndryshme. Prandaj po të mos krijojmë mundësi gjithnjë më të mëdha eksporti, në qoftë se nuk bëjmë kujdes për makineritë që importojmë dhe për ekonomizimin e lëndës së parë që vjen nga jashtë, jo vetëm nuk do t'i kapërcejmë dot vështirësitë që na dalin, por përkundrazi ato do të na shtohen.

Njerëzit e Partisë e kanë kuptuar drejt gjendjen dhe luftojnë për ta ekonomizuar lëndën e parë, sidomos atë që importojmë. Në këtë drejtim mirë punon uzina juaj mekanike. Po ne kemi nevojë për uzina të tjera, sepse ekonomisë sonë i shtohen çdo vit objekte të fuqishme industriale, shtohen mjetet mekanike në bujqësi, transport, deri në pajisjen e shkollave etj. Ngritja e uzinave mekanike është një gjë e domosdoshme, por në radhë të parë të forcojmë ato që kemi e pastaj të ngremë edhe të tjera. Gjatë këtij pesëvjeçari ne do të ndërtojmë disa uzina të reja mekanike. Kjo ka rëndësi shumë të madhe. Krahas tyre do të kemi një numër të mjaftueshëm tornosh që pjesërisht do të përdoren në ekonomi, por të mos e braktisim rrugën që kemi ndjekur duke ndërtuar edhe uzina të vogla mekanike. Mendoj se edhe në Korçë duhet të ketë akoma torno që mbahen në ndërmarrje të ndryshme dhe nuk shfrytëzohen mirë. Këto ndërmarrje për mbajtjen e tyre nxjerrin si pretekst që t'i kenë afër për të bërë shpejt ato

vegla e mjete që u duhen, sepse, sipas tyre, po të jenë tornot në një uzinë, prodhimi i atyre sendeve që do t'u nevojiten do të vonohej. Kjo nuk është e vërtetë. Nuk dua të them me këtë që të lëmë pa oficinë riparimesh një kombinat të madh. Sidoqoftë uzinat që kemi ndër-tuar janë aq afër ndërmarrjeve ekonomike sa atyre mund t'u vihet shpejt në ndihmë, riparimi i një vegle do t'u bëhet shpejt dhe nuk do t'u sillet asnjë pengesë. Ne do të vazhdojmë të kërkojmë ku ka makineri që nuk shfrytëzohen dhe t'i fusim në uzinë, se kështu krijojmë një qendër të shëndoshë ku përgatiten kuadro, punohet me seri, ekonomizohet lënda e parë dhe prodhimi del i cilësisë më të mirë. Në këtë drejtim duhet të ecet edhe te ju, se Korça ka nevojë të madhe për makineri, vegla e mjete. Uzina mekanike duhet të bëhet një nga plotësueset e rëndësishme të këtyre nevojave që ka rrethi juaj. Ajo ka punuar dhe po punon për këtë dhe ne i përgëzojmë shokët e kësaj uzine, çështja është që të punohet më tepër.

Rëndësi të madhe ka çështja e marrëdhënieve me popullin për të cilën foli shoqja Vasilika Kallanxhiu, e cila kritikoi Komitetin e Partisë të Rrethit. Kritika e saj ishte me vend, se ne jemi mësuar më shumë të kritikojmë dhe të tjerët të na kritikojnë pak. Kritika që bëjnë shokët e bazës nuk është pa vend.

Në jetë midis nesh duhet të ekzistojnë raporte shokësh dhe jo burokratësh. Ky duhet të jetë parim i përgjithshëm i kuadrove dhe i të gjithë njerëzve në punë e në shoqëri. Ky parim ka të bëjë me njeriun, që, siç e ka quajtur Stalini, është kapitali më i çmuar. Në punë kryesorja është bindja, mobilizimi i ndërgjegj-

shëm për të kryer detyrat, për të zbatuar rregullat, disiplinën e Partisë, ligjet, normat morale etj. Rregullat, disiplina etj., duhen respektuar e zbatuar se dhe ato edukojnë. Secili ka vendin e përgjegjësive të tij. Secili duhet të japë llogari. Të mos ketë liberalizëm, por kërkesë të rreptë llogaric, kritikë parimore, jo për ta dërrmuar tjetrin, por për ta ndihmuar. Rreptësia parimore e të kërkuarit llogari të kombinohet me taktin shoqëror e me ndihmën konkrete. Të vlerësohet kritika e shokut, të respektohet mendimi i tij dhe të merret zotim për ndreqjen e të metave. Ne jemi kundër arrogancës, nervozizmit, mungesës së durimit. Ne jemi për një punë të veçantë e të diferencuar me njerëzit.

Në jetën e përditshme në asnjë mënyrë s'duhet mbajtur qëndrim zyrtar, por krejtësisht shoqëror. Të njohim e të diskutojmë për hallet e njëri-tjetrit, të vëmë e të vijmë te shoqi-shoqi në ditë të mira e të vështira. Komunisti nuk duhet të jetë mizantrop, por i shoqërueshëm. Për probleme shoqërore ose profesionale të interesit të përbashkët të diskutojmë gjithmonë nga pozita krejt të barabarta.

Furnizimi i popullit në Korçë nuk ka shkuar keq, megjithëse viti i kaluar ka pasur vështirësi. Ne e dimë se furnizimi i popullsisë me mish, në krahasim me BS dhe me vendet e ish-demokracisë popullore, ka qenë i mirë. Çështjen e furnizimit të popullit, qoftë me mallra industriale, qoftë me artikuj bujqësorë e blegtoralë, duhet ta konsiderojmë nga problemet më të rëndësishme e të dorës së parë. Është e qartë se duhet të prodhosh pa të japësh. Po nuk mjafton kjo. Mund të prodhosh shumë e të mos dish si ta japësh, mund të pro-

dhosh edhe më pak po ta shpërndash drejt dhe në mënyrë të kulturuar. Me njësitë tregtare populli ka të bëjë herë pas here, kështu ai vë re si sillen punonjësit e tregtisë. Kur një blerës vjen në dyqan shikon edhe mallin si është, por edhe atë që shet se si sillet ndaj tij. Kini parasysh se ju punonjësit e tregtisë në disa momente përfaqësoni vijën e Partisë, të cilën nga një pakujdesi mund ta diskreditoni. Si rrjedhim fillojnë pakënaqësitë, i lihet rast armikut që të hedhë dhe parulla, ose të shfrytëzojë për interesin e tij fjalën «ujët lart buron i kulluar, po turbullohet poshtë». Kjo nuk i përshtatet realitetit tonë, sepse po të turbullohet ujët poshtë, është turbulluar edhe lart. Punët poshtë shkojnë mirë, prandaj edhe lart venë mirë. Udhëheqja është pasqyrë e bazës dhe baza e Partisë është pasqyrë e popullit. Populli dëshiron që Partinë ta ketë të pastër kudo. Ju punonjësit e tregtisë duhet ta konsideroni veten shërbëtorë të popullit, të tregoheni të durueshëm me të. Tregtia ka veçorinë e saj, po i pëlqeu tjetrit malli që ke në dyqan e blen, po nuk i pëlqeu nuk e blen. Shitësi duhet ta tërheqë blerësin dhe të sillet në mënyrë të kulturuar me të. Prandaj të gjithë punonjësit e tregtisë së pari të karakterizohen nga një dashuri e ngrohtë me masat dhe së dyti të karakterizohen nga ndershmëria, se kanë të bëjnë me mjete materiale e vlera financiare. Po të mos jenë ata të ndershëm dëmtohen edhe populli, shteti e Partia. Po ne e dimë se në rrjetin e tregtisë kanë hyrë edhe njerëz jo të ndershëm. Mendoni, shokë, sa dëm mund t'i bëhen ekonomisë sonë nga elementë të tillë të pakontrolluar që kanë hyrë në rrjetin e tregtisë sonë.

shtetërore dhe të kooperativave të konsumit. Për të ruajtur Partinë, shtetin dhe interesat e popullit, organizatat e Partisë në sektorin e tregtisë duhet të jenë luftarake dhe vigjilente.

Në tregti njerëzit edukohen e në përgjithësi bëhen të mirë, punëtorë, të sjellshëm, shërbëtorë të ndër-gjegjshëm të popullit, po në qoftë se Partia nuk punon t'i edukojë me frymën e saj punonjësit e këtij sektori mundet që nga këta të dalin edhe të këqij. Dhe e keqja nuk fillon menjëherë. Marksizëm-leninizmi na mëson se çdo gjë ecën në mënyrë dialektike. Kur një njeri bën keq, atë në fillim e vret ndërgjegjja ditë e natë. Dhe pikërisht në këto momente Partia duhet të kujdeset për ta ndrequr, të mos e lërë të keqen të trashet se bëhet zakon, njeriu futet më thellë dhe atëherë sëmundja bëhet e pashërueshme, personi nuk ndreqet ashtu siç nuk mund të shërojë mjeku një të sëmurë rëndë që ka shumë kohë që lëngon dhe është pa shpresë. Kur sëmundja është në procesin fillestar, ai e ka më lehtë ta shërojë. Po ndërsa mjeku ka dy sy, dy veshë për të zbuluar sëmundjet, Partia ka mijëra sy e veshë. Mjekut, kur i drejtohet një i sëmurë i dhimbset, i lëndohet zemra për të, ashtu edhe Partisë, që ka një zemër shumë të madhe, duhet t'i dhimbset «i sëmuri» e t'i shërbejë atij me të gjitha forcat dhe në kohën e duhur. Në çdo sektor njerëzit mund të preken nga «sëmundje». Po ka disa sektorë që preken më shumë. Aty duhet t'i ketë sytë dhe organizata e Partisë. «Sëmundjet» më të rënda mos i kërkonin nëpër qendrat e mëdha industriale, këtu infektimi e ka më të vështirë sepse e parandalon puna e mirë e intensive, edukative e organizative e

Partisë, klasa punëtore është më e fortë dhe bëhet një luftë klase më e ashpër. Në dyqanet ku ke të bësh me elementë të paformuar si duhet e që nuk janë me origjinë punëtore, po me prejardhje të ndryshme e që preken lehtë nga ndikimet mikroborgjeze, atje këto ndikime janë më të zhvilluara. Pikërisht në të tillë sektorë kërkohet dhe duhet të tregohet kujdes që të vejë mirë puna, që populli të jetë i kënaqur, që këto pasuri që hidhen në treg të trajtohen mirë. Kjo ka një rëndësi të madhe për Partinë.

Më pëlqeu gjithashtu diskutimi i shokut Sterjo Male nga Pusteci. Vëllezërit tanë të Pustecit, që përpara i quanin «shulinë», janë përbuzur nga regjimet antipopullore, ashtu siç përbuzej i gjithë populli ynë, kurse tani është kënaqësi e madhe që ata Partia i bëri të lumtur dhe bashkë me gjithë popullin shqiptar ndërtojnë socializmin me sukses. Ne e kemi ndjekur këtë çështje jo për arsye të propagandës shoviniste që bëjnë revizionistët jugosllavë, apo monarko-fashistët grekë për pakicat kombëtare në Shqipëri. Qëllimi kryesor i Partisë ka qenë që vëllezërit tanë të minoritetit, qoftë grek ose maqedonas, të bashkoheshin si një trup me atdheun tonë socialist. Dhe vëllezërit tanë minoritarë kanë luftuar krah për krah me popullin tonë. Nga rradhët e tyre kanë dalë njerëz të shquar në luftën për çlirim dhe në ndërtimin e socializmit. Tani ne i shohim ata me kënaqësi të ecin me sukses në rrugën e socializmit e të përparimit. Ne gëzohemi veçanërisht që tani vëllezërit tanë të Pustecit kanë arritur një shkallë të tillë përparimi që nuk ndryshon nga ai i krahinave të tjera të Korçës, bile mund të themi që kjo krahinë ka

arritur një mirëqenie më të madhe nga shumë zona malore të Korçës. Dhe duhet theksuar që nga Pusteci të marrin shembull disa prej lokaliteteve të tjera të rrethit tuaj. Kjo mirëqenie në Pustec është arritur në sajë të punës së mirë plot energji dhe organizim, nga dëshira e madhe për përparim që kanë vëllezërit dhe motrat e Pustecit. Në rrugën e Partisë ata kanë gjetur rrugën e tyre shpëtimtare. Ata kanë ditur ta përqafojnë vijën e Partisë, kanë studiuar mundësitë se ç'mund të japë toka e tyre, kulturat më të përshtatshme që japin rendimente të mjaftueshme, kështu në kulturat e ndryshme bujqësore e blegtorale merren rendimente të mira, si në drithë, duhan etj. Dhe ne shohim, si rezultat i kësaj, që në të gjitha këto anë bëhet një jetë më e kulturuar, janë ndërtuar shtëpi të reja, të cilat janë mobiluar më së miri. Njerëzit e kësaj krahine janë bërë punëtorë të mirë në gjuetinë e peshkut, meqenëse jetojnë buzë liqenit. Ata janë të përparuar edhe në kulturë, në fshatrat e tyre kanë krijuar grupe vallesh që mund të themi se konkurrojnë shumë mirë me krahinat e tjera të Korçës. Të gjithë u kënaqëm kur pamë parmbremë motrat dhe vëllezërit e Pustecit që kërcejnin bukur e me shije. Bukur kërcejnë edhe devollitët. Atje ka njerëz që heqin valle me mjeshtëri dhe i kanë shumë të bukura. Njerëzit e këtyre anëve kanë ndjenja muzikore, dinë t'i ruajnë pasuritë e folklorit e t'i zhvillojnë në mënyrë socialiste. Prandaj disa grupe folkloristike këtu në Korçë që mendojnë se janë më të mira, mund të mësojnë nga pustecarët apo devollitët.

Me këtë rast desha të theksoja çështjen që kooperativeve bujqësore malore t'u japim rëndësi të veçantë.

Këtu mundësitë nuk janë si të fushës, po edhe në malësi duhet të luftojmë për të krijuar mundësi për një zhvillim më të shpejtë ekonomik. Dhe kushtet i kemi, vetëm duhet punë e kujdes më i madh. Ka mundësi që, brenda këtij viti, Komiteti Qendror të bëjë një Plenum të veçantë lidhur me masat që duhen marrë për zhvillimin e vrullshëm të kooperativave bujqësore të zonave malore. Me këtë nuk dua të them se ato janë lënë pas dore, vetëm se kujdesi nuk ka qenë aq i madh. Që të përparojë një ekonomi duhet në radhë të parë që toka të punohet mirë me që. Po qetë në këto zona, mungojnë, prandaj duhen siguruar medoemos. Komiteti ekzekutiv i rrethit dhe dikasteri përkatës duhet të mendojnë seriozisht që, brenda një afati të caktuar, kjo detyrë të realizohet kudo, jo vetëm nëpër fusha po edhe në malësi. Të mos kërkojmë kudo mjete të motorizuara. Ne duhet të sigurojmë forca të mjaftueshme tërheqëse me kafshë edhe në fusha po sidomos në malësi. Kështu sigurohen prodhime të bollshme pa të cilat nuk ka përparim. Ja, për shembull, në Gramsh gjendja e qëve nuk ishte e kënaqshme. Ne biseduam para ca muajsh me shokët drejtues të rrethit, se si mund të sigurohej një numër më i madh qesh. Këto ditë pas një artikull nga i cili mësova se në fshatrat e këtij rrethi janë duke u arritur rezultate të kënaqshme në shtimin e qeve. Qetë nuk shtohen shpejt, po çështja është të planëzohet shtimi si dhe blerja e tyre nga oborret kooperativiste. Kjo punë kërkon një organizim të mirë, për këtë qëllim mund të jepet edhe kredi nga shteti që brenda 3-4 vjetëve kjo çështje të zgjidhet plotësisht. Dhe mundësi kemi se gjatë kësaj kohe ne do ta kemi



shtuar edhe mekanikën, do të kemi krijuar mundësitë për rritje bagëtish, për t'i çuar në malësitë tona. Një punë e tillë po bëhet por duhet arritur në shkallë më të gjerë. Pra, t'i vëmë kujdes malësisë jo vetëm për punimin më të mirë të tokave po edhe për zhvillimin e gjithë bujqësisë.

Në radhë të parë të bëjmë përpjekje që në malësi të prodhojmë bukën, pastaj të kërkojmë zhvillimin e blegtorisë. Të mos e lëmë pas dore këtë çështje. T'i vëmë rëndësi malësisë edhe për një gjë tjetër, ajo është prapavija jonë e sigurt për çdo eventualitet. Situatat shkojnë çdo ditë në favor të revolucionit, po kurdoherë duhet të jemi vigjilentë dhe të parashikojmë rrezikun që eventualisht mund të kërcënojë vendin tonë. Duhet të mendojmë që malësitë në rast lufte do të jenë furnizueset kryesore të popullit dhe të ushtrisë sonë me bukë. Komiteti Qendror rekomandon që malësitë të ndihmohen për ta zhvilluar ekonominë në drejtimet kryesore, veçanërisht në drithë dhe blegtori, sigurisht pa lënë mënjanë edhe drejtimet e tjera sidomos frutikulturën. Dhe ne kemi arritur rezultate të mira në këtë drejtim. Kemi tani fshatra në malësitë tona që janë model për prodhimin e drithërave, për blegtorinë dhe për frutikulturën. Atëherë përse të mos bëhen qindra e qindra fshatra të tjera kështu? Kjo varet nga Partia, nga aftësia organizative dhe fryma luftarake e anëtarëve të Partisë në këto fshatra. Prandaj në këtë drejtim duhet punuar shumë.

Më pëlqeu mjaft edhe diskutimi i shokut Fatmir Pavliqoti nga Progri. Ai foli për përmirësimin e jetesës në fshat. Për këtë çështje ne bëmë një Plenum të ve-

çantë në qershorin e vitit të kaluar. Orientimet që u dhanë në këtë Plenum kanë filluar të vihen në jetë. Këto orientime, që kanë të bëjnë me ngritjen e mirëqenies së popullit, organizata-bazë e Partisë e Progrit i ka kuptuar drejt dhe, siç mora vesh, ajo lufton seriozisht për zgjidhjen e detyrave që i dalin. Po nuk ka asnjë dyshim se në të gjitha fshatrat e Korçës që janë të përparuara, në ato të fushës së Devollit në radhë të parë do të vihen në zbatim orientimet e Komitetit Qendror. Jo vetëm në Korçë po edhe në Tiranë janë hapur ekspozita për mobiljet e fshatit. Kjo është një gjë e mirë, po nuk duhet të presim edhe një vit akoma sa të fillojnë të prodhohen mobiljet. Ato duhen prodhuar shpejt, gjë që kërkon nga komitetet ekzekutive dhe komitetet e Partisë një punë shumë më të organizuar. Orientimi i KQ të Partisë është i domosdoshëm, prandaj le të merret me zjarr nga Partia ky problem që ka të bëjë me jetesën e njerëzve, me ruajtjen e shëndetit të tyre.

Në rast se nuk zbatohen të gjitha këto që thotë Partia, nuk e kemi plotësuar si duhet orientimin kryesor të saj, çështjen e punës me njerëzit dhe jetesën e tyre. Mund të jemi të pasur, por, po të mos dimë si t'i përdorim pasuritë tona, do të na dëmtohet shëndeti ynë dhe i fëmijëve dhe si pasojë punët nuk do të na venë mirë. Në qoftë se do të prodhojmë, qoftë edhe më pak, dhe të dimë si t'i përdorim mirë këto prodhime, ne do të kemi zbukuruar më shpejt jetën e njerëzve, të familjeve tona. Kjo varet si e kupton vetë Partia, si ia shpjegon popullit këtë çështje. Këtu ne kemi përparime të mëdha, po nuk duhet të kë-

naqemi me kaq. Pretendimet e popullit tonë nuk janë të shumta, se po të ishte kështu, në kushtet që po shkojmë drejt përparimit duke mos i plotësuar dot të gjitha nevojat, mund të krijoheshin pakënaqësi. Njerëzit e kuptojnë drejt kohën, kërkesat dhe mundësitë prandaj s'ka pakënaqësi. Pakënaqësitë që mund të ekzistojnë në disa njerëz nuk janë të bazuara. Sidoqoftë pakënaqësitë që shkaktohen nga mosorganizimi i mirë i punës nuk duhen lejuar. Populli ynë është realist, ai sheh se ka një Parti besnike, që të gjitha përpjekjet i vë në interes të tij dhe ai e kupton se Partia, siç thotë populli, «i shtrin këmbët sa ka jorganin». Njerëzit tanë këtë e kuptojnë fare mirë, prandaj, kur u thotë një gjë Partia, kanë besim të patundur te vija e saj dhe veprojnë si thotë ajo. I tillë është besimi i popullit te Partia. Prandaj duhet t'i zbatojmë gjithmonë e më mirë orientimet e saj.

Qytetet tona janë zbukuruar dhe do t'i zbukurojmë edhe më shumë. Po për ne ka rëndësi të madhe zbukurimi i fshatit, se populli ynë në shumicën e vet banon në fshat. Prej këtij rrjedhin edhe detyra të mëdha, që fshatin ta bëjmë kudo qendër të bukur ekonomike dhe kulturore se vetëm kështu fshatari nuk do të largohet nga fshati. Në qoftë se fshati bëhet i tillë edhe qytetarët do të kenë dëshirë të venë atje për të punuar e për të ndihmuar, për të dhënë kulturë e arsim, bile edhe për të jetuar përgjithmonë. Ne duhet të punojmë shumë për këtë dhe të gjitha mbledhjet e plenumeve tona këtë qëllim ndjekin.

Dua të përmend edhe diskutimin e shoqes Dituri Lalollari, emër i bukur ky, e cila zanatin e ka zgjedhur ashtu siç ka emrin. Është kënaqësi e madhe për po-

pullin tonë që tani ka shkolla në çdo fshat, arsimi po përhapet me hapa të mëdhenj në të gjithë Shqipërinë. Tashmë ne kemi institutet tona që po zgjerohen nga dita në ditë. Në mbledhjen e fundit të Byrosë Politike morëm në shqyrtim disa çështje të punës së universitetit, sidomos në lidhje me zgjerimin e punës shkencore në sektorin e historisë dhe të gjuhës sonë<sup>1</sup>. Vetëm për institutin që biseduam në Byronë Politike u bënë disa kërkesa, të cilat duken modeste, po doli se duhen një numër kuadrosh të lartë, që do të punojnë në disa drejtime të gjuhës dhe të historisë. Po kërkesa të tilla do të na paraqiten nga të gjitha degët e universitetit, se çdo shkencë ka rëndësinë e vet. Është një sukses i madh për Shqipërinë që Partia krijoi një rrjet kaq të gjerë shkollash, institutesh e fakultetesh. Çdo vit universiteti ynë nxjerr rreth 800 kuadro të lartë që çojnë në popull dituri, përparim e dritë.

Ndiej kënaqësi kur shoh se edhe në malësitë tona kanë dalë njerëz të rinj, sidomos vajza, që zënë një vend të rëndësishëm në arsim, shëndetësi, tregti, PTT etj., të mos flasim për bujqësinë ku gratë luftojnë krah për krah me burrat. Ndofta ndonjëri do të thotë se ditët e punës së tyre janë më të pakta se ato të burrave. Po të llogarisim në ditë-punë punën që bëjnë gratë në shtëpi, shërbimin ndaj fëmijëve, përgatitjen e bukës e të gjellës, ato ua kalojnë shumë ditëve të punës së burrave. Po edhe gratë nuk duhet të kënaqen me arsimin që kanë marrë dhe të mos kufizohen të punojnë vetëm në sektorë të tillë si arsimi, shëndetësia, tregtia etj., po të marrin në duart e tyre edhe punët në sekto-

1 Shih në këtë vëllim f. 56.

rin e ndërtimit. Do të jetë shumë i kënaqur shoku Thoma Samara<sup>1</sup> në qoftë se gratë korçare do të shkojnë të punojnë në këtë sektor. Mos kujtoni se Partia dhe pushteti nuk e llogarisin natyrën delikate të gruas dhe disa nevoja të veçanta të saj. Shokët e Partisë dhe të pushtetit nuk e harrojnë këtë. Gruaja nuk duhet të futet në punë që janë jashtë mundësive të saj fizike, po ajo duhet të futet kudo edhe në punë të përshtatshme të ndërtimit. Përpara nënat dhe motrat i kanë lyer shtëpitë, atëherë përse të mos merren ato me suvatim, të lyejnë pallatet që bëhen këtu në Korçë, në të cilat do të jetojnë vetë? Kjo është një mjeshtëri që do dorë, mendje të hollë dhe gruaja i ka këto cilësi, ajo mund të bëhet edhe elektriciste, bojaxheshë, saldatore, muratore etj. Një pjesëmarrje e tillë e gruas kudo, në çdo punë, do të bëjë që të mos na vijnë të na kërkojnë punë nga fshati në Korçë. Prandaj ju, shoqe komuniste, ndihmoheni ndërtimin se Korça po bëhet e bukur, pallatet e ndërtuara e kanë zbukuruar shumë dhe në të ardhmen, me ndërtimet që do të bëhen, edhe më e bukur do të jetë. Dua të them se planifikimi është i tillë që ka dhe do të krijohen mundësi që zbatimi i planimetrisë së re ta kthejë Korçën në një qytet të përparuar socialist.

Dua të flas pak edhe për problemin e kufirit. Kufiri duhet ruajtur dhe ne e ruajmë atë me vigjilencë se kufijtë tanë janë të shenjtë, të paprekshëm dhe mbrohen nga bijtë besnikë të popullit. Kufijtë tanë janë të siguruar në radhë të parë se atje udhëheq dhe punon Partia. Ne mund të lejojmë që në brezin kufitar

---

1 Në atë kohë drejtor i Ndërmarrjes së Ndërtimit të rrethit të Korçës.

kooperativat të çojnë tufa bagëtish për kullotje dhe njëkohësisht të mbrojnë kufirin bashkë me kufitarët. Kështu do të na shtohen njerëzit që do të ruajnë brezin kufitar. Armiku përpiqet kurdoherë të gjejë ndonjë shteg për të hyrë këtej, po nuk do të gjejë kurrë, se shtigjet janë të zëna nga kufitarët tanë trima bashkë me kooperativistët. Kështu kur armiku i jashtëm të shohë një bari me pushkë në krah nuk do të guxojë të futet brenda kufirit. Por në qoftë se Partia mendon të dërgojë njerëz në kufi për të ruajtur bagëtitë e kooperativës nuk do të thotë që të lejohet të venë atje njerëz dosido. Partia është e fortë, e urtë, e matur dhe di kë të dërgojë. Në kufi ne kemi njerëz heroikë, që nga kuadrot e deri tek ushtarët, të tillë duhet të jenë edhe barinj të kooperativistë.

Një diskutant trajtoi këtu çështjen e mbledhjeve të plenumit. Ne duhet të bëjmë edhe plenumë të zgjeruara, po edhe mbledhje vetëm me anëtarët dhe kandidatët e tij. Edhe plenumi i zgjeruar ka interes të veçantë, se aty vijnë edhe shokë të tjerë, të cilët dëgjojnë, edukohen dhe çojnë pastaj fjalën e Partisë në bazë. Po kur plenumi është i zgjeruar, duhet thënë se kritika nuk mund të bëhet në lartësinë e duhur, anëtarët e plenumit, duke parë se mbledhja është shumë e gjerë, sikur rezervohen të flasin hapur. Kur bëhet një mbledhje pune vetëm me anëtarët e tij, çështja është ndryshe. Në plenumet tona ka kritikë dhe autokritikë po mund të krijohen edhe forma që plenumi të bëhet më luftarak. Ai që vjen në plenum dhe bën një diskutim duhet të ketë parasysh se cilido ka mendimin e vet dhe në qoftë se ndonjë gjë është në kundërshtim me mendimin e ndo-

njërit që flet më pas, ky i fundit mund dhe ka të drejtë të ngrihet dhe të thotë aty për aty se nuk jam dakord dhe pastaj thotë mendimin e tij. Kjo është një kritikë direkte që bëhet pa u përgatitur më parë. Në Parti duhet të mos bëhen vetëm diskutime të përgatitura me shkrim qysh më parë dhe tjetri të vijë e të lexojë atë që ka shkruar, të bëjë edhe ndonjë kritikë të përgjithshme dhe kalon. Jo. Kur bëhet një plenum jo i zgjeruar, anëtarit të plenumit duhet t'i dridhen këmbët jo nga frika, por nga shqetësimi. Dhe ai do t'i thotë vetes mos mendo se aty do të kalosh ashtu lehtë-lehtë, të tjerët nuk do të të lënë, do të të kërkojnë llogari se për këtë çështje që ti po diskuton ne kemi vendosur të bëhej kështu apo ashtu, atëherë përse një gjë e tillë nuk është bërë? Pra, cilido të diskutojë e të thotë mendimin e tij edhe për probleme që dalin gjatë mbledhjes.

Në qoftë se ne do të bëjmë vazhdimisht mbledhje të plenumit me shokë që nuk janë anëtarë të këtij forumi, do të vijë puna që nuk do të dallohet ai që është anëtar i plenumit nga ai që nuk është. Kurse kur bëhet një plenum vetëm me anëtarët, të gjithë mbajnë përgjegjësitë që u takojnë, kështu përgjegjësia ndahet. Pastaj, kur vjen çështja që problemi i trajtuar në plenum të punohet në bazë, dërgohen anëtarët e plenumit ta punojnë vendimin dhe mbajnë përgjegjësi për punën që do të bëjnë.

Ne kemi krijuar një frymë luftarake në Partinë tonë, po edhe më mirë duhet punuar. Të bësh plenumë të zgjeruara nuk është diçka jashtë rregullit, përkundrazi është një masë e drejtë. Në këto mbledhje nuk përjashtohet mundësia që të bëhen kritika të zakon-

shme se ata që ftohen në plenumë janë njerëzit tanë, janë nga shokët më të afërt të Partisë, po ka edhe gjëra të brendshme të plenumit që mund të mos thuhën në mbledhje të zgjeruara. Pra duhet në çdo rast të bëhet një punë e gjallë. Ja, me të mbaruar konferenca, shoqja e tregtisë, fjala vjen, mund të shkojë e të bëjë menjëherë mbledhjen e kuadrove të sektorit të saj, t'u flasë në emër të plenumit ç'u bë këtu. Kështu edhe personaliteti i saj rritet dhe ajo e ndien veten që është një drejtuese e punës së Partisë në atë sektor.

Punë të madhe kemi përpara. Kjo konferencë le të shërbejë për të kryer detyrat që na dalin. Por neve anëtarëve të Partisë përgjegjësitë nuk na kanë trembur kurrë. Planin tani e kemi në dorë, prandaj ta fillojmë punën me të gjitha forcat për realizimin e tij. Sa hyra në territorin e rrethit tuaj m'u kënaq zemra nga fusha e Maliqit, një fushë e sistemuar, ku nuk sheh një gardh apo një gur. Dhe e tillë nuk është vetëm kjo fushë ku janë harxhuar miliona lekë, po e gjithë fusha e Korçës ku është derdhur djersa dhe dituria e fshatarësisë. Kjo tregon sa e zhvilluar është bujqësia në rrethin tuaj. Një fushë kaq e mirë dhe me njerëz të përparuar duhet të japë medoemos prodhime të tilla që të tejkalohen planet. Te ju janë të gjitha mundësitë dhe kemi bindjen se planet do të realizohen, pasi fillimi është i mbarë.

Mobilizohuni shokë për garat e 20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut se ato kanë rëndësi të madhe. Gjatë këtyre 20 vjetëve lufte për përparimin e vendit janë bërë përpjekje të mëdha nga Partia dhe populli shqiptar për ndërtimin e socializmit. Flamurin mund të mos e marrësh në një vit të zakonshëm, po në një vit të



tillë jubilar si ky i 1964-ës Partia dhe i gjithë populli i rrethit tuaj duhet të ngrihen në këmbë për të fituar atë. Kur kalova nga Elbasani, shokët atje më thanë se do të bëhen postbllok dhe flamurin nuk do ta lëshojnë. Prandaj, mobilizohuni me të gjitha forcat që ta merrni flamurin dhe ta keni kujtim, që kur të rriten fëmijët tuaj të kënaqen duke parë në muzeun e Korçës flamurin e garave për nder të 20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut që e kanë fituar prindërit ose gjyshërit e tyre.

Për forcimin e mëtejshëm të Partisë ne bëmë Plenumin për çështjet organizative<sup>1</sup>. Raportin e kemi punuar dhe vazhdojmë ta punojmë nëpër organizata, po kjo është një punë e gjatë që ka për qëllim forcimin e Partisë. Kur e kemi Partinë të fortë ecim përpara dhe çdo gjë na shkon mbarë. Të tillë Parti kemi ne. Tani Partia jonë është 23-vjeçare dhe ka një eksperiencë të madhe të sajën si dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Partia jonë është një Parti politike luftarake e pajisur me ideologjinë e shëndoshë të Marksit, Engelsit, Leninit dhe të Stalinit, Parti që mbështetet dhe edukohet me shkencën marksiste-leniniste. T'i ruajmë këto karakteristika të saj dhe t'i zhvillojmë më tej. Njerëzit e Partisë të jenë kurdoherë njerëz politikë. Kjo nuk do të thotë që çdo njeri në Parti të dijë vetëm, për shembull, se në Gabon<sup>2</sup> një toger dhe një kapter morën fuqinë në dorë, por që pas 24 orësh borgjezia monopoliste franceze dërgoi forca dhe e shtypi kryengritjen. Edhe kjo ka rëndësinë e saj të veçantë për të vërtetuar egërsinë e kapitalizmit, që shumë popujve u ka

1 Shih në këtë vëllim f. 1.

2 Shtet në Afrikë.

dhënë një pavarësi formale, por që në të vërtetë në këto vende sundon akoma çizmja e egër e kapitalit dhe forca e tij shtypëse ushtarake. Rëndësi ka që t'u bëhet interpretim i thellë problemeve që trajton gazeta, jo thjesht një lexim. Vetëm duke i trajtuar kështu çështjet do të jesh në gjendje të punosh me njerëzit, që çdo problem që do t'u shtrosh përpara për ta zgjidhur ta kuptojnë politikisht, të kuptojnë esencën, të mirën dhe të keqen e tij. Çdo gjë të shihet me syrin kritik, të gjykojmë në interes të Partisë dhe të popullit.

Ka rëndësi puna politike që bën Partia. Nuk ka punë të Partisë që të mos ndërthuret me gjykimet politike. Komunistët janë të armatosur për të luftuar kundër çdo rreziku. Ne duhet të luftojmë për vijën e drejtë të Partisë, të jemi në ballë, ta kemi të qartë këtë vijë, në mënyrë që njerëzit të orientohen drejt në çdo kohë dhe të gjejnë rrugën e vërtetë. Kjo kërkon që puna politike në Parti të mbahet vazhdimisht në lartësinë e duhur. Ka ardhur koha të ngremë më lart nivelin politik. Jo vetëm të mos përtojmë të lexojmë gazetën, po të reflektojmë mbi çdo gjë që lexojmë në të, të fiksohet jo fakti po qëllimi, se ato që shkruhen janë pika orientuese.

Anëtarët e Partisë duhet të mësojnë kurdoherë nga ideologjia marksiste-leniniste, se pa u mbështetur tek ajo mund të nbyten edhe në një lugë ujë, kurse ata që e kanë marksizëm-leninizmin busull të mendimit dhe të veprimit të tyre, nuk gabojnë. Nuk është e thënë që të gjithë anëtarët e Partisë të bëhen filozofë, por ama çdo anëtar partie i ka të gjitha mundësitë të përvetësojë bazat e marksizëm-leninizmit jo vetëm nëpër-

mjet librave, por edhe nëpërmjet jetës, sepse e gjithë jeta jonë është e ndërtuar në baza marksiste-leniniste. I gjithë ndërtimi i socializmit i ka themelet në parimet kryesore të marksizëm-leninizmit të zbatuara në kushtet konkrete të vendit tonë.

Anëtarët e Partisë e kanë për detyrë që teorinë marksiste-leniniste ta lidhin me jetën. Kush punon mirë në jetë, ai i kupton mirë direktivat e Partisë, ligjet e shtetit dhe e ka më të lehtë ta kuptojë teorinë marksiste-leniniste. Partia na ka mësuar të përvetësojmë vijën marksiste-leniniste në zbatimin praktik të saj dhe kur na paraqitet një problem konkret e zgjidhim drejt. Tani pas kaq vjetësh pune Partia ka bërë që njerëzit e saj të kuptojnë dhe të punojnë në mënyrë marksiste për ndërtimin e socializmit. Momentet janë të tilla që pa përvetësuar teorinë marksiste-leniniste nuk mund të hedhësh asnjë hap përpara. Në qoftë se bëhen, dhe duhet të bëhen, më shumë përpjekje nga shokët e Partisë për ta mësuar atë, qoftë në shkollat e arsimit të përgjithshëm qoftë edhe në shkollat e Partisë ne do të na shumëfishohen forcat. Duke shumëfishuar forcat e mendimit marksist, do të kemi forcuar Partinë, të cilën e kemi bërë çdo vit e më shumë si një shkëmb graniti. Këtë çështje ne duhet ta kemi mirë parasysh dhe të mos neglizhojmë. Shkolla kërkon përpjekje, ajo ka shumë vështirësi. Burra e gra, të rinj e të reja, të gjithë të ne duhet të mësojnë. Edhe pleqtë duhet të bëjnë përpjekje, po përpjekje të mëdha të bëjnë sidomos të rinjtë. Partia jonë është bazuar në shkencën marksiste-leniniste pa të cilën nuk mund të ndërtohet socializmi. Këtë nuk e kemi kuptuar të gjithë. Megji-

thatë te ne ka një zell të madh për të mësuar. Një gjë e tillë duhet përgëzuar, sepse kjo do t'i shërbejë si klasës punëtore ashtu edhe fshatarësisë punonjëse, pra gjithë shoqërisë sonë. Studiojnë te ne mësuesi, mjeku, inxhinieri e kushdo. Kujtdo i janë krijuar të gjitha mundësitë për të zhvilluar dituritë. Kjo është pozitive dhe te ne kjo punë po bëhet në masë. Shkenca është e pafund dhe kërkon njerëz të praktikës. Po edhe njerëzit e praktikës për zhvillimin e aftësive të tyre bazohen në shkencë. Të gjitha mundësitë tani po i krijojmë dhe po i zgjerojmë. Vazhdimisht do të krijohen te ne institute edhe më të mëdha, të pajisura me mjetet më moderne. Prandaj nuk është e drejtë që të gjitha këto të mos ndiqen me kujdes, të mos shfrytëzohen në radhë të parë nga anëtarët e Partisë dhe, në shembullin e tyre, nga të gjitha masat.

Ne duhet t'i lavdërojmë inxhinierët, mjekët, agronomët tanë etj., që po bëjnë mrekullira në të gjitha fushat e diturisë. Kjo ndodh për shkak të vullnetit që u ka zhvilluar kuadrove tanë Partia, për shkak të zgjuarsisë së natyrshme të popullit tonë, të dashurisë që ka ai për dije dhe shkencë si dhe të mundësive të mëdha që u ka krijuar Partia njerëzve te ne. Shkollat tona kanë laboratorë të pasur, që i vënë në shërbim të masivizimit të shkencës, gjë që s'ndodh në vendet kapitaliste, sepse në këto vende shteti nuk interesohet për arsimimin e masave. Kjo nuk do të thotë se sot në këto vende nuk ka laboratorë, po është fakt se shumë prej tyre janë në duart e trusteve, që kanë bashkë me laboratorët edhe universitetet, edhe të gjithë punonjësit shkencorë. Të gjithë këta shkencëtarë punojnë për in-

teresat e Fordit, Melonit, Dyponit etj., për të prodhuar aeroplanë lufte, tanke dhe bomba atomike.

Me një vrull të madh kemi ecur në zhvillimin e shkencës dhe horizonte më të mëdha na hapen përpara. Universiteti ynë bëri një punë të madhe në këtë fushë. Studimet e inxhinierëve tanë janë pëlqyer edhe jashtë. Kohët e fundit ne kemi dërguar jashtë shtetit disa nga inxhinierët tanë për të marrë eksperiencë në ndërtimin e hidrocentraleve. Por është fakt se edhe inxhinierë të vendeve të tjera kanë kërkuar të vijnë në Shqipëri për të marrë eksperiencë nga ndërtimi i hidrocentraleve tona malore. Shkencën, pra, ne duhet ta përvetësojmë dhe ta zbatojmë në praktikë, me një punë revolucionare që hovin e popullit tonë kurdoherë ta mbajmë të ngritur.

Problemet e qëndrimit socialist ndaj punës, disiplina e prodhimit, normat, ruajtja e pasurisë socialiste duhet të jenë në qendër të vëmendjes së organizatave të Partisë. Në raport u tha se ka mijëra orë e ditë-punë të humbura, ka sorollatje, pretekste sëmundjeje etj. Rrjedhimi? Nuk prodhohet sa duhet, kërkojnë punëtorë të tepërt etj. Në Korçë afro 1/4 e punëtorëve punojnë pa norma, kurse 22 për qind e atyre që punojnë me norma nuk i realizojnë këto. Veç këtyre, aty u tha se ka pasur vjedhje, ngordhje të bagëtisë, shpërdorime etj. që bëjnë miliona lekë. Ç'tregojnë këto? Këto tregojnë se ndërgjegjja socialiste në disa njerëz s'është në lartësinë e duhur, pra dhe puna e Partisë çalon. Atëherë ç'duhet bërë? Që të zhduken këto të meta e dobësi duhet të forcohet puna edukative e Partisë me vetë anëtarët e saj dhe me të gjithë punonjësit, duhet

të zbatohen me rigorozitet rregullat, ligjet dhe për ata që i thyejnë këto të merren masat përkatëse. Por para se të arrihet në masa duhet të punohet me njerëzit, të popullarizohen iniciativat për rritjen e normave etj. Krahas punës sistematike të Partisë në këtë drejtim duhet të punojnë më mirë edhe bashkimet profesionale.

Me këto çështje që kanë të bëjnë me qëndrimin e njerëzve ndaj pronës, shtimin dhe ruajtjen e saj, të merren më shumë kuadrot kryesorë në rrethe. T'i shohin problemet në prizmin politik, ideologjik dhe ekonomik, të venë më shpesh në bazë dhe të përgatiten mirë që të lënë atje gjurmë të thella.

Çdo punë ta kryejnë me frymë partie, të vendosim në çdo rast disiplinë në punë, që nga mësimi e deri në jetën tonë personale. Me këtë nuk dua të them që të vendosim një disiplinë prusiane, të pavetëdijshme, po një disiplinë të ndërgjegjshme, marksiste, që për ta zbatuar kërkohet kuptimi i saj politik e ideologjik. Po kujt i shërben një disiplinë e tillë? Sigurisht vetes sonë, shoqërisë sonë, për ta bërë jetën më të bukur, për ta bërë punën më të lehtë, që prodhimet t'i nxjerrim më të mira e më të lira. Të vendosësh një regjim të rregullt ditor është gjë shumë e mirë. Duke fjetur në rregull, me një regjim normal në jetë, edhe në qoftë se do hash një vakt më pak, shëndetin do ta ruash. Në rregull fle ai që nuk ka halle, që punën e bën mirë, që fëmijët i venë mirë në shkollë etj. Disiplina e përmirëson njeriun. Kush kupton dhe zbaton disiplinën e Partisë, ai kupton e zbaton edhe disiplinën shtetërore, se nëpërmjet rregullave e ligjeve reflektohet vija e Partisë, disciplina

shtetërore bazohet në disiplinën dhe ligjet e Partisë. Partia bën të gjitha përpjekjet që disiplina dhe ligjet e saj të kuptohen nga ana politike dhe ideologjike për të mirën e kolektivit dhe të çdo individi. Këtë punë Partia e bën vazhdimisht duke u qëndruar njerëzve kurdoherë afër. Prandaj kush shkel ligjet dhe rregullat ai ka shkelur ligjet e disiplinën e Partisë dhe në raste të tilla hyjnë në veprim ligjet e shtetit. Po edhe zbatimi i ligjeve të shtetit nuk synon t'i ndëshkojë ata që gabojnë, ai është një mjet administrativ që merret në fund, pasi, në rrugë partie, janë bërë të gjitha përpjekjet dhe nuk është arritur asnjë rezultat. Po edhe masat administrative janë një mjet shërimi që përdoren për të ndrequr një njeri kur nuk ka pasur rezultate puna politike e Partisë, zemërgjerësia e saj. Masa administrative është mjeti i fundit që përdor Partia për ta ndihmuar njeriun që të mos shkojë më tej. Prandaj ligjet e Partisë dhe të shtetit kanë një qëllim, ato duhen zbatuar në mënyrë të shkallëzuar dhe kur të jetë konsumuar puna politike edukative atëherë mund të merren masa shtetërore. Ligjet janë të paprekshme, ato janë armë të diktaturës së proletariatit që përfaqësojnë vullnetin e mbrojnë interesat e masave. Ato edukojnë masat dhe duhen zbatuar nga të gjithë, në radhë të parë nga kuadrot. Zbatimi i ligjeve është i lidhur ngushtë me popullarizimin e njohjen e tyre. Ato duhet të zbatohen me drejtësi të madhe, me rreptësi, por gjithmonë duke i gjykuar mirë të gjitha rrethanat e në mënyrë krejt të paanshme.

Në zbatimin e ligjeve rol të madh luan edhe forcimi i bashkëpunimit të organeve të policisë, të drej-

tësisë etj., me masat punonjëse. Partia vazhdimisht duhet të kontrollojë zbatimin e forcimin e ligjshmërisë socialiste. Ta kemi kurdoherë të qartë se forcimi i vigjilencës së komunistëve e të masave është rruga më e mirë për të kontrolluar zbatimin e ligjeve.

Ndërtimi i socializmit është vepër e masave. Dituria dhe eksperiencia e masave janë të pazëvendësueshme. Të inkurajohen, të dëgjohen e të vlerësohen drejt kritikak e punonjësve, vërejtjet, propozimet e sugjerimet e tyre të bëra në mbledhje, në shtyp ose me letra. Duhet të merren masa të rrepta kundër gjithë atyre që mundohen të shtypin kritikën e të shpërdorjnë postin zyrtar apo shoqëror për qëllime personale.

Partia jonë është Parti e klasës punëtore që udhëheq të gjitha masat punonjëse. Këtë s'duhet ta harrojmë kurrë. Po nuk kuptuam këtë nuk kemi kuptuar asgjë. Kjo do të thotë që të lidhemi ngushtë me masat e popullit. Lidhja me masat te ne nuk është një parullë, por një realitet që shprehet në të gjithë jetën e veprimtarinë tonë, që shprehet në format e organizimit të punës së Partisë dhe të shtetit. Kudo ku ka masa, atje është Partia jonë, e cila i forcon gjithnjë e më tepër lidhjet e saj me to. Prandaj këshillat popullorë, asamblëtë e kooperativave, komisionet e fabrikave etj., duhet të gjallërohen, ato duhet të bëhen gjithnjë e më shumë revolucionare. Duhet të ketë një bashkëpunim të ngushtë e të çiltër të komunistëve me masat. Gjatë këtij bashkëpunimi t'i hapin sytë të gjithë, edhe udhëheqësit, edhe masat. Njëpërmjet diskutimeve të gjendet rruga e zgjidhjes së çdo problemi,



të gjendet ku është gabimi që të kritikojmë dhe ku është mirë të mbrojmë.

Të gjitha forumet e zgjedhura duhet të vlerësojnë mirë dhënien e llogarisë para zgjedhësve. Të forcohet gjithashtu kontrolli i organizatave të Partisë në ndërmarrje e kooperativa, të rritet roli i mbledhjeve të prodhimit, i bashkimeve profesionale etj.

Ka disa që nuk e zbatojnë drejt vijën e Partisë. Për këta ne nuk mund të marrim menjëherë masa, përkundrazi duhet të punojmë t'i bindim me durim. Partia është treguar kurdoherë e durueshme me njerëz të tillë. Po ka të tjerë që nuk para e kuptojnë vijën e saj. Me këta është më i lehtë takimi qoftë i përbashkët qoftë edhe një nga një. Ka njerëz që vijën e Partisë e kuptojnë, po ngaqë nuk u plotësohen të gjitha dëshirat hiqen mënjanë. Për njerëz të tillë ne nuk mund të bëjmë ligje të veçanta për t'u plotësuar çdo dëshirë. Nuk mund të ketë ligje të tilla që të plotësojnë dëshirat e veçanta të çdo njeriu. Partia merr vendime të atilla që të jenë në interes të përgjithshëm dhe zbatimi i të cilave do të sjellë përfitime për të gjithë, bile gradualisht do të plotësojë edhe dëshirat e veçanta të çdo njeriu. Prandaj njerëz të tillë duhet t'i mbajmë afër, se do të vijë koha të sqarohen.

Njerëzit e Partisë nuk duhet të jenë burokratë. Burokratizmin ta flakim tej, ata nuk duhet të jenë gjithashtu prepotentë, si për shembull, meqë ndonjëri është zgjedhur sekretar, t'i shohë njerëzit nga lart ose të mendojë se pikëpamjet e tij janë të pagabueshme, aq më shumë nuk na lejohet t'i përcjellim njerëzit pa i sqaruar. Kush vepron kështu nuk i ka të qarta si du-

het mësimet e Partisë. Njerëzit duhet t'i ndihmojmë, t'i përgëzojmë kur punojnë mirë dhe t'i kritikojmë kur punojnë keq. Partia na mëson të jemi të thjeshtë e të dashur me masat, të dëgjojmë zërin e tyre. Kuadrot duhet të sillen korrekt dhe në mënyrë të kulturuar me masat, se ata përfaqësojnë vijën e Partisë dhe populli gjykon për ta jo si persona, por si përfaqësues të saj. Vetëm në këtë mënyrë veprohet në rrugën e Partisë që është rruga e masave. Kush nuk ecën në rrugën e drejtë të Partisë, masat kanë për t'i treguar vendin. Prandaj midis masave e udhëheqësve takimet të jenë shoqërore, vëllazërore. Kjo nuk do të thotë të jemi liberalë, liberalizmi nuk duhet lejuar. Si komunistë duhet të jemi zemërgjerë, kur shohim se një komunist ka bërë një gabim, jo me ndërgjegje, këtij t'i thuhet «shko, je i larë, mjaft që ia the Partisë» etj. Një njeri i tillë dhe në qoftë se nuk ta thotë sot gabimin që ka bërë, do të vijë nesër të ta thotë. Ndryshe është me ata që veprojnë në mënyrë të ndërgjegjshme. Kur tregohesh zemërgjerë e liberal ndaj njerit që vazhdon të gabojë, po mbylle një sy në shenjë miqësie ndaj tij, gabon rëndë. Jo, kjo nuk duhet të lejohet.

Ka sekretarë partie që populli i do shumë, i ka përcjellë me lot kur janë transferuar, sepse ata janë sjellë me të si i ka mësuar Partia. Kjo është një forcë e madhe e Partisë. Sekretarë të tillë mos kujtoni se u kanë bërë qejfin të gjithëve. Atyre që gabonin, ata ia thonin çdo gjë në sy, ku e kishin mirë e ku e kishin keq. Të tillë punëtorë partie ka shumë që punojnë në sektorë të ndryshëm.

Edhe në ushtri organizatën e Partisë e kemi të for-

të se kuadrot e ushtrisë janë nga më të vjetrit, ata kanë luftuar e kanë derdhur gjak, janë njerëz partie, të kulturuar dhe me zemër komunisti. Ata e dinë ç'rëndësi ka ushtria, njohin ndjenjat e ushtarëve, dinë si të sillen me ta. Për këtë arsye ne e kemi ushtrinë të fortë si çeliku e të zonjën, megjithatë komunistët duhet të punojnë kurdoherë për forcimin e saj. Dhe në këtë çështje sjellja me njerëzit ka rëndësi të madhe. Mbi çdo gjë, pra, të forcojmë Partinë, ta kemi monolite, të ketë në të unitet politik, ideologjik e shkencor, unitet mendimi e veprimi, bllok në luftë kundër armiqve të marksizëm-leninizmit, revizionistëve dhe imperia-listëve, për ndërtimin socialist të vendit tonë.

Për çështjen e bukës nuk do të zgjatem se kuptova që në këtë drejtim ju i keni plotësisht të qarta orientimet e Partisë. Çështja është që bukën ta kursejmë. Fshatari ynë është ekonomiqar dhe nuk e harxhon parane pa vend. Kur Partia jep një direktivë të tillë, fshatari e përkrah sepse e kupton që është në interesin e tij dhe të të gjithë vendit. Kjo pastaj e lejon të grumbullojë edhe ca të holla për të blerë pajisje për shtëpinë, Fshatari duhet të kuptojë se shteti importon me miliona rubla bereqet, prandaj sikur të importojë më pak do t'i teprojë më shumë devizë për të furnizuar tregun me mallra të tjera. Këtë mundësi mund dhe duhet ta krijojë. Shteti ka plotësisht të drejtë ta marrë këtë masë se bukën e paguan shtrenjtë.

Ne duhet të prodhojmë jo vetëm drithë, po edhe perime, se ato kanë shumë lëndë ushqyese për organizmin e njeriut. Po kështu të prodhojmë më shumë edhe

patatë. Në kemi marrë 70-80 kv për ha patate. Unë ua thashë shokëve drejtues të rrethit tuaj që të marrin masa më të mira për të mbjellë patate që të zëvendësojnë bukën.

Problem me rëndësi është dhe sigurimi e organizimi racional i forcave të punës. Rëndësinë e lëvizjes së forcave të punës nga fshati në qytet ju e keni kuptuar mirë dhe po e zbatoni drejt. Komiteti ekzekutiv dhe Komiteti i Partisë duhet të bëhen barrikadë për këtë çështje. Kjo nuk do të thotë se nuk do të merren më punëtorë nga fshati, po kjo do të bëhet me plan. Kjo masë nuk përbën ndonjë ndalim të lirisë së personit, po Partia dhe shteti kanë përgjegjësi që qytetarëve t'u gjejnë punë, që të mos jetojnë si parazitë, t'ua plotësojnë nevojat, t'u sigurojnë banesë të përshtatshme, të ndërtojnë shkolla për fëmijët e tyre etj.

Fshati nuk duhet braktisur, pushteti dhe Partia kanë për detyrë ta ndihmojnë atë që të zhduken dallimet thelbësore midis tij dhe qytetit. Si ishte përpara fshati dhe si është tani! Përpara në shumicën e fshatrave nuk kishte as shkolla, pa lëre kinema, shtëpi kulture, radio etj. siç i kanë tani. Shumë fshatra sot kanë dritë elektrike, ujë, shtëpi kulture etj. Atëherë përse të mos qëndrosh në fshat? Asnjë arsye nuk ka ta braktisësh atë. Prandaj njerëzit të mos lëvizin kot veçse në bazë të rregullave, të cilat i kemi vënë dhe duhet t'i zbatojmë. Po edhe Partia të përpiqet t'i bindë njerëzit të qëndrojnë në fshat, sepse kemi nevojë jo vetëm për ata që janë, po edhe për të tjerë, pavarësisht se do të kemi gjithnjë e më shumë mekanizim. Po për t'u bërë të gjitha shërbimet kulturave të ndryshme, kemi nevojë

për forca pune speciale, bile në fshat mund dhe duhet të dërgojmë edhe forca nga qyteti.

Shteti ka nevojë edhe për punëtorë në qytete, se po ndërtojmë vepra të mëdha. Për këtë arsye edhe njerëzit e qyteteve duhet të venë atje ku ka punë. Forcat e lira duhet të shkojnë në dy drejtime: ca të venë në fshat, kurse të tjerët të punojnë në objektet e mëdha që ndërtojmë. Kjo gjë bëhet kur t'u jenë krijuar kushtet t'i dërgojmë me gjithë familje, ndryshe të venë burrat vetëm, të punojnë një vit, dy vjet dhe si të sigurojnë strehim, të marrin edhe gratë e fëmijët. Kështu duhet vepruar në gjithë Shqipërinë, kjo është e domosdoshme. Ne nuk do të lejojmë të na ndodhë si në vendet e ish-demokracisë popullore të Evropës ku tani sundojnë revizionistët. Në këto vende, duke mos i vënë rëndësi këtij problemi, në qytete janë grumbulluar me çindra e mijëra të papunë, shumë nga të cilët detyrohen të lënë atdheun e të venë për të kërkuar punë në vende të tjera. Partia jonë si nikoqire e mirë do të vërë rregull në lëvizjen e forcave të punës atje ku është nevoja dhe sa është nevoja. Kështu jeta e njerëzve tanë si në fshat ashtu edhe në qytet do të përmirësohet me punë, me vepra konkrete. Partia dhe shteti e shohin këtë çështje në perspektivë. Qyteti i Korçës po rritet nga dita në ditë në mënyrë natyrale, të rinjtë që vijnë në moshë duan punë dhe kjo ndodh çdo vit. Ata duhet të punojnë, se parazitë nuk mund t'i lëmë. Prandaj po të mos vëmë rregull, atëherë do të na lindë papunësi. Ne duam të ngrihen kudo fabrika dhe në to të punojnë punëtorë për t'i vënë në lëvizje. Fabrikat që ngremë e të tjera që do të ndërtojmë i kemi e do t'i kemi

moderne. Prandaj këto çështje, ashtu sikurse edhe ato të tjerat që thashë më lart, duhet t'i kemi parasysh në punën tonë se kanë rëndësi të madhe ekonomike dhe shoqërore.

Tani dëshiroj të flas pak edhe për gjendjen ndërkombëtare. Sot ekziston një gjendje revolucionare, që zhvillohet në favor të socializmit dhe të çlirimit kombëtar të popujve. Imperializmi dhe agjentura e tij, revizionizmi modern, po demaskohen. Gjendja po zhvillohet drejt krijimit të partive të reja marksiste-leniniste. Prandaj, duke e parë situatën në këtë prizëm, ne themi se ajo është në favor të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, të paqes dhe të lirisë së popujve.

Në saje të luftës heroike të Partisë sonë, të partive marksiste-leniniste revolucionare dhe në përgjithësi në saje të luftës që bëjnë të gjithë marksistë-leninistët në botë, vëmë re se lëvizja nacionalçlirimtare ka marrë kudo një hov të madh. Kjo do të thotë që sot në botë pozitativat e imperializmit, me atë amerikan në krye, po dobësohen.

Ne vëmë re gjithashtu se në kampin imperialist, në aleancat politike dhe ekonomike të imperialistëve ka një çarje shumë serioze, ekzistojnë kontradikta të mëdha që nuk po gjejnë zgjidhje. Marksizëm-leninizmi na mëson se kontradiktat midis imperialistëve shfaqen e zgjerohen derisa mund të arrijnë edhe në luftë botërore.

Nga Lufta e Dytë Botërore imperialistët amerikanë dolën të fuqishëm. Në këtë periudhë ata manovruan për forcimin e pozitive të tyre ekonomike dhe ushtarake, për t'u diktuar ligjet e veta partnerëve kapitalistë,

në radhë të parë Anglisë, Francës, Gjermanisë Perëndimore, Italisë, Japonisë e shumë vendeve të tjera. Pra imperializmi amerikan me forcat e tij ushtarake dhe ekonomike ndërmori një politikë për të vënë nën drejtimin e vet të gjitha shtetet kapitaliste, për t'u thithur atyre mjetet jetike, për të vendosur hegjemoninë e vet botërore, dhe kështu u forcua. Ai mendoi të përballonte forcën gjithnjë në rritje të socializmit dhe ta likuidonte këtë. Kjo ishte politika, në vija të përgjithshme, e imperializmit amerikan pas Luftës së Dytë Botërore, që u përpoq ta vinte në zbatim në kushtet e krijuara. Dëshira e imperializmit amerikan ishte, në radhë të parë, të mëkëmbte Francën dhe Anglinë, po njëkohësisht edhe t'i grabiste ato dhe kolonitë e tyre, domethënë t'i vinte kolonitë e këtyre shteteve të mëdha në drejtimin e vet në formën e kolonializmit të ri, më të egër nga ai i vjetri. Dhe si kurdoherë, jo pa interes, kapitali amerikan derdhi shuma kolosale, forcoi ekonominë e Francës, të Anglisë, veçanërisht të Gjermanisë Perëndimore, e cila për SHBA-në ka qenë dhe mbetet maja e armës kundër bolshevizmit, komunizmit dhe vendeve socialiste. Në Gjermaninë Perëndimore imperializmi amerikan jo vetëm investoi kapitale të shumta për të mëkëmbur industrinë e shkatërruar nga lufta, por ai i financoi manjatët e mëdhenj gjermanë për të ngritur një industri edhe më të fuqishme, e cila të shërben-te si një armë për të paralizuar skercot eventuale që mund t'i bënin Franca me Anglinë në të ardhmen, ashtu sikurse po bëjnë tani. Imperialistët amerikanë mëkëmbën të gjitha bandat e Hitlerit në Gjermaninë Perëndimore. Shteti i Bonit tani nuk është veçse një shtet

fashist, ku nazistët, pikërisht ata që i kanë shërbyer besnikërisht Hitlerit, janë në fuqi. Prandaj nën maskën e një demokracie borgjeze u ngrit ekonomikisht dhe ushtarakisht Gjermania Perëndimore, një nga partneret më të afërta të SHBA-së.

Mirëpo në Francë dhe në Angli situatat nuk u zhvilluan siç i parashikoi imperializmi amerikan. Është fakt që me ndihmën e amerikanëve dhe me forcat e veta, kapitalizmi francez është zhvilluar në një masë të fuqishme. Sot ai është mëkëmbur në atë shkallë që ndihma amerikane nuk është më e nevojshme për të. Kjo do të thotë që SHBA nuk janë në gjendje të bëjnë tani presion mbi kapitalizmin francez dhe t'i diktojnë këtij vullnetin e vet. Franca, sikurse u deklarua zyrtarisht tani së fundi, i ka borxh SHBA-së vetëm 50 milionë dollarë për çështje civile dhe 120 milionë të tjera për çështje ushtarake, kurse Anglia i ka rreth 100 milionë vetëm për çështje civile dhe asnjë dollar për çështje ushtarake. Kjo rimëkëmbje e kapitalizmit në Angli e në Francë ka sjellë sot kundërshtime në mes tyre. Po përveç ndihmës ekonomike, imperialistët e SHBA-së, për të pasur nën kontroll partnerët e tyre, krijuan aleanca ushtarake si NATO-n, e cila shkoi duke u forcuar. Por SHBA donin që NATO-ja të ishte krejtësisht në duart e tyre, të kishte një organizim të tillë që sustën ta shkelte komanda amerikane, kurse të tjerët të zbatonin urdhrin e saj. Mirëpo edhe kjo evoluoi në atë drejtim që u duk çarja e parë e madhe në gjirin e imperialistëve. Kështu Franca, ka kontradikta të papajtueshme me imperializmin amerikan, sepse ky me të gjitha mundësitë e veta do që ta eliminojë influencën ekonomike



dhe politike të Francës nga të gjitha vendet ku akoma është kjo influencë, ashtu sikurse dëshiron edhe kundër Anglisë, për të vendosur kudo influencën e vet, si në Indokinë, ish-koloni e Francës. Dihet se si luftoi populli i Vietnamit, i cili i theu francezët në Dien Bien Fu. Pastaj imperialistët amerikanë u vendosën vetë në Vietnam; një gjë të tillë ata duan ta bëjnë në të gjitha kolonitë franceze. Ne e dimë luftën heroike të popullit algjerian kundër Francës. Këtë luftë kjo e bëri edhe për naftën e Saharasë, ku ka arritur të nxjerrë gjer në 20 milionë tonë në vit. Imperializmi francez e kishte llogaritur se e vllente të bënte luftë, për të ruajtur interesat e monopoleve të tij në Saharë. Kjo ishte kryesorja. Po lufta heroike e algjerianëve bëri që Algjeria të fitonte pavarësinë.

Duke parë dështimin e madh në Indokinë dhe në Algjeri, Franca përdori një taktikë tjetër, atë të mashtrimit, të cilën e kishte përdorur më parë Anglia, duke u dhënë gjoja pavarësinë shumë vendeve ish-koloni të saj. Kështu 16-17 vende në Afrikë u shpallën shtete të pavarura. Po kjo pavarësi është e sipërfaqshme sepse atje sundon kapitali francez, shoqëritë monopoliste të Francës. Tani populli dhe udhëheqësit e këtyre vendeve po bëjnë përpjekje të mëdha për t'u shkëputur, po një gjë e tillë nuk mund të bëhet me një ditë. Gjatë këtij procesi imperializmi amerikan ka planet e veta. Ai po futet atje ku politika franceze lëkundet, prandaj në këto vende janë ndeshur interesat e monopoleve franceze me ato amerikane.

Krahas kësaj, po ndeshen edhe interesat ushtarake të imperializmit amerikan me ato të NATO-s. Ai kërkon

të dominojë në Evropë dhe armët bërthamore t'i ketë kurdoherë nën drejtimin e vet. Dhe në qoftë se tani po bëhen përçapje nga të gjithë që ta kenë këtë armë, qëllimi është që ta ketë Gjermania Perëndimore, kurdoherë e maskuar nën drejtimin e amerikanëve. Çështja është që Gjermania Perëndimore të ketë armët bërthamore. Pra me anën e aleancave SHBA duan të sundojnë në Evropë. Për këtë kapitalizmi francez është revoltuar sepse janë prekur interesat e tij kapitaliste, financiare, ushtarake e politike. Në këto rrethana Franca përpiqet të forcojë gjendjen dhe po punon për krijimin e armëve të veta bërthamore. Qëllimi i saj është që në Evropë të dominojë ajo dhe jo SHBA.

Për të dominuar politika e saj në Evropë, Francës i duhen edhe aleatë, që ajo përpiqet t'i gjejë, për këtë qëllim po afrohet me Gjermaninë Perëndimore. Gjermania e Bonit ka përfituar shumë pas Luftës së Dytë Botërore, ajo bën shumë intriga dhe anon më tepër nga SHBA se ka nevojë për mjete financiare dhe për bombën atomike. Derisa të mëkëmbet ajo kërkon të ketë një mbështetje të fortë, nën maskën e së cilës të krijojë një shtet militarist fashist dhe të realizojë ëndrrën e vjetër prusiane. Strumbullari tani është Gjermania Perëndimore.

Që të ketë sukses në fushën politike duhet siguruar edhe ana ekonomike, të gjitha të zhvillohen në një platformë. Prandaj imperialistët kanë krijuar «Tregun e përbashkët» në të cilin ka kundërshtime të mëdha midis Francës dhe SHBA-së, Anglisë dhe Gjermanisë. Midis tyre po bëhet një luftë e madhe për të mbytur njëri-tjetrin.

Është fakt, pra, se imperializmi amerikan dhe imperialistët e tjerë nuk janë më në harmoni. Ky është një sukses i madh për forcat që luftojnë për liri, pavarësi e socializëm. Krijimi i kësaj situatë ndihmon për shtyrjen e luftës. Kushtet e mëdha objektive të gjendjes së sotme botërore, roli që luan socializmi dhe marksizëm-leninizmi, ka bërë që imperialistët të mos mundin të zhvillojnë dot politikën e tyre si të duan dhe të bien në kundërshtim me njëri-tjetrin. Sot në Azi, në Afrikë dhe në Amerikën Latine po kërcet pushka, të gjithë kanë hapur zjarr dhe luftojnë kundër imperializmit, kolonializmit, kundër kapitalistëve amerikanë në radhë të parë, po edhe kundër atyre të Anglisë, Francës, Gjermanisë Perëndimore, e gjithë bishtrave të tyre të shitur. Domethënë këto tri kontinente janë kthyer sot në një vullkan të zjarrtë.

Të marrim kontinentin afrikan që po zien. Në këtë kontinent janë krijuar shumë shtete të pavarura. Kjo është një gjë shumë pozitive, pavarësisht se atje ekziston kapitali monopolist francez, amerikan etj. Po është i rëndësishëm fakti se njerëzit u zgjuan dhe këto vende po marrin formën e shtetit të pavarur. Veç, pavarësinë e tyre duhet ta kuptojmë drejt. Kishte rëndësi të madhe për vendin tonë Shpallja e Pavarësisë në vitin 1912, pavarësisht se kjo ishte formale pasi u fut kapitali i huaj dhe për pasojë imperialistët e ndryshëm i qëndronin përsëri popullit mbi kurriz. Megjithëse populli ishte i pavarur, ai luftoi për ta forcuar pavarësinë derisa erdhi dita e sotme. Ky proces do të zhvillohet edhe në Afrikë. Forca e madhe e marksizëm-leninizmit do t'i shtyjë përpara gjithë këta popuj për

forcimin e pavarësisë, për të hequr qafe zinxhirin e robërisë kapitaliste. Ky është një revolucion që ecën përpara dhe që është kundër hegjemonisë së imperialistëve, veçanërisht të atij amerikan. Revolucionin ngjitet dhe kjo është në favor të socializmit dhe në dëm të orvatjeve të imperialistëve për të forcuar pushtetin e skllavërimit, një pengesë e madhe për të shpallur luftën. Zjarri kudo u përcëllon këmbët imperialistëve dhe sikurse na mëson marksizëm-leninizmi, imperializmit, kapitalistëve duhet t'ua bëjmë jetën të pamundur derisa t'i fusim në varr. Vija e drejtë e Partisë sonë ndihmon që të mbahet lart flamuri i revolucionit botëror në forma të ndryshme, duke kaluar etapat e nevojshme dhe jo në mënyrë shabllone, sepse kështu ajo ndihmon që imperializmi, me atë amerikan në krye, të jetë në vështirësi të mëdha.

Në situatën e sotme ka «luftë të nxehtë» dhe «luftë të ftohtë». «Luftë e nxehtë» bëhet në Vietnamin e Jugut, një luftë heroike, ku shokët vietnamezë nga dita në ditë po korrin fitore, ndërsa amerikanët po pësojnë humbje të mëdha. Kjo shpjegohet me vetë situatën e paqëndrueshme të amerikanëve në Vietnamin e Jugut, saqë tani janë ngritur zëra të autorizuar që i këshillojnë imperialistët amerikanë të tërhiqen andej se do ta pësojnë si Franca në Dien Bien Fu.

Në Laos imperialistët amerikanë po pësojnë vazhdimisht disfata të mëdha politike dhe ushtarake.

Në Amerikën Latine lëvizja është shumë e madhe, jo vetëm lëvizja greviste po edhe lufta partizane, si në Venezuelë, Peru dhe Bolivi. Kudo në Amerikën Latine situata është e favorshme, revolucionare.

Në këtë situatë shumë të favorshme për ne, imperializmi ka hedhur në lëvizje agjenturën e vet, revizionizmin modern, që është vënë në shërbim të kapitalizmit dhe që u shërben interesave të kapitalizmit botëror. Banda e Hrushovit është një bandë renegatësh revizionistë nga më të poshtrat, tradhtarë me damkë e klasës punëtore të BS. Në të njëjtën radhë qëndron edhe klika e Titos, që është plotësisht një agjenturë e imperializmit. Të dyja këto banda përbëjnë kokën e revizionizmit modern në shërbim të kapitalizmit botëror me një politikë unike, me një vijë e taktikë të përbashkët, që synon likuidimin e marksizëm-leninizmit, të socializmit dhe transformimin e vendeve socialiste në vende borgjeze kapitaliste.

Le të marrim Jugosllavinë. Është fare e qartë për të gjithë se atje është vendosur prej kohësh kapitalizmi. Atje kanë mbetur vetëm fjalët dhe etiketat marksiste-leniniste, kurse ndërtimi shoqëror ekonomik e kulturor ka hyrë plotësisht në rrugën kapitaliste. Atje është krijuar një shtresë kapitalistësh të rinj. Në krye të shtetit ka ardhur në fuqi borgjezia e re që sundon nën maskën e socializmit. Ajo është sjellë në fuqi, është ngritur dhe është edukuar nga një klikë renegatësh. I gjithë sistemi i ekonomisë jugosllave asgjë nuk ka marksiste, i tëri është kapitalist me të gjitha format dhe veçoritë e këtij sistemi. Radio Beogradi dhe shtypi revizionist jugosllav as e kanë fare për turp që transmetojnë dhe botojnë lajme se popullit në Jugosllavi i mungon mishi, se duhet të rritet çmimi i tij, se mungesa e mishit vjen ngaqë eksportohet, prandaj «populli duhet të shtrëngojë rripat». Se ku venë të ar-

dhurat e ekonomisë jugosllave dihet, ato grabiten nga klika në fuqi. «Vetadministrimi» nuk është gjë tjetër veçse një formë mashtrimi, shtypjeje e shfrytëzimi e shpikur nga klika revizioniste me qëllim që të ardhurat e punonjësve të shkojnë tek ata që marrin nga 18 e 20 rroga në vit. Çdo ndërmarrje çmimet e mallrave në treg i cakton vetë. Gjithashtu lejohet falimentimi i ndërmarrjeve ekonomike në favor të ndërmarrjeve më të mëdha. Çdo ndërmarrje ka lidhje të veçanta me kapitalistë të ndryshëm të Evropës. Mund të merret me mend ç'grabitje e madhe bëhet në kurriz të masave punonjëse. Njerëz të tillë u duhen hrushovianëve dhe revizionistëve të tjerë në Evropë që duan të fusin Titon në radhët e tyre, se edhe ata ndjekin rrugën e tij. Kështu duan t'i ndërrojnë paraqitjen ujkut, duke gënjyer me ndonjë të ashtuquajtur autokritikë. Po kjo nuk ndryshon gjë se në Jugosllavi sundon kapitali amerikan. Miliarda dollarë janë derdhur atje hapur. Po si mund të mendohet që imperializmi amerikan t'i lëshojë ashtu kot të gjitha këto?

Hrushovi përpiqet të gënjejë popujt që të ecin në rrugën e tij antimarksiste, në rrugën e tij të bashkekzistencës false paqësore. Bashkekzistenca që pretendon Hrushovi është në rrugë tradhtare, nuk është bashkekzistenca leniniste për të cilën jemi e luftojmë edhe ne. Bashkekzistenca e Hrushovit në radhë të parë është pajtim i plotë me imperializmin amerikan. Kjo do të thotë që të pushojë lufta politike dhe ideologjike kundër imperializmit, të zhvillohen me të marrëdhënie të tilla ekonomike jo si midis një vendi socialist me një vend kapitalist, po me një zemërgje-

rësi dhe miqësi që nuk bëhen as midis vetë vendeve kapitaliste. Të këmbejmë eksperiencën me njëri-tjetrit, trumbeton Hrushovi. Po për çfarë eksperience është fjala? Për eksperiencën më të mirë? Marksi na mëson se komunistët mund të marrin edhe ndonjë eksperiencë të mirë, që ka krijuar sistemi kapitalist, por gjërat e këqija t'i luftojnë. Hrushovi, në politikën e tij do që të merret gjithçka nga kapitalizmi, edhe të mirat, edhe të këqijat. Një politikë të tillë ndjek ky tradhtar. Politika e bashkekzistencës e Hrushovit është politika e tradhtisë. Gjithashtu me politikën e çarmatimit Hrushovi përpiket të çarmatosë popujt, në radhë të parë synon që të vendosë hegjemoninë e tij. Ky qëllim mbulohet me maskën e pacifizmit. Po një politike të tillë po i del boja në sytë e popujve, se shumë është folur prej tij për këtë çështje dhe asgjë nuk është bërë.

Qëllimi i Hrushovit dhe i SHBA-së është që të çarmatosen të gjitha vendet dhe të vendoset hegjemonia e armëve të tyre bërthamore. Një kuptim të tillë ka Traktati i Moskës<sup>1</sup> që është bërë për të ligjësuar monopolizimin e armëve bërthamore nga ana e BS dhe e SHBA-së që të dominojnë botën ushtarakisht.

Revizionizmi hrushovian ka për qëllim të marrë fuqinë dhe të shuajë gjendjen revolucionare në të gjithë botën. Hrushovi, besnik i kapitalizmit botëror, kërkon që kudo në botë, imperializmit, veçanërisht atij amerikan, të mos i shkaktohen kokëçarje. Ai është përpjekur dhe do të përpiket deri në fund t'i shuajë revolucionet, po nuk do t'ia arrijë dot qëllimit. Ai hodhi parullën:

---

1 Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 25, f. 248.

«Pushteti të merret në rrugë paqësore», e veshi këtë parullë me rroba false marksiste, por kjo gjë nuk i piu më ujë se është hedhur poshtë jo vetëm nga marksistë-leninistët po edhe nga demokratët revolucionarë të të gjitha vendeve që përkrahin tezën e drejtë marksistë-leniniste se pushteti do të merret me armë, me rrugën e revolucionit.

E gjithë politika dhe ideologjia e Hrushovit është orientuar në drejtim të afrimit, të forcimit të miqësisë dhe të aleancave me imperialistët amerikanë. Ky është boshti i politikës së sotme sovjetike, prandaj është e natyrshme që për t'ia arritur këtij qëllimi u bëhen çfarëdo lëshimesh imperialistëve amerikanë. Në qoftë se nuk shohim konkretisht të nënshkruhet traktati me Gjermaninë, kjo ndodh se Hrushovi dëshiron të bëjë lëshime për çështjen gjermane. Dhe çështja gjermane ka rëndësi shumë të madhe. Mbi kurrizin e RD Gjermane do të hidhet vallja e revizionistëve në favor të Adenauerit dhe të shokëve të tij. Format e kësaj pune kanë filluar të dalin. Vendimet e drejta që parashikonin si duhej të zgjidhej çështja gjermane kanë filluar të shkelen. Hrushovi do të bëjë lëshime të mëdha se ndjek kursin e SHBA-së, si rrjedhim ai me politikën e tij të lëshimeve po braktis të gjithë miqtë e vërtetë të BS. Hrushovi e mendoi se kjo politikë do të haste në kundërshtim, prandaj u përpoq me dinakëri të siguronte aprovimin e saj. Me forma të ndryshme u mundua të shpjegonte se kjo na qenkësh vija e drejtë që duhej ndjekur. Për ata që do të kundërshtonin, do të merrte masa të ndryshme për t'i nënshtruar ose për t'i likuiduar, duke përdorur lajkën, frikësimin, mashtri-



min dhe kërcënimin dhe po t'i shkonte edhe forcën; disa do të përpiqej t'i komprometonte, të tjerët, që nuk do t'i kundërshtonin, do t'i nxiste kundër të parëve. Dhe me zigzage ai iu fut kësaj pune.

Kundërshtime me Hrushovin ne kishim edhe më parë. Kontradikta kryesore midis nesh dhe atij ishte për çështjen e Stalinit, po në atë kohë për interes të socializmit ne nuk i shprehnim haptazi kontradiktat tona. Kur u poqën kushtet, Partia jonë e tha fjalën e vet. Në mbledhjen e Bukureshtit ne kundërshtuam me guxim veprimet dhe kursin e tij. Në Konferencën e Moskës ne i hapëm përsëri zjarr, natyrisht brenda normave të marksizëm-leninizmit, ashtu sikurse duhet bërë midis shokësh. Si e pa keq Hrushovi, nisi të vërë në zbatim planet e tij. Ai filloi të na frikësojë, po ne nuk u frikësuam, qëndruam të patundur në rrugën tonë dhe kundërshtimet i vazhduam. Më vonë ai dhe bashkëpunëtorët e tij të ngushtë morën masa më të rrepta për të na mposhtur, por ne qëndruam. Atëherë Hrushovi pa se duhej goditur duke menduar se me një të goditur do të na shkatërronte, me një të lëvizur të gishtit të tij të tjerët të mos bënin «gëk» se ndryshe do t'ua bënte si Shqipërisë. Po ndërmarrja e tij dësh-toi. Shqipëria u bë kështjellë e pamposhtur dhe she-mbull qëndrese.

Në Kongresin e 22-të të PK të BS ai na sulmoi publikisht, na goditi, po edhe ne topat i kishim gati. Ai sulmoi i pari duke e justifikuar këtë se ishte një masë që duhej marrë «në interesin e marksizëm-leninizmit kundër udhëheqjes shqiptare, antimarksiste, spiune» etj., etj. Shumë parti e duartrokritën, po ne nuk u tu-

tëm. Shembulli i Shqipërisë ishte shembull i qëndrimit heroik për të gjithë botën.

Miq e armiq kanë folur shumë këta tre vjet për Shqipërinë. Autoriteti i Shqipërisë dhe i PPSH u rrit, kurse Hrushovi dështoi me taktikën e tij. Për një kohë Titoja herë fliste herë nuk fliste, kurse Hrushovi nuk fliste se mendohej ta afronte e ta fuste Titon në vathë, ose të paktën të kishte mundësi të përqendronte polemikën dhe zjarrin e tij kundër Shqipërisë. Para se të kritikonim haptazi rrugën e shtrembër të udhëheqjes tradhtarë e revizioniste sovjetike, për një kohë zjarrin e përqendruam kundër udhëheqjes revizioniste të Jugosllavisë, gjë që donte të thoshte bjeri derës të dëgjojë penxherja. Mirëpo Hrushovi e pa se po demaskohej.

Në taktikën e tij të parë Hrushovi dështoi dhe pa tmerrin e tij. Atëherë ai mendoi se kundër nesh duhej të luftonte me zjarr të përqendruar. Me këtë donte t'u thoshte të tjerëve të mos ngrinin kokën. Por shumë udhëheqës partish ranë në grackën e tij, u bashkuan në korin e Hrushovit. Ne përsëri edhe pas sulmit frontal revizionist qëndruam heroikisht.

Hrushovi, kur e pa se edhe me këto mënyra nuk i eci mbarë, kërkoi të pushohej polemika. Ai në fillim shpalli se polemika kundër shqiptarëve ishte e domosdoshme, në interes të marksizëm-leninizmit, kurse tani kërkon të pushohet se na qenka në dëm të kampit socialist, se ajo e përçan këtë, se i dhënka armë armikut. Ne iu përgjigjëm qetë se ju e hapët polemikën, tani kjo e keqe për ju, është e mirë për ne, prandaj ne do ta vazhdojmë polemikën deri në shkatërrimin e plotë

të revizionistëve. Kjo përgjigje i ka bërë Hrushovin dhe shokët e tij të dridhen, në radhë të parë se ata përsuan disfata të mëdha dhe janë demaskuar në politikën e tyre të përgjithshme, në marrëdhëniet me imperialistët. Edhe nga sukseset që kishte arritur gjoja politika e tij e jashtme nuk u duk asgjë, qoftë në çështjen e çarmatimit, të ndalimit të bombës atomike etj.

Satelitët e Hrushovit tani janë në vështirësi të mëdha, se politika që ndoqën i futi në qorrrokak partitë dhe vendet e tyre. Jo vetëm politika e jashtme po dhe politika ekonomike brenda në BS ka dështuar me turp. Atje ka uri, bukën ua japin amerikanët, se BS, nga politika që ndoqi Hrushovi, harxhoi të gjitha rezervat e drithit dhe tani jo vetëm nuk ka bukë por nxjerr edhe floririn jashtë. Në bujqësi Hrushovi shkon drejt ngjalljes së shtresës së kulakëve, drejt krijimit të sistemit kapitalist të tipit jugosllav. Hrushovi ka deklaruar se kryesor në socializëm është stimuli material personal. Kështu kolkozet që japin më shumë stimulohen më mirë. Kjo do të thotë transformim i kolkozeve në institute ekonomike kapitaliste, në duart e disave. Edhe në industri ai përpiket të krijojë një shtresë borgjezësh të rinj, ajo po organizohet në ato forma si është bërë në Jugosllavi ku po futet edhe kapitali amerikan, që kullon gjak punëtorësh amerikanë. Kështu bashkë me këtë gjak do të kullojë edhe gjaku i popullit sovjetik. Uzinat për prodhimin e plehrave kimike që po ndërton Bashkimi Sovjetik, do t'ia japin Franca, Anglia dhe SHBA. Po këta e bëjnë këtë me qëllim që të ndryshohet ekonomia sovjetike nga socialiste në ekonomi kapitaliste.

Imperialistëve u intereson të kenë më mirë një vend sovjetik me Hrushovin në krye sesa një BS të vërtetë socialist. Hrushovi po e çon BS në rrugën kapitaliste. Kohët e fundit ai ka nxjerrë nga arkiva një letër që Lenini ia ka drejtuar emigracionit ekonomik rus në SHBA<sup>1</sup>. Këta emigrantë, duke parë varfërinë e madhe të shtetit sovjetik në vitet e para, shkruanin se do të hiqnin nga goja e tyre për t'i dërguar ca traktorë popullit sovjetik. Lenini i ka falënderuar ata për ndihmat, kurse Hrushovi e boton këtë letër për të mbështetur veprimtarinë e tij në drejtim të afrimit me amerikanët që do të vazhdojë edhe në të ardhmen dhe këtë përpjet ta mbulojë me emrin e Leninit.

Në BS tani ka kushte jashtëzakonisht të vështira, dhe për pasojë ka rezistencë, njerëzit flasin, shajnë politikën që ndjek qeveria sovjetike. Malinovski është plotësisht dakord me vijën e Hrushovit, po në një mbledhje ai është detyruar të kritikojë shkrimtarët dhe poetët që hedhin poshtë heroizmin e Ushtrisë Sovjetike gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kur Malinovski na qenka në rrugë të drejtë, siç thonë revizionistët, përse u lejuan gjithë këta njerëz të poshtër të shijnë në fushën e teatrit, të kinematografisë, të letërsisë etj., dhe të nxjerrin filma të tillë reaksionarë, si «Qielli i kaltër», që edhe një regjisor i Hollivudit zor se do të guxonte ta realizonte? Në këtë film shihen vetëm oficerë të demoralizuar nga lufta e popullit, komunistë të rraskapitur. Populli dhe komunistët e vërtetë i urrejné këta dhe po reagojnë. Megjithatë filmat, prodhimet letrare, teatrale

---

1 Shih në këtë vëllim, f. 159.

etj. të kësaj natyre dalin në dritë, nuk pengohen, ato bëjnë punën e tyre. Atje ka njerëz që flasin hapët se nuk janë dakord me vijën e Hrushovit, pra ka rezistencë dhe klika hrushoviane merr masa të ashpra, fut në burg ata që kundërshtojnë politikën e saj. Nga ana tjetër, hrushovianët, para reagimit të masave popullore, veprojnë edhe duke thënë ndonjë fjalë për demagogji se gjoja e mbrojnë heroizmin e Ushtrisë Sovjetike gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Politika e revizionistëve i ka futur në qorrsoyak partitë dhe vendet e ish-demokracisë popullore. Kjo ka bërë që edhe në ato vende të ngjasë e njëjta gjë si në BS. Situata atje zien, njerëzit flasin. Satelitët e Hrushovit janë në vështirësi të mëdha. Në Bullgari po hapen gjyqe speciale për të eliminuar njerëzit e shëndoshë. Zhivkovit nuk i mjafton bashkëpunimi, në kuadrin e KNER-it, me BS dhe kohët e fundit shkoi në Moskë e nënshkroi disa marrëveshje të tjera që e lidhin ngushtë ekonominë bullgare me atë sovjetike, me qëllim që sovjetikët të jenë kurdoherë brenda në Bullgari. Ekonomikisht dhe politikisht vendet ish-socialiste të Evropës janë në gjendje shumë të vështirë, udhëheqësit e tyre janë diskredituar, prandaj po marrin masa terrori, bëjnë përjashtime nga partia në masë, çmobilizojnë oficerë të vjetër. Në Varna një hamall bullgar që shkoi me punë në vaporin tonë, kërkoi një cigare dhe kur filloi ta pinte u tha shokëve tanë se për herë të parë pas kaq kohësh po e ndiente veten të lirë. Unë kam qenë kolonel, u tha ai. Të jesh hamall nuk do të thotë se bën një punë të poshtër, po me këtë ai donte të thoshte se këtu e kishte katandisur atë revizionisti Zhivkov. Po

nuk është çështja vetëm te një njeri, në Bullgari deri ambasadorët dhe atashetë ushtarakë u thonë shokëve tanë se shqiptarët janë njerëz besnikë.

Tani Hrushovi është në hall të madh, prandaj përpigjet të pushojë polemikën, po ne nuk e pushojmë. Kohët e fundit ai mbledhi plenumin e KQ me etiketën e problemeve të bujqësisë, kurse në fakt në plenum ai shtroi çështjen se si do të bëhet «me polemikën». Ata mbetën dakord ta diskutonin këtë çështje dhe morën vendim që të gjitha materialet e diskutuara në plenum kundër PPSH t'i botonin në shtypin e tyre qendror. Mirëpo u duhej t'u thoshin edhe satelitëve, se njëherë u dhanë urdhër të na sulmonin dhe ata sulmuan, pastaj kur u thanë ta pushonin polemikën, ata e pushuan, më vonë kërkuan të sulmojnë përsëri dhe tani përsëri sulmojnë. Për këtë qëllim Hrushovi u ka dërguar një letër të gjitha partive, në të cilën u thotë se janë të detyruar të sulmojnë «trockistët e rinj». Të tjerët me këtë gjendje kishin gjetur njëfarë rehatie. Prandaj ca u nisën për në Moskë «për t'u siguruar më mirë», ca ishin dakord me Hrushovin.

*Më poshtë, pasi foli për forcimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të lëvizjes marksiste-leniniste në botë, për luftën që zhvillojnë partitë dhe grupet marksiste-leniniste kundër imperializmit dhe revizionizmit, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

E tillë është gjendja ndërkombëtare në përgjithësi. Konkluzioni është që Partia jonë ndjek një vijë të drejtë marksiste-leniniste, të palëkundshme. Vija e drejtë e Partisë sonë ka ndihmuar të mprehet vigjilenca në miliona e miliona komunistë në botë, të cilët, duke i

parë tani çështjet qartë, kanë filluar të luftojnë në mënyrë të organizuar kundër revizionizmit brenda dhe jashtë partisë së tyre. Tani ne jemi duke asistuar në krijimin e partive të reja që janë në shenjën e armikut. Në këto parti do të përpiqen të futen njerëz të kontrolluar, po do të përpiqen, për qëllimet e tyre, të futen edhe njerëz të pakontrolluar. Po të gjithë do t'i shohitë lufta, ajo do t'i kalitë njerëzit. Më në fund revizionistët do të izoloohen dhe ne do të forcohem. Partia jonë ecën në rrugë të drejtë dhe gëzon simpatinë e të gjithëve, të gjitha partitë marksiste-leniniste e mbrojnë partinë tonë.

Të dashur shokë,

Dy vjetët e fundit të pesëvjeçarit i kemi shumë të ngarkuar, realizimi me sukses i tyre kërkon të mobilizojmë të gjitha forcat. Ne duhet të prodhojmë më shumë drithëra buke, të përmirësojmë blegtorinë, të realizojmë të gjitha planet në industrinë e rëndë e të lehtë. Kjo është një nga detyrat më të rëndësishme politike, ekonomike e morale, prandaj ato duhet t'i përfundojmë dhe t'i fusim sa më parë në shfrytëzim, sepse në bazë të këtyre realizimeve do të mbështesim planin tonë të pesëvjeçarit të ardhshëm, që po e përgatitim në vija të përgjithshme orientuese dhe që do të kalojë në Qeveri, në Byronë Politike dhe në Plenumin e Komitetit Qendror. Në Kongresin e ardhshëm të Partisë të vemi me planin e katërt pesëvjeçar të përgatitur.

Lufta për ndërtimin e socializmit të lidhet ngushtë me luftën kundër imperializmit e revizionizmit; puna

ndërtimtare të lidhet ngushtë me forcimin e mbrojtjes, të vigjilencës dhe këto të bëhen nëpërmjet aksioneve politike. Kjo lidhje shkencore e çështjeve na ka siguruar gjithnjë suksese kolosale, kështu që duhet realizuar kurdoherë nga çdo organizatë partie. Viti 1964 është viti i 20-vjetorit të Çlirimit dhe viti vendimtar për realizimin e planit të tretë pesëvjeçar, prandaj duhet të mobilizohemi të gjithë.

Këto janë me pak fjalë dhe në vija të përgjithshme çështjet që doja të theksoja. Komiteti Qendror ju porositi, shokë dhe shoqe, që të mobilizoni të gjitha forcat dhe të bëni të gjitha përpjekjet për realizimin e detyrave të planit. Udhëheqja është e bindur se në Korçë kemi një organizatë marksiste-leniniste të pjekur, me eksperiencë të madhe. Shumë nga shokët e organizatës suaj tani kanë flokë të bardhë, eksperiencë të madhe, po edhe kuadrot e rinj që dalin janë të aftë dhe me iniciativë. Me një Parti të tillë këto plane do t'i realizojmë patjetër. Ju uroj nga zemra suksese gjithnjë më të mëdha, në realizimin e detyrave që ju ngarkon Partia!

Të rrojë Partia!

*Botohet për herë të parë, me  
disa shkurtime, sipas origjinalit  
që gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*



## N. HRUSHOVI SH TREMBËRON IDETË E LENINIT PËR T'I HAPUR RRUGË KURSIT TË VET PROIMPERIALIST

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

**1 mars 1964**

Këto ditë gazeta «Pravda» botoi një letër të panjohur të V. I. Leninit, dërguar më 14 nëntor 1922 «Kolonisë ruse në Amerikën e Veriut». Sikurse thuhet edhe në shënimin e redaksisë, Lenini ia dërgonte letrën e tij asaj pjese të kolonisë ruse që mbante qëndrim miqësor ndaj Ruisë Sovjetike. Ai falënderonte, në emër të qeverisë sovjetike, «Shoqatën e miqve të Ruisë Sovjetike» dhe «Shoqatën e ndihmës teknike për Rusinë Sovjetike», sidomos për ndihmën e dhënë për bujqësinë, për përmirësimin e teknikës së kësaj ekonomie, gjë që në atë kohë ishte e rëndësishme dhe e çmueshme. Vladimir Iliçi e cilësonte ndihmën ndaj Ruisë Sovjetike si një shfaqje të qartë të internacionalizmit proletar, të solidaritetit vëllazëror të punonjësve. Në këtë letër Lenini mbron Politikën e Re Ekonomike, NEP-in,

nga sulmet shpifarake të shtypit kapitalist e të bjellogardistëve rusë në Amerikë dhe shpjegon kapitalizmin shtetëror si një nga momentet e kësaj politike të re ekonomike.

Pra, si e gjithë vepra e pavdekshme e V. I. Leninit, edhe letra dërguar «Kolonisë ruse në Amerikën e Veriut» është një mbrojtje e flaktë e politikës së drejtë të Partisë Komuniste, e pushtetit sovjetik, e socializmit. Në periudhën e rimëkëmbjes, në të cilën ndodhej Rusia Sovjetike, ndihma e bijve të saj të mërguar ishte simbol i atdhedashurisë së tyre. Rusët e Amerikës dhe miqtë e Ruisë Sovjetike që i jepnin ndihmën e tyre të çmuar Republikës së sovjetëve, sikurse e bën dallimin vetë Lenini, nuk kishin asgjë të përbashkët me armiqtë e Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, me imperialistët amerikanë, pjesëmarrës në intervencionin për përmbysjen e pushtetit sovjetik, si dhe me bjellogardistët, menshevikët e eserët, që ishin arratisur në Amerikë dhe që ushqeheshin në grazhdet e dollarit amerikan. Emigrantët ekonomikë rusë ishin njerëz të punës, që kishin marrë rrugët e kurbetit për shkak të gjendjes së keqe ekonomike në Rusinë cariste, prandaj ata e përshëndetën si fitoren e tyre, si fitoren e punës, fitoren e proletariatit të Ruisë në Revolucionin e Madh të Tetorit. Kështu që si iniciativat patriotike e internacionaliste për ndihmë Ruisë Sovjetike ashtu edhe pranimi i tyre nga Bashkimi Sovjetik, ishin plotësisht të drejta.

Ndihmat e rusëve të mërguar për atdheun e tyre na kujtojnë qëndrimin patriotik, atdhedashurinë e zjarrtë të vëllezërve tanë të mërguar në Amerikë e në

vende të tjera, na kujtojnë ndihmën e çmuar, përkrahjen patriotike që ata kanë dhënë dhe japin pa kursim për mëmëdheun e tyre, Republikën Popullore të Shqipërisë. Kjo është e natyrshme.

Por, ç'na shtyn, atëherë ne të ndalemi në këtë rast? Ajo që na shtyn është fakti se Hrushovi, duke vënë në majë të gjilpërës këtë dokument të Leninit, përpiqet të shtrembërojë idetë e Leninit, t'i përdorë ato si «bazë leniniste», si «sfond leninist», të kursit të vet anti-marksist e kapitullues, si mbështetje për të realizuar qëllimet e veta për t'u lidhur sa më ngushtë me imperialistët amerikanë.

Botimi i letrës së panjohur të Leninit krahas me letrën-direktivë të fermerit amerikan Rosuell Harst, në kohën kur grupi i Hrushovit, i hasur në vështirësi serioze, sidomos në fushën e bujqësisë, ka hedhur parullën për t'i shtrirë dorën imperializmit amerikan, për t'u drejtuar nga eksperiencia e imperialistëve amerikanë, nuk është aspak një kuriozitet i thjeshtë i botimit të një dokumenti të panjohur, nuk është aspak një gjë e rastit.

Me këto botime, si dhe me gjithë frymën e kursit të tij revizionist e proamerikan, Hrushovi orvatet të krijojë përshtypjen se bashkëpunimi i tij i gjithanshëm me imperialistët amerikanë, si në fushën e politikës, të ideologjisë e të ekonomisë, na paska qenë një orientim i parashikuar nga Lenini, dhe Hrushovi vetë s'bëka gjë tjetër veçse zbatoka këtë orientim! Me «faktin» se gjoja edhe Lenini, në kohën e vet, paska kërkuar ndihmën e imperialistëve amerikanë, ai synon të justifikojë kreditë që mund të ketë marrë e që mund të marrë

nga imperialistët amerikanë, sidomos për sektorin e bujqësisë, ku me politikën e tij revizioniste ka sjellë dëme serioze. Shkurt, ai përpiqet të vërë shenjën e barazimit midis qëndrimit marksist të Leninit ndaj imperializmit amerikan dhe kursit të vet revizionist.

Hrushovi po pëson në politikën e tij disfata pas disfatash, si në fushën e ideologjisë ashtu edhe në fushën e ekonomisë, e sidomos në bujqësi. Vija e tij antimarksiste po demaskohet si në arenën ndërkombëtare ashtu edhe nga forcat e shëndosha, nga masat revolucionare të komunistëve sovjetikë. Prandaj, për të vazhduar më tej veprimtarinë e tij antimarksiste, atij i duhet të mbulohet mirë nën maskën e leninizmit, ta paraqesë veten si zbatues të porosive të Leninit.

Si pragmatist që është, ai nuk bëhet aspak merak për parimet. Atij i intereson të realizojë qëllimin. Për të s'kanë rëndësi mjetet e metodat e ulëta që përdor. Në këtë rast, për shembull, i duhet ta përdorë Leninin si «mbështetje» për të justifikuar kërkesat e tij për kredi nga imperialistët, si çelës për t'i hapur dyert e Bashkimit Sovjetik imperializmit amerikan dhe nuk ngurron ta bëjë këtë.

Tanimë janë të njohura thirrjet e Hrushovit drejtuar imperialistëve dhe veçanërisht imperialistëve amerikanë, që të mos druhen, por të veprojnë shpejt për të marrë porosi nga Bashkimi Sovjetik, për t'i dhënë atij kredi, për të bërë investime në Bashkimin Sovjetik.

Kështu, qysh në vitin 1959, në një fjalim të mbajtur në Lajpcig, duke iu drejtuar kapitalistëve, ai tha: «Kur ju do të na jepni neve kredi, ne do t'ju paraqe-

sim porositë tona, do të zhvillojmë industrinë tonë në atë drejtim dhe në ato degë për të cilat do të interesoheni ju dhe do të sigurojmë mundësinë e pagimit të këtyre porosive».

Kur ishte në SHBA, përsëri në vitin 1959, në një drekë të shtruar për nder të tij nga botuesi i gazetës amerikane «Xhornell ov komers», Hrushovi tha: «Në qoftë se industrialistët amerikanë duan që të marrin nga ne porosi të mëdha, ne mund t'i bëjmë ato në rast se ata do të na japin neve kredi. Kam parasysh kreditë nga firmat, ashtu sikurse bënë anglezët. Për sa u përket kredive nga ana e qeverisë, në marrëdhëniet e tanishme midis vendeve tona, kjo gjë, me sa duket, është e pamundur. Në qoftë se firmat do të na japin kredi, ne do të paguajmë përqindjen e arsyeshme».

Disa muaj më parë, në ditën e festës së Revolucionit të Tetorit, Hrushovi, duke iu përgjigjur një dollie të ngritur nga Xhejms Lindeni, drejtor i revistës së përjavshme amerikane «Tajms», që organizoi udhëtimin e përfaqësuesve të ndërmarreve më të mëdha amerikane në Bashkimin Sovjetik, tha se «nuk ka investim më të mirë sesa një investim i bërë në Bashkimin Sovjetik. Në qoftë se investoni kapital, theksoi ai, do të nxirrni fitime të mira me garancinë e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik». Duke vazhduar fjalën e tij, Hrushovi këshilloi se «kapitalisti duhet të shkojë gjithmonë atje ku mund të shpresojë të nxjerrë fitime».

Dhe në plenumin e dhjetorit të KQ të PK të BS të vitit 1963 ai theksoi: «Përsëris se atyre që duan të fitojnë ndershmërisht, ne do t'u japim porosi në qoftë

se do të na japin kredi, sepse kjo është bërë sot një normë e marrëdhënieve ekonomike».

Për të justifikuar këtë kurs antisocialist, antiso-vjetik, Hrushovi përpiqet më kot të gjejë mbështetje te Lenini. Renegatët revizionistë, Hrushov e kompani, nuk mund të mbulojnë ndyrësitë e tyre me veprat e Leninit. Në veprat e Leninit fryn era e pastër, e zjarrtë, e revolucionit, që djeg e përvëlon kalbësirën revizioniste.

Amerikën e miliarderëve, që grupi i Hrushovit e konsideron në fakt aleate të natyrshme, një shtet demokratik e paqedashës, ku qetësinë e prishin vetëm disa «të tërbuar» jashtë Shtëpisë së Bardhë, Lenini i madh e quante, siç ishte dhe siç është edhe sot, një skllavëri të re, skllavëri kapitaliste, skllavëri me mëditje nën sundimin e një grushti miliarderësh, ku ekziston grabitja brutale e shfrytëzimi çnjerëzor, një shtet imperialist e agresiv, që desh të mbyste që në djep Republikën e re socialiste Ruse.

Lenini i madh shikonte «në çdo dollar gjurmë ndyrësie: të traktateve të fshehta të ndyra... të traktateve mbi ndarjen e plaçkës së grabitur, të traktateve të «ndihmës» shoqi-shoqit në shtypjen e punëtorëve dhe në ndjekjen kundër socialistëve-internacionalistë. Në çdo dollar ka një tok ndyrësie nga furnizimet ushtarake «fitimprurëse», që kanë pasuruar në çdo vend pasanikët dhe kanë rrënuar të vobektët»<sup>1</sup>.

---

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 28, f. 54.

Të tillë e konsideron edhe sot lëvizja komuniste e punëtores imperializmin amerikan. Deklarata e Moskës e vitit 1960, e nënshkruar nga përfaqësuesit e 81 partive komuniste e punëtores, e konsideron imperializmin amerikan si «shfrytëzuesin më të madh ndërkombëtar», «kështjellë kryesore të reaksionit botëror», «xhandar ndërkombëtar» dhe «armik të popujve të të gjithë botës». Edhe sot dollari amerikan mban gjurmët e gjakut të punëtorëve amerikanë, të Koresë së Jugut, të patriotëve panamezë e vietnamezë, të revolucionarëve dhe të luftëtarëve të lirisë në të gjitha anët e botës. Në të janë njollat e ndyrësive e të intrigave, të lidhjeve e të kompleteve që thuren sot midis imperialistëve, revizionistëve dhe reaksionarëve kundër marksizëm-leninizmit, kundër socializmit, kundër lirisë e pavarësisë së popujve.

Disa vjet më parë, vetë Hrushovi mbante tjetër qëndrim për «ndihmën» amerikane, për dollarët dhe kreditë amerikane, që sot i quan si një «normë të marrëdhënieve ekonomike» midis shteteve.

Në vitin 1957, në përgjigjet e dhëna kryeredaktorit të gazetës «Nju-Jork tajms», Hrushovi, duke folur për qëllimet e ndihmës imperialiste amerikane, ndër të tjera, vinte në dukje: «Duhet të mbahet parasysh se natyra e kapitalizmit është e tillë që ai nuk mund të ndihmojë ndonjë shtet pa ndjekur gjithnjë qëllimet që i interesojnë atij. Prandaj çdo shtet socialist, ose çdo shtet tjetër, duhet të tregojë kujdes duke marrë ndihmë nga shtetet kapitaliste, për të mos humbur pavarësinë e tij.

Mos ju ka rënë në sy ndonjë mizë ose bletë që vërtitet rreth mjaltit dhe pastaj zbret mbi të? Në fillim i ngjiten këmbët, pastaj thimthi dhe pas pak del në shesh se e gjithë bleta ose miza ka mbetur e zhytur në mjaltë».

Një vit më pas, në Kongresin e 7-të të Partisë Komuniste të Bullgarisë, duke «kritikuar» klikën e Titos, që merrte ndihma nga imperializmi amerikan, thoshte: «Për çfarë arsye imperialistët, të cilët synojnë të fshijnë nga faqja e dheut shtetet socialiste dhe të shtypin lëvizjen komuniste, në të njëjtën kohë financojnë njërin nga vendet socialiste, i japin atij kredi me kushte të favorshme, si dhe dhurata pa pagesë?... Të gjithë e dinë se imperialistët asnjëherë dhe asnjërit nuk i japin të holla më kot, «për sytë e bukur», ata i derdhin kapitalet e tyre vetëm në ato ndërmarrje prej të cilave shpresojnë të marrin përfitime të mira. Në qoftë se imperialistët bien dakord që t'i japin «ndihmë» ndonjë shteti socialist këtë ata natyrisht nuk e bëjnë që ta forcojnë atë».

Duke u mbështetur në dritën e fakteve të reja, ne pyesim:

Përse imperialistët amerikanë, që synojnë të fshijnë nga faqja e dheut marksizëm-leninizmin, sistemin socialist botëror, lëvizjen komuniste e punëtore, tregohen aq zemërgjerë për të ndihmuar e për të përkrahur grupin e Hrushovit? Mos vallë ka në botë dy socializma: një socializëm që e urren për vdekje imperializmi dhe një socializëm të cilit i jep kredi e grurë? Që kur imperialistët, qarqet monopoliste të SHBA-së, qenkan



të interesuara për forcimin e socializmit e të komunizmit?

Përgjigjja është e qartë. Imperialistët ndihmojnë Hrushovin jo për të forcuar komunizmin në Bashkimin Sovjetik, po për t'i vënë kazmën, për të likuiduar fitoret e Revolucionit të Tetorit, për të likuiduar sistemin socialist, për të restauruar kapitalizmin. Për këto qëllime i janë dhënë dollarët dhe klikës së Titos, për këto qëllime i jepen ato edhe sot.

Imperialistët e përkrahin Hrushovin sepse kursi i tij është në dobi të tyre, sepse, sikurse ka thënë një nga krerët e socialdemokracisë belge e ndërkombëtare, Spaku, ish-sekretar i përgjithshëm i NATO-s: «Zoti Hrushov na ka bërë shërbime të çmueshme». Gjithashtu miliarderi Kenedi, duke vlerësuar shërbimet e Hrushovit, ka thënë se me të «filloi të fryjë filladi i freskët prapa perdes së hekurt», që do të thotë filloi evolucionin drejt të ashtuquajturës «botë e lirë».

Ç'do të thotë t'u bësh thirrje imperialistëve amerikanë për kredi dhe investime në ekonominë sovjetike afro 50 vjet pas triumfit të Revolucionit të Tetorit, në periudhën e ndërtimit të komunizmit? A nuk do të thotë kjo që dollari amerikan të thithë edhe gjakun e punëtorit e të fshatarit sovjetik, të çliruar prej kohësh nga shtypja dhe shfrytëzimi kapitalist? A nuk do të thotë kjo të bësh një hap të madh prapa drejt formash ekonomike tanimë të kapërcyera? Dhe a nuk është kjo një fyerje e diskreditim i madh për Bashkimin Sovjetik, për Partinë Komuniste të themeluar nga Lenini, për popullin sovjetik?

Sot janë bërë shumë aktuale fjalët e J.V. Stalinit,

të thëna prej tij qysh në vitin 1928; ai paralajmëronte për mundësinë e ndjekjes së dy vijave politike diametralisht të kundërta.

«Njëra nga të dyja, thoshte ai:

*Ose ne do të vazhdojmë edhe paskëtaj të zbatojmë politikën revolucionare, duke grumbulluar rreth klasës punëtore të BRSS proletarët dhe të shtypurit e të gjitha vendeve, dhe atëherë kapitali ndërkombëtar do ta pengojë me çdo mënyrë përparimin tonë;*

*ose ne do të heqim dorë nga politika jonë revolucionare, duke i bërë një varg koncesionesh parimore kapitalit ndërkombëtar, dhe atëherë kapitali ndërkombëtar, ndoshta, nuk do të jetë kundër të na «ndihmojë» për degjenerimin e vendit tonë socialist në një republikë «të urtë» borgjeze»<sup>1</sup>.*

Jeta provoi drejtësinë e parashikimeve të J.V. Stalinit.

Pikërisht këtë qëllim kanë ndjekur dhe ndjekin imperialistët me të ashtuquajturat ndihma për vendet socialiste. Këtë qëllim ndjekin ata sot edhe ndaj Bashkimit Sovjetik. Kursi revizionist i grupit të Hrushovit shpie ujë në mullirin e imperialistëve. Ai ndihmon në realizimin e strategjisë së tyre të përgjithshme për ta shndërruar Bashkimin Sovjetik në një Republikë të «urtë» borgjeze, për ta degjeneruar rendin sovjetik.

<sup>1</sup> J. V. Stalin. Veprat, vëll. 11, f. 55-56.

Grupi i Hrushovit përpqet gjithashtu që idenë e drejtë të Leninit për të marrë eksperiencën e mirë nga vendet kapitaliste, ta shtrembërojë e ta përdorë sipas qejfit, duke e zëvendësuar me idenë për të marrë gjithçka nga bota kapitaliste, e në radhë të parë nga SHBA. Çështja e përfitimit nga eksperiencia pozitive është një ide e njohur me kohë, e formuluar nga klasikët e marksizëm-leninizmit. Partitë marksiste-leniniste e përdorin drejt eksperiencën pozitive të huaj në lëmet e ndryshme, sidomos të shkencës e të teknikës. Këtu s'ka asgjë të keqe. Përkundrazi, kjo është e nevojshme.

Por në gojën e Hrushovit çështja për të marrë eksperiencë nga vendet kapitaliste, dhe sidomos nga Amerika, ka tjetër kuptim. Për të Amerika është pasqyra ku duhet parë për të mësuar për gjithçka, për të marrë çdo eksperiencë. Një shembull i qartë në këtë drejtim është edhe botimi në «Izvestia», në ditët e zhvillimit të plenumit të shkurtit të këtij viti të KQ të PK të BS, bashkë me diskutimet në plenum, i letrës së fermerit amerikan Rosuell Harst, i cili i dikton Bashkimit Sovjetik rrugët që duhet të ndjekë për zhvillimin teknik të bujqësisë sovjetike. Bile në plenumin e fundit Hrushovi bëri kërcënime të hapëta për ata që kundërshtojnë zbatimin e eksperiencës amerikane. «Në qoftë se punonjësit, tha ai, nuk duan të studiojnë dhe të vënë në jetë atë që është e re, në qoftë se ata janë shumë kundërshtarë për sa i përket marrjes së realizimeve teknike e praktike, vazhdojnë të kapen me ngulm pas së vjetrës, ata duhet të zëvendësohen dhe të vihen në vendin e tyre të tjerë, të rinj».

A nuk e tha me plot gojën Hrushovi, gjatë vizitës

së tij te klika e Titos në Jugosllavi, se çfarë eksperiencë i duhet sot Bashkimit Sovjetik? A nuk e mburri ai eksperiencën titiste të «vetadministrimit», e cila po rivendos me shpejtësi në Jugosllavi, në gjithë jetën e vendit, sistemin kapitalist? Në një fjalim përpara punëtorëve në Rakovicë, Hrushovi nuk ngurroi të kritikojë edhe metodat e drejtimit sovjetik të ekonomisë. Aty ai nënvizoi edhe një herë haptazi se eksperiencë e «vetadministrimit» jugosllav duhet të studiohet me kujdes dhe, lidhur me këtë, shtoi se do të dërgojë në Jugosllavi patjetër një grup funksionarësh të partisë, të sindikatave dhe të organeve ekonomike për të studiuar me hollësi praktikën jugosllave. Hrushovi, duke e paraqitur Amerikën si ideal për ndërtuesit e komunizmit, nënvleftëson eksperiencën shumë të vyer të Bashkimit Sovjetik, fyen njerëzit e talentuar sovjetikë, nënçmon epërsitë e rendit socialist ndaj atij kapitalist.

Por sado që të mundohet me dredhi, Hrushovi nuk do të mundë të mashtrojë për shumë kohë popullin sovjetik, Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Ai do të dështojë edhe në orvatjen e re për të shtrembëruar idetë e Leninit e pastaj për t'u maskuar pas tyre, për ta paraqitur veten si zbatues të ideve të Leninit.

Kursi i Hrushovit është mohimi i ideve të V. I. Leninit, është antileninizmi në veprim, është tradhtia më e madhe që i bëhet çështjes së Leninit, ndërtimit të socializmit e të komunizmit. Prandaj kundër këtij kursi antimarksist janë ngritur e ngrihen dita-ditës, me forca të bashkuara, komunistët e revolucionarët kudo në botë. Lufta kundër oportunizmit të grupit të Hrushovit është

lufta për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, për mbrojtjen e socializmit, për mbrojtjen e unitetit të vendeve socialiste e të lëvizjes komuniste, kjo është lufta kundër imperializmit, për mbrojtjen e paqes.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 152 (4834), 1 mars 1964*

*Botohet sipas librit: «E vërteta marksist-leniniste do të triumfojë mbi revizionizmin», vëll. i 3-të, f. 218. Tiranë, 1964*

## PUNA E PARTISË NË LAGJE ËSHTË MJAFT INTERESANTE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**21 mars 1964**

Puna e Partisë në lagje është mjaft interesante. Këtu rëndësi të madhe morale e psikologjike ka krijimi i dashurisë së njerëzve për lagjen dhe rrugën ku banojnë. Për këtë mund të bëhet një punë më e organizuar, më sistematike, që të krijohet te të gjithë ndjenja e rregullit, që njerëzit të kujdesen për pastërtinë, qetësinë në rrugën e tyre etj. Dhe në këtë drejtim është bërë njëfarë pune. Në bulevard shikon që ka pastërti, njerëzit nuk hedhin vend e pa vend mbeturina dhe fëmijët nuk i thyejnë pemët, kurse po të futesh në thellësi nuk e sheh një gjë të tillë. Pse të mos e bëjë këtë qytetari edhe në rrugicën e tij?

Ju, shokë të Komitetit të Partisë të Rrethit të Ti-

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi punën politike në lagjet e qyteteve.

ranës, duhet të punoni që të keni në qytet jo vetëm shtëpi dhe amvisa të mira, por edhe lagje shembullore, ku të ketë pastërti, rregull e qetësi, që fëmijët të mos qëndrojnë vonë rrugëve etj. Prandaj, krijimi i komisioneve që do të aktivizohen për punën politike, punën me fëmijët, pastërtinë dhe fqinjësinë e mirë është një punë mjaft e mirë që duhet vazhduar edhe në të ardhmen. Çështja është që këto komisione të aktivizohen. Njerëzit që do të bëjnë pjesë në to, t'i kryejnë detyrat mirë, të mbështeten te kolektivi dhe të udhëhiqen nga organizatat-bazë të Partisë në lagje.

Është e vërtetë se këtu në Tiranë ka lagje që kanë shumë pallate e pak vende për të luajtur fëmijët. Por ka edhe vende që janë të rrethuara me murc dhe përsëri fëmijët nuk i frekuentojnë, por luajnë në rrugë. Prandaj të punohet që fëmijët të grumbullohen në vende të përshtatshme për të luajtur e të mos rrezikohen nga aksidentet automobilistike. Në familje e në shkolla të bëhet propagandë që fëmijët të mos luajnë në rrugë, po në sheshe, ku, sa të jetë e mundur, puna të organizohet mirë. Edhe vendet e lira midis blloqeve mund të mos mbillen të gjitha me lule, por të lihen edhe sheshe për të luajtur fëmijët. Veç këtyre, mund të parashikohet edhe ndërtimi i ndonjë salle ose kinemaje të vogël. Qeveria na e lejon një gjë të tillë, sepse në Tiranë ka lagje që janë 6 herë më të mëdha, për shembull, se Gramshi, dhe se ngritja e këtyre sallave të vogla mendoj se nuk është ndonjë gjë e madhe, sidomos për kryeqytetin. Prandaj të bëhen studimet dhe propozimet përkatëse.

Parqe të mëdha është zor të ndërtojmë, mund të bëjmë 1-2, por më shumë duhen sheshet, sepse fëmijët

tanë luajnë pranë shtëpisë dhe nën kujdesin e prindërve. Prandaj është më mirë të kemi disa sheshe të vogla pranë shtëpive. Atje ku ka parqe të mëdha, të shikohet se çfarë mund të shtohet në to që të bëhen më tërheqëse për qytetarët.

Çështja e parqeve dhe e lulishteve është një gjë e mirë, por kam mendimin të mos shkohet me parimin që të gjitha rrugët t'i mbjellim me lule, pse ato duan edhe njerëz për t'i mirëmbajtur. Kështu do të duhen miliona lekë. Prandaj duhet t'i shikojmë këto që të mos bëjmë gjëra fantastike, por ato që janë të nevojshme dhe të mundshme.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*



## PO TË PËRMIRËSOJMË METODËN E PUNËS, KRIJOJMË REZERVA KOHE DHE KUADRI

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

21 mars 1964

Dëshiroj të them diçka lidhur me metodën e punës. Sikurse shihet, këtu na janë paraqitur për t'u shqyrtuar një sërë problemesh të ndryshme. Kjo ndodh se ne kemi caktuar si rregull që mbledhjet e Sekretariatit dhe të Byrosë Politike të zhvillohen një herë në muaj. Në vendosjen e këtij rregulli ne jemi nisur nga kriteri që të na lihet kohë për të vajtur në bazë. Ky është një kriter i drejtë. Por në përgjithësi më duket se po abuzohet në kriterin që kemi caktuar dhe si pasojë rezultatet nuk janë të dëshiruara. Neve na vijnë këtu në Sekretariat 14-15 probleme dhe pothuaj kaq pro-

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi gjendjen e kuadrit në aparatet e Komitetit Qendror dhe aparatet e komiteleve të Partisë në rrethe, në Shkollën e Lartë të Partisë «V. I. Lenin», në organet e pushtetit e të organizatave të masave si dhe në disa dikastere qendrore.

bleme na vijnë edhe për mbledhjen e Byrosë Politike. E njëjta gjë ndodh edhe me Qeverinë. Kryesisë së Këshillit të Ministrave i paraqiten për shqyrtim 16-17 probleme dhe 10-12 probleme mbledhjes së Qeverisë. Kjo e kufizon vajtjen në bazë dhe nuk u lë kohë shokëve për të studiuar problemet e shumta që na paraqiten për shqyrtim.

Në qoftë se neve na paraqitet një mori e tillë çështjesh, si do të bëhet trajtimi i tyre? Më gjithë vullnetin tonë të mirë këto nuk mund të shikohen si duhet. Unë mendoj se, që të mund t'i studiojmë më thellë problemet që na paraqiten dhe të marrim vendime të drejta, duhet ta lëmë këtë metodë pune dhe t'i bëjmë një herë në dy javë mbledhjet e Byrosë Politike dhe të Sekretariatit. Po kështu të veprojnë edhe Kryesia e Këshillit të Ministrave dhe Qeveria. Për këtë qëllim ne duhet të shikojmë planin e çështjeve që kemi aprovuar, në mënyrë që të mos na vijnë në mbledhje më tepër se dy prej tyre, e shumta tri, sepse ne, sekretarët e Komitetit Qendror, për çështje praktike takohemi çdo ditë.

Në këtë mënyrë neve, sekretarëve dhe anëtarëve të Byrosë Politike, do të na duhen katër ditë për t'u përgatitur. Kaq ditë janë të mjaftueshme për t'i lexuar materialet dhe për t'u konsultuar me njerëz të tjerë. Kështu mbeten për shokët sekretarë dhe anëtarët e Byrosë Politike 10 ditë të lira për të vajtur në rrethe.

Edhe kur venë në bazë shokët e Partisë dhe të Qeverisë duhet të kenë parasysh disa kritere. Ka vajtje në bazë për t'u informuar e për të shikuar, ka dhe vajtje për punë konkrete. Natyrisht, kur velet për punë

mund edhe të informohesh. Ja, unë vajta, për shembull, në konferencën e Partisë të Korçës. Me këtë rast vizitova Fabrikën e Trikotazhit dhe disa qendra të tjera. Për t'u informuar, për të marrë kontakt me njerëzit e fabrikës, për të mbajtur shënime dhe për t'u dhënë atyre disa udhëzime, është e mjaftueshme 3 ose e shumta 5 orë, sepse më parë atje kanë vajtur edhe shokë të tjerë të Partisë ose të organeve të pushtetit. Prandaj, për të vajtur me punë në një rreth mund të jenë të mjaftueshme edhe dy ditë. Kështu, kur ke 10 ditë në dispozicion, është një gjë e mirë.

Kuptohet që vajtja në rrethe duhet të koordinohet, që të mos shkohet në 5 rrethe njëherësh, se vendi ynë është i vogël. Në qoftë se vete në Krujë, që është këtu afër, mund të qëndrosh tri orë dhe të kthehesh përsëri në mbrëmje. Prandaj më duket se kur ke 20 ditë në dispozicion në muaj mund të shkosh jo në një, por në katër rrethe. Por edhe vajtja në këto katër rrethe duhet të koordinohet mirë, pse në qoftë se tani vajta unë në Korçë, pas 10 ditësh vete, ta zëmë, shoku Hysni dhe pas 10 ditësh të tjera shoku Mehmet, kjo nuk është e drejtë. Në këtë mënyrë do të gozhdojmë edhe kuadrat e rrethit.

Shtrohet çështja se kush duhet t'i përgatisë materialet që do t'i paraqiten për shqyrtim udhëheqjes? Këto materiale duhet t'i përgatitë aparati në bashkëpunim me specialistë të sektorëve përkatës. Në radhë të parë përgjegjësinë për përgatitjen e tyre e ka aparati. Në qoftë se shkojmë nga parimi që inspektorët dhe instruktorët të qëndrojnë 20 ditë në rrethe, kjo nuk është e drejtë. Këtu më duket që abuzojnë instruktorët dhe

drejtoritë. Ne duhet t'i bëjmë një rishikim serioz kësaj çështjeje, sepse sot në rrethe kuadrot janë rritur. Që të vejë një instruktor e të qëndrojë 20 ditë në një rreth ku ka gjithë ata kuadro, më duket se është e tepërt ose u pret iniciativën shokëve të bazës. Instruktori mund të shkojë në një ose dy organizata-bazë për të parë gjendjen e për të ndihmuar dhe jo për të qëndruar 20 ditë.

Po ta shikojmë problemin në këtë mënyrë, jo vetëm që nuk do të humbasim kohë, po do t'i drejtojmë këta njerëz që janë këtu të na përgatitin si duhet materialet. Eksperienca e Partisë mund të merret nga të dhënat e instruktorëve që kanë vajtur në bazë, nga sekretarët e komiteteve të Partisë që vijnë këtu dhe nga raportet që bëjnë komitetet e Partisë. Prandaj këto materiale duhet të studiohen me kujdes.

Të vijmë tani te çështja e organikave, nëse kemi njerëz shumë ose pak. Në qoftë se zbatojmë një metodë më të mirë pune, do të na dalë që kemi mjaft njerëz në organika. Po akoma më shumë njerëz kanë dikasteret. Shokët e rretheve na thonë se pengohen nga të dërguarit e dikastereve. Sigurisht që këta i ndihmojnë, por, po ta analizosh thellë këtë çështje, dyshoj se kjo ndihmë nuk është për ato detyra që shokët e rretheve nuk i zgjidhin dot.

Kjo gjë duhet thënë si për ne të qendrës, ashtu edhe për shokët e rretheve, sepse sot ndodh që sekretari i komitetit të Partisë merr automobilin dhe vete, për shembull, në Kuç për një problem, të cilin mund ta zgjidhë edhe me telefon. Mirë, fundja vajti sekretari i komitetit të Partisë, por nesër vete kryetari i komite-

tit ekzekutiv e kështu me radhë. Çfarë bëjnë të gjithë këta njerëz që shkojnë njëri pas tjetrit në një fshat?

Këtu e kam çështjen që nuk duhet të abuzohet me fjalët «të vemi në bazë». Prandaj s'jemi për vajtje të tilla. Kur të shkohet në bazë, të mendohet mirë qysh më parë se për çfarë do të shkohet në këtë ose atë qendër pune dhe të llogaritet koha sa do të qëndrohet për të ndihmuar e për të kontrolluar.

Të gjitha këto nuk mund të bëhen menjëherë. Gjatë muajit prill mund të vazhdojmë punën sipas planit që kemi aprovuar, kurse për më vonë, t'i shikojmë planet që kemi bërë si për Sekretariatit dhe për Byronë Politike. Të shikohen gjithashtu planet e instruktorëve dhe të inspektorëve duke pasur parasysh kohën që do të harxhojnë, problemin që do të shikojnë dhe nëse janë në gjendje ta bëjnë këtë ose atë punë vetë sekretarët e komiteteve të Partisë ose jo etj. Kështu do të kemi rezerva kohe dhe kuadri.

Edhe mbledhjet e plenumeve duhen parë, se ndoshta duhen bërë më pak. Nga ana tjetër, raportet të jenë deri në 15 faqe, duke u zhveshur nga gjërat e përgjithshme dhe teprimet. Këto të paraqesin problemet kryesore që e preokupojnë organizatën e Partisë dhe të kenë kritikë e autokritikë. Kurse sot ne e dimë se si përgatiten raportet dhe diskutimet. Ne duhet ta mësojmë Partinë që të mos vijë në konferencë me fjalë bombastike. Në Sarandë, për shembull, dukej sikur çdo gjë shikonte si në vaj, por doli se nuk ishte kështu. Atje ishte krijuar një atmosferë sikur ishin vetëm sekretari i parë dhe i dytë ata që punonin, kurse të tjerët na qenkeshin sa për numër dhe mjerë ai që do të kriti-

konte. Me këtë nuk dua të them se te ne nuk ka kritikë. Puna është që kjo të bëhet gjithnjë e më mirë dhe drejt. Në Parti njerëzit duhet të shfaqin mendimet e tyre dhe udhëheqja e Partisë të japë shpjegime.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## PUNA E PARTISË NË USHTRI LUAN NJË ROL VENDIMTAR

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**25 mars 1964**

Edhe unë jam dakord me diskutimet që u zhvilluan, me kritikën dhe me autokritikën që bënë shokët e ushtrisë. Kryesisht ne kemi më shumë gjëra të mira në ushtri, po kemi edhe dobësi. Unë mendoj se, pavarësisht nga këto të meta që ekzistojnë, në përgjithësi ushtrinë e kemi në gatishmëri.

Shumë nga të metat që u thanë dhe që duken në këtë kohë, sigurisht, në të ardhmen do të eliminohen. Është e drejtë ajo që thanë shokët që të metat të mos i mbulojmë, por, duke i parë këto në sy, të punojmë që t'i zhdukim.

---

1 Në këtë mbledhje të Byrosë Politike të KQ të PPSH u diskutua «Mbi përgatitjen luftarako-politike të ushtrisë për vitin 1963».

Siç diskutuan shokët, të dy drejtimet janë të rëndësishme për ushtrinë, si ana e Partisë, ashtu edhe ana ushtarake. Njëra pa tjetrën nuk mund të bëjnë. Po të mos jetë mirë njëra anë, do të çalojë edhe tjetra. Prandaj të dyja këto duhet të jenë të harmonizuara. Teknika do të plotësohet, strategjia e taktika e ushtrisë do të jenë të mira, kur kjo të jetë e përgatitur si duhet. Këtu puna e Partisë luan një rol të madh vendimtar. Kjo punë duhet të konsistojë që teknika të merret në dorë dhe të përvetësohet. Puna e Partisë duhet të jetë e gjallë, luftarake dhe jo shabllone. Fryma teknokrate që duket të disa njerëz, siç tha këtu një shok, duhet të zhduket. Puna politike duhet të jetë hallka kryesore për përgatitjen ushtarake dhe për forcimin e ndërjegjes së njerëzve. Prandaj të mos harrohen as ana ushtarake dhe as ajo e Partisë. Këtë gjë Partia duhet ta bëjë të qartë.

Në qoftë se i bëjmë vlerësim të mirë anës përgatitore ushtarake, natyrisht aty përfshihet edhe puna e Partisë, por, po ta analizojmë pak më në hollësi anën e edukimit ushtarak me punën e Partisë, më duket se, kjo e fundit, është njëçikë më e dobët. Ne shohim se në çështjet teknike dhe të ruajtjes së armëve ecet më shpejt. Natyrisht, këtu përfshihet edhe puna e Partisë, por më duket sikur kjo qëndron më pas dhe nuk shkon paralelisht me vrullin që ecën ana teknike, sepse shikojmë mjaft gjëra të jashtëzakonshme që na japin sinjalizimin se organizata e Partisë atje nuk është e gjallë dhe nuk qëndron afër njerëzve. Në qoftë se Partia nuk qëndron afër ushtarit dhe oficerit, atëherë ndonjë prej tyre arrin edhe në arrest. Nuk është arritur akoma që



masat ndëshkimore të përdoren si duhet, sipas gabimeve e fajeve. Punëtorët e Partisë duhet të gjykojnë për të dhënë dënime sipas rastit dhe të mos lejojnë dënime të padrejta. Çështja është këtu: një njeri mund ta dënosh, por mund edhe t'i flasësh rreptë e të mos e dënosh dhe këtë ai të mos e harrojë gjithë jetën. Mënyra e veprimit është mjaft delikate dhe është e lidhur me natyrën e njeriut. Prandaj këtu luan një rol të madh Partia.

Këtu u ngrit çështja e përgatitjes së kuadrove tanë të lartë me një kulturë ushtarake të gjerë dhe me njohuritë e duhura teorike për zbatimin e operacioneve. Këta janë të përgatitur me kulturë dhe aftësi teknike, por në kushtet e reja, ka ardhur koha që këta, me atë horizont që kanë pasur më parë, nuk u përgjigjen si duhet kërkesave të tanishme. Kjo është një çështje me rëndësi të madhe. Edhe për këtë duhet të na paraqitet një raport. Ky studim duhet të na shërbejë jo vetëm për çështjen e edukimit të kuadrit që kemi, po të shikojmë edhe programet e Akademisë dhe të shkollave ushtarake, në mënyrë që këto të jenë krejtësisht të përshtatshme për detyrat që na dalin. Si këto mund të ketë edhe disa probleme të tjera të këtij kalibri, që kanë interes jetik për ushtrinë. Këto çështje duhet t'i shikojmë në mbledhjet që do të kemi.

Për sa i përket asaj që u tha këtu, se ushtarakët janë mësuar në përgjithësi për mbrojtje, duhet të bëjmë që ata të mësohen edhe për mësymje, kundërgoditje, kundërsulme. Në këtë drejtim kuadrove ushtarakë u duhet hapur horizonti.

Gjithashtu, nga ana operative puna duhet të jetë më e gjerë. Ju që merreni drejtpërdrejt me ushtrinë, duhet ta keni parasysh këtë.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha «Në ndihmë të Ushtrisë Popullore», vëll. II, f. 493.  
Tiranë, 1975*

*Botohet, me ndonjë shkurtim, sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

# PLANI PESËVJEÇAR TË MBËSHTETET NË RADHË TË PARË NË MUNDËSITË TONA TË BRENDSHME

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**25 mars 1964**

Mendimet që do të shfaq nuk dalin jashtë kuadrit të diskutimeve që bënë edhe shokët, me të cilat jam dakord, prandaj të shikohen së bashku me të gjitha vërejtjet e tyre.

Në përgjithësi mendoj se ne kemi një eksperiencë pak a shumë të gjatë, me suksese dhe vështirësi, dhe të gjitha këto duhet të na ndihmojnë për të hartuar një plan pesëvjeçar, që t'i përgjigjet realitetit.

Ky plan pesëvjeçar duhet të synojë në zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë popullore, me qëllim që të përmirësohet më shumë jeta e popullit. Të hartojmë

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi orientimin e përgjithshëm për hartimin e projektplanit të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës popullore për pesëvjeçarin e katërt 1966-1970 dhe mbi programin e punës.

një plan real dhe të mbështetur, në radhë të parë, në mundësitë e brendshme, proporcionet e tij të jenë shkencërisht të bazuara dhe të synojnë në zhvillimin e ekonomisë më shumë në thellësi. Mbi të gjitha plani duhet të jetë i mbështetur financiarisht në të ardhurat kombëtare.

Industrisë ekzistuese duhet t'i japim një orientim më të përsosur në drejtim të shfrytëzimit të plotë të kapaciteteve të saj. Kjo është e para. Çështje tjetër është zgjerimi rentabël i saj drejt modernizimit dhe automatizimit. Shumë shokë folën gjerë për këtë problem, si për industrinë ushqimore ashtu dhe për degët e tjera. Prandaj bazën e industrisë që kemi, ta përmirësojmë si duhet, në mënyrë që ajo të prodhojë më mirë, më shumë dhe më lirë. Ky të jetë qëllimi kryesor. Veç kësaj, duhet që mundësisht e gjithë industria jonë të punojë me lëndët e para në vend dhe të sigurojë në një shkallë më të gjerë, prodhimin e veglave të ndërrimit dhe makinerive në vend. Ky duhet të jetë qëllimi i dytë kryesor. Si pasojë, me një industri të tillë dhe me këto orientime, të arrijmë të zëvendësojmë në një shkallë të gjerë një mori sendesh të nevojshme për popullin, të cilat tani i importojmë. Kjo çështje duhet parë në mënyrë serioze që shumë artikuj t'i heqim nga importi. Ky të jetë qëllimi i tretë kryesor.

Çfarë mund t'i shtohet industrisë sonë gjatë pesëvjeçarit të katërt? Unë them se mund të mbahen parasysh:

Të ndërtohet një fabrikë çimentoje në Elbasan dhe një në Krujë. Çimentoja mund të hyjë në ndërtim dhe kudo. Ritmin e ndërtimeve duhet ta shpejtojmë, por

jo me kosto të lartë. Për këtë mund të ishte e nevojshme dhe ngritja e një fabrike panelesh. Kjo çështje duhet të na preokupojë, sepse në ndërtim duhet të ulim koston dhe të rritim rendimentin në punë.

Për industrinë ushqimore, përveç atyre që u thahen, mund të shikohet që të ndërtojmë fabrika të vogla, po moderne, për djathëra të buta, qumësht pluhur etj., sepse ne jemi një vend blegtoral. Po kështu të bëjmë modernizimin dhe zgjerimin e fabrikave të frutave dhe të zarzavateve.

Lidhur me prodhimet e veshmbathjes, të shikojmë modernizimin dhe zgjerimin e fabrikës së leshit që të prodhojmë stofa të mira për konsum të brendshëm. Për sa u përket këpucëve, ne duhet të heqim dorë nga importimi i tyre, prandaj të modernizojmë dhe të zgjerojmë fabrikat ekzistuese, në mënyrë që të mos sjellim më këpucë nga jashtë, por këto t'i prodhojmë në vend. Të modernizojmë e të zgjerojmë edhe fabrikën e porcelanit.

Për uzinat mekanike jam plotësisht dakord me shokët që të bëhet përqendrimi, modernizimi i mëtejshëm i tyre, përcaktimi i profileve të reja, specializimi dhe automatizimi, duke u caktuar edhe plan, në mënyrë që me anën e këtyre uzinave jo vetëm të ulim pjesët e këmbimit që importojmë, po të ndërtojmë edhe makineri. Mendoj që këto uzina të thithin edhe të gjitha prodhimet e artizanatit për fshatin dhe të prodhojnë më shumë mallra të konsumit të gjerë e të nevojës së përditshme për popullin, të cilat sot i bëjmë me kosto të lartë e harxhojmë shumë materiale, ose i sjellim nga jashtë. Uzinat dhe bazat mekanike

duhet të fillojnë të prodhojnë edhe kazma e lopata, duke i stampuar, hekura për hekurosje, soba për ngrohje etj. Po këto nuk mund të bëhen pa një centralizim dhe specializim të uzinave dhe të bazave mekanike. Këtu më duket që Byroja Politike dhe Qeveria duhet të kapërcejnë shpirtin e repartit të këtij ose të atij dikasteri. Ne mund t'u lëmë dikastereve minimumin e domosdoshëm të makinerive dhe pajisjeve për nevojat e tyre dhe jo makineri për të prodhuar vegla ose bulona në seri. Këtë nuk duhet ta lejojmë. Artizanatit t'i lëmë vetëm riparimet dhe specialistët e tij mund të përdoren në uzinat mekanike.

Siç e thanë edhe shokët, këto çështje kanë një rëndësi të jashtëzakonshme për vendin tonë. Prandaj mendoj që Komisioni i Planit të Shtetit ta shikojë shumë leverdinë dhe rentabilitetin e përqendrimit, modernizimit dhe specializimit të uzinave mekanike për vendin tonë. Në rast se ne do të bëjmë këto përqendrime në industrinë mekanike, mendoj të shikojmë edhe çështjen e importimit të tornove e të frezave, që i sjellim sot në mënyrë të shkëputur. Të evitojmë në maksimum sjelljen e veglave të ndërrimit nga jashtë dhe të importojmë më shumë hekur për prodhimin e tyre në vend. Prandaj shtimi i hekurit nuk duhet të na frikësojë. Ky pesëvjeçar duhet të ketë si orientim pakësimin e importimit të veglave, prodhimin e tyre brenda, mirë dhe lirë, përgatitjen e një industrie mekanike dhe të makinave më të zgjeruara për pesëvjeçarin e pestë, tok me zgjerimin e metalurgjisë, përgatitjen e specialistëve për përpunimin e hekurit.

Për sa u përket minierave mendoj që ky pesëvje-

çar duhet të synojë në kërkime dhe në zgjerimin e rezervave të mineraleve të njohura: në naftë, krom, hekur, hekur-nikel, bakër, boksit, qymyr dhe minerale të rralla, disa prej të cilave t'i shfrytëzojmë me mjete të brendshme. Prandaj këtë pesëvjeçar duhet të zgjerojmë kërkimet dhe të sigurojmë rezervat.

Pesëvjeçari i katërt duhet të jetë njëkohësisht përgatitor, për të filluar studimet dhe projektimet e veprave të mëdha, pavarësisht nëse këto janë të leverdishme. Të punohet për projektimin e hidrocentraleve të reja dhe të hekurudhave, duke studiuar edhe se ku duhet t'i ndërtojmë këto. Në radhë të parë ne duhet të dimë sa janë rezervat e mineraleve; të gjitha këto janë të lidhura zinxhir me njëra-tjetrën, sepse në qoftë se duam të ndërtojmë metalurgjinë, kjo është e lidhur me hidrocentralet, hekurudhën etj. Prandaj brenda këtij pesëvjeçari ne duhet të bëjmë një studim frontal dhe të përgatitemi edhe për projektet, sepse, siç e dimë, këto nuk janë shumë të studiuara. Kështu do të jemi më të përgatitur për pesëvjeçarin e pestë.

Mendoj se gjatë pesëvjeçarit të katërt për minierat nuk duhet të bëjmë investime që janë jashtë mundësive tona. Ne do të caktojmë një plan për minierat dhe këtë duhet ta sigurojmë me aq investime sa nevojiten.

Naftën duhet ta konsiderojmë burimin më kryesor. Prandaj mendoj që në pesëvjeçarin e katërt, prodhimi i naftës të shtohet. Kjo është e domosdoshme. Për këtë të parashikohen investimet që nevojiten për pro-

dhimin e saj, duke përdorur në maksimum makinerinë që kemi.

Të mendojmë edhe për rafineri moderne. Naftës duhet t'i vemi gjer në fund, në përpunimin e saj, në përdorimin e çdo derivati të saj; të prodhojmë më shumë gjëra prej derivateve, të ulim importin dhe të shtojmë eksportin e materialeve të përpunuara. Ne nuk duhet të kënaqemi me gjëra të vogla, po të gjejmë makineri moderne për të rafinuar naftën që kemi. Pastaj ne duhet të shikojmë për materialet plastike, se ka leverdi të madhe. Prandaj të kërkojmë që kjo makineri të jetë komplekse dhe moderne për të shfrytëzuar gjer në fund prodhimet e naftës.

Në këtë drejtim mendoj të japim këto orientime:

E para, ky pesëvjeçar të jetë pesëvjeçari i vlerësimit sa më të madh të naftës, kësaj pasurie të madhe të vendit tonë, jo vetëm në zbulime, por edhe në përpunim. Ky problem duhet të studiohet në thellësi dhe t'i shkohet deri në fund.

E dyta, të marrim masa për modernizimin dhe automatizimin e proceseve ekzistuese.

Naftën të mos e përdorim për djegie në TEC-et, sepse kjo është antiekonomike. Prandaj synimi ynë duhet të jenë hidrocentralet. Në TEC-et duhet të përdorim qymyr.

Për gazin orientimi ynë duhet të jetë ky: Të zbulojmë dhe të përcaktojmë rezervat, prandaj në këtë fushë të intensifikojmë kërkimet. Veç kësaj, me anë të gazit të vëmë në lëvizje disa qendra industriale. Në qoftë se shfrytëzojmë gazin, ne do të ekonomizojmë



lëndën e drurit. Kjo mund të na vlejë për të mbuluar këtë lëndë deficitare dhe për të ulur transportin.

Në qoftë se nuk rëndohemi në plan, të ndërmarim ndërtimin e një fabrike për prodhimin e sendeve plastike, se me anë të lëndëve plastike mund të prodhohen sende të nevojshme për konsum të gjerë, të bukura dhe të lira, si për nevojat e brendshme, edhe për eksport.

Në lidhje me transportin mendoj që parashikimet të mos jenë të tilla sa të mos na dalin llogaritë. Prandaj këtë pesëvjeçar të evitojmë ndërtimin e hekurudhave dhe të përqendrohemi në projektimin e tyre. Gjithashtu të mendojmë për zëvendësimin e rrugëve pyjore me teleferik.

Bujqësia duhet të bëhet objekti kryesor i këtij plani pesëvjeçar. Në bujqësi duhet të forcojmë punën sidomos në këto drejtime: në bonifikime, ujitje, sisteme, mekanizim dhe plehërim. Këto duhet t'i shërbejnë frontalisht zhvillimit të të gjithë bujqësisë, të gjitha prodhimeve bujqësore e blegtorale, pra të ecet drejt modernizimit të bujqësisë, ngritjes së rendimenteve në çdo kulturë dhe sektor të saj.

Zhvillimi i bujqësisë fillon që nga punimi më i mirë i tokës dhe deri te shtimi i numrit të kuadrove, prandaj të synojmë, në radhë të parë, duke përmirësuar rrënjësisht punën në bujqësi, të fillojmë ose të shpejtojmë atje ku mund të kemi përfitime më shumë e më shpejt, të studiojmë mirë investimet, proporcionalisht sipas interesit të zhvillimit dhe investimet e një sektori të mos pengojnë ose të mos ngadalësojnë zhvillimin e degëve të tjera të domosdoshme. Të marrim, për shem-

bull, çështjen e mekanizimit. Mekanizimi i madh në asnjë mënyrë të mos na shpjerë në pakësimin e pendëve të qeve.

Për punimin e tokave, për ujitjen dhe bonifikimin e tyre, të planifikojmë në mënyrë të harmonishme investimet shtetërore me ato kooperativiste. Këtë nuk e kemi bërë në shkallë të gjerë dhe të organizuar mirë. Megjithëse kooperativat janë ekonomi socialiste të një grupi njerëzish, investimet për to, ne si shtet, më duket sikur ia kemi lënë pak spontaneitetit, prandaj, në të ardhmen të planifikojmë pjesëmarrjen më të gjerë të kooperativave bujqësore në ndërtimin e kanaleve dhe në punime të tjera krahu që ndërmerr shteti. Kjo nuk do të thotë që shteti të mos llogaritet më mirë pjesëmarrjen e fshatarësisë në zhvillimin e bujqësisë. Prandaj, siç thanë shokët, jo të japim më shumë kredi për ditët e punës, por për bazën materiale. Kooperativat bujqësore mund të investojnë edhe vetë për zhvillimin e tyre.

Gjatë këtij planifikimi të orientojmë më mirë për zhvillimin e kulturave të arave, të blegtorisë dhe të frutikulturës në kooperativat e fushës dhe në ato kordinore e malore. Në bujqësi të japim orientimin që gjatë këtij pesëvjeçari të shtojmë fondet për bonifikime të mëtejshme; të ndërmarrim një plan të madh ujitjeje; të shtojmë mekanizimin, ashtu sikurse u tha, të balancuar në traktorë, kombajna, buldozerë, plugje, vegla të thjeshta bujqësore etj.; të përmirësojmë farnat, sidomos të drithërave, të pambukut dhe të panxharit; të marrim masa për të siguruar insekticidet e domosdoshme, për të luftuar kundër sëmundjeve; t'i

kushtojmë kujdes problemit të shtimit të qeve, sidomos në zonat malore dhe për transport në zonat fushore.

Çështja kryesore në bujqësi, sikurse thanë edhe shokët, duhet të jetë mbi të gjitha sigurimi i bukës. Unë jam i mendimit se, me masat që do të marrim për ujitjen, bonifikimet dhe mekanizimin, rendimentet e caktuara nuk janë të paarrtshme. Por bujqësia duhet të sigurojë gjithashtu industrinë me lëndët e para.

Veç këtyre, duhet të na preokupojë rritja e sasisë së mishit dhe e yndyrnave. Për peshkun dhe zarzavatat të japim një orientim për një zhvillim akoma më të madh gjatë pesëvjeçarit të katërt, në mënyrë që të plotësohen më mirë nevojat për to. Prandaj të shtojmë në mënyrë të konsiderueshme zënien e peshkut dhe prodhimin e zarzavateve. Këto të fundit duhet të shtohen për t'i ngrënë të njoma dhe për prodhim konservash për konsum të brendshëm dhe eksport. Rëndësi t'i japim veçanërisht prodhimit sa më shumë të fasules dhe të patates; shtimin e prodhimit të tyre duhet ta konsiderojmë edhe si pakësim të konsumit të bukës, sepse ato janë bukë e gjellë.

Për përmirësimin e jetesës së popullit jam dakord me mendimin e të gjithë shokëve, që nuk mund të ecim me një rritje kaq të vogël gjatë pesëvjeçarit. Përmirësimi i jetesës së popullit duhet të planifikohet në mënyrë shumë të ndjeshme për çdo vit. Ky përmirësim duhet të vijë jo nga rritja e rrogave, por nga ulja e çmimeve dhe nga zënia me punë e forcave të reja.

Për përmirësimin e jetesës së popullit duhet të kemi si orientim që investimet e tepërta të evitohen dhe të harmonizohen akumulimet me uljen e çmime-

ve. Të shtohet rendimenti, të ulët kostoja etj. Në përmirësimin e jetesës së popullit do të ndikojnë edhe rritja e ndërtimit të banesave, hapja e shkollave të reja, shtimi i shtëpive të kulturës dhe i disa kinemave ose teatrove të rinj, asfaltimi i rrugëve e i trotuarëve, ngritja e parqeve, dhënia e ilaçeve falas për fëmijët deri në 1 vjeç etj. Mendoj që në hartimin e këtij plani të kemi parasysh ngritjen e nivelit të jetesës së popullit dhe këto të bëhen të gjitha të koordinuara. Prandaj të studiohen të gjitha këto për të parë se çfarë mundësi kemi për këtë problem të rëndësishëm.

Për sa i përket çështjes së import-eksportit këto do të shikohen më tej. Shifra që është vënë për eksportin, në qoftë se është e lartë, mund ta ulim pak.

Kështu, pesëvjeçari i katërt duhet të jetë, në radhë të parë, pesëvjeçari i bujqësisë, i zhvillimit të mëtejshëm të industrisë, minierave, i zgjerimit të rezervave të minierave dhe pjesërisht i përpunimit të tyre në vend, i modernizimit, automatizimit dhe shtimit pjesërisht të industrisë së gazit, i koncentrimit të mekanikës, të uzinave, i uljes së pjesëve të ndërrimit dhe i sendeve të nevojës së parë nga importi dhe fabrikimi i tyre në vend, i ngritjes së mirëqenies së popullit etj. Kurse pesëvjeçari i pestë — pesëvjeçari i industrisë së rëndë, kryesisht i hidrocentraleve, hekurudhave etj.

Lidhur me projektvendimin që na është paraqitur, mendoj se këtë nuk mund ta pranojmë kështu. Propozoj që t'u japim shokëve të gjitha propozimet dhe diskutimet që u bënë në këtë mbledhje të Byrosë Politike, të cilat pasi të studiohen, të pasqyrohen në projektvendim dhe ky të na paraqitet për ta aprovuar. Nuk

do të ishte keq që ky plan pesëvjeçar t'i vijë Byrosë Politike edhe dy herë, ose t'i paraqitet një herë Byrosë Politike dhe dy herë Qeverisë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbajtur në mble-  
dhjen e Byrosë Politike të KQ  
të PPSH që gjendet në AQP*

**FUSHATA E ZGJEDHJEVE PËR KËSHILLAT  
POPULLORË KA RËNDËSI POLITIKE,  
ORGANIZATIVE DHE EKONOMIKE**

*Fjala e mbylljes në mbledhjen e Këshillit të  
Përgjithshëm të Frontit Demokratik  
të Shqipërisë*

**30 mars 1964**

*Mbas aprovimit të Thirrjes së Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë, lidhur me zgjedhjet e këshillave popullorë të rretheve, qyteteve, lokaliteteve, lagjeve si dhe zgjedhjet për gjykatat popullore, e mori fjalën shoku Enver Hoxha:*

Në bazë të kësaj thirrjeje do të punojnë tani gjithë Fronti dhe organizatat e tjera të masave nën udhëheqjen e Partisë.

Nuk dua të zgjatem, se të gjithë e kuptojmë rëndësinë e kësaj fushate kaq të madhe, siç u theksua dhe nga raporti, që mbajti shoku Gogo Nushi, dhe nga diskutimet që u bënë, por dua të theksoj, që të mos ha-

rrojmë, se mobilizimi i popullit, i Partisë, i organizatave të masave për realizimin e kësaj platforme dhe fushate, nuk ka vetëm rëndësi politike, por dhe organizative, sepse do të zgjidhen këshillat dhe gjykatat popullore, ka njëkohësisht karakter ekonomik sepse do të mobilizohet populli për realizimin e problemeve ekonomike që kemi përpara. Të gjitha këto së bashku kanë një rëndësi të madhe politike për sa i përket pozitës sonë ndërkombëtare.

Situata për ne është e favorshme, si ajo ndërkombëtare ashtu edhe ajo brenda vendit.

Për sa i përket asaj ndërkombëtare, politika e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe e të gjitha partive të vërteta marksiste-leniniste si dhe lufta e gjithanshme e gjithë marksistë-leninistëve dhe e njerëzve përparimtarë të botës, kanë bërë që situata ndërkombëtare të jetë në favor të paqes, të përparimit, të luftërave nacionalçlirimtare, kundër imperializmit amerikan, kundër revizionizmit.

Imperializmi amerikan ka filluar me hapa të mëdhenj të shkojë drejt disfatave të tij. Qëllimi kryesor i imperializmit amerikan është që të dominojë botën, t'i mbajë popujt në skllavëri, t'i vërë shtetet e tjera borgjeze imperialiste e kapitaliste nën drejtimin e vet, të likuideojë marksizëm-leninizmin e socializmin dhe t'i futë ata që mund t'i futë nën drejtimin e tij. Mirëpo, siç dihet, ai po pëson dita-ditës disfata pas disfatash, dhe nuk po ia arrin dot që vendet kapitaliste t'i mbajë nën sundimin e vet, sepse midis tyre ka kontradikta të mëdha që thellohen e ashpërsohen deri në konflikte.

Pra, kampi imperialist, me në krye Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ka filluar të ketë të çara serioze, të cilat janë shkaktuar nga lufta parimore e partive marksiste-leniniste dhe nga lufta e popujve që luftojnë kundër kolonializmit të vjetër dhe të ri dhe kundër imperializmit amerikan. Prandaj, në këtë drejtim, ne mund të themi se nuk është aq lehtë që imperializmi amerikan të shpërthejë një luftë të madhe botërore.

Në shumë vende të botës po ziejnë luftërat nacionalçlirimtare kundër imperializmit dhe, në radhë të parë, kundër imperializmit amerikan, kundër tendencës së tij që të dominojë politikisht, ushtarakisht ekonomikisht. Shohim që në Azi, në Afrikë dhe në Amerikën Latine është hallka më e dobët e imperializmit amerikan. Pra, është shumë e drejtë ajo që thuhet nga partitë marksiste-leniniste që popujt dhe në radhë të parë popujt e Azisë, Afrikës dhe të Amerikës Latine duhet të ndihmohen, sepse atje ka shpërthyer zjarri i luftës për liri dhe pavarësi kundër shtypjes dhe kolonializmit, kundër imperializmit, në radhë të parë atij amerikan. Fitorja përfundimtare nuk është çështje ditësh, por situata ecën përpara, ajo zhvillohet në dëm të imperializmit dhe të shërbëtorëve të tij.

Prandaj, ne themi se situatat janë të favorshme. Dhe këtë e themi se, siç e ka bërë të qartë Partia, në radhët e lëvizjes komuniste ndërkombëtare ka lindur dhe është rritur një rrymë tradhtarësh e bashkuar me imperializmin amerikan, rryma e revizionistëve modernë, në krye të të cilëve qëndrojnë Hrushovi, Titoja, Toliati dhe të tjerë. Këta kanë marrë përsipër të shkatërrojnë marksizëm-leninizmin, të bashkohen me im-



perializmin dhe të deklarojnë luftënxitëse Shqipërinë dhe popuj të tjerë që luftojnë kundër imperializmit. Këta janë të lidhur politikisht e organizativisht dhe qëllimi i tyre është që Bashkimi Sovjetik dhe imperia- lizmi amerikan të dominojnë botën, të krijojnë një forcë të tillë për ta mbajtur këtë nën shtypje. Ky është qëllimi i revizionistëve, si agjentë të imperia- lizmit, që janë të rrezikshëm sepse janë edhe në pu- shtet. Ata përfitojnë nga forca e Bashkimit Sovjetik, nga prestigji që kishte Bashkimi Sovjetik, por ata janë tradhtarë të socializmit dhe të popujve. Në këtë gjendje të krijuar nga revizionistët, u ngritën në luftë kundër tyre partitë e vërteta marksiste-leniniste. Ne jemi në rrugë të drejtë, sepse mbrojmë deri në fund marksizëm- -leninizmin, sepse çdo veprimtari jona, udhëhiqet nga teoria marksiste-leniniste, nga interesat e popullit, se- pse ajo bazohet në unitetin internacionalist të klasës punëtore të të gjitha vendeve, sepse ne jemi shumica, jemi më të fortë se imperializmi amerikan dhe ata që e pasojnë, sepse Hrushovi, Titoja etj. janë me pakicën.

Revizionistët që sundojnë në Bashkimin Sovjetik dhe në partitë revizioniste të vendeve ish-socialiste të Evropës dhe të vendeve kapitaliste, janë klika, të cilat po izoloohen çdo ditë, sepse çdo ditë e më shumë masat atje po sqarohen dhe po shikojnë se ku po i çon rruga e tyre, shikojnë drejtësinë e marksizëm-leninizmit.

Revizionistët modernë nga njëra anë na sulmojnë, nga ana tjetër përpiqen që të pushohet polemika. Hru- shovi e filloi polemikën duke menduar se do të na shkatërronte, por u gabua. Ai u mbështet në forcën e madhe ekonomike e ushtarake dhe në prestigjin e

BS për të na shkatërruar ne, për të shkatërruar partitë marksiste-leniniste, por ai nuk mundi dhe nuk do të mundë kurrë që të shkatërrojë komunizmin. Tani që gjendet në pozitë shumë të vështirë, kërkon që të pushohet polemika, por kjo do të thotë: ne të mbyllim gojën dhe ata jo. Por polemikën ne nuk do ta pushojmë kurrë, përkundrazi, do ta vazhdojmë se vazhdimi i saj do të thotë dobësim, shkatërrim i revizionizmit, dobësim i imperializmit, do të thotë fuqizim i partive tonë, do të thotë forcim i popujve në luftë për çlirimin e tyre. Ne ecim në këtë rrugë, kurse Hrushovi shkon drejt greminës. Prandaj kjo vijë e lavdishme e Partisë sonë duhet të pasqyrohet në fushatën e zgjedhjeve, që kemi përpara, për të cilën desha të flas pak.

Fushata e zgjedhjeve është jashtëzakonisht me rëndësi, sepse në këshillat popullorë duhet të zgjidhen njerëzit më të mirë. Nuk është vetëm çështja e marrjes së votave qind për qind për kandidatët e Frontit, por që këta qind për qind të zgjedhur të jenë njerëzit më të mirë, politikisht në rrugë të drejtë, moralisht të lartë, ashtu siç e kërkon morali i Partisë e i popullit tonë. Kur të themi qind për qind, të themi edhe se i dhamë popullit kandidatët më të mirë, njerëzit më besnikë, njerëzit që gëzojnë simpatinë dhe dashurinë e popullit në pushtet. Zgjedhja e njerëzve besnikë e të aftë ka rëndësi për realizimin e detyrave.

Duhet të kuptohet drejt çështja e funksioneve të komiteteve ekzekutive dhe të këshillave popullorë, çështja e marrjes së vendimeve, e zbatimit të detyrave, të ligjeve dhe këto duhet të zbatohen jo vetëm prej komiteteve ekzekutive, por dhe prej këshillave popu-

llorë. Prandaj nuk duhet ulur roli i madh që kanë këshillat popullorë. Në fshatra, për shembull, këshillat popullorë kanë rëndësi të madhe. Kryesitë e kooperativave kanë detyrat e tyre, por dhe këshillat popullorë kanë detyra. Këto detyra nuk janë vetëm në kompetencat që këshillave u ka dhënë ligji, por kryetari i këshillit, si i zgjedhur nga populli, ka të drejtë të shikojë, të bëjë vërejtje, të shkundë edhe kryetarin e kooperativës në rast se ka të meta. Përpara Asamblesë së kooperativës, ai, si këshilltar i pushtetit, duhet të paraqesë vërejtjet e veta, të thotë mendimin e tij për ato çështje që nuk venë mirë në kooperativë, të flasë, pra, në emër të këshillit popullor dhe të kërkojë që të merren këto apo ato masa, të kërkojë që të mbrohet ligji. Shkelje të ligjeve ka si në qytet ashtu edhe në fshat. Në fshat kjo ndodh nga shkeljet që i bëhen Statutit të kooperativës. Prandaj pushteti në fshat luan një rol të jashtëzakonshëm. Këtë duhet ta kuptojmë mirë. Mirëpo ndodh të jenë zgjedhur kryetarë këshillash njerëz dosido. Mendoj se kryetar i këshillit të fshatit duhet të zgjidhet një njeri i zoti ose pothuaj njësoj i zoti me kryetarin e kooperativës, sepse vëmë re se kur kemi në fshat një kryetar të këshillit popullor të mirë edhe puna atje vete më mirë. Të mos ngjasë që ai të rrijë nën hijen e kryetarit të kooperativës ose të mos guxojë t'i ngrejë probleme sekretarit të organizatës-bazë të Partisë, për shembull, që pse nuk merren masa për këtë ose atë shkelje të ligjit etj., gjë që ai e ka të drejtë, sepse mbron ligjin. Prandaj, çështja e zgjedhjes së kandidatëve më të mirë për këshillat popullorë është një punë e madhe. Natyrisht propozimet për kandidatët

i bën organizata e Frontit Demokratik, por në mbledhje këto duhen diskutuar e shoshitur mirë.

Në shumë fshatra kemi kooperativa të bashkuara. Atje pushteti merr një rëndësi edhe më të madhe, sepse duhet të drejtojë një territor dhe një numër shumë më të madh familjesh. Prandaj në këshillat të zgjidhen njerëzit më të mirë, më të aftë për të drejtuar.

Kështu dhe në gjykatat popullore duhet të vihen njerëzit më të ndershëm. Në drejtësi nuk mund të vihen njerëz që kanë njolla, por njerëz të pastër, me moral të lartë, të zgjuar dhe në radhë të parë me frymë revolucionare. Gjykatat tona popullore duhet të luftojnë burokratizmin. Interpretimi i ligjeve në to nuk duhet të bëhet në frymë burokratike siç bëhet në gjyqet borgjeze. Ligjet tona janë të thjeshta e të qarta. Ato duhet të zbatohen në frymë revolucionare, por që të zbatohen në këtë frymë, nuk duhet vetëm dituria, për këtë duhen njerëz të dashur, të pastër e me partishmëri, se vetëm ata mund t'i zbatojnë ligjet në rrugën revolucionare, në rrugë partie.

Në qoftë se gjërat i kuptojmë dhe veprojmë kështu atëherë ne do t'i kemi plotësuar qind për qind detyrat tona për forcimin e këshillave popullorë, të gjykatave popullore dhe do t'i marrim votat qind për qind, sepse kemi një popull xhevahir, i cili e shikon vijën e drejtë të Partisë, e ka kuptuar prej kohësh se ç'thotë Partia është për të mirën e tij.

Kemi pasur dhe kemi vështirësi, por ato i kemi kapërcyer e do t'i kapërcejmë. Perspektivat janë të shkëlqyera se kemi një popull heroik, kemi Partinë tonë marksiste-leniniste. Prandaj, shokë, dita e 31 majit

të kthehet në festë fitoresh, për të treguar unitetin e çeliktë të popullit dhe të Partisë, si për të mirën e tyre ashtu edhe për të mirën e popujve të botës që luftojnë kundër imperializmit, revizionizmit, për paqen, socializmin dhe komunizmin.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**TESERA E PARTISË ËSITË ME KAPAKË TË KUQ  
DHE ME DISA FLETË, POR SIMBOLIZON RRUGËN  
E LAVDISHME PËR NË KOMUNIZËM**

*Fjala me rastin e shpërndarjes së tesarave të reja  
të Partisë një grupi komunistësh të qytetit  
të Tiranës*

**6 prill 1964**

Të dashur shokë dhe shoqe,

Ne jemi mbledhur sot për t'u dorëzuar tesarat e reja të Partisë një pjese shumë të vogël të komunistëve, se organizata e Partisë e qytetit të Tiranës është një organizatë e madhe.

Me këtë rast dëshirojmë të falënderojmë organizatën e Partisë të universitetit, që na dha mundësinë të mbledhemi në këtë sallë, dhe njëkohësisht ta përgëzojmë atë për punën e madhe që bën në edukimin ideologjik, politik dhe kulturor të rinisë sonë. Organizata e Partisë e universitetit ka në gjirin e saj mjaft shokë e shoqe, të cilët e kryejnë mirë detyrën që u është besuar në këtë institucion kaq të rëndësishëm për vendin tonë:

Në këtë moment të gjithë ne ndiejmë emocion dhe gëzim, por njëkohësisht edhe njëfarë dhimbje. Ndiejmë gëzim të madh për arsye se marrim taserën e re të Partisë, por, nga ana tjetër, nuk na vjen mirë që ndahemi nga tesera e vjetër, që e kemi mbajtur për një kohë të gjatë, kemi jetuar me të, jemi hedhur në aksione, kemi kapërcyer vështirësi, kemi korrur fitore, kemi kaluar gëzime dhe hidhërime. Megjithatë, gëzimi është më i madh se dëshpërimi, sepse tesera, qoftë e vjetra apo e reja, është tesera e Partisë sonë të lavdishme, e cila, duke pasur një unitet të çeliktë në rradhët e saj, ka bërë kurdoherë një luftë të pandërprerë e të vazhdueshme në rrugën e drejtë të marksizëm-leninizmit.

Tesera e Partisë ka rëndësi të jashtëzakonshme. Ajo është e vogël dhe e thjeshtë, me kapakë të kuq e të bukur dhe me disa fletë, por ka një përmbajtje të madhe. Ajo simbolizon rrugën e lavdishme për në komunizëm. Në taserën e Partisë është shkruar historia e shkëlqyer e popullit tonë jo vetëm gjatë këtyre 24 vjetëve, por edhe ajo që ka kaluar në shekuj, sepse Partia jonë është trashëgimtarja e denjë e traditave më të mira të heroizmit, ndershmërisë dhe zgjuarsisë së popullit tonë. Historinë e popullit tonë mund ta ndajmë në periudha, por jeta, lufta dhe përpjekjet e tij janë një vazhdë e tërë ngjarjesh heroike dhe të lavdishme, midis të cilave ka pasur edhe momente tragjike e të hidhura.

Shtypësit barbarë kanë kaluar njëri pas tjetrit mbi popullin tonë të vogël, por ai kurrë nuk u është përuhur armiqve, kurrë nuk e ka humbur shpresën, sepse

në ndjenjat e tij janë ruajtur e janë zhvilluar gjithnjë aspiratat e zjarra të lirisë dhe të krenarisë, sepse ai me trimëri u ka bërë ballë furtunave dhe ka çarë rrezikun, duke menduar se vetëm me luftë, me përpjekje e sakrifica do të arrinte fitoren. Kjo e ka bërë popullin tonë të pamposhtur, i ka dhënë atij forcë të madhe, e ka mbajtur të gjallë, e ka frymëzuar për të bërë heroizma dhe për të mbajtur kurdoherë lart shpirtin luftarak. Kështu, duke luftuar me armë në dorë, me heroizëm, burrëri, vendosmëri e trimëri të pashoqe dhe pa marrë parasysh sakrificat e panumërta, populli shqiptar doli në dritë.

Në këtë tescrë të vogël janë shkruar heroizmi i popullit tonë të udhëhequr nga Skënderbeu kundër pushtuesve turq, zotësia e tij politike dhe ushtarake, lidhjet e tij si një grusht i vetëm përpara armikut; këtu janë shkruar luftërat dhe përpjekjet e popullit tonë për kulturë e dituri, janë shkruar emrat e rilindasve tanë, të cilët me pushkë dhe me pendë luftuan që Shqipërinë ta shikonin «zonjë», janë shkruar emrat e njerëzve të mëdhenj e të thjeshtë të popullit tonë, që u sakrifikuuan, që u vranë nëpër male dhe u dogjën në zjarr, por që kurrë nuk e ulën kokën dhe nuk e humbën besimin në fitore; në të janë shkruar luftërat e vazhdueshme kundër armiqve të mëvonshëm imperialistë, të cilët nuk kanë mundur e nuk do të mundin asnjëherë ta nënshtrojnë popullin shqiptar.

Të gjitha këto i ka trashëguar e i ka përjetësuar më së miri Partia jonë, e cila, siç e dini, u formua në momentet më të vështira të luftës. Numri i anëtarëve të saj, megjithëse në fillim ishte i vogël, përbënte një for-



cë të madhe, dhe duke ruajtur në zemër të gjitha ato thesare të çmueshme të popullit tonë, që thashë më sipër, Partia ishte e sigurt se do të lidhej ngushtë me masat e gjera të popullit, do të bëhej një me popullin tonë heroik dhe se nga lufta e saj e drejtë do të shtoheshin nga gjiri i popullit radhët e Partisë sonë komuniste. Dhe kështu u bë. Partia jonë mishëron eksperiencën e popullit dhe u udhëhoq nga teoria marksiste-leniniste, e cila ishte pishtari i madh që u ndriçoi rrugën klasës punëtore, fshatarësisë punonjëse dhe inteligjencies përparimtare në luftën për plotësimin e aspiratave të tyre. Duke ditur të lidhë luftën shekullore dhe ëndrrat e popullit tonë me shkencën e marksizëm-leninizmit, Partia përpunoi vijën e përgjithshme, që duhej të ndiqnin klasa punëtore dhe aleatët e saj dhe duke luftuar së bashku me popullin dhe për popullin me flamurin e marksizëm-leninizmit, me ideologjinë e klasës punëtore, u hodh në luftë kundër pushtuesve, kundër reaksionit, për një Shqipëri të lirë, demokratike e popullore, për përmbysjen e feudo-borgjezisë dhe për të ndërtuar shoqërinë e re, socializmin dhe komunizmin.

Pra, në këtë taserë janë shkruar emrat dhe gjaku i dëshmorëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, heroizmat e mëdha të popullit dhe të komunistëve tanë, të cilët me qindra dhe mijëra u hodhën në beteja duke pasur të qartë përse luftonin, si duhej të luftonin e të qëndronin përpara armikut dhe armëve të tij të shumta e moderne, si duhej të luftonin kundër demagogjisë e politikës mashtruese të pushtuesit dhe të aleatëve të tij në vendin tonë.

Partia na mësoi, na edukoi e na kaliti të gjithëve

dhe me përpjekje, me luftë e me sakrifica të mëdha kundër armiqve të çdo lloji arriti të ndërtojë vijën e saj të drejtë e të pastër si kristali si gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, ashtu dhe në periudhën e ndërtimit të socializmit. Vija e përgjithshme e Partisë sonë ka qenë dhe është e drejtë që nga themelimi i saj. Natyrisht, nuk përjashtohet që ne të mos kemi pasur të meta e gabime, sepse si të gjithë njerëzit edhe komunistët mund të gabojnë, por të metat e gabimet tona gjatë luftës nuk kanë qenë parimore, ato kanë qenë të vogla, taktike dhe nuk e dëmtuan asnjëherë vijën e përgjithshme të Partisë. Nga këto gabime e të meta Partia, komunistët, ditën të nxjerrin mësimet e duhura, sepse komunistët e asaj kohe kishin po atë guxim, vullnet dhe heroizëm që kanë sot komunistët e rinj. Në atë kohë ne nuk kishim këtë zhvillim të madh ideologjik e kulturor që kanë sot komunistët dhe gjithë njerëzit e vendit tonë. Megjithatë, Partia mund të krenohet dhe komunistët e parë, komunistët e viteve të luftës, mund ta mbajnë ballin lart, se ata ishin pionierët e asaj lufte të madhe. Anët pozitive të tyre kanë qenë aq të shumta sa edhe në qoftë se kanë bërë disa gabime, ato janë mikroskopike në sfondin e fitoreve të mëdha që janë arritur, sepse vija e drejtë e Partisë dhe edukata që morën prej saj i bëri ata heronj dhe të aftë të mobilizojnë masat e popullit, të cilat panë te Partia udhëheqësen e tyre të vërtetë e të guximshme. Partia Komuniste, tani Partia e Punës e Shqipërisë, u hapi masave perspektivën, u bëri të qartë qëllimet e luftës, arriti unitetin e çelikle të popullit e të Partisë dhe korri fitore të mëdha, të cilat sot po i

zhvillon edhe më tej. Këto fitore janë shkruar në tescerën e Partisë. Në të janë shkruar emrat e komunistëve që luftuan e ranë heroikisht, po që rrojnë e do të rrojnë në shekuj në zemrat tona dhe do të jenë kurdoherë një frymëzim i madh për Partinë dhe për popullin tonë.

Në tescerën e Partisë është shkruar lufta e madhe që ka bërë populli dhe Partia jonë pas Çlirimit për ndërtimin e socializmit. Të gjithë ne të vjetrit e mbajmë mënd mirë atë kohë, kurse brezi i ri nuk i ka parë përpjekjet dhe sakrificat e popullit shqiptar pas Çlirimit, gërmadhat e shkatërrimet e luftës, sëmundjet, mungesën e shkollave dhe të arsimitarëve, mungesën e klasës punëtore, të teknikëve, inxhinierëve etj. Por populli u ngrit i tëri në këmbë me në krye Partinë, e cila përcaktoi programin e ndërtimit të socializmit, të rimëkëmbjes së ekonomisë, të zhvillimit të industrisë e të bujqësisë, të arsimit e të kulturës, të përgatitjes së kuadrove dhe kështu me radhë. Brezi i ri shikon tani fushat e bukura të atdheut tonë socialist dhe jetën e re që lulëzon në fshat, por ai nuk e ka jetuar atë kohë, kur shtypej e shfrytëzohej fshatari ynë, si e punonte ky tokën me parmendën e vjetër shekullore dhe si vuante nga sëmundjet e padituria. Këto gjëra brezi ynë i ri duhet t'i mësojë, të dijë si ka qenë më parë dhe si u arritën këto ndryshime, të mësojë përpjekjet e bujkut tonë për tokën, gëzimin që ai ndjeu kur Partia dhe pushteti popullor realizuan Reformën Agrare dhe i dhanë fshatarit tokën, kur u hapën kanale ujitëse etj. Nuk kishte, pra, në këto momente, gëzim më të madh për fshatarin tonë rob, që çlirohej nga feudali, nga beu, agai apo nga bajraktari, të cilët, për shekuj

me radhë, i kishin pirë gjakun, e kishin vrarë, e kishin dërrmuar tërë jetën, por fshatari ynë kurrë nuk ishte përkulur. Të gjitha këto janë shkruar në taserën e Partisë, sepse Partia e udhëhoqi fshatarin në këto aksione të mëdha, e çliroi atë përgjithmonë nga shtypja e shfrytëzimi.

Në taserën e Partisë është shkruar lufta jonë për ngritjen dhe zhvillimin e industrisë socialiste, për ngritjen e fabrikave, të uzinave dhe të minierave në të katër anët e vendit, të cilat u realizuan me përpjekjet e mëdha të popullit dhe të Partisë sonë dhe me ndihmën internacionaliste të popullit sovjetik dhe të Josif Stalinit. Në të është shkruar krijimi i klasës sonë punëtore, i asaj klase të madhe dhe të stërvitur në luftëra klasore, ideologjinë e së cilës Partia jonë e ka mbajtur kurdoherë lart. Pra u krijua klasa jonë punëtore, e cila, e edukuar nga Partia me ideologjinë e saj të vërtetë marksiste-leniniste, bëri dhe po bën mrekullira.

Pas Çlirimit u hapën shkolla në të katër anët e vendit. Me një vullnet të madh, popull e Parti, burra e gra, me atë pak dituri që kishin shkonin për të çuar arsimin e kulturën edhe në bjeshkët më të largëta, atje ku errësira e regjimeve antipopullore dhe e fesë i kishte lënë njerëzit në padituri. Juve mund t'ju kujtohet, shokë, se si komitetet e Partisë caktonin njërin apo tjetrin që të shkonte e të punonte në Veri, duke u thënë se atje ku s'kishte shkolla, duheshin hapur që njerëzit të mësonin të shkruanin e të lexonin. Ata e kuptonin që kjo ishte një luftë e madhe, se socializmi nuk mund të ndërtohet pa dituri dhe pa shkencë. Dituria nuk merret

vetëm në universitet, sepse që të vish në universitet, më parë duhet të marrësh arsim e kulturë në shkolla më të ulëta, prandaj Partia, me përpjekjet e saj, mundi të hapë shkolla anembanë vendit dhe më në fund arritëm të krijojmë edhe universitetin tonë në Tiranë. Këtë e ngriti Partia jonë me iniciativën e saj dhe sugjerimin që kishte bërë Stalini i madh, prandaj populli shqiptar do t'u jetë mirënjohës Stalinit dhe Partisë së bolshevikëve, që udhëhiqej nga ideologjia e vërtetë marksist-leniniste, për ndihmën që u dhanë popullit shqiptar dhe Partisë së Punës të Shqipërisë. Të gjitha këto janë shkruar në taserën e vogël të Partisë.

Në taserën e Partisë është shkruar gjithashtu lufta e madhe vigane e Partisë sonë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit. Kjo është vendimtare. Për këtë Partia jonë e mban ballin lart. Ajo ka ditur ta bëjë këtë jo se ra e tillë nga qielli, jo se ka një eksperiencë të madhe 50 apo 60-vjeçare si parti të tjera dhe që sot po gabojnë, jo se ishte me yll në ballë, por për arsye se e gjithë jeta e saj dhe e popullit tonë ka qenë luftë e përditshme kundër revizionizmit për të zbatuar me besnikëri marksizëm-leninizmin.

Brezit tonë të ri, shokë, duhet t'i mësojmë se 20 e ca vjet më parë puna e Partisë sonë ka qenë shumë e vështirë, por, duke zbatuar drejt mësimet e marksizëm-leninizmit, ne fituam lirinë, fituam çdo gjë. Prandaj në radhë të parë Partia duhet të mbrojë marksizëm-leninizmin. Në rast se ajo nuk do të kishte ngulur këmbë në mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, kjo do të ishte katastrofa më e madhe për atdheun tonë, për të ardhmen e popullit tonë.

Nuk ishte aq e lehtë të njihje Titon dhe agjentët e tij. Armiku mund të të gënjejë për një copë herë, mund të gënjejë disa, por ai nuk mund t'i gënjejë të gjithë dhe kurdoherë. Prandaj Partia, duke qenë vigjilente, diti që, në atë afrim të madh të vëllazërimit dhe të unitetit internacionalist që ekzistonte në atë kohë, të diktonte dalngadalë armiqësinë e madhe të titistëve, të zbulonte qëllimet e tyre komplotiste kundër marksizëm-leninizmit dhe veçanërisht kundër Partisë e vendit tonë. Partia jonë i kapërceu vështirësitë dhe në unitet me të gjitha partitë e tjera marksiste-leniniste e demaskoi titizmin tradhtar. Mënyra se si veproi Partia Komuniste (b) e Bashkimit Sovjetik dhe Stalini në paralajmërimet që iu bënë titistëve të ndreqnin gabimet e të futeshin në binarë, si dhe vendimet e Byrosë Informative, ishin plotësisht të drejta, marksiste, shoqërore. Koha vërtetoi se titistët ishin tradhtarë të marksizëm-leninizmit dhe agjentë të imperializmit.

Partia jonë diti që, gjatë përpjekjeve të saj, jo vetëm të diktojë veprimtarinë tradhtare të Titos, por edhe t'i rezistojë asaj dhe bashkë me partitë e tjera të mbajë kurdoherë lart flamurin e marksizëm-leninizmit, ta demaskojë vazhdimisht e pa ndërprerje bandën tradhtare të Titos. Kjo ishte një fitore e madhe për Partinë tonë, për vendin tonë dhe për komunizmin ndërkombëtar. Gjithë marksistë-leninistët në botë nuk e harrojnë kurrë luftën e drejtë, të zgjuar dhe parimore që Partia jonë ka bërë, për më tepër se 20 vjet, kundër bandës tradhtare të Titos, përkundrazi ata e admirojnë, e nderojnë dhe kanë respekt të madh për Partinë e Punës të Shqipërisë, që, megjithëse e vogël

në numër, është e madhe në vepra. Kjo luftë dhe këto fitore janë shkruar e janë mishëruar në taserën e Partisë.

Lufta kundër armiqve të marksizëm-leninizmit vazhdon edhe sot. Krahas Titos dolën antimarksistë e tradhtarë të tjerë akoma më të tërbuar e më të rrezikshëm, që kanë një forcë më të madhe ekonomike e ushtarake dhe maskohen me prestigjin e Partisë së madhe të Leninit. Këta janë banda e Hrushovit dhe e gjithë atyre që e ndjekin pas. Partia jonë ishte e para që hapi zjarr kundër kësaj bande tradhtare të marksizëm-leninizmit, për arsye se kishte një eksperiencë të madhe në luftën për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, dhe marksizëm-leninizmi mbrohet me trimëri, guxim e vendosmëri. Për këtë neve nuk na rritet mendja.

Partia jonë na mëson se komunistët duhet të jenë të guximshëm dhe të drejtë. Ajo na mëson të flasim hapur dhe pa frikë, sepse, në qoftë se kritikojmë drejt, gabimet do të ndreqen dhe kështu do të ecet përpara, kurse në qoftë se gabojmë, atëherë të tjerët le të na kritikojnë që të ndreqemi, kështu gabimet të na bëhen mësim. Ky është mësimi i përditshëm që Partia u jep anëtarëve të saj.

Në bazë të eksperiencës së madhe që kishte fituar në luftën kundër revizionizmit, kundër titistëve dhe kundër të gjitha intrigave hrushoviane, që akoma nuk kishin filluar të nxirrnin brirët, Partia jonë u tregua vigjilente, trime dhe e pjekur, jokokëkrisur siç pretendon Nikita Hrushovi. Partia jonë u tregua e pjekur edhe në drejtim të atyre që kishin gabuar, që këta të njihnin gabimet e të përmirësoheshin, të ndërronin

rrugë, kurse ata që vepronin kundër Partisë dhe vendit tonë, të ndaleshin. Njëkohësisht ne u tregonim atyre dashurinë e madhe që kishin populli dhe Partia jonë për popullin sovjetik, për Partinë Bolshevike të Leninit e të Stalinit. Partia jonë nuk ishte nga ato që të hidhte hapa të pamatur. Qëndrimi i lartë e parimor i saj bëri që ajo të arrijë të ngrejë zërin ku duhej dhe kur duhej kundër revizionizmit hrushovian. Fjala jonë ishte e drejtë, e thjeshtë por e fuqishme, dhe i turbulloi aq shumë armiqtë, sa ata, mund të themi, u tmerruan nga mprehtësia, guximi dhe drejtësia marksiste-leniniste e Partisë sonë. Kjo e tronditi N. Hrushovin dhe ai sulmoi brutalisht Partinë e Punës të Shqipërisë, se ajo ishte e para që dha sinjalin për komplotin e madh që ishte organizuar kundër kampit socialist, kundër marksizëm-leninizmit, kundër Partisë Komuniste të Kinës. Revizionistët modernë sovjetikë u sulën kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqjes së saj që të nxirrnin mësimë të tjerët. Kjo ishte një aventurë, një veprimtari e tërbuar antimarksiste, armiçësore, e cila do të dështonte sikundër dështoi. N. Hrushovi kujtoi se do ta likuidonte shpejt një situatë të tillë të disfavorshme për veten e tij, por përkundrazi jo vetëm që nuk e likuidoi ashtu siç mendonte ai, po u bë ajo që dihet. Kështu u krijua një situatë e rrezikshme për të dhe shpëtimtare për marksizëm-leninizmin. Të gjitha këto janë shkruar në toserën e Partisë.

Partia jonë e Punës qëndron në ballë të luftës heroike kundër revizionistëve modernë hrushovianë, titistë, toliatistë e të tjerë. Këtë e ka treguar me prova. Ka parti të tjera më të mëdha në numër, që drejtojnë



popuj më të mëdhenj, por që nuk janë akoma në ballë të kësaj lufte, ashtu siç është Partia jonë. Këtë vend nderi Partia jonë e ka fituar me zgjuarsinë, pjekurinë, qëndresën dhe luftën e saj konsekuente kundër imperializmit dhe revizionizmit modern.

Revizionizmi modern është sëmundja më e rrezikshme në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Partia jonë nuk u gabua kur tha se revizionizmi modern duhet luftuar deri në fund për të shpëtuar marksizëm-leninizmin nga kjo sëmundje e rëndë dhe për të shkatërruar këtë armë të rrezikshme në duart e imperializmit, sepse revizionistët janë vegla të imperialistëve, agjenturë e tyre. Faktet tregojnë se Hrushovi e Titoja janë vënë në shërbim direkt të imperializmit amerikan, prandaj duhen demaskuar e luftuar deri në shkatërrimin e tyre të plotë. Është e qartë jo vetëm për Partinë tonë, por edhe për shumë parti të tjera dhe për miliona komunistë në botë, se N. Hrushovi dhe pasuesit e tij kanë për qëllim të shkatërrojnë komunizmin, të shkatërrojnë vendet socialiste, të degjenerojnë partitë marksiste-leniniste në parti socialdemokrate, të bashkohen me socialdemokratët e të gjithë botës dhe të bëhen mbështetja e borgjezisë dhe e imperializmit. Ky është qëllimi i tyre. Prandaj partitë komuniste e punëtore të të gjithë botës duhet jo vetëm ta shikojnë këtë rrezik, por të hidhen në luftë për ta likuiduar.

Gjatë kësaj kohe është bërë një përparim kolosal në luftën kundër revizionizmit modern. Në politikën e jashtme dhe të brendshme N. Hrushovi po pëson disfata të njëpasnjëshme. Në politikën ndërkombëtare ai s'ka asnjë sukses, përkundrazi, çdo ditë e çdo muaj po i nën-

shtrohet gjithnjë e më tepër imperializmit amerikan. Qëllimi i politikës së jashtme hrushoviane është që Bashkimi Sovjetik të lidhet në aleancë me SHBA-në për të sunduar botën.

Imperializmi amerikan, nga njëra anë, përpiqet që nëpërmjet agjenturave të tij, si Hrushovi, Titoja etj., të goditë socializmin dhe me anën e ideologjisë reformiste të degjenerojë partitë komuniste e punëtore në vendet socialiste, të çorientojë proletariatin, fshatarësinë dhe inteligjencien popullore në vendet kapitaliste për të mos u hedhur në luftë kundër kapitalit dhe, nga ana tjetër, përpiqet të dominojë mbi aleatët e tij. N. Hrushovi gjithashtu synon të minojë socializmin, të dobësojë dhe të likuidojë RP të Shqipërisë dhe vende e parti të tjera që qëndrojnë në pozita të drejta marksiste-leniniste, ose që këto t'i transformojë në shtete dhe parti satelite të tij.

N. Hrushovi ka bërë orvatje të panumërta kundër vendit tonë. Ai ka përkrahur elementët armiq e spiunë që dolën në Konferencën e Partisë të qytetit të Tiranës më 1956, për të cilët deklaroi se ata janë «patriotë dhe komunistë të shquar që u ngritën kundër kultit të personit». Kjo do të thotë se në këtë punë ka pasur gisht jo vetëm Titoja, por edhe ambasada sovjetike në Tiranë. Kështu, pra, shumë tentativa ka bërë grupi i Hrushovit kundër vendit tonë, por ai kurrë nuk ka mundur t'ia arrijë qëllimit për të vendosur këtu sundimin e tij revizionist, borgjez, kapitalist.

Revizionistët hrushovianë po e çojnë Bashkimin Sovjetik në rrugën e restaurimit të kapitalizmit. Në këtë rrugë ata kanë hyrë e po zhyten në batac. Gjithë

politika e brendshme e N. Hrushovit ka për qëllim ta transformojë Bashkimin Sovjetik në një vend borgjez, por për ta bërë këtë duhet të transformojë partinë dhe ideologjinë e saj, prandaj ai vepron në të gjitha drejtimet, duke filluar që nga mohimi i rolit të partisë me parullën «partia e gjithë popullit», deri në mohimin e diktaturës së proletariatit dhe të luftës së klasave. Nga ana tjetër, në ekonominë e vendit ai ka krijuar një kaos të madh dhe këtë e bën jo pa qëllim, por me një objektiv të caktuar, për të krijuar shtresat e privilegjuara të nëpunësve, të drejtuesve të ekonomisë dhe të kulakëve të rinj në fshat, të cilët janë majmur e janë pasuruar në kurriz të kolkozianëve. Këto shtresa janë bërë mbështetja e tradhtisë së N. Hrushovit dhe e bashkëpunëtorëve të tij në Bashkimin Sovjetik. Këtyre shtresave të privilegjuara revizioniste nuk u mungon asgjë, kurse popullit sovjetik i mungon buka, mishi etj.

Kjo situatë dhe ky kaos i madh në Bashkimin Sovjetik janë rezultat i vijës së revizionizmit modern të përcaktuar nga N. Hrushovi për të krijuar në BS borgjezinë e re, me qëllim që të forcojë pozitat e tij tradhtarë dhe të vazhdojë kursin e tij drejt aleancave me imperializmin e SHBA-së dhe kapitalizmin botëror. Një gjë e tillë po ngjet në të gjitha vendet e ish-demokracisë popullore të Evropës ku janë në fuqi pasuesit hrushovianë. Ky ka qenë dhe është qëllimi i N. Hrushovit dhe i bandës së tij.

Në rrugën e tradhtisë ecin dhe parti të tjera të vendeve kapitaliste ku në krye janë revizionistët. Partia Komuniste e Italisë mban flamurin për degjenerimin e plotë të vijës së saj dhe të shthurjes organiza-

tive të partisë. Struktura organizative e kësaj partie po bëhet gjithnjë e më tepër amorge. Bazat e partisë, celulatat, gati janë likuiduar. Ato mbliidhen vetëm sa për propagandë, se pothuaj për çdo gjë vendos komiteti, kurse anëtarët e partisë as që i pyet njeri. Revizionistët italianë shkojnë drejt asaj që partia e tyre të shndërron në një organizatë si ajo e bashkimeve profesionale.

Partia Komuniste e Francës gjithashtu po transformohet në rrugën e Partisë Komuniste të Italisë. Orientimin që ka dhënë udhëheqja e saj për kongresin e 17-të të partisë, që do të mbahet në maj të këtij viti, dhe artikujt e njëpasnjëshëm që ajo boton për çështjet kryesore të marksizëm-leninizmit duke i deformuar këto, tregojnë qartë se Partia Komuniste e Francës po shkon drejt likuidimit të saj, drejt afrimit me partitë socialdemokrate.

Pra, me pak fjalë, qëllimi i N. Hrushovit ka qenë dhe është që të likujdijë socializmin, t'i kthejë vendet socialiste në shtete borgjeze kapitaliste, t'i lidhë këto pas qerres së tij, të shkojë në aleancë me imperializmin amerikan. Në këtë luftë të madhe që zhvillohet kundër revizionizmit modern, Partia jonë qëndron në ballë, lufton me heroizëm dhe fjala e saj dëgjohet kudo. Kjo luftë e madhe e Partisë sonë është shkruar në këtë tesarë të vogël me kapakë të kuq e të bukur.

Lufta kundër revizionizmit modern, shokë, nuk është e vogël, nuk është e thjeshtë, nuk është e shkurtrë. Duhet të mbajmë parasysh se kemi përpara një armik të egër, që bën demagogji të madhe dhe ka një potencial të fuqishëm ekonomik. Njëkohësisht kemi për-

para edhe imperializmin amerikan, i cili i jep ndihmë e përkrahje revizionizmit modern si armik i brendshëm i komunizmit, për të sulmuar marksizëm-leninizmin. Por rezultatet e kësaj lufte janë të favorshme për ne dhe të disfavorshme për ta. Tani duket qartë jo vetëm demaskimi i revizionistëve, por është fakt se Hrushovin nuk e besojnë më si më parë, qoftë armiqtë qoftë edhe miqtë e tij, sepse miqtë dyshojnë në fjalët dhe veprimet e tij. Nikita Hrushovit po i tronditen themelet, ai është në situata jashtëzakonisht të vështira. Lufta jonë frontale e drejtë dhe marksiste-leniniste po i shton vazhdimisht radhët tona, kurse kampi revizionist me Hrushovin dhe Titon në krye po çahet dhe në partitë e ndryshme ngrihen grupe revolucionare, të cilat luftojnë revizionizmin në partitë e tyre. Këto grupe në disa vende kanë arritur të krijojnë partitë marksiste-leniniste, kurse në një sërë vendesh të tjera, grupet revolucionare, që akoma nuk kanë gjetur një rrugë të përbashkët, janë duke bërë përpjekje për të krijuar unitetin e vërtetë.

Këtë proces që po zhvillohet e kanë frikë për vdekje Hrushovi dhe revizionistët e tjerë, sepse ai sjell edhe një rrezik tjetër, thellimin e përçarjes në vetë klikat revizioniste. Dhe s'ka si bëhet ndryshe, se kjo do të ngjasë, natyrisht jo përnjëherësh, po do të kalojë procesin e vet. Kur ne u ngritëm të parët kundër Hrushovit, disa parti, që në fillim u lëkundën, më pas erdhën në rrugën tonë. Ka parti të tjera që më parë i thonin Partisë sonë «s'kemi ç'të bëjmë, duhet t'i ngremë kapelën Nikita Hrushovit», kurse tani po përpëliten. Një gjë e tillë do të ngjasë edhe me parti të tjera, por

kjo nuk do të bëhet brenda një dite, po duke u forcuar lufta jonë e përbashkët. Shtimi i radhëve tona do të bëjë që revizionistët të ndodhen para vështirësive akoma më të mëdha.

Tani, siç jeni në dijëni, duke qenë në pozita të vështira, Hrushovi kërkon të pushohet polemika. Por polemika nuk mund të pushohet, ajo është e domosdoshme, shpëtimtare. Në këtë çështje Hrushovi ka gjetur kundërshtimin e drejtë, marksist-leninist të Partisë së Punës të Shqipërisë, që i thotë: Polemikë deri në vdekjen e revizionizmit! Polemika mund të pushohet, kemi thënë ne, në rast se Hrushovi deklaron hapur që ka bërë gabime kolosale; që ka sulmuar padrejtësisht dhe në mënyrë të poshtër Partinë e Punës të Shqipërisë; që vija e Kongresit të 20-të dhe të 22-të të PK të Bashkimit Sovjetik është e gabuar; që bashkëzistenca paqësore etj., etj. «teorira» të tij kanë qenë krejtësisht të gabuara dhe antimarksiste; që traktati i Moskës për ndalimin e pjesshëm të provave bërthamore midis SHBA-së, Anglisë dhe Bashkimit Sovjetik është një tradhti e madhe. Në qoftë se i bën të gjitha këto, atëherë ne jemi gati të pushojmë polemikën. Por Hrushovi, si revizionist dhe armik që është, duke menduar se ka përpara njerëz që nuk i kuptojnë djallëzitë e tij, përdor të gjitha taktikat: një herë pushon kritikën e flet me buzëqeshje, pastaj kërcëllon dhëmbët, më vonë flet gjoja për unitetin e kampit socialist, pastaj prapë sulmon e shkruan kundër PPSH, më vonë përsëri kërkon të pushohet polemika. Pra, për të dalë nga situata e vështirë, ai përdor të gjitha taktikat: sulmin, shantazhin, kërcënimin, prerjen e marrëdhënieve diplomatike

etj. Të gjitha këto Hrushovi i ka përdorur kundër vendit tonë dhe tani s'ka ç'të bëjë tjetër, prandaj pushimi i polemikës nuk mund të pranohet, përkundrazi ajo do të vazhdojë deri në fund, deri në shpartallimin e plotë të revizionizmit.

Në vazhdim të politikës së tij tradhtare, N. Hrushovi tani bën përpjekje të organizojë një mbledhje të komunizmit ndërkombëtar. Qëllimi i kësaj mbledhjeje për ne është i qartë. Por a janë dakord të gjithë miqtë e tij për ta bërë këtë mbledhje? Këtu ka filluar lëkundja. Mirë, e bëjmë mbledhjen, thonë ata, por a do të vijjnë shqiptarët dhe kinezët? Në qoftë se shqiptarët dhe kinezët nuk vijjnë, atëherë përse do ta bëjmë mbledhjen? Në rast se e bëjmë për të dënuar kinezët dhe shqiptarët, duke thënë se ata e vunë veten jashtë kampit socialist, janë «trockistë» etj., ç'fitojmë me këtë, thonë disa pasues të tjerë të Hrushovit? Mos vallë do t'i dënojmë kinezët e shqiptarët? Jo! Atëherë a duhet ta marrim ne iniciativën për të bërë mbledhje të tillë për të përjashtuar Shqipërinë e Kinën dhe të shkaktojmë përçarje? «Dogmatikët» do ta shfrytëzojnë këtë, mendojnë ata, sepse edhe pa e bërë mbledhjen akoma, marksistë-leninistët në vendet kapitaliste janë ngritur, kanë formuar grupe, bile kanë krijuar edhe partitë e tyre. Kur ne të shkaktojmë përçarjen, atëherë çfarë do të ndodhë në partitë tona? Një gjë e tillë e ka bërë Partinë Komuniste të Italisë, që është në pararojë të revizionizmit tok me N. Hrushovin, të trembet.

Nga informatat që kemi, Kosigini, kur ishte për vizitë në Itali, i ka thënë Toliatit se duhet të bëjmë mbledhjen ndërkombëtare (për arsye se Partia Komu-

niste e Italisë ka deklaruar zyrtarisht se nuk është dakord për të bërë mbledhjen e përgjithshme të partive komuniste e punëtoare, sepse, sipas saj, nuk ka ardhur koha, duhet të vazhdojnë bisedimet dypalëshe midis partive dhe se, po të bëhet kjo mbledhje, partia do të humbasë dhe një gjë e tillë nuk na intereson). Çështja që Partia Komuniste e Italisë nuk është dakord për mbledhjen ndërkombëtare, nuk do të thotë se ajo qëndron në pozita të drejta, përkundrazi, ajo është në pozita plotësisht armiqësore, por një mbledhje e tillë asaj nuk i leverdis.

Hrushovi po bën ç'është e mundur që mbledhja të zhvillohet, por kjo nuk dihet nëse do të bëhet ose jo, kur do të bëhet dhe si do të bëhet, sepse pengesat janë të mëdha. Por një mbledhje e tillë Hrushovit i duhet medoemos, pasi me anën e saj ai kërkon t'i angazhojë akoma më thellë udhëheqjet e partive komuniste dhe punëtoare në rrugën e tradhtisë, t'i bëjë të mos dridhen e përdridhen, por të rrinë sus. Hrushovi mendon se duke dënuar në këtë mbledhje «dogmatizmin» kinez dhe shqiptar, do të gjejë «ilaçin» për të siguruar «unitetin» në lëvizjen komuniste dhe punëtoare ndërkombëtare. Për këtë qëllim Hrushovi po zhvillon një veprimtari të gjerë diplomatike, me rubla dhe dollarë, për të gënjyer dhe për të forcuar pozitat e tij dhe të pasuesve të tij.

Tani flitet se krerët revizionistë do të mblidhen në Moskë më 16 prill për të festuar 70-vjetorin e ditëlindjes së Hrushovit. Ishte thënë se me këtë rast do të shkonte Gomulka, por ai nuk do të shkojë, jo sepse ecën në rrugën tonë (pasi Gomulka është një tradhtar revi-



zionist po ashtu si edhe Hrushovi), por sepse me këtë ai kërkon t'i thotë Hrushovit: «Ngadalë, unë nuk bëj ashtu siç thua ti, se duhet të dëgjosh edhe ato që them unë». Këtë Gomulka e bën sepse në partinë e tij është krijuar një situatë shumë e rëndë, pasi ndodhet midis dy zjarreve, midis zjarrit të komunistëve të vërtetë dhe zjarrit të fashistëve brenda në parti, si Zambrovski. Por edhe Hrushovi, herë mbron Zambrovskin e herë Gomulkën, po kurdoherë në luftë kundër komunistëve të vërtetë.

Me pak fjalë, tani ne vëmë re se në kampin revizionist ka filluar lëkundja. Nesër do të botohet në gazetë një artikull<sup>1</sup> tjetër, që tregon se rruga që ndjekin revizionistët modernë puqet plotësisht me atë të social-demokracisë. Kjo është si për revizionistët sovjetikë ashtu dhe për ata francezë, italianë dhe gjithë të tjerët që kanë braktisur rrugën e drejtë, prandaj ne u themi atyre: dilni nga kjo situatë sa nuk është vonë, por për të bërë këtë duhet të reflektojnë. Sa efekt do të ketë ky artikull, do të shikojmë.

Partia jonë dhe partitë e tjera marksiste-leniniste po korrin çdo ditë suksese në luftën kundër tradhtarëve revizionistë. Ky është një nga momentet më të vështira për Hrushovin, por, me sa duket, ai do të përpëlitet akoma. Vënia e Hrushovit në këtë pozitë të vështirë u arrit në saje të luftës së pamposhtur dhe të drejtë të partive tona marksiste-leniniste. Kjo luftë heroike, shokë, është shkruar në këtë taserë të vogël; prandaj ne komunistët mburremi me Partinë tonë.

---

<sup>1</sup> Shih në këtë vëllim, f. 237.

Partia jonë është jeta e çdo komunisti, jeta e gjithë popullit tonë, çështja e Partisë puqet plotësisht me ndërgjegjen e komunistëve. Partia na porosit që tesorën e anëtarësisë ta mbajmë si gjënë më të vlefshme, më të vyer, më të shtrenjtë, sepse ajo na nxit dhe na frymëzon në punën tonë, në ndjenjat tona, në trimërinë tonë. Kur bën një gjë të keqe, një padrejtësi, një gabim politik, ekonomik apo moral të vret ndërgjegjja si anëtar i Partisë, sepse tesera të ngacmon e të thotë: «Komunist, shiko, nuk je në rrugë të mirë, prandaj ndreqi në çdo drejtim!».

Partia na mëson që tesorën ta ruajmë si jetën tonë, se ajo simbolizon Partinë që na lindi, na rriti, na bëri njerëz të drejtë, të ndershëm, humanitarë, marksistë me zemër të gjerë, por për të goditur pa mëshirë armiqtë dhe për të ndihmuar ata që bëjnë gabime e mund të ndreqen. Këtu qëndron zotësia e Partisë dhe e çdo komunisti. Kur shikojmë një njeri që më parë ka qenë i lëkundur, që ka bërë gabime dhe ne e kthejmë në rrugë të drejtë, ky është satisfaksioni më i madh. Raste të tilla Partia jonë ka pasur me qindra dhe me mijëra gjatë luftës së saj. Prandaj populli e do aq shumë Partinë tonë, ai me sytë e tij shikon zemrën e madhe dhe të dashur të Partisë ndaj njerëzve, shikon mençurinë e saj, pjekurinë e saj, vijën e saj të drejtë.

Ne, shokë, kemi korrur fitore të mëdha, por kemi akoma edhe mjaft gjëra për të bërë. Përpara nesh qëndrojnë detyra shumë të mëdha në ndërtimin socialist të vendit. Bujqësia dhe industria jonë duhet të zhvillohen e të perfeksionohen vazhdimisht, në mënyrë që të prodhojnë më shumë për popullin. Kurrë të mos

mendojmë se, meqë kemi arritur këto suksese dhe kemi krijuar këtë bazë ekonomike, i kemi kapërcyer vështirësitë dhe i kemi zgjidhur të gjitha problemet, jo. Lufta për zhvillimin e ekonomisë socialiste do të jetë akoma e rëndë dhe e vështirë, por ajo do të jetë shumë e lavdishme, prandaj komunistët as mërzhiten as frikësohen nga puna dhe vështirësitë, as u rritet mendja dhe të kënaqen me kaq. Komunistët janë një brumë më i kalitur në kudhrën e Partisë, prandaj duhet të jemi kurdoherë vigjilentë dhe të armatosur, të jemi të bashkuar me Partinë si një trup i vetëm.

Uniteti në Parti nuk mund të arrihet në mënyrë idealiste, por sipas rregullave që ka caktuar Partia jonë në frymën marksiste-leniniste, prandaj dashuria midis njerëzve të Partisë me njëri-tjetrin, në celula dhe në punë, duhet të jetë një dashuri marksiste. Kritika dhe autokritika duhet të jetë e ndershme dhe e hapur. Kur njeriut të ndershëm i flet hapur për të metat e tij, në goftë se ai nuk e kupton sot, do ta kuptojë nesër. Kurse njeriu i lig as sot dhe as mot nuk do të kuptojë, prandaj bën mirë që ia thua, sepse në këtë mënyrë forcon unitetin e Partisë, mbron interesat e popullit, lufton për zhvillimin e industrisë dhe të bujqësisë, për rendimente të larta etj., etj. Në këtë punë të komplikuar, por të lavdishme, duhet të jenë në radhë të parë komunistët.

Shokë,

Sot është një ditë e rëndësishme, sepse, duke marrë teserat e reja, komunistët e ndjejnë veten më krenarë

se kurrë për Partinë e tyre heroike. Në emër të Komitetit Qendror të Partisë ju uroj punë të mbarë dhe suksese gjithnjë e më të mëdha! Nën flamurin e lavdishëm të Partisë sonë, të lidhur ngushtë me popullin dhe me një unitet të pathyeshëm e të plotë marksist-leninist në radhët e Partisë, armiqtë kurrë nuk do të kenë mundësi të dëmtojnë Partinë dhe popullin tonë, përkundrazi, ne do t'i shkatërrojmë revizionistët modernë me Hrushovin e Titon në krye, sepse me ne, me marksizëm-leninizmin, janë komunistët dhe popujt e botës.

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## ARMIKUN E HAPUR E KEMI MERAK VETË — TË RUHEMI SIDOMOS NGA ARMIKU I FSHEHTË

*Nga biseda me delegacionin e Bashkimeve Profesionale  
të RD të Vietnamit*

7 prill 1964

*Pasi shkëmbehen përshëndetjet e rastit dhe miqtë  
zënë vend rreth tryezës, fjalën e merr*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Jemi shumë të gëzuar që erdhët në Shqipëri. Kurdoherë që vijnë këtu shokë nga Vietnamit ne ndiejmë një gëzim të madh. Vendet tona gjeografikisht janë larg, por megjithatë ne jemi me zemër gjithnjë pranë popullit vëlla vietnamez. Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli ynë mbahen kurdoherë në korent me ngjarjet e vendit, me rezultatet, me jetën dhe me luftën e popullit tuaj. Por është e qartë se kur bisedojmë kështu sy në sy është edhe më mirë.

Unë s'kam qenë ndonjëherë në vendin tuaj, por jam takuar disa herë me shokun Ho Shi Min dhe kam biseduar me të. Ne kemi respekt për popullin e vendit tuaj dhe i kuptojmë shumë mirë jo vetëm barrën e rë-

ndë, por edhe vështirësitë e mëdha që keni ju. Të gjithë kanë vështirësi, por mendimi ynë është që vështirësitë tuaja janë më të mëdha. Ne jemi të rrethuar nga imperialistët dhe revizionistët dhe bëjmë një luftë të ashpër kundër tyre, po kështu bëni edhe ju, por vetëm me një ndryshim — që ju bëni luftë me armë kundër imperializmit amerikan dhe tradhtarëve, kurse në vendin tonë, në saje të luftës së popullit dhe të udhëheqjes së drejtë të Partisë sonë të Punës, nuk kemi luftë të armatosur brenda vendit. Ne e konsiderojmë, dhe kështu është, se lufta që bëhet sot në Vietnam nuk është vetëm luftë e Vietnamit të Jugut, por e gjithë popullit tuaj, se lufta e partisë në Jug nuk është vetëm luftë e një partie të veçuar në Vietnamin e Jugut, por e gjithë Partisë së Punonjësve të Vietnamit. Prandaj ne i kuptojmë vështirësitë tuaja. Kjo sjell si pasojë që jo vetëm njerëzit të vriten, që vendi të digjet, por që të lindin edhe vështirësi të mëdha ekonomike. Të gjitha këto janë të paevitueshme gjersa në botë ekziston imperializmi. Këto sakrifica duhet të bëhen gjer në çlirimin e plotë, gjersa të shkatërrohen imperializmi dhe klasat sunduese. Prandaj ne themi se lufta që bën populli vietnamez në Vietnamin e Jugut jo vetëm është një luftë heroike që do të çojë në çlirimin e vendit, por ajo është ndihmë dhe shembull i madh edhe për vendin tonë, si dhe për të gjithë popujt dhe partitë që luftojnë kundër imperializmit. Ne e marrim me mend se lufta që bën prej kaq vitesh populli vietnamez është një luftë shumë e madhe që e ka rrezikuar dhe e rrezikon seriozisht imperializmin amerikan.

Në këtë situatë kaq të vështirë për Vietnamin, sa

e poshtër dhe tradhtare duket veprimtaria e grupit renegat të Hrushovit, e këtij puçisti të regjur! Ai është armik, se në kohën kur vriten vëllezërit tanë në Vietnam e në vende të tjera, thotë që imperialistët amerikanë janë bërë njerëz të arsyeshëm. Po kush qenkan këta «njerëz të arsyeshëm» sipas Hrushovit?! Janë Xhonsoni dhe Din Rasku, vrasësit e njohur të popujve vietnamez, laosian, kamboxhian dhe të mijëra njerëzve të tjerë të pafajshëm në botë.

Kjo që ngjet sot në udhëheqjen e PK të BS është një tragjedi e madhe. E vështirë ka qenë që të kuptoheshin djallëzitë e N. Hrushovit dhe pastaj të organizohej lufta kundër bandës së tij. Por armiku në mos sot, nesër demaskohet, sepse, duke u përpjekur të realizojë qëllimet e tij, s'ka si bën ndryshe, veçse t'i zbulojë me duart e veta planet e tij djallëzore.

Partia jonë e dalloi mirë tradhtinë e Hrushovit, jo se ajo ishte *a priori* një parti ndryshe nga të tjerat, por sepse ne kishim një përvojë të gjatë dhe të pasur në luftën kundër revizionizmit. Partia jonë ka shumë vjet që lufton me konsekuencë kundër revizionizmit jugosllav — titizmit dhe intrigave të tij mjaft të djallëzuara dhe, në luftë me të, kemi fituar një eksperiencë të madhe për të mbrojtur dhe për të zbatuar drejt parimet e marksizëm-leninizimit.

Në saje të kësaj eksperience Partia jonë i pa qysh në fillim qëllimet dhe taktikën oportuniste e tradhtare të Hrushovit. Ne mund ta kishim ngritur zërin dhe dorën kundër këtij renegati edhe më parë, sepse e dinim prej kohësh që ai së bashku me disa tradhtarë të PPSH organizonte komplete kundër Partisë sonë. Por

ne, nga një anë, likuiduam tradhtarët e brendshëm të Partisë dhe, nga ana tjetër, u treguam të duruar për sa i përket Hrushovit, duke ndjekur me vëmendje veprimet e tij. Ai u përpoq të organizonte ushtrinë tonë kundër pushtetit popullor dhe Partisë sonë, dhe më në fund, nëpërmjet ambasadorit të Bashkimit Sovjetik në Shqipëri, u bëri thirrje haptazi ushtarakëve tanë të ngriheshin kundër Partisë. Por ushtarakët tanë ia thanë në sy ambasadorit sovjetik se ai po vepronte në mënyrë armiqësore ndaj nesh. Kështu, planet e tij dështuan. Por kur erdhi puna që grupi i Hrushovit organizoi puçin e Bukureshtit, Partia jonë tha se duhet dalë hapur kundër Hrushovit, duhet mbrojtur marksizëm-leninizmi dhe i duhet rënë në kokë revizionizmit. Dhe kështu bëri.

Fakti është se sot revizionistët po shkojnë tatë-pjetë. N. Hrushovi po demaskohet çdo ditë e më shumë. Ai e ka situatën jashtëzakonisht të vështirë, sepse partitë marksiste-leniniste tani janë të rreshtuara në një radhë dhe janë të lidhura me njëra-tjetrën si betonarme, kurse hrushovianët janë në një fasadë të paqëndrueshme, ku i fryn era sa nga një anë në tjetrën; vapori i tyre po shpohet dhe minjtë po fillojnë të ikin; ata i kanë zënë ethet e Maltës.

Kush është bagazhi i revizionistëve? Bagazhi i revizionistëve është bagazhi i banditëve që i shërbejnë hapur imperializmit. N. Hrushovi ka për mision të inkurajojë kundërrevolucionin. Kështu shpjegohen edhe ngjarjet në Hungari. Partia e Punonjësve të Hungarisë nuk është sot një parti komuniste, ajo s'ka asgjë të përbashkët me marksizëm-leninizmin. Në saje të poli-



tikës liberale të partisë, borgjezia po fiton pozitë e saj të vjetra; rreth Kadarit po grumbullohen reaksionarët hortistë. Janosh Kadari është një kundërrevolucionar, i cili ka bashkëpunuar hapur me Imre Nagin. Ai firmosi në atë kohë vendimin për shpërndarjen e Partisë së Punonjësve të Hungarisë me ndihmën e tankeve sovjetike, prandaj ai është jo vetëm kundërrevolucionar, por edhe likuidator. Tani N. Hrushovi është për vizitë në Hungari dhe po bën dasëm, ngre dollin e mban fjalime kundër komunistëve të vërtetë.

Partia jonë mendon se ne jemi në rrugë të drejtë dhe se në radhë të shtrënguara me partitë e grupet e tjera marksiste-leniniste ne do të fitojmë. Ne s'kemi frikë nga shpifjet dhe bllokadat ekonomike të revizionistëve, nga sharjet dhe presionet e tyre. Sa më shumë që të na shajnë, aq më të nderuar do të jemi ne dhe aq më tepër do të diskreditohen e do të demaskohen ata. Lufta jonë është e vështirë, ajo do të jetë e gjatë, por rëndësi ka fakti se ajo është e drejtë, parimore, është një luftë joaventureske, por e menduar dhe e pjekur. Prandaj ne do të fitojmë, kurse imperializmi, revizionizmi modern, Hrushovi dhe të gjithë ata që e ndihmojnë atë do të humbasin.

*Duke marrë fjalën kryetari i delegacionit të Bashkimeve Profesionale të RD të Vietnamit, Sekretari i Përgjithshëm i Federatës, Tran Danh Tuen, e falënderon shokun Enver Hoxha për këtë takim dhe për vlerësimin e lartë që i bëri luftës heroike të popullit vietnamez kundër imperializmit amerikan dhe veglave të tij. Më poshtë, pasi informoi mbi zhvillimin e situa-*

*tës aktuale në Vietnam, Kamboxhia e Laos, mbi krimet e reja të imperializmit amerikan në këto vende, ai vazhdoi:*

Për sa i përket rrezikut të revizionizmit ne e kemi shumë të qartë. Vetëm një muaj pas takimit të Hrushovit me Kenedin në Vjenë amerikanët dërguan në Vietnamin e Jugut komandantin Harkins. Ne kemi 8 vjet që luftojmë dhe Hrushovi asnjë ndihmë s'na ka dhënë, asnjëherë nuk tha një fjalë të mirë për luftën në Vietnamin e Jugut, veçse këshilla që të veprojmë avash-avash. Vetëm kjo mjafton për të kuptuar se kush janë ata.

Me rastin e ardhjes sonë në Shqipëri ne patëm një fat të madh që u takuam me Ju. Ne ju falënderojmë për përkrahjen tuaj të madhe që i jepni luftës së popullit të Vietnamit të Jugut për çlirim.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Këtë ne e kemi për detyrë, sepse jemi marksistë. Ne e vlerësojmë luftën tuaj, sepse ajo është një ndihmë e madhe për të gjithë ne. Ju e pasaroni me forma të reja luftën kundër imperializmit amerikan dhe kukullave të tij dhe kjo ndihmon në strategjinë dhe taktikën tonë të përbashkët në luftën kundër imperializmit, kundër reaksionit dhe kundër revizionizmit.

Populli ynë thotë: «Armikun e hapur e kemi merak vetë, por të ruhem sidomos nga armiku i fshehtë». Dhe armiq të fshehtë janë revizionistët modernë, të cilët në trastën e tyre kanë plot metoda, por, në fund të fundit, metodat dhe taktikat e tyre janë ato të kapitalizmit dhe të imperializmit. Prandaj armikut të fshehtë kurrë nuk

i duhet zënë besë dhe kurrë nuk duhet t'ia kemi frikën. Gjersa nuk e kemi frikë armikun e hapët është e qartë që s'e kemi frikë dhe armikun e fshehtë. Populli vietnamez, i cili lufton me aq heroizëm kundër imperia-  
lizmit, sigurisht që nuk e ka frikë edhe armikun e fshehtë. Kur populli dhe Partia e Vietnamit i kuptojnë dre-  
dhitë e armiqve të hapët dhe me taktikën e drejtë marksiste-leniniste i shkatërrojnë planet e tyre, ata janë në gjendje të kuptojnë dhe të shkatërrojnë edhe taktikën e armiqve të fshehtë.

Partia jonë, siç u thashë edhe më lart, ka një ek-  
speriencë të mirë në luftën kundër revizionizmit, sepse ajo është ndeshur gjatë me revizionizmin titist që është një agjunkturë e hapët e imperializmit. Para se të de-  
maskoheshin nga Byroja Informative, revizionistët ju-  
gosllavë hiqeshin si miqtë tanë, por në realitet kjo ishte një maskë, sepse ata ishin armiq të fshehtë që vepronin si agjunkturë e imperializmit dhe bashkëpunonin me të kundër komunizmit ndërkombëtar dhe Bashkimit Sovjetik. Por unë këtu do të përmend shkurtimisht ndonjë rast për veprimet e tyre kundër Shqipërisë.

Në vitet e para të Çlirimit ata, nga njëra anë, hiqeshin si miq e aleatët tanë, por, nga ana tjetër, të gjitha sekretet tona të mbrojtjes ua kishin dhënë anglezëve. Kështu, në një mëngjes, anglezët provokuan në Jug të Shqipërisë<sup>1</sup>. Ky ishte i pari provokacion ndaj

---

1 Është fjala për incidentin në kanalën e Korfuzit. Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 5, f. 495-497.

Shqipërisë që tregoi se revizionistët jugosllavë ishin në bashkëpunim me anglezët dhe amerikanët.

Nga ana tjetër, po në ato vite, monarko-fashistët grekë, që ishin vënë në dijeni nga jugosllavët për forcat tona ushtarake në kufirin tonë, organizoheshin për të na sulmuar, kurse Titoja dërgonte këtu gjeneralët e shtatmadhorisë së tij gjoja për të na mbrojtur kundër sulmit të grekëve! Qëllimi i tij ishte që të fuste divizionet jugosllave në Shqipëri. Por Partia jonë nuk e pranoi një gjë të tillë dhe kështu dështoi qëllimi i Titos ndaj vendit tonë. Kjo ndodhi para demaskimit të hapët të Titos.

Pse i thashë këto? Sepse revizionistët janë të gjithë njëloj. Hrushovianët janë tradhtarë, të lidhur me imperializmin amerikan dhe si të tillë ata kanë organizuar e po intensifikojnë luftën kundër marksizëm-leninizmit. Prandaj, duke u nisur nga eksperiencia jonë, ju themi: ruhuni nga Hrushovi dhe njerëzit e tij, asnjë besim mos keni ndaj tyre, sepse, ashtu siç vepruan revizionistët jugosllavë kundër vendit tonë, edhe revizionistët hrushovianë, në qoftë se marrin vesh për planet tuaja të luftës, për taktikën tuaj luftarake, për forcat tuaja, ata me siguri këto të dhëna do t'ua japin imperialistëve! Dhe këtë Hrushovi e bën sepse ai nuk do që të triumfojë lufta e popullit në Vietnamin e Jugut, pse kjo do të thotë që të triumfojë marksizëm-leninizmi, rruga e drejtë e revolucionit. Kështu demaskohet e gjithë vija tradhtare e Hrushovit, forcohen pozitat e marksizëm-leninizmit dhe merr zjarr e gjithë Indokina, hidhet imperializmi në det e bashkë me të të gjithë renegatët dhe kukullat që i shërbejnë. As-

një iluzion nuk duhet pasur ndaj revizionistëve sovjetikë. Ata janë armiq të betuar të marksizëm-leninizmit.

Ne u folëm hapur Partisë e popullit për veprimtarinë e revizionistëve sovjetikë dhe kjo bëri që, kur filluam luftën me Hrushovin, të mos kishim frikë as nga kërcënimet e tij, as nga shantazhet, as nga prerja e ndihmës ekonomike, as nga prerja e marrëdhënieve diplomatike.

Ju e thatë shumë drejt se lufta juaj dhe lufta jonë u shërben mbrojtjes së lirisë së popujve tanë, fitores së popujve tanë, por ajo është njëkohësisht edhe një luftë e madhe me karakter internacionalist. Me luftën tonë ne mbrojmë marksizëm-leninizmin, mbrojmë të drejtën e popujve të të gjithë botës.

Partia jonë mendon se N. Hrushovin duhet ta izolojmë. Por si ta izolojmë? Duke ia thënë «të katër të vërtetat në fytyrë». Në radhë të parë kjo duhet bërë për popullin sovjetik, që ka luajtur një rol të madh në historinë e komunizmit. Por fakt është që komunistët dhe popujt sovjetikë kanë një përgjegjësi të madhe, pasi lanë që revizionizmi t'i kapte në grykë. Ne jemi të bindur se ata do të reagojnë si duhet kundër bandës së Hrushovit. Hrushovi ndalon me të gjitha mjetet shkrimet e partive marksiste-leniniste që të futen në Bashkimin Sovjetik, për arsye se ai ka frikë, dhe grupi i tij është një klikë, se ai ka grumbulluar gjithë llumin rreth vetes së tij, kurse elementët e shëndoshë dhe populli sovjetik janë kundër tij, janë me marksizëm-leninizmin.

*Në fund shoku Enver Hoxha u uroi miqve suksese dhe fitore në luftën kundër imperializmit amerikan dhe kukullave të tij, kundër revizionizmit modern.*

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura në këtë  
takim që gjenden në AQP*

## REVIZIONISTËT MODERNË NË RRUGËN E DEGJENERIMIT SOCIALDEMOKRAT E TË SHKRIRJES ME SOCIALDEMOKRACINË

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

**7 prill 1964**

Çdo ditë që kalon sjell fakte të reja, të cilat dëshmojnë se revizionistët modernë, grupi i N. Hrushovit dhe ata që e pasojnë kanë tradhtuar përfundimisht dhe janë shndërruar në armiq të marksizëm-leninizmit e të internacionalizmit proletar, të socializmit dhe të lëvizjes revolucionare e çlirimtare të klasës punëtore e të popujve të robëruar, në armiq të unitetit të kampit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Ata kanë krijuar një «aleancë të shenjtë» me imperialistët amerikanë dhe reaksionarët e vendeve të ndryshme, me të gjitha forcat e antikomunizmit kundër popujve e socializmit. Gjithë tehun e luftës së tyre ata e kanë drejtuar kundër marksizëm-leninizmit, kundër të gjitha partive motra dhe komunistëve revolucionarë që i qëndrojnë besnikë atij, kundër lëvizjes antiimperialiste, çlirimtare e revolucionare të popujve. Të gjitha fjalët e

tyre mbi «besnikërinë» ndaj marksizëm-leninizmit, ndaj çështjes së socializmit, revolucionit dhe internacionalizmit proletar janë blofe dhe fund e krye demagogji.

Në rrugën e realizimit të kursit të tyre antimarksisht, antisocialist e kundërrevolucionar, ata kanë nevojë për aleatë. Dhe aleatët më të afërt nuk mund të mos ishin elementët revizionistë në partitë e ndryshme dhe klika titiste në Jugosllavi. Prandaj Hrushovi e grupi i tij, me anë puçesh e komplotesh, me pretekstin e luftës kundër «kultit të personit», duke gënjyer disa, duke komprometuar të tjerë, mundën të sjellin në fuqi në krye të disa partive komuniste e punëtores elementët revizionistë, ndërsa, nga ana tjetër, rehabilituan klikën renegate të Titos dhe u bashkuan plotësisht me të. U krijua kështu fronti i bashkuar revizionist. Ky ishte hapi i parë.

Krahas kësaj, revizionistët modernë nuk i kanë pushtuar asnjëherë përpjekjet për të gjetur edhe aleatë të tjerë. Dhe kush mund të ishin këta? Është krejt e natyrshme që ata i kthyen, dhe nuk mund të mos i kthenin, sytë nga «vëllezërit» e tyre të tradhtisë — krerët e djathtë socialdemokratë. Sepse revizionizmi dhe socialdemokratizmi i sotëm janë dy shfaqje të së njëjtës ideologji — ideologjisë borgjeze. Socialdemokratizmi është shfaqje e ideologjisë borgjeze në lëvizjen punëtores, kurse revizionizmi është shfaqje e ideologjisë borgjeze në lëvizjen komuniste.

Kjo është baza e përbashkët ideologjike, që i afron dhe i bashkon revizionistët me socialdemokratët dhe krijon premisat për shkrirjen e tyre të plotë jo vetëm ideopolitike, por edhe organizative. Prandaj është krejt



e natyrshme e logjike që sot po duken gjithnjë më qartë orvatjet e revizionistëve për t'i degjeneruar partitë komuniste që ata drejtojnë në parti socialdemokrate, tendenca për shkrirjen e plotë të tyre me socialdemokracinë.

Orientimi për afrimin e bashkimit me socialdemokracinë, ashtu si dhe gjithë vija tradhtare e revizionistëve modernë, e ka fillimin në Kongresin e 20-të të PK të BS. Ky orientim u ritheksua në kongreset e 21-të e të 22-të dhe u sanksionua në programin e ri të PK të BS. Duke folur për këtë kurs të afrimit e të bashkimit me socialdemokracinë në Kongresin e 22-të, N. Hrushovi tha se «kjo nuk është një parullë e përkohshme taktike, por vija e përgjithshme e lëvizjes komuniste, që diktohet nga interesat rrënjësore të klasës punëtore». Gjithashtu ai ka thënë: «Në qoftë se flitet për rolin dhe vendin e partive jokomuniste, para së gjithash, duhet nënvizuar se në gjendjen e sotme për transformimin socialist të shoqërisë bashkëpunimi i partisë komuniste me partitë e tjera është jo vetëm i mundshëm, por edhe i domosdoshëm» (Përgjigjet e N. Hrushovit dhënë redaktorit të gazetës australiane «Herald», Xhon Uoters, botuar në «Pravda», 25 qershor 1958).

Menjëherë pas Kongresit të 20-të, kursi i afrimit dhe i bashkimit me socialdemokratët filloi të vihet në jetë. KQ i PK të BS u është drejtuar partive socialdemokrate të Evropës Perëndimore me letra, në të cilat bëhet thirrje për unitet. Duke filluar nga viti 1956, Bashkimin Sovjetik e kanë vizituar shumë udhëheqës socialdemokratë dhe delegacione të tëra të partive so-

cialdemokrate, të cilat kanë pasur takime dhe kanë zhvilluar bisedime me grupin e Hrushovit.

Fushata për unitetin me socialdemokratët është intensifikuar shumë sidomos këto kohët e fundit. Për këtë dëshmojnë vizitat që bënë vitin e kaluar në Moskë krerët e socialdemokracisë, si Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Socialiste të Belgjikës, P.A. Spak, kryetari i tanishëm i Partisë Laburiste të Anglisë, Harold Wilson, dhe Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Socialiste të Francës, Gi Mole, të cilët zhvilluan bisedime me N. Hrushovin dhe udhëheqësit e tjerë sovjetikë. Lidhur me këto bisedime, Gi Mole, në një intervistë me gazetarët e huaj në Moskë, tha se diskutuan me Hrushovin «një numër çështjesh, që përfshinin të gjitha problemet teorike e doktrinare të një karakteri të përhershëm e që karakterizojnë raportet midis partive socialdemokrate e komuniste». Kurse në një intervistë dhënë gazetës «Unita» (22 shkurt 1964) Gi Mole deklaroi se «bisedimet që delegacioni i SFIO-s pati me udhëheqësit e PK të BS, dhe në mënyrë të veçantë me Nikita Hrushovin, na dhanë satisfaksion të sigurt në shumë pika».

Frugën e shkrirjes me socialdemokracinë e sotme, nën diktatin e «shkopit të dirigjentit» po e ndjekin edhe udhëheqjet e partive komuniste e punëtore në disa vende të tjera. Kjo duket në mjaft veprime të tyre, në artikuj e deklarata të ndryshme, në faqet e revistës hrushoviane «Probleme të paqes dhe të socializmit», në «Dokumentin e KQ të PK të Italisë për konferencën kombëtare të organizimit», botuar në gazetën «Unita» të datës 9.I.1964, në projektrezolutën për kon-

gresin e 17-të të PK të Francës, që do të mbahet në maj të këtij viti etj.

Në të gjitha këto përpjekje, në këto dokumente e materiale të revizionistëve modernë mbizotëron ideja e unitetit dhe e shkrirjes me socialdemokratët «nbi çdo bazë» e «me çdo kusht», duke hequr dorë nga çdo gjë që mund të pengonte këtë bashkim, qoftë në lëmin ideologjik, qoftë në lëmin organizativ, pavarësisht nga frazat që ata përdorin për t'i maskuar këto qëllime.

Orvatjet e revizionistëve modernë për t'u afruar e për t'u bashkuar me socialdemokratët, janë pasojë logjike e tradhtisë së tyre ndaj marksizëm-leninizmit, janë pjesë përbërëse e planit të tyre të madh strategjik të «integritit botëror», të formuluar qartë nga Titoja në intervistën e njohur dhënë Drju Pirsonit në datën 7 gusht 1962. Për realizimin e këtij qëllimi revizionistët përdorin gjerësisht parullat demagogjike. Ata përpigën të justifikojnë afrimin e bashkimit të tyre me imperialistët dhe reaksionarët në emër të «bashkekzistencës paqësore e të shpëtimit të botës nga lufta shfarosëse termobërthamore», afrimin e bashkimit me klikën e Titos në emër të «socializmit», me papën e Romës në emër të «humanizmit», me socialdemokratët në emër të «unitetit të klasës punëtore».

## REVIZIONISTËT MODERNË ECIN NË GJURMËT TRADHTARE TË SOCIALDEMOKRACISË

Afrimin dhe bashkimit të tyre me socialdemokratët revizionistët modernë përpigën ta justifikojnë me pretekstin se gjoja në gjirin e partive socialdemokrate,

sidomos kohët e fundit, po duken «tendenca pozitive»: se gjoja ato janë shprehur për paqen, për bashkekzistencën paqësore, për çarmatimin, kanë ndryshuar pozitivisht qëndrimin e tyre ndaj BRSS, janë shprehur për njëfarë afrimi me komunistët, kanë shprehur njëfarë gatishmërie për plotësimin e kërkesave të klasës punëtore, për ruajtjen dhe forcimin e institucioneve demokratike, kanë deklaruar se janë për transformimin socialist të shoqërisë etj. Kështu, revizionistët, për të justifikuar kursin e tyre të afrimit me krerët e djathtë socialdemokratë, përpiqen të krijojnë te njerëzit iluzionin se gjoja nuk është treni i revizionistëve që po ecën me shpejtësi drejt stacionit socialdemokrat, por është stacioni socialdemokrat që po shkon drejt trenit revizionist!

Kjo nuk është një taktikë e re e revizionistëve. Pikërisht këtë manovër kanë përdorur grupi tradhtar i Hrushovit dhe ata që i shkojnë pas për të justifikuar afrimin dhe bashkimin e tyre të plotë me klikën titiste, duke thënë se udhëheqësit jugosllavë gjoja kanë korrigjuar shumë nga gabimet e tyre dhe kanë ardhur në pozita «marksiste-leniniste». Po kështu, për të justifikuar kursin e tyre tradhtar të pajtimit dhe të afrimit me imperializmin, sidomos me imperializmin amerikan, ata kanë përhapur e përhapin iluzionin se gjoja krerët e imperializmit janë bërë tani «të urtë», «realistë», «paqedashës», «të arsyeshëm» etj.

Por faktet provojnë se aq sa kanë ndryshuar natyrën dhe qëndrimin e tyre klika titiste dhe imperializmi, aq kanë ndryshuar edhe krerët e sotëm socialdemokratë. Në qoftë se mund të flitet për ndonjë farë

ndryshimi në pikëpamjet dhe qëndrimet e krerëve socialdemokratë, i vetmi ndryshim që vihet re është animi i tyre gjithnjë më i theksuar nga e djathta.

## Ç'përfaqëson socialdemokracia e sotme?

Socialdemokracia e sotme është vazhduesja e drejt-përdrejtë e Internacionales së Dytë tradhtare. Ajo ka trashëguar gjithë bagazhin ideologjik, organizativ e taktik të partive të Internacionales së Dytë. Tradhtinë e tyre socialdemokratët e filluan me largimin nga mësimet themelore të marksizëm-leninizmit, të cilat ato i shpallin të vjetruara e të papërshtatshme, me mohimin e luftës së klasave dhe zëvendësimin e saj me «teorinë» e harmonisë e të pajtimit të klasave, me mohimin e revolucionit dhe zëvendësimin e tij me reformat brenda rendit kapitalist, me heqjen dorë nga rruga revolucionare dhe zëvendësimin e saj me rrugën «paqësore», «demokratike» e parlamentare, me mohimin e nevojës së domosdoshme për thyerjen e aparatit të vjetër të shtetit borgjez dhe me pranimin e shtetit kapitalist si mjet për kalimin në socializëm, me mohimin e diktaturës së proletariatit dhe zëvendësimin e saj me «demokracinë e kulluar e të përgjithshme», me largimin nga internacionalizmi proletar, duke arritur deri në shkarjen e plotë në pozitë e nacional-shovinizmit, të bashkimit të hapët me borgjezinë imperialiste.

Duke demaskuar tradhtinë e socialdemokracisë së vjetër, Lenini, qysh në veprën «Ç'të bëjmë?», ka shkruar:

«Socialdemokracia duhet të shndërrohet nga parti e revolucionit social në një parti demokratike reformash sociale. Këtë kërkesë politike Bernshtajni e ka përforcuar me një bateri të tërë argumentesh dhe arsyetimesh «të reja», të lidhura harmonikisht me njëri-tjetrin. Është mohuar mundësia që të argumentohet shkencërisht socializmi dhe të provohet, nga pikëpamja e kuptimit materialist të historisë, se ai është i domosdoshëm dhe i pashmangshëm; është mohuar fakti se varfëria dhe proletarizimi po shtohen dhe se kontradiktat kapitaliste po acarohen; është shpallur si i pathemeltë vetë nocioni i «qëllimit final» dhe është hedhur poshtë pa kushte ideja e diktaturës së proletariatit; është mohuar divergjenca parimore që ekziston midis liberalizmit dhe socializmit, është mohuar teoria e luftës së klasave, që gjoja nuk mund të zbatohet në një shoqëri krejt demokratike, të geverisur sipas vullnetit të shumicës etj»<sup>1</sup>.

Duke u futur në këtë rrugë, socialdemokracia u shndërrua në një mbrojtëse besnike të rendit kapitalist, në një shërbëtoreshë të borgjezisë, në mbështetjen më të rëndësishme ideologjike e politike të borgjezisë në gjirin e lëvizjes punëtore. Ajo e ka ndihmuar borgjezinë të shtypë e të shfrytëzojë punëtorët e vendit të vet dhe popujt e vendeve të tjera, të mbytë lëvizjen e tyre revolucionare e çlirimtare.

---

1 V. I. Lenin, Veprat, vëll. 5, f. 414-415.

*«Praktikisht është provuar, thotë V.I. Lenini, se militantët në gjirin e lëvizjes punëtore, që bëjnë pjesë në rrymën oportuniste, janë mbrojtësit më të mirë të borgjezisë sesa vetë borgjezët. Po të mos udhëhiqeshin punëtorët nga këta njerëz, borgjezia nuk do të mund të mbahej më këmbë»<sup>1</sup>.*

Por socialdemokracia e sotme ka shkuar edhe më tej në rrugën e tradhtisë në krahasim me kohën e Internacionales së Dytë. Në epokën e sotme atë e karakterizon një anim gjithnjë më i theksuar nga e djathta.

Duke filluar nga viti 1955, partitë socialdemokrate të Evropës Perëndimore, si Partia Laburiste e Anglisë, partitë socialdemokrate të Francës, të Austrisë, të Zvicrës, të Holandës, të Luksemburgut, të Gjermanisë Perëndimore e të vendeve skandinave kanë ndryshuar programet e tyre, ose janë marrë me përpunimin e qëndrimeve të reja programatike. Ç'i karakterizon këto programe e qëndrime të reja programatike? Ato i karakterizon bashkimi eklektik i teorive të vjetra oportuniste me teoritë borgjeze «moderne», heqja dorë përfundimisht nga të gjitha parimet e idealet e socializmit, mbrojtja e hapët e rendit të shfrytëzimit kapitalist dhe antikomunizmi i tërbuar.

Në qoftë se reformistët e vjetër pranonin, qoftë edhe vetëm me fjalë, si qëllim të tyre të fundit vendosjen e socializmit, socialdemokratët e sotëm e kanë hedhur poshtë haptazi këtë qëllim. Ata predikojnë se janë për të ashtuquajturin «socializëm demokratik», i

---

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 254.

cili nuk ka asgjë të përbashkët me socializmin e vërtetë shkencor, është mohimi i tij, zëvendësimi i tij me disa reforma liberale borgjeze, që nuk cenojnë aspak bazat e shoqërisë kapitaliste. Për çfarë socializmi mund të bëhet fjalë kur në shumë programe socialdemokrate është hequr edhe kërkesa elementare e socializmit për likuidimin e pronës private mbi mjetet e prodhimit?

Pas deklaratës së njohur të Internacionales Socialiste «Qëllimet dhe detyrat e socializmit demokratik» (viti 1951), programet e reja e orientojnë klasën punëtore jo kundër kapitalizmit, por vetëm kundër kapitalizmit «të pakontrolluar». Shtetëzimi i një pjese të ndërmarrjeve nga shteti borgjez, krijimi i kapitalizmit monopolist shtetëror, ndërhyrja e shtetit kapitalist në jetën ekonomike të vendit, zbatimi i disa reformave demokratike-borgjeze — të gjitha këto në programet dhe në deklaratat e reja të socialdemokratëve shikohen si fakte që dëshmojnë se gjoja në disa vende kapitaliste janë hedhur bazat e socializmit. Në të njëjtën kohë, ata mohojnë karakterin socialist të transformimeve në vendet socialiste. Ata përsëritin në këtë mënyrë, hapur ose tërthorazi, teoritë borgjeze të modës mbi «kapitalizmin popullor», «të kontrolluar», «të organizuar», «demokratik» etj.

Këtë largim të socialdemokratëve nga parimet e socializmit e në mbrojtje të kapitalizmit e ka përshëndetur më se një herë shtypi reaksionar borgjez. Në një krycartikull të saj me titull «Varrimi i marksizmit» gazeta «Uashington post and tajms herald» shkruante: «Pas 84 vjetëve nga formimi i saj në kongresin historik të Gotës, PSD Gjermane, në kongre-



sin e saj të Bad-Godsbergut, hoqi dorë nga ideologjia marksiste dhe në fakt pushoi së qeni socialiste në kup-timin e vërtetë të kësaj fjale. Ajo u pajtua me parimin e «iniciativës së lirë private kudo që ajo është e mundur» në jetën ekonomike».

Në programet e reja të partive socialdemokrate janë flakur idetë mbi kontradiktat, antagonizmin dhe luftën e klasave, janë fshirë kufijtë midis të shtypurve e shtypësve, të shfrytëzuarve e shfrytëzuesve. Në vend të luftës së klasave ata predikojnë «ndjenjën e përgjegjësisë» të njeriut «në përgjithësi». Kështu, në programin e PSD të Gjermanisë thuhet: «Liria dhe demokracia në shoqërinë industriale janë të mundura vetëm në rast se sa më shumë njerëz do të ngrenë ndërgjegjen e tyre shoqërore dhe do të shprehen të gatshëm të ndajnë përgjegjësinë. Socialdemokratët shprehen për solidaritetin dhe harmoninë e gjithë njerëzve», për realizimin e qëllimit «mbiklasor» — «socializmit demokratik».

Duke qenë se «socializmi demokratik» nuk prek aspak bazat e rendit kapitalist, por është njëlloj kapitalizmi «i reformuar», është e natyrshme që këtu s'ka as vend as nevojë për kurrfarë revolucioni socialist. «Socializmi demokratik», sipas tyre, do të realizohet me anën e «evolucionit ekonomik spontan», të kufizimit të të drejtave dhe fuqisë së bashkimeve monopoliste dhe me ndihmën e vetë shtetit kapitalist. Por megjithatë, për kurorëzimin e këtij ideali, është e nevojshme që socialdemokratët të vijnë në pushtet dhe rruga e vetme për këtë është lufta elektorale për fitimin e shumicës në parlamentin borgjez. Duke lavdëruar deklaratën e

Internacionales Socialiste mbi «Qëllimet dhe detyrat e socializmit demokratik», një nga krerët e saj, Braun-tal, ka thënë se kjo deklaratë «i jep fund diskutimit mbi diktaturën e proletariatit», «përjashton luftën revolucionare klasore si metodë për realizimin e socializmit», «hedh poshtë aderimin në ndonjë teori socialiste».

Partitë socialdemokrate kanë prerë çdo lidhje me marksizëm-leninizmin, me teorinë e socializmit shkencor dhe me botëkuptimin materialist. Në programin e Partisë Socialiste të Austrisë thuhet se «socializmi është një lëvizje ndërkombëtare, që nuk kërkon aspak një-llojshmëri të domosdoshme pikëpamjesh. Pavarësisht nga fakti se nga i nxjerrin pikëpamjet e tyre socialistët, nga analiza marksiste apo nga ndonjë analizë tjetër shoqërore, nga parimet fetare apo humane — të gjithë ata synojnë drejt një qëllimi të përbashkët». Duke folur në kongresin e PSD të Gjermanisë në Bad-God-sberg, ish-kryetari i kësaj partie, E. Olenhauer, tha se «kërkesa për ta bërë programin politik të K. Marksit dhe F. Engelsit përmbajtje të programit socialdemokrat të vitit 1959 është aq antimarksiste saqë nuk mund të imagjinohet», dhe vazhdoi: «Ne nuk mund të na kuptojnë në qoftë se flasim me gjuhën e së kaluarës, ne nuk mund t'i zgjidhim problemet e ditës së sotme me konceptet tona të vjetra».

Socialdemokracia e sotme jo vetëm që ka shkarë me kohë në pozitën e idealizmit filozofik e merr në mbrojtje idealizmin, por kërkon të gjejë mbështetje dhe bile të shkrihet me formën e tij më ekstreme — fenë. Kështu, për shembull, në programet e socialdemokracisë gjermane, austriake, zvicerane etj. vihet në dukje

se «socializmi demokratik» i ka rrënjët e tij në etiketën dhe doktrinën kristiane, se socializmi dhe feja jo vetëm nuk e përjashtojnë njëri-tjetrin, por përputhen plotësisht. Duke folur në kongresin e Partisë Socialiste të Austrisë më 1958, autori i programit të ri, B. Kautski, tha: «Ne dëshironim të hartonim një program, të cilin të mund ta nënshkruante plotësisht si marksisti dhe jomarksisti, si ateisti ashtu edhe socialisti besimtar». Një orvatje e tillë për të pajtuar kristianizmin me socializmin, botëkuptimin idealist fetar me botëkuptimin materialist shkencor bëhet edhe në intervistën e dhënë korrespondentit të gazetës italiane «Unita» nga Gi Mole dhe që u botua në këtë gazetë më 22 shkurt të këtij viti.

Të tilla janë në vija të përgjithshme pikëpamjet ideologjike të socialdemokracisë së sotme. Ajo që duhet theksuar këtu është se programet, si gjithmonë, janë më të majta se veprat e saj. Në qoftë se me fjalë socialistët e djalhtë përpiqen ende ta heqin veten si socialistë për të mashtruar punëtorët, me vepra ata janë shndërruar prej kohësh në mbrojtës besnikë të rendit kapitalist. Si kur janë në opozitë ashtu edhe kur janë në krye të qeverive borgjeze, ose marrin pjesë në to, krerët e socialdemokracisë, me tërë pikëpamjet e veprimet e tyre, u shërbejnë ruajtjes dhe forcimit të rendit borgjez. Gjithë demagogjia socialiste e socialdemokracisë së sotme është hedhur poshtë nga vetë jeta. Socialistët kanë qenë më se një herë në krye të qeverisë borgjeze, si në Angli, Francë e gjetkë. Ata edhe sot janë në krye të qeverive të shumë vendeve kapitaliste, ose marrin pjesë në to. E ç'kanë bërë ata për punonjë-

sit, për socializmin? Ata s'kanë bërë gjë tjetër veçse kanë zbatuar në jetë porosinë e Leon Blumit se, duke qenë në pushtet, socialistët duhet të jenë «drejtues luajalë të shoqërisë kapitaliste».

Le të ndalemi qoftë edhe shkurtimisht në veprimtarinë e Partisë Socialiste të Francës dhe të kreut të saj, Gi Mole, i cili ka marrë pjesë më se një herë, dhe bile ka kryesuar qeverinë franceze, dhe që tani revizionistët e paraqesin si një element të majtë dhe zhvillorinë me të bisedime të përzemërta. Socialistët francezë, kur kryesonin qeverinë, kanë lëshuar qentë kundër punëtorëve grevistë, ata nxitën ndezjen e luftës së ndyrë në Indokinë, ndërmorën represione policore kundër popujve të kolonive të tjera, zhvilluan e forcuan luftën kundër popullit algjerian, aprovuan paktin e Atlantikut të Veriut dhe riarmatimin e Gjermanisë Perëndimore. Qeveria e Gi Molesë nënshkroi marrëveshjen për «Tregun e përbashkët» dhe «Euratomin», ajo ishte një ndër organizatoret e agresionit ushtarak kundër Egjiptit, tradhtia e Gi Molesë i hapi rrugën vendosjes së pushtetit personal në Francë etj., etj. Duke folur për veprimtarinë e qeverisë së Gi Molesë, bile edhe e përjavshmja laboriste «Tribjun» shkruante në fillim të vitit 1957 se «Mole është turp si për Francën ashtu edhe për socializmin».

E tillë është fytyra e vërtetë tradhtare e socialdemokracisë së sotme. Jo më kot shumë përfaqësues të bergjezisë kanë theksuar rolin e madh të partive socialdemokrate në mbytjen e lëvizjes revolucionare të punonjësve dhe në mbrojtjen e rendit kapitalist, u kanë thurur atyre elozhe. Kështu, për shembull, T. Ju-

nilla, drejtor i një banke kapitaliste në Finlandë, ka deklaruar: «Në luftën për shpirtrat e punëtorëve industrialë vetëm socialdemokratët mund të shërbejnë si një forcë e fuqishme, që qëndron kundër komunistëve. Në qoftë se socialdemokracia e humbet këtë betejë, kjo mund të jetë fare mirë fundi i demokracisë në Finlandë. Ja përse unë, duke qenë një konservator borgjez, jam i detyruar të them se neve na duhet një parti socialdemokrate e bashkuar, luftarake dhe që përkrah vendosmërisht demokracinë veriore». Po kështu, gazeta borgjeze angleze «Fainenshil tajms» shkruante më 28 qershor 1963 se «... industrialistët u tremben më pak laburistëve, dhe disa prej tyre bile janë të mendimit se qeveria laburiste do të hapë perspektiva më të mira për zhvillimin sesa Tori».

Pikërisht sepse socialdemokratët janë agjenturë e borgjezisë në lëvizjen punëtore, marksistë-leninistët e kanë pasur kurdoherë të qartë se, pa një luftë të vendosur për demaskimin dhe shpartallimin ideopolitik të socialdemokracisë, klasa punëtore nuk mund të zhvillojë me sukses luftën e saj dhe nuk mund ta çojë atë në fitore.

*«Partitë punëtore borgjeze» si një fenomen politik — ka shkruar V.I. Lenini — tashmë janë krijuar në të gjitha vendet e përparuara kapitaliste, se pa një luftë të vendosur, të pamëshirshme në të gjithë vijën kundër këtyre partive — ose, çka është njëlloj, kundër grupeve, rrymave etj. — as që mund të bëhet fjalë as për luftën kundër imperializmit, as për*

*marksizmin, as për lëvizjen punëtore socialiste»<sup>1</sup>.*

Edhe J.V. Stalini, si një revolucionar e marksist konsekuent, ka theksuar:

*«Socialdemokratizmi i sotëm është mbështetja ideologjike e kapitalizmit. Lenini kishte një mijë herë të drejtë, kur thoshte se politikanët e sotëm socialdemokratë janë «agjentë të vërtetë të borgjezisë në lëvizjen punëtore, qehaja të klasës kapitaliste nga radhët e punëtorëve» dhe se në «luftën civile të proletariatit kundër borgjezisë» ata do të marrin patjetër «anën e «versajasve» kundër «komunarëve»».*

*Nuk mund t'i jepet fund kapitalizmit pa i dhënë fund socialdemokratizmit në lëvizjen punëtore. Prandaj epoka e vdekjes së kapitalizmit është njëkohësisht epoka e vdekjes së socialdemokratizmit në lëvizjen punëtore»<sup>2</sup>.*

Gjithashtu, në Deklaratën e Moskës të vitit 1960, duke theksuar se «krerët e djathtë socialdemokratë kanë kaluar haptazi në pozitat e imperializmit, mbrojnë sistemin kapitalist, përçajnë klasën punëtore» dhe se ata janë «armiq të komunizmit», u kërkohej komunistëve që të vazhdojnë luftën për demaskimin e tyre.

Por revizionistët modernë, me grupin e Hrushovit në krye, si renegatë e armiq të marksizmit, vep-

1 V. I. Lenin, Veprat, vëll. 23, f. 138.

2 J. V. Stalin, Veprat, vëll. 10, f. 242.

rojnë krejt në kundërshtim me mësimet e Leninit dhe të Stalinit, me porositë e Deklaratës së Moskës: ata ndjekin rrugën e bashkimit dhe të shkrirjes me krerët e djathtë socialdemokratë. Dhe kjo nuk është e rastit: socialdemokracinë e sotme dhe revizionistët modernë i lidhin shumë gjëra të përbashkëta, ata ecin në një drejtim ose drejt një qëllimi të përbashkët kundërrevolucionar.

### **Revizionistët modernë kanë shkarë në pozitat e socialdemokracisë**

Ashtu si dikur oportunistët e reformistët e vjetër tradhtuan marksizëm-leninizmin, çështjen e klasës punëtore, të revolucionit dhe të socializmit, edhe revizionistët e sotëm i kanë tradhtuar këto ideale dhe po ndjekin kështu të njëjtën rrugë të paraardhësve të tyre, që janë njëkohësisht edhe frymëzuesit e tyre shpirtërorë. Ata që kanë ndryshuar nuk janë socialdemokratët, por janë pikërisht revizionistët e sotëm, të cilët kanë shkarë në pozitat tradhtare të socialdemokracisë.

Socialdemokratët, duke hedhur poshtë marksizëm-leninizmin, thonë se «nuk mund të zgjidhen problemet e ditës së sotme me konceptet e vjetra». Edhe revizionistët, duke ecur në gjurmët e tyre, spekulojnë me kushtet e fenomenet e reja dhe, nën maskën e luftës kundër «dogmatizmit» e për «zhvillimin krijues të marksizmit» thonë se sot shumë gjëra duhen parë në mënyrë kritike, se ajo që ishte e drejtë 30 vjet më parë, sot nuk mund të jetë më e tillë, se armët atomike dhe rre-

ziku i luftës termobërthamore kanë bërë të domosdoshme rishqyrtimin e pikëpamjeve dhe të qëndrimeve tona për shumë çështje të strategjisë dhe të taktikës, se kush u përmbahet tezave themelore të Marksit dhe të Leninit në vitet 60-të të shekullit të 20-të ai është dogmatik, që nuk merr parasysh ndryshimet e mëdha që janë bërë në botë, se kush u drejtohet vepërave të klasikëve të marksizëm-leninizmit për të analizuar dhe për të shpjeguar procesin e sotëm historik, ai vuan nga citomania etj., etj. Pra, edhe për revizionistët marksizëm-leninizmi është vjetruar, ai nuk u përshtatet më kushteve të reja, ai duhet «pasuruar» me ide dhe konkluzione të reja. Ashtu si gjithë oportunistët e reformistët e vjetër e të rinj, edhe revizionistët po i heqin marksizmit shpirtin e tij kritik e revolucionar dhe po orvaten ta shndërrojnë atë, nga një armë në duart e klasës punëtore kundër borgjezisë, në një armë të borgjezisë kundër klasës punëtore.

«Jo lufta e klasave, por solidariteti dhe harmonia e të gjithë njerëzve që kanë ndjenjën e përgjegjësisë për shoqërinë» — ja, kjo është forca lëvizëse e shoqërisë së sotme, thonë socialdemokratët. Edhe revizionistët e kanë fshirë nga defteri luftën e klasave, dhe në fakt e kanë zëvendësuar atë me idenë e pajtimit të klasave në emër të «ruajtjes së paqes» në botë, ata kanë hequr dorë nga kjo luftë në emër të «shpëtimit të botës nga rreziku i luftës termobërthamore» dhe në vend të luftës së klasave predikojnë «bashkekzistencën paqësore», si mjetin e vetëm për zgjidhjen e të gjitha problemeve jetike që qëndrojnë përpara shoqërisë njerëzore. «Paqe me çdo kusht e me çdo çmim, paqe me të



gjithë e mbi të gjitha», «dashuria kristiane për çdo njeri», «humanizmi abstrakt mbiklasor» — këto janë idetë që propagandojnë në të katër anët revizionistët modernë. Në emër të këtij ideali, revizionistët bashkohen sot me armiqtë e klasës, imperializmin dhe reaktionarët e vendeve të ndryshme, dhe me agjentët e shërbëtorët e tyre — krerët e djathtë socialdemokratë e klikën titiste, ndërsa, nga ana tjetër, luftojnë me tërbim kundër të gjithë atyre që u qëndrojnë besnikë interesave të klasës punëtore dhe ideologjisë së saj marksiste-leniniste — partive komuniste dhe gjithë komunistëve revolucionarë.

Socialdemokratët kanë hequr dorë prej kohësh nga revolucioni dhe predikojnë se në socializëm do të arrijnë me anën e reformave brenda kuadrit të rendit borgjez, të demokracisë e ligjshmërisë borgjeze. Duke ecur në gjurmët e tyre, edhe revizionistët e kanë braktisur rrugën revolucionare, thonë se rruga drejt socializmit është rruga drejt një demokracie gjithnjë e më të gjerë, rruga e respektimit dhe e zbatimit të kushtetutave borgjeze, rruga e «reformave të strukturës». Ashtu si socialdemokratët, edhe revizionistët luftën për demokraci e identifikojnë me luftën për socializëm, luftën për socializëm e kufizojnë me luftën për demokraci. Ata, duke nxjerrë nga varri teoritë e Kautskit e të Bernshtajnit, shprehen vetëm e vetëm për rrugën «paqësore», «parlamentare», të cilën e paraqesin si një parim strategjik botëror, dhe të gjitha përpjekjet e tyre i kanë përqendruar në luftën për votat, për të fituar shumicën e vendeve në parlamentet borgjeze.

Socialdemokratët e shohin shtetin kapitalist si një

shtet mbiklasor, si shprehës dhe mbrojtës të interesave të shoqërisë në tërësi, ata janë kundër thyerjes së aparatit të shtetit të vjetër borgjez, kundër diktaturës së proletariatit, e cila, sipas tyre, është mohim i demokracisë, është një pushtet totalitar etj. Edhe revizionistët përhapin iluzionet se shteti kapitalist mund të ndryshojë karakterin e tij klasor, se ai mund të bëhet një shtet që të shprehë jo vetëm interesat e borgjezisë, por edhe të proletariatit e të masave punonjëse; ata thonë se teza e Leninit mbi domosdoshmërinë e thyerjes së aparatit të shtetit borgjez duhet korrigjuar, se diktatura e proletariatit është një ide e vjetruar, ose, fundja, e përshtatshme vetëm për vendet e prapambetura, se ajo mund të ketë jo vetëm forma të ndryshme, por mund të marrë edhe një përmbajtje krejt të ndryshme. Ashtu si socialdemokratët, edhe revizionistët shpifin kundër diktaturës së proletariatit, e paraqesin gjithë periudhën e sundimit të saj si periudhën e terrorit dhe të arbitraritetit në masë, si periudhën e shkeljes brutale të ligjshmërisë e të demokracisë socialiste etj., etj.

Edhe në veprimtarinë politike praktike revizionistët modernë po ecin në gjurmët e krerëve tradhtarë të socialdemokracisë. Ata në fakt janë bashkuar me armiqtë e socializmit e të popujve — me imperializmin, veçanërisht me imperialistët e SHBA-së, dhe me reaktionarët e vendeve të ndryshme. Për hir të afrimit me imperializmin, për hir të bashkëpunimit sovjeto-amerikan, që është ëndrra dhe ideali më i lartë i N. Hrushovit dhe i grupit të tij, revizionistët nuk ndalen as përpara tradhtisë ndaj miqve e aleatëve të vërtetë të popullit sovjetik, ndaj interesave jetike të vendeve so-

cialiste, ndaj klasës punëtore, ndaj popujve e kombeve të shtypur e të shfrytëzuar nga imperializmi. Për këtë dëshmojnë të tilla veprime të revizionistëve me grupin e Hrushovit në krye, si qëndrimi i tyre aventuresk e kapitullues në krizën e Karaibeve, presionet ndaj Kubës për t'iu nënshtruar imperializmit amerikan, duke sakrifikuar dinjitetin dhe sovranitetin e saj, bashkimi me reaksionarët indianë kundër RP të Kinës, me klikën titiste dhe Venizellosin kundër RP të Shqipërisë, traktati famëkeq i Moskës për ndalimin e pjeshëm të provave bërthamore, që është një tradhti e madhe ndaj interesave të Bashkimit Sovjetik, të vendeve të tjera socialiste e të paqes dhe në dobi të imperializmit amerikan, si dhe mjaft fakte të tjera.

Antikomunizmi përshkon gjithë ideologjinë dhe veprimtarinë praktike të socialdemokracisë së sotme: ajo shpif kundër vendeve socialiste e partive komuniste, përçan lëvizjen punëtore, i kundërvë socializmit shkençor «socializmin demokratik», që s'është gjë tjetër veçse kapitalizmi i reformuar, përpiqet me çdo mënyrë të ruajë rendin kapitalist atje ku ai është në fuqi dhe ta rivendosë atë atje ku ai është përmbysur. Edhe revizionistët modernë po zhvillojnë një veprimtari të gjerë antisocialiste e antikomuniste. Grupi i Hrushovit dhe pasuesit e tij revizionistë kanë përçarë kampin socialist e lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe po ecin me shpejtësi në rrugën e degjenerimit të vendeve socialiste në «republika të urta borgjeze» dhe të partive komuniste e punëtore, nga parti të revolucionit social në «parti të reformave sociale». N. Hrushovi dhe grupi i tij mohojnë karakterin klasor proletar të shtetit so-

cialist e të partisë komuniste, ata po likuidojnë diktaturën e proletariatit dhe Partinë Komuniste në Bashkimin Sovjetik nën pretekstin e shndërrimit të tyre në shtet dhe parti të «të gjithë popullit». Revizionistët kanë ndërmarrë organizime e riorganizime për ndryshimin e formave të drejtimit të ekonomisë në shembullin e Jugosllavisë titiste, duke shkelur parimet marksiste të ndërtimit e të drejtimit të ekonomisë socialiste, ata denigrojnë eksperiencën shumëvjeçare të ndërtimit socialist në Bashkimin Sovjetik e në vendet e tjera socialiste dhe bëjnë thirrje për të mësuar nga eksperiencia e vendeve kapitaliste, sidomos nga eksperiencia amerikane. Ata shprehen për një bashkëpunim në të gjitha fushat me vendet kapitaliste, duke arritur deri atje sa t'u shtrijnë dorën imperialistëve për ndihma, kredi e investime kapitalesh «për ndërtimin e socializmit e të komunizmit», siç bëri kohët e fundit edhe vetë Hrushovi. Nën maskën e luftës kundër «kultit të individit dhe pasojave të tij», ata kanë likuiduar kuadrot e shëndoshë marksistë-leninistë dhe kanë rehabilituar tradhtarët e armiqtë e socializmit, të gjallë e të vdekur. Ata i kanë hapur dyert për depërtimin e gjerë e pa pengesa të ideologjisë borgjeze në vendet socialiste, të gjithfarë tendencave e shfaqjeve të huaja antisocialiste në art, letërsi e në gjithë jetën e vendit, në emër të «lirisë së mendimit» e të një «humanizmi» abstrakt e mbiklasor. Ky socializëm «liberal» e «humanist» i revizionistëve modernë po i afrohet gjithnjë e më shumë të ashtuquajturit «socializëm demokratik», që predikojnë krerët e socialdemokracisë së sotme.

Pra, të gjitha të dhënat tregojnë qartë se revizio-

nistët modernë po ecin në gjurmët tradhtare të social-demokracisë. Këtë e shohin shumë mirë krerët socialistë, të cilët kanë shprehur hapur aprovimin, gëzimin dhe shpresat e tyre lidhur me kursin tradhtar të grupit të Hrushovit e të pasuesve të tij. Ja disa nga deklaratat e tyre:

P.A. Spaku, në fjalimin që mbajti para Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në sesionin e saj të fundit, tha: «Hrushovi po orvatet të bëjë një eksperiment të bashkekzistencës paqësore dhe Perëndimi nuk duhet ta bëjë më të vështirë këtë eksperiment. Do të ishte një gabim i tmerrshëm dhe i pafalshëm po ta dekurajonim. Në këtë moment vija e nesërme e demarkacionit nuk do të jetë më midis komunistëve dhe jokomunistëve, midis të kolonizuarve dhe kolonizatorëve, midis ideologjive e racave. Ne jemi dëshmitarë të luftës midis atyre që presin kohën oportune dhe doktrinarëve çnjerëzorë, nga njëra anë, dhe atyre që kanë pasur besim në përparimin dhe nuk kanë pushuar kurrë së shpresuari, nga ana tjetër. Të mos e lëmë të na shpëtojë nga duart ky okazion i madh».

Kryetari i Partisë Laburiste të Anglisë, H. Uilson, në intervistën e tij të 24 shkurtit 1964, vuri në dukje se ishte i pari nga politikanët e Perëndimit që vizitoi Rusinë pas vdekjes së Stalinit dhe, pas kthimit të tij nga Rusia, i raportoi U. Çërçillit, i cili në atë kohë ishte kryeministër, se «në politikën sovjetike është duke u bërë një ndryshim i madh» dhe se «kjo ka një rëndësi të madhe për sa u përket marrëdhënieve midis Lindjes dhe Perëndimit». Ai ka plot të drejtë të krenohet për

parashikimet e tij largpamëse, të cilat sot janë bërë realitet.

Drejtori i gazetës së Partisë Socialiste të Francës Zherard Zhak, para se të shkonte me delegacionin socialist në Moskë për bisedime me N. Hrushovin dhe udhëheqësit e tjerë sovjetikë, deklaroi: «Ne kemi hequr dorë prej kohe nga polemika me Bashkimin Sovjetik dhe pranojmë se ky vend ndodhet në fazën e plotë të evolucionit... Problemet që shtrohen janë ato të demokracisë e të garancisë demokratike, të partisë së vetme, të rolit të partisë socialiste në shoqërinë socialiste, të karakterit të regjimit socialist dhe të strukturës së tij. Qëndrimi i mbajtur nga PK e BS në divergjencat midis Moskës dhe Pekinit sjell një sqarim pozitiv në qëndrimin e kësaj partie ndaj dogmatizmit dhe sektarizmit politik».

Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Socialiste të Francës, Gi Mole, pas kthimit në Paris nga bisedimet me N. Hrushovin, deklaroi se ai u bind që «në Bashkimin Sovjetik po ndodh një evolucion pozitiv», i cili, sipas fjalëve të tij, përmbledhet në këto çështje: «Njo-hja e rrugëve të shumta për ndërtimin e socializmit», «fundi i diktaturës së proletariatit», «evolucioni i brendshëm» etj. Kurse në intervistën dhënë gazetës «Unita» (22 shkurt 1964) Gi Mole deklaroi: «Jam i bindur se bota komuniste është në rrugën e transformimit».

Këto deklarata të krerëve socialdemokratë përputhen me deklaratat e krerëve të imperializmit e të zëdhënësve të tyre, të cilët, gjithashtu, shprehin përkrahjen e tyre për kursin revizionist të Hrushovit dhe e konsiderojnë atë «mikun më të mirë të Perëndimit në

Moskë», thonë se «kryeministri sovjetik Nikita Hrushov vepron si politikan amerikan» dhe pohojnë se personalitetet zyrtare në Departamentin e Shtetit të SHBA-së janë të mendimit se «gjer në njëfarë shkalle Shtetet e Bashkuara duhet t'ia lehtësojnë detyrën Hrushovit» etj., etj.

### DREJT SHKRIRJES SË PLOTË TË REVIZIONISTËVE MODERNË ME SOCIALDEMOKRATËT

Shkarja e revizionistëve modernë në pozitë ideologjike të socialdemokratëve për çështjet më kryesore është baza për shkrirjen e plotë të revizionistëve me socialdemokratët. Duke ndjekur këtë kurs dhe duke ua rekomanduar atë partive komuniste e punëtore të vendeve të ndryshme, revizionistët modernë, me grupin e Hrushovit në krye, synojnë t'i degjenerojnë partitë komuniste në parti reformiste të tipit socialdemokrat, të forcojnë ndikimin e ideologjisë borgjeze e të iluzioneve reformiste në masat punonjëse, të dobësojnë frymën luftarake revolucionare të lëvizjes së klasës punëtore dhe ta largojnë atë nga rruga e vetme e drejtë kundër rendit kapitalist të shtypjes e të shfrytëzimit.

Natyrisht, revizionistët, si kurdoherë, nuk i shpallin hapur qëllimet e tyre armiçësore. Çdo hap që ndërmarrin në dëm të çështjes së revolucionit e të komunizmit, ata e shoqërojnë me parulla demagogjike, e veshin me justifikime gjithfarëshe. Edhe aksionin e tyre antimarksist të shkrirjes me socialdemokracinë ata përpiqen ta justifikojnë me pretekstin se gjoja partitë

socialdemokrate janë parti punëtore dhe se në luftën kundër kapitalit duhet rivendosur medoemos uniteti i klasës punëtore. Le të ndalemi shkurtimisht te kjo çështje.

### Parti punëtore apo «parti borgjeze të klasës punëtore»?

A janë me të vërtetë parti të klasës punëtore partitë socialdemokrate?

Për të gjykuar nëse një parti është parti e klasës punëtore, nuk mund të nisesh nga emri që ajo i vë vetes. Edhe partia e Hitlerit e quante veten «nacional-socialiste»! I vetmi kriter i drejtë për këtë është nëse ajo mbron dhe shpreh interesat e klasës punëtore, lufton për çështjen e saj. Dhe për ta sqaruar këtë çështje duhet parë se në dobi të kujt është ideologjia, politika dhe gjithë veprimtaria praktike e kësaj apo asaj partie.

*«Mos u besoni frazave — na mëson V.I. Lenini — shihni më mirë kush përfiton nga kjo!»<sup>1</sup>.*

Dhe në qoftë se e shikojmë çështjen në këtë prizëm, në prizmin klasor, që është i vetmi kriter i drejtë, marksist-leninist, atëherë për çdo komunist të vërtetë është e qartë se partitë socialdemokrate nuk janë parti të klasës punëtore, por janë, ashtu siç i ka karakterizuar ato Lenini, «parti borgjeze të klasës punëtore».

<sup>1</sup> V. I. Lenin. Veprat, vëll. 19, f. 37.



Më sipër, me fakte të shumta, ne treguam se qoftë nga pikëpamja ideologjike, qoftë nga ajo politike dhe në gjithë veprimtarinë e saj socialdemokracia e sotme s'është gjë tjetër veçse, siç thotë Lenini, «një repart politik i borgjezisë» «përhapës i ndikimit të saj», «agjenturë e vërtetë e borgjezisë në lëvizjen punëtore».

Por edhe nga pikëpamja e përbërjes shoqërore të tyre në partitë socialdemokrate janë bërë e po bëhen ndryshime të dukshme. Në to po pakësohet gjithnjë e më shumë numri i punëtorëve dhe po shtohen elementët mikroborgjezë dhe burokracia punëtore. Reformistët e sotëm e kanë hedhur vetë parullën për «shproletarizimin» e partive socialdemokrate. Dhe kjo ka gjetur shprehjen e saj në programet e reja të shumë partive socialdemokrate. Kështu, për shembull, në programin e PSD të Zvicrës thuhet: «Në fillim socializmi ishte çështje vetëm e klasës punëtore, që shfrytëzohej nga kapitalizmi... Tani socializmi është bërë çështje e gjithë njerëzimit. Ai prek çdo njeri që ka ndjenjën e përgjegjësisë për mirëqenien e shoqërisë».

Kjo është për bazën, për masën e partive socialdemokrate, kurse për sa u përket kadrove drejtues, sa më lart ngjitesh në shkallën hierarkike të partive socialdemokrate, aq më pak punëtorë gjen në to. Në fakt, shumë krerë socialdemokratë janë shndërruar prej kohësh në kapitalistë të vërtetë: shumë prej tyre bëjnë pjesë në këshillat administrativë të bankave më të mëdha dhe zotërojnë paketa solide aksionesh, duke marrë me miliona e miliona të ardhura çdo vit. Kështu, për shembull, sipas disa të dhënave të viteve të fundit, 410 funksionarë kryesorë të PSD të Gjermanisë zinin 929

vende me pagesa shumë të larta në bankat dhe në shoqëritë e mëdha të Gjermanisë Perëndimore, 62 personalitete socialdemokrate ishin drejtorë në konsorciumet e Manesmanit, Kleknerit, Kruppit, Flikut etj. E tillë është gjendja edhe në partitë e tjera socialdemokrate të Perëndimit, si në Francë, Angli, Belgjikë, vendet skandinave etj.

Ja ç'«klasë punëtore» përfaqësojnë partitë socialdemokrate! Revizionistët modernë, që vetë nuk janë gjë tjetër veçse tradhtarë të klasës punëtore, kanë arsye t'i vënë etiketën «parti punëtore» jo vetëm vetes së tyre, jo vetëm socialdemokratëve, por edhe ndonjë partie konservatore borgjeze, në qoftë se këtë e dikton plani i veprimtarisë së tyre antimarksiste, antirevolucionare.

Duket sheshit, pra, se argumenti i revizionistëve modernë se gjoja partitë socialdemokrate janë parti të klasës punëtore, është krejt fals. Këtej del se dhe parulla e tyre mbi «nevojën e unitetit të klasës punëtore» është një parullë demagogjike, një pretekst për të justifikuar bashkimin me «partitë borgjeze të klasës punëtore».

Lëvizja punëtore, pothuajse në të gjitha vendet e zhvilluara kapitaliste, është e përçarë. Por kush është shkaktar i kësaj përçarjeje? Kush e pengon arritjen e unitetit të veprimeve në lëvizjen punëtore? Në Deklaratën e Moskës të vitit 1960 theksohet se shkaktarët dhe ruajtësit e përçarjes në shkallë kombëtare e ndërkombëtare janë «klasat sunduese, udhëheqësit e djathtë të socialdemokracisë dhe liderët reaksionarë të sindikatave». Në këto kushte, marksistë-leninistët revolu-

cionarë për të realizuar unitetin e veprimit në lëvizjen punëtore, kanë parasysh:

a) se uniteti i veprimeve mund të arrihet vetëm në luftë me përçarësit, prandaj ata zhvillojnë një luftë parimore, të pamëshirshme e konsekuente kundër përçarësve — krerëve tradhtarë socialdemokratë;

b) se të gjitha forcat duhen përqendruar për arritjen e unitetit të veprimit punëtor në bazë me masat punëtore të partive socialiste, se parulla e marksistë-leninistëve për unitetin e klasës punëtore mund dhe duhet të jetë: mbështetja te baza, aleancë me të majtët, luftë pa kompromis kundër krerëve të djathtë tradhtarë e përçarës, për demaskimin dhe izolimin e tyre;

c) se duke kërkuar unitetin e veprimit me socialistët, partitë komuniste duhet ta konsiderojnë këtë jo si një bashkëpunim midis dy partive politike të klasës punëtore, por si bashkëpunim midis partisë proletare me një parti joproletare, për arritjen e disa objektivave të caktuar. Lidhur me këtë duhen mbajtur kurdoherë parasysh e duhen zbatuar me rreptësi mësimet e Leninit, i cili më se një herë ka theksuar me forcë se është e domosdoshme që partia revolucionare e klasës punëtore, duke hyrë në aleanca e marrëveshje me lëvizjet e tjera, për këto apo ato çështje e objektiva, të ruajë në çdo moment e situatë pavarësinë e saj politike dhe ta diferencojë me saktësi veten ideologjikisht e politikisht nga të gjitha klasat e tjera dhe partitë e tjera, në mënyrë që të mos harrojë për asnjë çast interesat rrënjësore të klasës punëtore dhe luftën për arritjen e qëllimit të saj final — triumfin e socializmit e të komunizmit.

Çdo largim nga këto pozita marksiste-leniniste sjell si pasojë largimin e klasës punëtore nga rruga revolucionare dhe shkarjen e saj në llumin e oportunitizmit. I tillë është qëndrimi i marksistë-leninistëve lidhur me çështjen e unitetit të lëvizjes punëtore.

Por cili është qëndrimi që mbajnë lidhur me këtë revizionistët modernë? Ata jo vetëm kanë hequr dorë nga lufta kundër përçarësve të lëvizjes punëtore — krerëve të djathtë socialdemokratë, por, për më tepër, janë për unitet «me çdo kusht» e «me çdo çmim» me këta përçarës e tradhtarë. Bile revizionistët ngrihen kundër të gjithë atyre që luftojnë kundër krerëve të djathtë socialdemokratë dhe që demaskojnë tradhtinë e tyre, e konsiderojnë këtë luftë si qëndrim «sektar» e «dogmatik», si «sharje», «fyerje» e «sulme të dëmshme» etj.

Por dihet prej të gjithëve se krerët socialdemokratë, si Spaku, Gi Moleja e të tjerë, me të cilët Hrushovi dhe përkrahësit e tij zhvillojnë «bisedime të përziemërta» dhe përpiqen të arrijnë unitetin «me çdo kusht», janë shërbëtorë e agjentë të borgjezisë, të cilët, bile në mjaft vende kapitaliste, kanë qenë e janë në krye të qeverive borgjeze. Prandaj uniteti me këta tradhtarë nuk është aspak unitet i lëvizjes punëtore, por orvatje për «unitet» të klasës punëtore me borgjezinë, për nënshtrimin e klasës punëtore ndaj borgjezisë, unitet e bashkëpunim me qeveritë reaksionare borgjeze, gjoja «socialiste».

Më parë, kur nuk e kishin treguar akoma kaq hapur fytyrën e tyre tradhtarë, revizionistët modernë thonin se janë kundër krerëve të djathtë socialdemo-

kratë, se me ta nuk mund të ketë unitet etj., bile edhe kanë thënë ndonjë fjalë kundër tyre. Pikërisht Hrushovi në Kongresin e 21-të të PK të BS ka thënë se çështjen e unitetit të klasës punëtore e pengojnë «reaksioni imperialist dhe shërbëtorët e tij në lëvizjen punëtore, të tillë si liderët antikomunistë të socialdemokracisë — Gi Mole dhe Spak. Këta krerë të antikomunizmit ne i njohim të gjithë me emër dhe nuk mbështetemi tek ata kur flasim për unitetin e veprimit të klasës punëtore». Kurse tani është pikërisht po ky Hrushov që «bisedon përzemërsisht» dhe u lutet pikërisht të tillë liderëve antikomunistë, si Gi Moleja, Spaku, H. Uilsoni e të tjerë, për bashkëpunimin dhe për arritjen e «unitetit të klasës punëtore»! Një nga të dyja: ose Gi Moleja, Spaku dhe shokët e tyre kanë pushuar së qeni antikomunistë, ose vetë Hrushovi ka pushuar së qeni komunist dhe bashkohet me krerët e antikomunizmit, shërbëtorët e reaksionit imperialist! Deri tani nuk ka asnjë shenjë që të provojë të parën, ndërsa për të dytën janë të gjitha të dhënat.

Pavarësisht nga parullat demagogjike që përdorin për të mashtruar masat, revizionistët modernë janë në fakt jo vetëm për «unitet me çdo kusht» me socialdemokratët, duke përfshirë edhe krerët tradhtarë të tyre, por kanë shkuar akoma më tej, duke u shprehur për unitet e bashkëpunim me ta «mbi çdo bazë». Kështu, në një artikull të revistës «Komunist» të PK të BS, Nr. 3, 1960, thuhet: «Me reformistët, bile edhe me ata më të regjurit, uniteti i veprimit për këto ose ato çësh-

tje është gjithnjë i mundur në qoftë se ata përpiqen me të vërtetë të arrijnë çfarëdo reforme, qoftë kjo dhe më e vogla, në dobi të klasës punëtore, të punonjësve». Kurse udhëheqja e PK të Francës, në bazë të vendimit të plenumit të KQ të 27-28 shtatorit 1961, lidhur me çështjen e bashkëpunimit me Partinë Socialiste dhe me partitë e tjera, ka deklaruar: «Ne, nga ana jonë, jemi gati të bashkëpunojmë mbi çdo bazë»<sup>1</sup>.

Revizionistët, pra, duke spekuluar me parullën e «unitetit», sakrifikojnë parimet, fshijnë dallimin midis komunistëve dhe socialdemokracisë, marrin nëpër këmbë e sakrifikojnë interesat rrënjësore të klasës punëtore. Ky është një unitet i rremë, një unitet në dobi të borgjezisë e të agjenturës së saj në lëvizjen punëtore, i cili ka për qëllim t'ia nënshtrojë krejtësisht lëvizjen punëtore ndikimit borgjez e reformist, të likuidojë frymën revolucionare dhe partinë revolucionare të klasës punëtore. Kjo është një tradhti e madhe ndaj çështjes së klasës punëtore e të socializmit.

Nga të gjitha këto rrjedh një konkluzion i rëndësishëm: uniteti i vërtetë e mbi baza të shëndosha i lëvizjes punëtore mund dhe do të arrihet jo vetëm në luftë të ashpër me krerët e djathtë socialdemokratë, por edhe me revizionistët modernë, kundër orvatjeve të tyre të rrezikshme për t'ia nënshtroar krejtësisht lëvizjen punëtore influencës helmuese e kundërrevolucionare të socialdemokracisë dhe të krerëve të saj të djathtë tradhtarë.

1 Revista «Komunist», Nr. 3, 1962, f. 95.

## Likuidimi i partive komuniste — pikësnyimi i revizionistëve modernë

Faktet provojnë se zhurma e madhe që po bëjnë revizionistët modernë lidhur me çështjen e «unitetit» të lëvizjes punëtore s'është gjë tjetër veçse një bluf, një manovër demagogjike për të fshehur gjurmët. Kurse qëllimi i tyre i vërtetë është degjenerimi i partive komuniste në parti të tipit socialdemokrat, bashkimi «me çdo kusht» e «mbi çdo bazë» me socialdemokratët dhe, më në fund, likuidimi i partive komuniste, shkrirja e tyre e plotë me partitë socialdemokrate.

Krerët socialdemokratë, që nuk mund të mos i shohin këto orvatje e qëllime të revizionistëve, në përputhje me këto, kanë përcaktuar qëndrimin dhe taktikën e vet ndaj tyre. Ashtu si edhe imperialistët amerikanë e klika titiste, krerët socialdemokratë ndjekin ndaj revizionistëve një taktikë të dyfishtë:

Nga njëra anë, ata lavdërojnë kursin e tyre revizionist, u japin atyre përkrahje dhe i inkurajojnë si aleatë në rrugën e tradhtisë, i nxitin kundër marksizëm-leninizmit dhe të gjithë atyre që i qëndrojnë atij besnikë. Për t'u dalë përpara revizionistëve dhe për të mashtruar masat, disa krerë socialdemokratë, sidomos kohët e fundit, kanë filluar të flasin me një gjuhë të ngjashme me atë të revizionistëve dhe të bëjnë deklarata në favor të paqes, bashkekzistencës paqësore e çarmatimit, bile kanë ndryshuar deri diku edhe qëndrimin e tyre ndaj Bashkimit Sovjetik dhe ndaj komunistëve në vendin e tyre etj. Natyrisht, këtu nuk është aspak

fjala për ndonjë ndryshim të vërtetë të pozitave themelore të socialdemokratëve, po për një ndryshim të qëndrimit të tyre ndaj revizionistëve për arsyet e mësipërme. Pikërisht këtë lloj «ndryshimi» revizionistët, në mënyrë demagogjike, përpiqen ta paraqesin si «anim nga e majta» të socialdemokratëve, për të justifikuar kalimin e vet nga e djathta, për të justifikuar vijën e vet të afrimit e të bashkimit me ta.

Nga ana tjetër, krerët socialdemokratë mbajnë një qëndrim «të rëndë» e «krenar» ndaj kërkesave e lutjeve servile të revizionistëve për afrim e bashkim, u bëjnë atyre presione dhe kërkojnë lëshime të reja, gjithnjë më të mëdha. Dhe ç'kërkojnë socialdemokratët?

Në fushën ideologjike ata kërkojnë që revizionistët jo vetëm në thelb, por edhe formalisht, të heqin dorë përfundimisht nga parimet themelore të marksizëm-leninizmit, nga ideja e diktaturës së proletariatit, nga roli udhëheqës i partisë komuniste, nga internacionalizmi proletar etj.

Në fushën politike ata kërkojnë «garanci demokrate» të reja, lejimin e shumë partive, pra edhe të partive borgjeze, dhe ndarjen e pushtetit midis tyre në vendet socialiste, ndryshimin e sistemit elektoral, duke përfshirë në listat e kandidatëve edhe elementët anti-socialistë etj. Kërkojnë, me fjalë të tjera, «liberalizimin» e regjimit socialist dhe shndërrimin e tij në një demokraci të zakonshme borgjeze.

Në fushën ekonomike ata kërkojnë që të hiqet dorë nga sistemi kooperativist në fshat, nga «format e vjetra» të organizimit dhe të drejtimit të ekonomisë, që të ecet në rrugën e afrimit e të «bashkëpunimit të gjerë



e të gjithanshëm» të vendeve socialiste me vendet kapitaliste etj.

Në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare ata kërkojnë që të bëhen lëshime të reja e më të mëdha ndaj imperializmit në emër «të ruajtjes së paqes», të hiqet dorë nga përkrahja e lëvizjes revolucionare e nacionalçlirimtare, bile të sakrifkohet RD Gjermane, si kusht për vendosjen e paqes në Evropë.

Të tilla kërkesa kanë paraqitur, për shembull, Spaku, Gi Moleja dhe krerë të tjerë socialdemokratë. Këto kërkesa ngjajnë si dy pika uji me kërkesat që u kanë shtruar revizionistëve imperialistët, sidomos ata amerikanë, me anën e Ajzenhauerit, Dallesit, Kenedit, Xhonsonit etj.

Krerët socialdemokratë janë të bindur se revizionistët do të ecin në rrugën e lëshimeve të reja, sepse kjo është pasojë e pashmangshme e vijës tradhtare që ndjekin revizionistët. Dhe faktet provojnë çdo ditë e më qartë se ata nuk janë gabuar në shpresat e tyre. Me të vërtetë, revizionistët, pasi u futën thellë në rrugën e degjenerimit socialdemokrat të partive komuniste, ku ata janë në krye, tani po orvaten të hedhin edhe hapinjtjetër — atë të shkrirjes së plotë me partitë socialdemokrate.

Në krye të këtyre përpjekjeve qëndron «trojka» revizioniste — grupi i Hrushovit, klika e Titos dhe udhëheqja revizioniste e PK të Italisë, me P. Toliatin në krye. Shembulli më i qartë që dëshmon se si ecet në këtë rrugë tradhtare, është ai i udhëheqjes së PK të Italisë. P. Toliati dhe udhëheqësit e tjerë revizionistë i kanë imponuar PK të Italisë një vijë fund e krye opor-

tuniste e reformiste, që largohet në mënyrë flagrante nga mësimet e parimet themelore të marksizëm-leninizmit, një vijë që ka zëvendësuar luftën e klasave, revolucionin dhe diktaturën e proletariatit me të ashtuquajturën «rrugë italiane drejt socializmit» nëpërmjet «reformave të strukturës», në kuadrin e «demokracisë borgjeze», të shtetit «mbiklasor» borgjez e të kushtetutës borgjeze. Dhe jo vetëm kaq. Duke ecur në këtë rrugë antimarksiste, P. Toliati dhe udhëheqësit e tjerë revizionistë të PK të Italisë po trumbetojnë prej kohësh me të madhe domosdoshmërinë e ndryshimit të «karakterit, funksioneve dhe strukturës organizative» të partisë së tyre, në përputhje gjoja me problemet e mëdha politike që qëndrojnë para saj, me «transformimet e thella që janë kryer e janë duke u kryer në strukturën ekonomike, sociale e politike të vendit», «me problemet e luftës për socializëm në vendet e kapitalizmit të avancuar» etj., etj.

Se në ç'drejtim do të bëhen këto ndryshime dhe cili është pikësynimi i tyre, për këtë dëshmon qartë «Dokument i KQ të PK të Italisë për konferencën kombëtare të organizimit», botuar në gazetën «Unita» të datës 9 janar 1964. Në këtë dokument thuhet: «Ekzistenca esenciale është që të kërkohet e të vihet në jetë një sistem kontaktesh e lidhjesh të reja midis të gjitha forcave që pranojnë një politikë dhe një të ardhme socialiste» me perspektivë që «të kapërcehet organikisht ndarja që ekziston midis organizatave të ndryshme të klasës punëtore, duke hedhur bazat e një organizate të vetme». Bile thuhet se, në dritën e luftës kundër zhvillimit monopolist të vendit dhe për ta futur atë në rru-

gën e zhvillimit socialist, duhet parë edhe «problemi i raportit dhe i dialogut me lëvizjen politike e demokratike katolike, që është forca tjetër e madhe, përkrahja e së cilës është e domosdoshme për të ndërtuar në Itali një shoqëri të re».

Këto teza të udhëheqjes së PK të Italisë janë vazhdimi dhe konkretizimi i mëtejshëm i pikëpamjeve oportuniste të shprehura shumë kohë më parë nga P. Toliati. Qysh në mbledhjen e KQ të PK të Italisë më 24 qershor 1956 Toliati ka thënë: «Mund të shohim në fakt një shtytje drejt socializmit dhe një orientim pak a shumë të qartë drejt reformash e transformimesh ekonomike të tipit socialist edhe në vende ku partitë komuniste jo vetëm nuk marrin pjesë në pushtet, por nganjëherë nuk janë bile as ndonjë forcë e madhe... Kjo situatë paraqitet sot dhe merr një rëndësi të veçantë në ato zona të botës që janë çliruar pak kohë më parë nga kolonializmi. Por edhe në vende kapitaliste shumë të zhvilluara mund të ndodhë që klasa punëtore, në shumicën e saj, të shkojë pas një partie jokomuniste dhe nuk mund të përjashtohet që edhe në këto vende parti jokomuniste, por të bazuara në klasën punëtore, mund të shprehin shtytjen që vjen nga klasa punëtore për një ecje drejt socializmit. Bile edhe atje ku ekzistojnë parti komuniste të forta, mund të ekzistojnë, krahas tyre, parti të tjera që të kenë baza në klasën punëtore dhe një program socialist. Tendenca për të realizuar transformime ekonomike rrënjësore në një drejtim, që është përgjithësisht ai i socializmit, mund të vijë, më në fund, edhe nga organizata e lëvizje që nuk e quajnë veten socialiste».

E reja në dokumentin e fundit të KQ të PK të Italisë për konferencën organizative të partisë qëndron në faktin që nga konsideratat pseudoteorike tani po bëhen orvatje për të kaluar në terrenin praktik për krijimin e së ashtuquajturës «organizatë-unike të klasës punëtore», me fjalë të tjera, për likuidimin e partisë komuniste si pararojë revolucionare dhe e pavarur e klasës punëtore.

Ne edhe më parë kemi pasur rastin të vëmë në dukje se këto pikëpamje të udhëheqësve të PK të Italisë nuk janë aspak origjinale, por janë krejt të njëjllota me ato të renegatëve titistë, që janë të sanksionuara në programin e LKJ, të dënuar me kohë nga tërë lëvizja komuniste ndërkombëtare si thellësisht antimarksist. Pikërisht në këtë program revizionist thuhet: «Pikëpamja se partitë komuniste kanë monopolin në çdo anë të zhvillimit drejt socializmit dhe se socializmi shprehet vetëm në to e nëpërmjet tyre, teorikisht është jo e drejtë dhe praktikisht shumë e dëmshme». Aty thuhet gjithashtu se: «...LKJ e konsideron si dogmë shpalljen e monopolit absolut të partisë komuniste në pushtetin politik si parim universal e të përhershëm të diktaturës së proletariatit dhe të ndërtimit socialist».

Uniteti i pikëpamjeve të udhëheqjes së PK të Italisë me ato të klikës titiste ka të bëjë jo vetëm me këto çështje, por shtrihet në tërë vijën e tyre. Ky unitet revizionist u shpreh qartë edhe në komunikatën e përbashkët Tito-Toliati, të nënshkruar në Beograd më 21 janar të këtij viti, si dhe në një kryeartikull të Toliatit, të botuar në «Rinashita» pas kthimit të tij nga vizita në Jugosllavi.

Gjatë vizitës në Jugosllavi, Toliati dhe Titoja nuk

e fshehën se ata biseduan rreth çështjes së koordinimit të veprimeve të tyre të përbashkëta për përhapjen dhe triumfin e «kursit të ri pozitiv» në lëvizjen komuniste, sidomos në Evropë, dhe për zhdukjen e pengesave në rrugën e «unitetit» të lëvizjes punëtore e komuniste mbi bazën e këtij kursi. Gjatë këtyre bisedimeve u duk edhe një herë qartë «roli i veçantë» që udhëheqësit e PK të Italisë i kanë caktuar vetes të luajnë në lëvizjen komuniste e punëtore të Evropës Perëndimore (le të kujtojmë teorinë e «policentrizmit», ku, natyrisht, nënkuptohet se një nga qendrat drejtuese kryesore e më «tërheqëse» do të ishte, pa dyshim, PK e Italisë me P. Toliatin në krye!).

Për t'ia arritur qëllimit të tyre — triumfit të «kursit të ri», degjenerimit të partive komuniste, revizionistëve me grupin e Hrushovit në krye u duhet, në radhë të parë, medoemos të thyejnë, të nënshtrojnë plotësisht e të fusin në rrugën e degjenerimit, veç PK të Italisë, për të cilën përpiqet me zell të papërmbajtur vetë P. Toliati, edhe PK të Francës, si dy partitë më të mëdha të Evropës Perëndimore. Pikërisht për këtë arsye «Trojka trojane» — grupi i Hrushovit, klika e Titos dhe udhëheqja revizioniste e PK të Italisë — po ushtron mbi PK të Francës presione të forta e të gjithanshme, për ta detyruar të heqë dorë plotësisht nga parimet revolucionare leniniste. Në këtë drejtim mbi PK të Francës njëkohësisht ushtrojnë një presion të përditshëm krerët socialistë të djathtë me Gi Molenë në krye, si dhe elementët e ndryshëm revizionistë në gjirin e vetë Partisë Komuniste të Francës, si Rajmond Gijo e të tjerë.

PK e Francës është një parti me tradita revolucionare. Dikur ajo ka dhënë një kontribut të njohur në luftën kundër rrymave të ndryshme antimarksiste, duke filluar qysh nga socialistët e djathtë, si Leon Blumi e Gi Moleja, e deri te klika renegate e Titos. Tani vihet re se kjo kritikë është shtypur, qoftë si pasojë e bindjes ndaj «shkopit të dirigjentit», apo e presioneve të elementëve revizionistë, që duan ta çojnë PK të Francës në rrugën e palavdishme të nënshtrimit e të degjenerimit antimarksist, në atë rrugë kundër së cilës ajo luftonte.

Le të marrim, për shembull, dokumentin e fundit të udhëheqjes së PK të Francës — projektrezolutën për kongresin e 17-të të partisë, që do të mbahet në maj të këtij viti. Aty thuhet se, për hir të unitetit dhe të bashkëpunimit me Partinë Socialiste, PK e Francës ka bërë mjaft dhe është gati të bëjë akoma për zhdukjen e «pengesave» në rrugën e këtij bashkëpunimi, se «ajo ka hedhur poshtë idenë se ekzistenca e një partie të vetme është një kusht i domosdoshëm për kalimin në socializëm. Kjo ide, që mbrohej nga Stalini, përbënte një përgjithësim abuziv të rrethanave specifike në të cilat u zhvillua Revolucioni i Tetorit. Eksperiencia e mëvonshme provon se objektivat e përbashkët të partive që përfaqësojnë klasat punonjëse të qyteteve e të fshatrave, çojnë në një unitet gjithnjë më të thellë për kalimin në socializëm, për ndërtimin e shoqërisë socialiste».

Këtu kemi të bëjmë me një lëshim të ri, të madh e parimor që udhëheqja e Partisë Komuniste të Francës po u bën socialdemokratëve. Me këtë hap shumë serioz revizionistët francezë po vënë në rrezik vetë ek-

zistencën e Partisë Komuniste, po ecin drejt likuidimit të saj, drejt shkrirjes së plotë në Partinë Socialiste të Gi Molesë. Kjo është një dëshmi tjetër e qartë se ku po i çojnë partitë komuniste revizionistët modernë. Jo më kot gazeta e madhe borgjeze «Lë mond» e përshëndeste këtë deklaratë me fjalët: «Partia Komuniste hedh poshtë me vendosmërinë më të madhe teorinë e «partisë unike»». Sido që të orvaten ta justifikojnë këtë hap revizionistët nga Partia Komuniste e Francës, sido që të shpifin kundër Stalinit, ata nuk do të mund ta fshehin dot tradhtinë e tyre, komplotin që po përgatitin për degjenerimin socialdemokrat të Partisë Komuniste të Francës.

J. Stalini, si gjithë marksistë-leninistët konsequentë, nuk e ka mohuar kurrë mundësinë e bashkëpunimit me parti të tjera për marrjen e pushtetit dhe ndërtimin e socializmit. Ai kurrë nuk i ka absolutizuar rrethanat e posaçme historike, që përcaktuan ekzistencën e një partie të vetme në Bashkimin Sovjetik. Është një fakt i pamohueshëm se pikërisht në kohën e Stalinit, në vende të ndryshme të Evropës e të Azisë, për të parën herë, partitë komuniste bashkëpunuan me sukses me parti të tjera si gjatë revolucionit për marrjen e pushtetit, ashtu edhe pas marrjes së pushtetit gjatë ndërtimit të socializmit. Por është e qartë se si në dokumentet e udhëheqjes së PK të Italisë ashtu dhe në ato të PK të Francës nuk është puna te çështja nëse partia komuniste mund të bashkëpunojë me parti të tjera gjatë revolucionit socialist dhe ndërtimit të socializmit. Puna është se, për hir të këtij bashkëpunimi, në këto dokumente fshihet dallimi midis partive komuniste dhe

partive të tjera, mohohet në fakt domosdoshmëria e rolit udhëheqës të partisë komuniste të armatosur me teorinë marksiste-leniniste.

Kurse J. V. Stalini ka mbrojtur pikërisht këtë ide, idenë e rolit udhëheqës të partisë komuniste, e cila nuk është një ide vetëm e Stalinit, por një mësim themelor i Marksit, Engelsit, Leninit, që buron nga misioni historik i klasës punëtore dhe nga ideologjia e saj marksiste-leniniste, që është e vetmja ideologji e socializmit shkencor. Kjo është theksuar qartë edhe në Deklaratën e Moskës të vitit 1957, ku thuhet se «udhëheqja e masave nga ana e klasës punëtore, bërthama e së cilës është partia marksiste-leniniste, gjatë kryerjes së revolucionit proletar në këtë ose atë formë dhe vendosjes së diktaturës së proletariatit në këtë ose atë formë», është një ligj i përgjithshëm i kalimit nga kapitalizmi në socializëm.

Dikur udhëheqja e PK të Francës ka kritikuar ashpër udhëheqjen e PK të Italisë pikërisht sepse kjo e fundit e vinte partinë komuniste në një plan me partitë e tjera të ashtuquajtura «punëtore», shtronte si të domosdoshme ekzistencën e shumë partive në kushtet e socializmit dhe mohonte domosdoshmërinë e rolit udhëheqës të partisë marksiste-leniniste. Duke polemizuar me këto pikëpamje të P. Toliatit e të shokëve të tij, organi teorik i KQ të PK të Francës. «Kaje dy komunizmë», në numrin e vet të janarit 1957, në artikullin me titull «Lidhur me «rrugën italiane drejt socializmit»», vinte në dukje se të mohosh dallimin rrënjësor të partisë komuniste nga partitë e tjera të ashtuquajtura «punëtore», të cilat janë të përshkuara nga ideologjia e



klasave të tjera dhe prandaj nuk mund të përfaqësojnë plotësisht interesat e vërteta, të tanishme e të ardhme, të klasës punëtore, do të thotë në fakt ta vësh partinë komuniste në një plan me partitë joproletare, të mohosh se «ka vetëm një socializëm shkencor, që përcakton qartë rolin historik të klasës punëtore, taktikën dhe strategjinë që i lejojnë asaj të kryejë misionin e vet», dhe «të pranosh mundësinë e një «rruge» reformiste për në socializëm, që vihet në të njëjtin plan me rrugën revolucionare». Në «Kaje dy komunizmë» atëherë theksohej gjithashtu se kjo do të thotë të biesh në pozitën e Kardelit e të udhëheqësve të tjerë jugosllavë, të cilët rrugën socialdemokrate skandinave e kanë shpallur si një nga format e mundshme të ecjes drejt socializmit, duke fshirë kështu dallimin rrënjësor midis ideologjisë shkencore socialiste dhe ideologjisë socialdemokrate, që predikon pajtimin, bashkëpunimin klasor, integrimin paqësor, me fjalë të tjera, heqjen dorë nga qëllimet e socializmit.

Të heqësh dorë nga teza mbi rolin udhëheqës të partisë komuniste si kusht i domosdoshëm për kalimin në socializëm, ta vësh partinë komuniste në një plan me partitë e tjera «punëtore» e «socialiste», siç bëjnë revizionistët e sotëm, do të thotë të presësh çdo lidhje me socializmin e vërtetë shkencor dhe me ideologjinë e vërtetë socialiste, do të thotë të heqësh dorë nga parimet dhe programi i partisë komuniste dhe të bashkohesh e të shkrihesh me partitë socialdemokrate mbi bazën e programit të tyre antimarksist. Dhe pikërisht kështu po veprojnë revizionistët.

Dikur PK e Francës nuk ka qenë dakord me vijën

tradhtare, fund e krye revizioniste, të udhëheqjes së PK të Italisë, me P. Toliatin në krye. Po tani a ka divergjenca PK e Francës me udhëheqësit revizionistë të PK të Italisë? Në qoftë se ka, atëherë përse hesht ajo? Përse PK e Francës e mori aq lehtë kurajën të sulmojë PK të Kinës dhe PP të Shqipërisë dhe ndaj revizionistëve italianë hesht? Në qoftë se nuk ka, atëherë pse nuk e thotë hapur që është dakord me ta dhe që ka gabuar më përpara? Apo kështu e kërkon porosia e «shkopit të dirigjentit».

Të heshtësh, të mbyllësh sytë përpara vijës e veprimeve tradhtare të revizionistëve — një qëndrim i tillë është jo vetëm antimarksist, por edhe i rrezikshëm. Ai i shkakton një dëm serioz jo vetëm PK të Italisë, e cila duhet të ndihmohet që të shohë se ku po e çon revizionizmi i Toliatit, por është i dëmshëm edhe për vetë PK të Francës, për gjithë lëvizjen komuniste. Marksistët-leninistët revolucionarë shqetësohen seriozisht për katastrofën që kanos partitë komuniste e punëtore. Ata nuk mundet dhe nuk duhet të heshtin kur një grup tradhtarësh përpiqet të çojë drejt greminës partitë komuniste, si PK të BS, PK të Italisë apo të Francës etj., por duhet të ngrenë zërin e tyre për të ndihmuar komunistët e vërtetë, anëtarë të këtyre partive, që të shohin qartë rrezikun, të kuptojnë sa nuk është vonë se ku po i çon udhëheqja e tyre e sotme revizioniste.

Dikur, në kongresin e Turit e në atë të Livornos, u krijua Partia Komuniste e Francës dhe ajo e Italisë, si parti revolucionare proletare të tipit të ri, duke u shkëputur nga partitë e atëhershme socialiste, që kishin tradhtuar interesat e klasës punëtore e të socializmit, dhe

duke prerë çdo lidhje me oportunizmin e reformizmin e Internacionales së Dytë tradhtare, duke pranuar kushtet dhe programin marksist-leninist të Internacionales Komuniste. Tani ne jemi dëshmitarë të një procesi të kundërt. Vija e demarkacionit që u vendos në kongreset e Turit e të Livornos po fshihet. Po duken çdo ditë më hapur orvatjet e revizionistëve modernë për t'u bashkuar e për t'u shkrirë me ata me të cilët dikur u ndanë — me krerët tradhtarë socialdemokratë, duke u bërë atyre lëshime pas lëshimesh, duke hequr dorë nga parimet revolucionare të marksizëm-leninizmit. Prandaj komunistët revolucionarë të Italisë dhe të Francës, si dhe të çdo vendi tjetër, të cilët i kërcënon rreziku i revizionizmit, duhet të hidhen në luftë kundër renegatëve. Kjo është e vetmja rrugë e drejtë. Sulmi që trojka revizioniste, e udhëhequr nga N. Hrushovi, po bën kundër partive komuniste e punëtore, është shumë i ngjashëm me veprimet tradhtare të socialdemokratëve të Internacionales së Dytë. Prandaj marksistët duhet të nxjerrin mësim nga historia, duhet të ndjekin traditat revolucionare të kohëve të mëparshme për të mbrojtur partinë, marksizëm-leninizmin, revolucionin.

PK e Francës, përpara kongresit të saj të 17-të, është më tepër se kurrë në rrugëkryq: a do të vazhdojë t'i bindet ajo verbërisht shkopit të dirigjentit dhe ta lërë veten që grupi revizionist në udhëheqje ta hedhë atë përfundimisht në rrugën e tradhtisë, apo do ta thyejë shkopin e dirigjentit, do të korrigjojë gabimet e saj dhe do të kthehet në rrugën heroike dhe revolucionare të marksizëm-leninizmit?

Shumë udhëheqës të PK të Francës e kanë sharë

e sulmuar në mënyrë të turpshme PPSH dhe udhëheqjen e saj. Këto ne nuk i harrojmë. Do të vijë koha, në mos sot nesër, dhe çdo gjë do të vihet në vendin e saj, në mënyrë marksiste. Ne jemi të bindur se atyre që kanë vepruar kështu, nesër do t'u skuqet fytyra nga turpi... Ne s'i kemi ndonjë borxh PK të Francës, udhëheqësit e saj i kanë borxh PPSH. Por megjithatë ne i bëjmë sinjerisht thirrje PK të Francës të kthehet, sa s'është vonë, në rrugën e revolucionit, në rrugën e vërtetë marksiste-leniniste, në interes të popullit francez, të proletariatit francez dhe të proletariatit ndërkombëtar. Në këtë rrugë e ka vendin ajo. Ata që ndreqin gabimet, ngjallin respekt te të tjerët dhe kanë përkrahjen e komunistëve dhe të të gjitha masave përparimtare të botës, kurse tradhtarët s'i do njeri, ata i përbuzin dhe i luftojnë pa mëshirë, siç po bëjnë kundër grupit të Hrushovit, Titos, Toliatit dhe shokëve të tyre besnikë — gjithë revizionistëve modernë.

**T'u pritët rruga veprimeve tradhtarë  
të revizionistëve, të mbrohen  
partitë komuniste!**

Revizionistët modernë, me tradhtarin Hrushov në krye, me kursin e tyre politik dhe me tërë veprimtarinë e tyre praktike, kanë krijuar në shumë parti komuniste dhe në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare një gjendje të rëndë. Ata kanë minuar unitetin e brendshëm të partive të veçanta dhe të lëvizjes në tërësi dhe po ecin me hapa të shpejtë në rrugën e degjenerimit socialdemokrat të partive komuniste, po

orvaten ta futin mbarë lëvizjen komuniste botërore në një rrugë oportuniste e tradhtare. Kjo të kujton atë periudhë kur partitë e Internacionales së Dytë, për shkak të tradhtisë së krerëve të tyre, u larguan nga rruga revolucionare, hoqën dorë nga marksizmi, shkanë përfundimisht në llumin e oportunitizmit e të reformizmit, degjeneruan në «parti borgjeze të klasës punëtore».

Tradhtia e partive të Internacionales së Dytë, që u shpreh qartë sidomos në vitet e Luftës së Parë Botërore, kur ato kaluan në pozitat e socialshovinizmit të hapur, ndeshi — e nuk mund të mos ndeshte — në rezistencën e vendosur të komunistëve revolucionarë, me Leninin në krye. Ata për vite me radhë, megjithëse ishin në pakicë, por, duke shprehur interesat e vërteta rrënjësore të klasës punëtore e të masave punonjëse, bënë një luftë të ashpër parimore për demaskimin e krerëve tradhtarë të Internacionales së Dytë, për demaskimin e oportunitizmit e të reformizmit të partive të kësaj Internacionaleje, për mbrojtjen e marksizmit e të internacionalizmit proletar dhe për krijimin e partive të reja, revolucionare, të klasës punëtore.

*«Në kohën e sotme — shkruante atëherë V.I. Lenini — nuk mund të plotësohen detyrat e socializmit, nuk mund të arrihet uniteti i vërtetë ndërkombëtar i punëtorëve pa u shkëputur në mënyrë të vendosur nga oportunitizmi dhe pa i sqaruar masat për fiaskon e pashmangshme që ai do të pësojë»<sup>1</sup>.*

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 21, f. 19.

Duke folur për këtë luftë të Leninit, J. V. Stalini ka shkruar:

*«Çdo bolshevik, në qoftë se është me të vërtetë bolshevik, e di se Lenini shumë kohë përpara luftës, afërsisht që prej 1903-1904, kur u formua në Rusi grupi i bolshevikëve dhe kur u dukën për herë të parë të majtët në socialdemokracinë gjermane — ndiqte vijën e ndarjes, e prishjes me oportunistët edhe ndër ne, në Partinë Socialdemokrate të Rusisë, edhe atje në Internacionalen e Dytë, sidomos në socialdemokracinë gjermane»<sup>1</sup>.*

Kjo luftë e vendosur e parimore e Leninit dhe e komunistëve të tjerë revolucionarë për shpartallimin e plotë ideopolitik të oportunizmit e tradhtisë së Internacionales së Dytë çoi në fitore të reja të mëdha të marksizëm-leninizmit e të lëvizjes revolucionare botërore, ajo u kurorëzua me fitoren e Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit në Rusi, me krijimin e partive të reja revolucionare, të tipit të ri, me falimentimin e Internacionales së Dytë dhe zëvendësimin e saj me Internacionalen e Tretë Komuniste.

Edhe sot tradhtia e revizionistëve modernë, të cilët janë larguar përfundimisht nga marksizëm-leninizmi, nga parimet e partisë proletare revolucionare dhe nga interesat jetike të proletariatit revolucionar e të masave të gjera punonjëse, ka ndeshur — e nuk mund të mos ndeshë — në rezistencën e vendosur dhe luftën parimore të partive marksiste-leniniste e të të gjithë ko-

<sup>1</sup> J. V. Stalin. Veprat, vëll. 13, f. 83,

munistëve revolucionarë. Kjo është një luftë me rëndësi të madhe historike, që ka të bëjë me fatet e lëvizjes revolucionare e çlirimtare botërore, një luftë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit kundër revizionizmit, për mbrojtjen e internacionalizmit proletar kundër nacionalizmit e shovinizmit, për mbrojtjen e rendit socialist kundër degjenerimit liberal borgjez, për mbrojtjen e partive komuniste revolucionare kundër degjenerimit socialdemokrat, për mbrojtjen e unitetit marksist-leninist të partive komuniste, të lëvizjes komuniste ndërkombëtare e të socializmit, kundër përçarësve revizionistë.

Ashtu siç na mësojnë klasikët e marksizëm-leninizmit dhe gjithë eksperiencia e lëvizjes komuniste, e vetmja rrugë e drejtë është që sfidës së revizionistëve t'i përgjigjemi me bashkimin e forcave të marksist-leninistëve për një luftë të vendosur e pa kompromis kundër renegatëve revizionistë. Goditjeve e presioneve të revizionistëve, të jashtme e të brendshme, nuk u bëhet ballë duke ndjekur një vijë të lëkundur centriste, e as duke u preokupuar vetëm e vetëm për të ruajtur një unitet fals e formal. Partia nuk mund të shpëtohet me psherëtima e as nuk duhet sakrifikuar ajo për hir të ruajtjes së «prestigjit» të ndokujt, në një kohë kur ky «prestigj» po shfrytëzohet pa skrupull për të varrosur çështjen e madhe të klasës punëtore e të socializmit.

Grupi i Hrushovit i ka futur udhëheqësit e shumë partive komuniste në një rrugë pa krye. Ai i ka shtyrë ata të mohojnë të kaluarën revolucionare të PËK të BS dhe të partive të tyre, me shpifjet false kundër Stalinit, ai i ka vënë në pozita të vështira udhë-

heqësit e vjetër revolucionarë, që kanë pasur një të kaluar të shquar. Shumë prej tyre u gënjyen nga vija e paqes dhe e bashkekzistencës hrushoviane, që tanimë është bërë e qartë se është një vijë antileniniste, vijë e afrimit dhe e bashkimit me armiqtë e paqes e të socializmit — me imperialistët. Tragjedia e disave prej tyre qëndron pikërisht në faktin që, ndonëse ata i kanë kuptuar tani shumë gjëra, e shohin se vija e grupit të Hrushovit është një vijë revizioniste, me gabime kolosale, por megjithatë nuk gjejnë dot forcën marksiste për t'i thënë vetes: Ndal! Ata nuk sillen ndaj kësaj çështjeje ashtu siç u ka hije, si marksistë-leninistë revolucionarë. Ata përpiqen të ruajnë partinë në rrugën revizioniste, që është vdekjeprurëse për të. Kush më pak e kush më shumë përpiqet «ta justifikojë» këtë rrugë, për të cilën kanë dyshime dhe nuk janë plotësisht dakord, disa herë edhe flasin në rrethe të ngushta se kanë divergjenca me N. Hrushovin. Por mbeten vetëm këtu, nuk shkojnë më tutje, nuk marrin guximin që t'i shtrojnë këto çështje në partitë e tyre në rrugë marksiste-leniniste. Ata pranojnë që në partitë e tyre të punohen dokumente që u dërgon atyre N. Hrushovi, por kanë frikë të diskutojnë në parti edhe dokumentet e materialet e partive të tjera. Në ndërgjegjen e tyre bëhet një luftë e madhe. Por edhe grupi i Hrushovit punon, ai ka krijuar në udhëheqjen e shumë partive njerëzitetit e tij, që bëjnë presione e shantazhe me manovra të ndryshme, për t'i nënshtruar këto parti ndaj shkopit të dirigjentit. Duke ecur pas gjurmëve të Hrushovit, disa udhëheqës partish komuniste kanë hyrë në një qorrsovak me qëndrimet e tyre politike.



Natyrisht, është e drejtë të luftohet kundër rrezikut që i vjen paqes botërore nga militarizmi gjermano-perëndimor dhe nga boshti imperialist Bon-Paris, por është krejt e padrejtë dhe antimarksiste që, nën këtë pretekst, të hiqet dorë nga lufta kundër imperializmit amerikan, që është forca kryesore e luftës dhe e agresionit, kësh-tjella e reaksionit botëror, xhandari dhe shfrytëzuesi më i madh ndërkombëtar, armiku më i egër i popujve të të gjithë botës, siç e ka quajtur atë Deklarata e Moskës e vitit 1960. Është e drejtë, marksiste, të luftohet kundër «pushtetit personal» dhe pasojave të tij, por është krejt antimarksiste të ndiqet verbërisht politika proamerikane e Hrushovit dhe të mos shfrytëzohet përçarja që po thellohet gjithnjë më shumë në kampin imperialist. Ne e dimë për se mbahet ky qëndrim. Sigurisht, kështu ka urdhëruar «dirigjenti i orkestrës». Por nesër, nëse ky «dirigjent» do t'i buzëqeshë «pushtetit personal», për qëllime aventureske antimarksiste, si do t'i bëhet hallit? Apo dirigjenti po përgatit orkestrantë të tjerë, për t'u hapur rrugën aventurave të reja?

Kampi i revizionistëve po kalon vështirësi të mëdha. Vapori i tyre është çarë, i ka hyrë ujët brenda dhe po mbytet. Grupi i Hrushovit përpiket me çdo mënyrë të mënjanojë të keqen që po e kanos. Ai, për t'i shpëtuar demaskimit të mëtejshëm, çirret për pushimin e polemikës, të cilën vetë e filloi dhe dikur e quante plotësisht të drejtë, të nevojshme e leniniste. Por në kushtet e sotme, për çdo marksist e revolucionar të vërtetë të pushohet polemika do të thotë të bashkohesh me tradhtarët, t'u krijosh atyre mundësitë për ta degjeneruar e për ta shkatërruar marksizëm-leninizmin.

N. Hrushovi, për të mashtruar njerëzit, betohet për unitetin. Por revolucionarët e vërtetë dhe komunistët konsekuentë nuk mashtrohen dot nga aventurierët, demagogët e përçarësit. Komunistët revolucionarë ndjekin me besnikëri mësimet e Leninit të madh, i cili thoshte:

*«Uniteti është një punë e madhe dhe një parullë e madhe! Por çështja punëtore ka nevojë për unitetin e marksistëve, e jo për unitetin e marksistëve me armiqtë dhe shtrembëruesit e marksizmit»<sup>1</sup>.*

Tanimë është e qartë se N. Hrushovi dhe grupi i tij në lëvizjen e sotme komuniste përfaqësojnë pikërisht kundërshtarët dhe shtrembëruesit e marksizmit. Grupi i Hrushovit, nga ana tjetër, vazhdon punën e tij përçarëse e armiqtësore: në forma të ndryshme, me anë mbledhjesh rajonale, apo bisedimesh dypalëshe, dikton urdhra e detyra të reja, duke synuar të komprometojë dhe të futë gjithnjë më thellë, në rrugën e revizionizmit e të tradhtisë, partitë e tjera dhe udhëheqësit e tyre. Ka ardhur koha që secili t'i vërë gishtin kokës, të mos i bindet «shkopit të dirigjentit», të fillojë rezistencën kundër tradhtarëve për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, të socializmit, për mbrojtjen e çështjes së madhe revolucionare të klasës punëtore.

Detyra e gjithë komunistëve është të luftojnë me të gjitha forcat imperializmin, me atë amerikan në krye. Dhe lufta kundër revizionizmit modern është pjesë përbërëse e luftës kundër imperializmit, sepse ai është

<sup>1</sup> V. I. Lenin. Veprat, vëll. 20, f. 256.

pjellë dhe aleat i imperializmit, shfaqje e ideologjisë borgjeze në teori e në praktikë, «kali i Trojës» i imperializmit në kampin socialist dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Sot tingëllojnë më aktuale se kurrë fjalët e Leninit të madh se pa bërë një luftë të vendosur e deri në fund konsekuente kundër oportunizmit e revizionizmit, nuk mund të luftohet me sukses kundër imperializmit. Pa demaskuar e pa shpartalluar revizionizmin, nuk mund të fitojë revolucioni, nuk mund të mbrohet e të ndërtohet me sukses socializmi e komunizmi.

Ne kemi bindjen e patundur se, ashtu si në të kaluarën, edhe sot lufta kundër revizionistëve modernë, me grupin e Hrushovit në krye, do të kurorëzohet me fitore të reja të marksizëm-leninizmit, të socializmit e të lëvizjes revolucionare ndërkombëtare. Revizionistët nuk mund ta kthejnë dot prapa procesin historik revolucionar. Ne jemi dëshmitarë të faktit që revizionistët, si në vendet e veçanta ashtu dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, po diskreditohen e po demaskohen çdo ditë e më shumë, po pësojnë disfata pas disfatash, ndërsa po shtohen e forcohen radhët e partive që i qëndrojnë besnike marksizëm-leninizmit, dhe të komunistëve revolucionarë, po ngrihet gjithnjë e më lart lufta e tyre kundër revizionizmit modern. Disfata e plotë e revizionizmit dhe triumfi i marksizëm-leninizmit janë të pashmangshme.

*Botuar për herë të parë  
në gazetën «Zëri i popullit»,  
Nr. 83 (4865), 7 prill 1964*

*Botohet sipas librit: «E vërteta  
marksiste-leniniste do të triumfojë mbi revizionizmin»,  
vëll. III, f. 243, Tiranë, 1964*

## ELEKTRIFIKIMI I VENDIT ËSHTË PROBLEM KYÇ

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

15 prill 1964

Në këtë material studimi shokët na kanë dhënë disa ide rreth të cilave kisha për të thënë edhe unë disa fjalë.

Elektrifikimi i vendit është problem kyç, që ka një rëndësi të jashtëzakonshme për ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit në vendin tonë. Zgjidhjen e këtij problemi ne e kemi filluar me kohë dhe duhet ta vazhdojmë. Tok me zhvillimin e industrisë, të minierave, me modernizimin e bujqësisë dhe me ndërtimin e hekurudhave, ne kemi filluar të hedhim edhe bazën e elektrifikimit të vendit. Mund të themi se, për kushtet e vendit tonë, kjo që kemi bërë në një kohë kaq të shkurtër, nuk është pak dhe as një gjë e vogël. Ne kemi aktualisht, duke përfshirë dhe dy hidrocentralet e Bistricës që do të mbarojnë brenda këtij pesëvjeçari, 5 hi-

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi zhvillimin e industrisë elektrike gjatë pesëvjeçarit të katërt dhe në perspektivë.

drocentrale, disa termocentrale të fuqishme, do të ndërtojmë termocentralin e Fierit, kemi gjithashtu edhe një numër të konsiderueshëm grupesh të veçuara. Në përgjithësi ky është një fillim i mirë. Por ndërtimi i socializmit nuk na lejon që në këtë çështje të rëndësishme të qëndrojmë në vend. Ne duhet të shkojmë më përpara me elektrifikimin, sepse po ecim më tej në tërë zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës.

Përveç objekteve të tjera me rëndësi ekonomike që do të ndërtojmë në pesëvjeçarin e katërt, ne do të fillojmë ndërtimin e metalurgjisë, e cila do të marrë një zhvillim të mëtejshëm, sidomos gjatë pesëvjeçarëve të pestë e të gjashtë. Tok me metalurgjinë, s'ka dyshim, ne do të zhvillojmë më tej minierat e ndryshme, përpunimin në vend të një sërë mineralesh, do të zhvillojmë nxjerrjen dhe përpunimin e naftës e të gazit, transportin, industrinë e lehtë për prodhimin e mallrave të konsumit të gjerë, dhe atë ushqimore. Krahas këtyre, ne po modernizojmë bujqësinë, gjë që, sipas mendimit tim, nuk duhet kuptuar vetëm me mekanizimin, ujitjen dhe plehërimin, por edhe me elektrifikimin, duke filluar nga ndriçimi i fshatrave, elektrifikimi i shumë proceseve të punës, që nga pompimi i ujërave, grirja e ushqimeve dhe deri te bluarja e drithërave, mjelja e dhenve e qethja e tyre. Kështu duhet ta shikojmë perspektivën e zhvillimit të vendit tonë.

Në planet pesëvjeçare të mëparshme ne kemi planifikuar vepra energjetike për elektrifikimin dhe kemi një eksperiencë të mirë në këtë drejtim. Në bazë të kësaj eksperience dhe të gabimeve që na janë vërtetuar në llogaritje, ne duhet që për pesëvjeçarin e ardhshëm dhe

sidomos për pesëvjeçarët e mëtejshëm të hartojmë një plan të elektrifikimit të vendit me një perspektivë 15-20 vjeçare. Pa një plan të tillë s'mund të ecim, pse pa të nuk mund të vazhdohet ndërtimi i vërtetë i socializmit. Elektrifikimi i vendit duhet lidhur, pra, me zhvillimin e industrisë, minierave, bujqësisë, transportit, qyteteve dhe fshatrave.

Ngritja e centraleve të reja elektrike, qoftë hidrike, qoftë termike, si i atyre kryesore ashtu dhe i atyre sekondare, duhet të bëhet me një studim kompleks, jo vetëm për sa u përket studimit dhe ngritjes së tyre në vetvete, por edhe për sa u përket nevojave të përgjithshme, në kompleksin e tyre. Mendoj që në këtë studim të shikohen e të paraqiten të gjitha mënyrat e prodhimit të energjisë elektrike, si ato hidrike, ashtu dhe ato me avull, duke përdorur gazin ose qymyret e dobëta.

Prandaj, në bazë të perspektivës së zhvillimit, të eksperiencës së fituar, të mundësive reale të financimit dhe të nevojave, neve na duhet një plan perspektiv 15-20-vjeçar për elektrifikimin, dhe këtij plani ne mundemi dhe duhet t'i futemi ta përpunojmë qysh tani.

Komisioni i inxhinierëve tanë të talentuar na ka dhënë tash një bazë të mirë fillestare, bazë mbi të cilën ne duhet të mbështetemi. Studimi i tyre i vlefshëm, që ka sot në dorë Byroja Politike, do të bëjë pjesën vendimtare të këtij plani 15-20-vjeçar të elektrifikimit. Sigurisht kjo punë e mirë, e bërë prej tyre, do të përmirësohet më tej, do të zhvillohet, do të korrigjohet, do të përpunohet dhe do të plotësohet. Por ne mund të mbështetemi me siguri në këtë studim që kanë bërë shokët specialistë.

Dëshiroj të falënderoj nga zemra, në emrin e të gjithë shokëve të Byrosë Politike, inxhinierët dhe teknikët tanë, me në krye inxhinierin e talentuar Radovicka<sup>1</sup> që e kryeson këtë punë, të cilët kanë zbatuar me sukses detyrën që u kishim ngarkuar! Sigurisht ky është një fillim i mirë i një pune kolosale, siç është elektrifikimi i vendit, të cilin Lenini e ka cilësuar si «programin e dytë të partisë». Ju, shoku Radovicka dhe shokët e tjerë inxhinierë, e dini se na duhet shumë punë akoma për këtë çështje, duhet një mobilizim i madh i forcave tona shkencore dhe praktike, duhet një organizim i përsosur, duhet luftë kundër burokratizmit, kërko-hen heroizma, sakrifica dhe fonde të mëdha materiale.

Natyrisht, në këtë punë duhet të mbahen parasysh shumë gjëra, dhe në radhë të parë duhet të zhvillohet më tej studimi i burimeve hidrike, si dhe leverdishmëria e naftës, e qymyrit dhe e gazit. Do të na duhet, pra, në këto drejtime, të vlerësojmë burimet e naftës, të gazit, të qymyrit dhe të përcaktojmë më mirë, në vija të përgjithshme, përdorimin e leverdishëm të tyre në sektorët e ndryshëm të ekonomisë, të bëjmë, si me thënë, një ndarje racionale në drejtimin e destinacionin më të mirë të tyre në ekonominë popullore, si dhe të shohim më mirë sasisë që përdorim në TEC-e me rentabilitet më pak të kushtueshëm.

Plani i elektrifikimit, natyrisht, nuk mund të shërbejë pa pasur më parë të përcaktuar, në vija të përgjithshme, përdorimin e energjisë së prodhuar, dhe sidomos në sektorët kryesorë të ekonomisë — në industri,

---

1 Petrit Radovicka.

në përpunimin e materialeve të para dhe veçanërisht të hekur-nikelit, kromit, bakrit, boksitit etj. Përveç elektrifikimit të bujqësisë, ne duhet të shohim edhe perspektivën e elektrifikimit të hekurudhave, gjë që mund të na kushtojë më lirë se me qymyr, ose me mazut, dhe këto lëndë djegëse të na shërbejnë për prodhimin e energjisë ose për nevoja të tjera. Prandaj në shumë drejtime na hapen perspektiva, të cilat lypin studim e koordinim, qoftë edhe në vija të përgjithshme, deri në shtrirjen në mënyrë ekonomike të rrjetit të tensionit të lartë, që duhet të ekonomizohet, të racionohet dhe të koordinohet me vendburimet, që kërkojnë, qoftë edhe në një perspektivë pak a shumë të largët, energji elektrike.

Financimi i këtij plani perspektiv të elektrifikimit është një çështje e madhe, që duhet të na preokupojë, në radhë të parë, se pa e pasur të qartë këtë plan financimi, pa qenë të qarta burimet financiare, pra, pa llogari të sakta, asgjë s'mund të ecë përpara. Kështu do të evitojmë spontaneitetin, ose marrjen e vendimeve të shkëputura, të shtrënguar nga rrethana të papritura dhe të paparashikuara.

Për këtë do të duhen shuma kolosale, të cilat duhet të nxirren nga ekonomia jonë e brendshme. Ndihma e jashtme duhet siguruar medoemos, megjithëse kjo ndihmë në realitet do të jetë një përqindje e vogël përpara investimeve të brendshme; ajo duhet të jetë e studiuar, e balancuar dhe e koordinuar, sepse këto kredi, ato që kemi marrë e që do të marrim, për nevojat e tjera të zhvillimit të degëve të ndryshme të ekonomisë, duhet të kemi parasysh se do t'i kthejmë në afatet e caktuara.



Prandaj në ndërtimin e veprave duhet të llogarisim që secila vepër të lajë veten në një kohë sa më të shkurtër, që vepra të ndërtojë veprën tjetër dhe të fuqizojë ekonominë, të ngrejë nivelin e jetesës. Domethënë leverdishmëria e ngritjes së këtyre veprave të elektrifikimit dhe të ndërmarrjeve të tjera ekonomike që janë lidhur dhe do të lidhen me to, të jetë e studiuar nga të gjitha anët dhe ato të hyjnë në veprim pa shuma të mëdha, në kohën e caktuar dhe rendimenti i tyre të jetë i madh.

Kur çështja e planifikimit të këtyre apo atyre veprave bëhet e domosdoshme edhe në ato raste kur kërkohen fonde financiare të mëdha, që duhet të investohen për to, kam parasysh, në radhë të parë, ato gjëra që duhen për ndërtimin e këtyre veprave dhe kryesisht materialet e ndërtimit, që nga çimentoja, hekuri, guri e tjegulla, duke mos folur për të tjerat. Këto materiale duhet t'i parashikojmë që më parë me saktësi, që t'i prodhojmë me kosto sa më të lirë, me fuqinë punëtore dhe furnizimin e saj, me edukimin e kuadrove të rinj, të lartë dhe të mesëm, që na nevojiten, si për ndërtimin, ashtu dhe për shfrytëzimin. Pra do të ishte mirë që të kemi një perspektivë më të qartë, kuptohet në vija të përgjithshme, të zhvillimit të këtyre degëve kryesore të ekonomisë kombëtare gjatë 15-20 vjetëve të ardhshëm.

Ç'do të bëjmë konkretisht me propozimin që na paraqitet për pesëvjeçarën e katërt që kemi përpara dhe për zgjedhjen e varianteve që përmban studimi?

Propozimet, sikundër i dimë, janë të shtohet TEC-i i Fierit e ndonjë tjetër dhe të fillohet, në dy vjetët e

# **PARTIA KËRKON NJË PUNË TË KUALIFIKUAR TEORIKE, TË LIDHUR NGUSHTË ME PRAKTIKËN KONKRETE**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**16 prill 1964**

Sipas mendimit tim, materialet që na janë paraqitur nuk janë për Sekretariatit. Të marrim raportin «Mbi zhvillimin e zgjedhjeve në Parti» që na ka paraqitur Drejtorja e organeve të Partisë, të Rinisë e të Bashkimeve Profesionale. Çfarë të diskutojmë për këtë? Raporti është i mbushur me konstatime. Natyrisht, konstatime është e pamundur të mos ketë, bile ka edhe të tjera që nuk përmenden këtu. Por, në këtë raport duhej të na paraqitej eksperiencia e punës së Partisë, aq më tepër se përveç zgjedhjeve në organizatat-bazë u zhvilluan edhe konferencat e Partisë. Kam mendimin se në raporte nuk është nevoja të na shkruhen të gjitha problemet që u shtruan në këto konfe-

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi zhvillimin e zgjedhjeve në Parti.

renca, por çështjet më kryesore që i vlejné udhëheqjes, nga të cilat mund të dalin orientime për punën e ardhshme.

Në përgatitjen e raporteve që i paraqiten udhëheqjes duhet të marrin pjesë edhe inspektorët e Komitetit Qendror. Ata duhet të jenë ndihmësit kryesorë të shokëve sekretarë. Kur venë në bazë inspektorët çojné udhëzimet e Sekretariatit të Komitetit Qendror dhe ndihmojnë organizatat e Partisë, kurse kur vijnë këtu sjellin mendimin e bazës, konkluzionet e saj e të udhëheqjes së Partisë në rrethe. Për këtë qëllim inspektorët duhet të jenë të përgatitur që të shikojné të gjitha problemet që preokupojnë rrethën dhe jo vetëm në disa drejtime të veçanta. Po si mund të bëhet kjo? Kjo bëhet kur shokët përgjegjës i bien si duhet «çekanit» këtu sipër, domethënë t'u pritët rruga gjërave të thëna e të stërthëna dhe të kërkohet nga inspektorët një punë e kualifikuar teorike e lidhur me praktikën konkrete. Kur vete inspektori në bazë duhet të pajiset me një plan detyrash konkrete dhe kur të vijë këtu të zbrazë «qesen». Prandaj, më duket se duhet t'i kushtohet një kujdes më i madh përgatitjes së inspektorëve. Nuk e di mirë, po më kanë thënë se këta u rrinë mbi supe shokëve instruktorë të bazës, të cilët kanë nevojë që, kur vete inspektori i Komitetit Qendror, të mbli-dhen, të bisedojné dhe të gjejné së bashku mënyra praktike teorike për të bërë diçka të mirë që të mbetet në rreth. Kështu siç veprojnë disa herë inspektorët sot nuk zbulojné ndonjë gjë të re nga ato që dinë sekretarët e komitetit të Partisë. Partia kërkon nga ne më shumë punë, prandaj duhet të bëjmë përpjekje më të

mëdha që t'u përgjigjemi kërkesave në rritje të Partisë. Shokët e rretheve kanë respekt për ne, për njerëzit tanë që venë e i ndihmojnë, sepse kanë nevojë për ndihmën e aparatit të Komitetit Qendror, por kur themi të vërtetën, komunistit nuk i bie aspak vlera.

Aktivizimi i anëtarëve të plenumit të komiteteve të Partisë në rrethe është një problem i vazhdueshëm. Në këtë drejtim duhet të ketë përmirësime, po me sa duket çështja nuk është zgjidhur mirë. Aktivizimi i tyre varet në radhë të parë nga udhëheqja e Partisë në rreth, veçanërisht nga sekretari i parë dhe sekretarët e tjerë të komitetit të Partisë. Në përgjithësi këta nuk mbahen afër dhe nuk aktivizohen sa duhet nga sekretarët e komiteteve të Partisë.

Në një rreth ka 50 deri 70 anëtarë plenumi. Këta mund të aktivizohen për disa probleme lidhur me zonën ose vendin e punës ku janë. Anëtari i plenumit të komitetit të Partisë duhet të konsiderohet ndihmësi kryesor për zonën ose vendin ku punon. Këtu duhet të ngjallet ndjenja e përgjegjësisë dhe e autoritetit të tij. Kur sekretari i komitetit të Partisë vete për të ndihmuar e për të kontrolluar një zonë, duhet të marrë edhe anëtarin e plenumit që ndodhet në atë zonë dhe, bashkë me të, të bëjë punën e ngarkuar. Në asnjë mënyrë ata nuk duhet të lihen pa u caktuar me detyra. Ndryshe nuk ka se si të aktivizohen.

Në goftë se një anëtar i plenumit të komitetit të Partisë punon, për shembull, në një fabrikë, duhet që atje punët të shkojnë mirë, kolektivi të jetë sa më luf-tarak, dhe kur sekretari i komitetit të Partisë ose in-

struktori vete për të parë punën e kësaj fabrike, duhet të shkojë e të takohet pikësesëpari me të. Instruktori i komitetit të Partisë duhet të heqë kapelën para anëtarit të plenumit, sepse ky është më superior se ai. Sekretari i komitetit të Partisë duhet ta mësojë instruktorin të ketë respekt dhe të dëgjojë fjalën e atij që është anëtar i plenumit.

Në mbledhjet e plenumeve ka edhe formalizëm. Anëtari i komitetit të Partisë nuk është njeri që s'di të lidhë dy fjalë, sa të mos flasë në pesë mbledhje asnjëherë. Po të gjykojmë se «një anëtar plenumi nuk bën sepse nuk diskuton në mbledhjet e plenumit» kjo nuk është e drejtë, sepse atje ku punon, ai është njeri i dalluar. Po pse atëherë ka anëtarë plenumi që nuk diskutojnë? Kjo vjen sepse ata nuk e ndiejnë sa duhet përgjegjësinë si anëtarë të plenumit. Pastaj të gjithë venë në mbledhje të përgatitur me letër, kritika është e përgjithshme, kështu ai mendon se «ka të tjerë që do të flasin». Prandaj duhet t'i shikojmë gjëra të tilla, sepse na pengojnë dhe jo të marrim masa organizative, duke thënë se «ky nuk bën për arsye se s'ka folur në mbledhje të plenumit për një vit». Kjo nuk është e drejtë.

Ne duhet ta shikojmë çështjen e mbledhjes së plenumeve të komitetit të Partisë në rrethe. Ky nuk është një problem i ri, mbasi e kemi dëgjuar edhe herë tjetër, prandaj kjo duhet të studiohet dhe t'i paraqitet Byrosë Politike për të vendosur. Mendoj se mund të propozohet që gjatë vitit të zhvillohen tri-katër mbledhje të plenumeve. Më shumë mbledhje nuk është nevoja të bëhen, sepse neve na duhen jo llafe, por plume pune që të udhëheqin jetën dhe punën e rrethit. Ndërsa aktivet e

Partisë mendoj se nuk duhet të bëhen më shumë se dy herë në vit dhe këto aktive të lidhen me mbledhjet e plenumeve të Komitetit Qendror. Pse t'i eliminojmë mbledhjet e aktiveve të Partisë? Këto dhe seminarët me sekretarët e organizatave-bazë që bëhen një herë në muaj shërbejnë për të shpënë në bazë vijën dhe direktivat e Partisë. Mbledhjet e byrove të komiteteve të Partisë të mos bëhen më tepër se dy herë në muaj dhe mbledhjet e organizatave-bazë të Partisë një herë në muaj.

Me të drejtë tha këtu një sekretar i komitetit të Partisë të rrethit se asnjëherë nuk na është bërë ndonjë vërejtje nga Komiteti Qendror për tematikën e problemeve. Kjo kritikë qëndron. Neve na jepet rregullisht lista e problemeve që do të marrin në shqyrtim byrotë dhe plenumet e komiteteve të Partisë, po nuk shikojmë që rreth këtyre të bëhet ndonjë vërejtje, kurse këto tematika duhet të studiohen me kujdes dhe pastaj t'u bëhen edhe vërejtje komiteteve të Partisë. Ky studim është i domosdoshëm të bëhet të paktën një herë në vit dhe konkluzionet t'i jepen Partisë. Ndërtimi i një tematike problemesh siç kërkohet, nuk është aq e lehtë, këtë e shikojmë edhe ne kur bëjmë planet e Byrosë Politike dhe të Qeverisë.

Ne duhet të shohim edhe tematikat e tjera të Partisë. Për shembull, unë nuk e di se çfarë temash zhvillohen në seminarët me sekretarët e organizatave-bazë të Partisë, si trajtohen në këto mbledhje problemet dhe çfarë rezultatesh ka në zgjidhjen e tyre, sipas çështjeve që shtrohen. Këtu duhet parë nëse përfitojnë ose jo sekretarët e organizatave-bazë, si i zbatojnë ata udhëzimet që u jepen dhe si i shtrojnë përpara komunistëve.

Të marrim çështjen e letrave. Ne e marrim në shqyrtim këtë çështje në mbledhjen e Sekretariatit një herë në vit. Letrat shqyrtohen sipas kritereve që ne kemi caktuar. Shoku Mehmet më thoshte se nga të gjitha letrat që i janë drejtuar Qeverisë, vetëm 13 për qind e tyre janë gjetur të drejta. Prej njerëzve që bëjnë letra, ka që kushedi sa herë kanë vajtur në komitetin ekzekutiv të rrethit dhe pastaj u drejtohen organeve qendrore, deri në Komitetin Qendror e në Kryeministri. Por ka dhe njerëz të tillë që bëjnë vazhdimisht letra për një gjë që nuk kanë të drejtë. Bile ndonjëri, nuk mjaftohet duke dërguar letra, por bën çmos edhe të na takojë.

Letrat dhe kërkesat kanë karakter ekonomik dhe politik. Të gjitha letrat që vijnë duhet të merren e të lexohen, qoftë nga ne, nga Qeveria, nga ministritë, nga komitetet ekzekutive dhe prej tyre të nxirren konkluzione. Ato letra që kanë të bëjnë me çështjet ekonomike duhet t'i zgjidhin organet e pushtetit. Në qoftë se në letër qytetari parashtron një çështje që i përket pushtetit, Partia nuk bën asnjë veprim, por i thotë letërshkruesit që të drejtohet në organet e pushtetit. Kështu forcojmë edhe besimin e tyre ndaj pushtetit. Ne i pranojmë të gjitha letrat që dërgohen, po të mos harrojmë se Partia dhe Qeveria kanë edhe rregulla se ku duhet të drejtohesh. Në qoftë se në letër ai ankohet se i janë bërë gjëra të padrejta, atëherë komiteti i Partisë verifikon çështjen dhe, po u vërtetua ankesa, thërret personin që nuk ka vepruar drejt dhe i tërheq vëmendjen. Pra, me kërkesat që kanë karakter ekonomik nuk duhet të ngarkohen instruktorët dhe inspek-

torët e Partisë. Për letra të kësaj natyre, si për strehim, për bursa etj., që i drejtohen Komitetit Qendror, mund t'u shkruhet herë pas here komiteteve të Partisë, bashkë me ndonjë konkluzion që del. Ndërsa letrat që kanë karakter moral dhe politik mendoj se duhet t'i shqyrtojë Partia. Në rast se Partisë i vijnë letra ku thuhet se bëhen hatëre, se në këtë ose në atë vend ndodhin vjedhje etj., këto çështje duhet të shikohen nga organizatat dhe organet e Partisë deri në aparatin e Komitetit Qendror.

Ne u kemi vënë si detyrë kryetarëve të komiteteve ekzekutive të rretheve që duhet të bëjnë takime me popullin. Kjo ka për qëllim që ata të marrin kontakt me masat punonjëse dhe të zgjidhin kërkesat e drejta.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*



# POPULLI E DO SHUMË ESTRADËN, TA FORCOJMË KËTË LLOJ TË BUKUR TË ARTIT

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

16 prill 1964

Lidhur me zhvillimin e teatrit në vendin tonë i është paraqitur edhe një studim Qeverisë. Në këtë studim, përveç të tjerash, bëhet fjalë edhe për mosrealizimin e të ardhurave, ka propozime edhe për të shfaqur opereta e opera. Por çështja e zhvillimit të teatrit, si një nga gjinitë e artit, duhet kuptuar drejt. Në Vlorë, për shembull, ose në rrethe të tjera mund të ketë edhe teatër dramatik, edhe teatër estrade, por jo të krijohet një gjendje e tillë ku të mos jetë e saktë as njëra as tjera. Dëshira mund të jetë e madhe, por duhen parë mundësitë, kuadri etj. Patjetër te ne do të krijohen institucione të ndryshme teatroshe, por me kohë, pasi të

---

1 Një nga çështjet që u diskutua në këtë mbledhje ishte edhe ajo mbi gjendjen dhe masat për përmirësimin dhe forcimin e punës ideoartistike në estradat profesioniste.

sigurohen kushtet e nevojshme. Kjo çështje më duket se nuk duhet parë vetëm nga ana financiare. Natyrisht, edhe këtë anë do ta shohim, por në kushtet tona ne do ta subvencionojmë teatrin, nga ana tjetër duhet të bëhen të gjitha përpjekjet që brenda mundësive të shfrytëzohen mirë fondet që jepen. Këtë gjë ta kenë mirë parasysh drejtuesit e teatrit dramatik, të operës dhe të estradave.

Teatri i estradës mendoj se po ecën mirë, ka bërë përpertime, megjithatë nuk është akoma në nivelin e duhur, si në kryeqytet, ashtu dhe në rrethet e tjera. Partia dhe drejtuesit e estradave e kuptojnë rëndësinë e këtij lloji të artit, por, me sa duket, ky kuptim duhet të jetë më i thellë. Formalizmi në estradë, si në çdo fushë, është i dëmshëm. Po ta shikojmë çështjen në përgjithësi, mendoj se ne kemi forca që, edhe me këto materiale që disponojmë, shfaqjet e estradave të jenë më të mira, veçse duhet të marrim masa serioze. Të nënvleftësosh teatrin e estradës do të thotë të biesh në kundërshtim me ndjenjat e popullit, i cili e do shumë humorin. Këtë ta mbajnë mirë parasysh si udhëheqja e Partisë në rrethe, ashtu dhe njerëzit që merren me letërsinë, te disa nga të cilët vihet re një megalomani, për t'u marrë «me gjëra të mëdha» e jo me krijime për estradën. Unë nuk mund ta kuptoj se si shkrimtari ynë të nënvleftësojë pjesë me humor për estradë, veçse nga megalomania për të bërë «vepra të mëdha», «drama të mëdha», që të kenë sukses në skenë! Ky është shkaku që disa shkrimtarë nuk shkruajnë për këtë zhanër kaq të bukur të popullit dhe nxitës për ndërtimin e socializmit.

Te ne ka shkrimtarë që janë jashtëzakonisht të talentuar për të shkruar në mënyrë satirike për estradat. Unë kam parasysh Nonda Bulkën, i cili është një shkrimtar i mirë dhe me talent, i njohur për satirat e tij, por si ai ka dhe të tjerë që, po t'i afrojmë, do të jenë të gatshëm për të shkruar. Me sa kam lexuar unë, për estradat dhe në estrada kanë shkruar e kanë marrë pjesë drejtpërdrejt edhe shkrimtarë e aktorë satirikë të mëdhenj.

Jam dakord që të merren disa masa për të forcuar estradat. Në radhë të parë të bëhet një punë më e mirë politike dhe edukative me shkrimtarët që janë në gjendje t'i furnizojnë estradat. Të punohet që këta shkrimtarë të kuptojnë rëndësinë që ka kjo gjini dhe të mos shkojnë me mendimin se nuk kanë talent dhe frymëzim që të shkruajnë për të. Shkrimet për estradë kanë rëndësi jashtëzakonisht të madhe. Shkrimtari mund të shkruajë në gazetë, po një skeç i shkruar prej tij dhe i vënë në skenën e estradës do të bëjë një efekt shumë më të madh për edukimin e masave. Ai mund të bëjë edhe një kritikë në «Zërin e popullit», por kjo kritikë nuk mund të ketë një efekt të tillë, siç mund të kishte në një skeç të estradës.

Ne duhet të mendojmë se në rrethe kemi polhuaj vetëm teatrin e estradës, prandaj, në qoftë se nuk i vëmë rëndësi këtij zhanri, atëherë pjesa më e madhe e popullit s'ka ç'të shohë veçse filma të huaj, që mburrin monarkinë. Prandaj duhet t'i forcojmë estradat, të thellojmë përmbajtjen e tyre, të ngremë nivelin artistik. Në repertorin e tyre ka gjëra të tepruara dhe të pahijshme. Kjo tregon se ndjenjave të

popullit nuk u jepet rëndësia e duhur, gjë që s'duhet lejuar asnjëherë.

Ne duhet të marrim masa të forta për të përmirësuar gjendjen e estradave, si nga ana materiale ashtu edhe për të siguruar kuadrin dhe repertorin. Të interesohe mi më shumë për këtë zhanër të vetëm që kemi në shumë rrethe të vendit. Nuk jam i mendimit që t'i prishim teatrot e ndryshëm që kemi në kryeqytet, por më duket se estradat e rretheve duhet të kenë një ndihmë më të madhe nga institucionet artistike të Tiranës. Unë them që nuk duhet të lejojmë që këtu në qendër të kemi çdo natë shfaqje të ndryshme artistike deri tek ato të baletit, kurse në rrethe të mos ketë asgjë. Nuk është aspak e drejtë të mbahen këtu të gjithë ata që mbarojnë Shkollën e Lartë të Artit dhe në rrethe të mos dërgohet asnjë. Ashtu siç punohet këtu në Tiranë, punon i gjithë populli shqiptar, prandaj këngët e bukura të një këngëtarit që dëgjohen këtu në kryeqytet, duhet të dëgjohen në çdo kënd të vendit tonë. Është e domosdoshme që ne të dërgojmë në estradat e rretheve regjisorë, këngëtarë, kërcimtarë, ashtu siç dërgojmë kuadro për të gjithë sektorët e tjerë. Kjo gjë duhet të rregullohet.

Artistët e estradave bëjnë përpjekje me aq mundësi sa kanë. Kur këta dalin në skenë, nga një anë shikohen përpjekjet dhe zelli i tyre dhe, nga ana tjetër, puna e Partisë. Po njerëzve të Partisë nuk mund t'u falet që lejojnë të duken në skenat e estradës disa shfaqje aspak tipike për rrethin. A janë probleme në Gjirokastër dhe në Sarandë ato që kritikon estrada lidhur me garderobat? Jo, atje nuk ka një problem të

tillë. Atëherë shfaqje të atilla nuk vlejné aspak. Asnjëriut nga populli nuk i vjen mirë kur shikon disa që vishen me pantallona të ngushta. Kjo do të thotë se në këtë drejtim Partia nuk punon që shfaqje të tilla, sado të vogla që duken, të vihen në shenjën e kritikës. Shkrime për këto çështje mund të bëjë edhe një njeri me shkollë fillore. Nuk ka Partia një forcë të atillë në rreth që të bëjë një skeç politik ose humoristik për të kritikuar diçka që nuk shkon mirë në atë rreth? Patjetër që ka. Po pse nuk bëhet një gjë e tillë? Sepse për këto çështje nuk ka një interesim serioz nga ana e Partisë, nuk mobilizohen sa duhet punonjësit e kulturës dhe të arsimit në rreth, që ta bëjnë estradën një gjë të bukur. Ka mundësi që këto shfaqje të jenë shumë më të dobishme duke i dhënë edhe më pak ndihmë nga sa u japim ne. Për këtë unë kam bindje të plotë. Në rrethe nuk ka pretendime për shfaqje me famë botërore.

Përse në shfaqjet e estradave në rrethe dhe në kryeqytet të ketë edhe numra banalë? Për shembull në estradën e Sarandës shikon skeçe që s'kanë asnjë kuptim. Nuk është e mundur që sekretari i Komitetit të Partisë të mos i njohë problemet e rrethit ku punon dhe të mos ketë kohë që të thërresë përgjegjësit përkatës, t'i orientojë për dy-tri çështje ekonomike dhe politike që duhet të trajtojnë. Pse, nuk ka këtu në Tiranë ose në Vlorë forca që të bëjnë skeçe shumë herë më të bukura nga ato që shfaqen sot? Mos vallë nuk ka njerëz me talent? Jo, kjo është e pamundur. Njerëz ka. E gjithë kjo lëvizje amatorësh që kemi duhet të jetë një mbështetje e mirë për estradat. Këta duhet të afro-

hen dhe të japin shfaqje në estradat. Në radhët e amatorëve ka lloj-lloj talentesh, që mund të luajnë në skenë: akrobatë, këngëtarë popullorë, komikë etj. Ne kemi aktorë të tillë dhe rapsodë popullorë, që masat i duartrokasin. Duke u interesuar, çdo gjë mund të bëhet. Nga ana tjetër, shteti ka caktuar edhe fonde për zhvillimin e aktiviteteve artistike, prandaj shokët e estradave duhet të mendojnë që me fondet e caktuara të plotësojnë sa më mirë nevojat.

Në vendin tonë populli ka një respekt të madh për artistët. Partia i vlerëson këta si njerëz të nderuar. Në qoftë se ka ndonjë nënvleftësim në këtë drejtim, kjo duhet të luftohet. Natyrisht ka edhe artistë që nuk kanë respekt për spektatorët.

Rëndësi ka edhe çështja e orientimit të estradave, të cilat duhen shikuar seriozisht. Sado e mirë që të jetë shfaqja e estradës në një rreth, brenda një ose dy netëve atë e shikon i gjithë publiku. Atëherë, çfarë duhet të bëjë trupa e kësaj estrade? Për këtë duhet të hartohet një program, që artistët të venë në fshatra brenda rrethit dhe në rrethe të tjera. Në fillim estradat mund të venë në rrethet e afërta dhe pastaj edhe në rrethet më të largëta. Pra, duhet ndërtuar një plan i tillë, që estradat të shkëmbehen më shpesh midis tyre. Në këtë drejtim nuk është pengesë mungesa e automjeteve, sepse estradat i nxjerrin shpenzimet e udhëtimit. Për sa u përket ushqimeve, kjo mund të rregullohet me anën e një kontrate. Në qoftë se ka mundësi që artistëve t'u jepen dieta, kjo është edhe më mirë. Po të jetë nevoja mund të shikohen edhe fondet që kanë shtëpitë e kulturës, me qëllim që një pjesë e tyre t'u jepet

estradave. Në rast se shokët janë dakord me këto mendime, atëherë të shikohen nga ana e Drejtorisë së Agjitpropit dhe Ministria e Arsimit.

Një rëndësi të madhe ka edhe muzika. Ne nuk jemi kundër muzikës së popujve të tjerë, por degjenerimi që synon borgjezia nuk duhet lejuar në asnjë mënyrë. Unë ua kam thënë edhe shokëve se nuk më ka pëlqyer festivali i muzikës që u bë vitin e kaluar<sup>1</sup>. Në festivalet tona duhet të konkurrojnë pjesë që t'u përshtaten ndjenjave të popullit tonë dhe idealeve të socializmit. Nuk jam kundër interpretimit të muzikës së huaj, kur kjo është e mirë, por një kopjim i tillë banal, si në këngët e këtij festivali, është i papranueshëm. Dëgjova në radio që mjaft spektatorë duartrokitnin për të gjitha këngët. Po cila këngë ishte e mirë dhe cila ishte e keqe? Të gjitha njëlloj janë këto? Jo, sepse ka këngë që janë të mira, por ka edhe këngë të këqija. Edhe njerëzit e jurisë i duartrokasnin të gjitha këngët, pa bërë ndonjë dallim. Në këtë drejtim njerëzit tanë të artit duhet të edukohen me frymë revolucionare, mbi institucionet artistike të ushtrohet kontroll dhe të jepet ndihmë si nga Drejtoria e Kulturës pranë aparatit të Komitetit Qendror, ashtu edhe nga Ministria e Arsimit. Ky kontroll nuk është në lartësinë e duhur jo vetëm në çështjet e muzikës, por edhe në pjesët teatrale që shfaqen. Pashë një shfaqje teatrale në Korçë, e cila kishte dobësi në përmbajtje. Shfaqje të tilla në asnjë mënyrë nuk mund të lejohen. Në qoftë se shkrimtari dëshiron që krijimet e tij të botohen ose

---

1 Festivali i 2-të i Këngës në Radio.

që drama e tij të vihet në skenë, duhet që ai t'i japë popullit pjesë të shëndosha. Prandaj gjëra të tilla duhen kontrolluar.

Punonjësit e estradave t'i ndihmojmë më mirë. Këta kanë sukses në punën e tyre, por duhet të përpiqen më tepër, që të kenë suksese akoma më shumë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*



## LE TË QËNDROJË PENDA JUAJ PËRKRAH KAZMËS DHE PUSHKËS

*Letër përshëndetjeje drejtuar Konferencës së 4-t  
Kombëtare të Gazetarëve të Shqipërisë*

18 prill 1964

Të dashur shokë,

Konferenca e 4-t e gazetarëve të Shqipërisë është një ngjarje me rëndësi jo vetëm për ju, por edhe për Partinë, sepse shtypi, të cilit ju i keni kushtuar mendjen dhe zemrën tuaj, është një nga armët më të fuqishme të Partisë në luftën për ndërtimin e jetës së re socialiste në vendin tonë, për triumfin e çështjes së madhe të marksizëm-leninizmit. Prandaj, në emër të Partisë — themelueses së shtypit tonë popullor, si dhe në emrin tim personal, më lejoni të përshëndes me këtë rast të gjithë punonjësit e shtypit, të gazetave e të revistave, të radios e të Agjencisë Telegrafike Shqiptare!

Që ditën që lindi Partia, shtypi ynë revolucionar u bë, ashtu siç thoshte Lenini i madh, pjesë e çështjes së përgjithshme të Partisë, pjesë e çështjes së përgjith-

shme të proletariatit. Traktet dhe gazetat tona shpunë në popull fjalën e zjarrtë të Partisë dhe i ngritën njerëzit peshë në luftën kundër pushtuesve fashistë e tradhtarëve të vendit. Jo më pak se nga armët partizane armiku tmerrohej nga shtypi ilegal. 20 vjet jetë e lirë, vite lufte dhe pune të palodhur, vite fitoresh mbi vështirësitë e panumërta dhe mbi armiqtë të pabesë mbajnë edhe vulën e shtypit tonë popullor të udhëhequr nga Partia.

Shtypi ynë i ka kryer detyrat e tij, pse ai është përshkuar gjithmonë nga vija e drejtë e Partisë, pse vetë Partia jonë marksiste-leniniste i ka kryer si duhet detyrat e saj nacionale dhe internacionale.

Misioni i gazetarit është sa i vështirë e delikat aq dhe fisnik. Ai më shumë se kushdo tjetër duhet të ecë me kohën dhe bile më shpejt se këmba, duke përshkuar vështrimin e tij jo vetëm në të tashmen, por dhe në të ardhmen; ai duhet të jetojë me zemër dhe trup midis masave punonjëse dhe bile të jetë në krye, në pararojë të tyre; ai duhet të jetë përçues i vijës së Partisë në popull. Gazetarët revolucionarë janë arkitektë të mendimit revolucionar të masave. Duke bërë bilancin e rrugës së lavdishme të shtypit tonë të ri, populli me të drejtë krenohet me gazetarët që lindi dhe kaliti Partia jonë, me këta luftëtarë të pendës, që e kanë kryer vazhdimisht dhe po e kryejnë me nder misionin e tyre.

Shekuj kanë kaluar që kur lindi shtypi në botë. Sa qindra dhe mijëra tonelata letër dhe bojë janë harxhuar dhe harxhohen në këtë fushë! Por ndërsa një pjesë e madhe është përdorur për t'u hapur sytë masave punonjëse, një pjesë e konsiderueshme është shpen-

zuar dhe shpenzohet për të helmuar ndërgjegjen e tyre. Që nga fillimi i tij e deri më sot, dhe derisa në botë do të ekzistojnë shoqëri me klasa antagoniste, shtypi ka pasur, ka dhe do të ketë karakter klasor. Profkat mbi «shtypin e lirë» dhe «mbiklasor» në vendet kapitaliste, e tani dhe në vendet ku sundojnë klikat revizioniste, janë demaskuar prej kohësh nga klasikët e marksizëm-leninizmit dhe sot po i demaskon edhe një herë koha. Vetë përmbajtja borgjeze dhe antimarksiiste e shtypit imperialist e revizionist, tregon se ai është armë në duart e disa klikave dhe u shërben interesave të tyre të ngushta shfrytëzuese dhe kundërrevolucionare.

Shtypi ynë, që bën pjesë në shtypin botëror leninist, shpreh dhe mbron interesat e klasës punëtore dhe të masave të gjera të punonjësve. Ai përshkohet nga ideologjia e pavdekshme e marksizëm-leninizmit dhe i edukon masat me ndjenjat e patriotizmit popullor e të internacionalizmit proletar; ai e mobilizon popullin në luftë për triumfin e qështjes së madhe të socializmit, të paqes, të lirisë e të demokracisë dhe në luftën kundër imperializmit, me SHBA-në në krye, si dhe kundër revizionizmit modern të grupit Hrushov-Tito e pasuesve të tyre, që sot përfaqësojnë rrezikun kryesor në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare.

Ashtu si vetë Partia jonë e Punës, edhe shtypi ynë aq sa është i dashur për popullin tonë dhe për popujt vëllezër të vendeve të tjera, për partitë motra marksiste-leniniste dhe për të gjithë revolucionarët në botë, aq është i urryer për armiqtë e hapët e të maskuar të Partisë e të popullit tonë. Ky, pa dyshim, është nderi dhe

shpërblimi më i madh për punonjësit e shtypit të vendit tonë.

Partishmëria e lartë, principialiteti dhe vërtetësia, papajtueshmëria me armiqtë dhe me ideologjinë e tyre reaksionare, shpirti luftarak dhe sulmues — këto janë karakteristika të mrekullueshme të shtypit tonë, që i ka rrënjosur thellë në të Partia jonë e Punës, të cilat ne duhet t'i ruajmë dhe t'i zhvillojmë më tej për ta ngritur sa më lart shtypin tonë popullor.

Gazetarët tanë e dinë mirë rolin e shtypit në ndërtimin socialist të vendit dhe influencën e tij të madhe në edukimin e masave me ndërgjegjen socialiste. Prandaj, për këto arsye ata u kushtojnë këtyre problemeve vendin kryesor në organet e shtypit. Partia e ka shtruar thjesht problemin: pa shtyp s'mund të këtë edukim të masave, pa shtyp s'mund të këtë mobilizim të tyre të ndërgjegjshëm, organizim dhe zgjidhje të problemeve të ndërtimit ekonomik e kulturor në shoqërinë e re socialiste. Ja pse jeta dhe aktiviteti i masave në qendrat e prodhimit, në kooperativat bujqësore, në fushën e arsimit, të kulturës, të artit etj., veprat e njerëzve të thjeshtë, fitorja e së resë në luftë me të vjetrën, të gjitha këto përbëjnë objektin e madh të shtypit tonë.

Në luftën fisnike për të kryer sa më mirë rolin e tij, shtypi ynë është rritur e forcuar nga dita në ditë, nga viti në vit. Mbi këtë eksperiencë të pasur dhe mbi këtë bazë të shëndoshë, ekzistojnë mundësitë për ta shpënë atë akoma më përpara, për ta ngritur lart e më lart, duke synuar për të pasur kurdoherë një shtyp me përmbajtje të shëndoshë e të pastër, ashtu si është vetë Partia e populli ynë. Kjo është sot detyra e madhe që

vë Partia përpara gazetarëve tanë. S'ka dyshim se në këtë drejtim do të ndihmojë shumë dhe konferenca juaj e tanishme.

Le të jetë dhe në të ardhmen shtypi ynë, tribunë, ku të buçasë me forcë fjala jetëdhënëse e Partisë, ku të shkëlqejnë vija e saj e drejtë dhe mësimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, ku të flasin dhe të shkëmbejnë eksperiencën e tyre qindra e mijëra kuadro e punonjës të tjerë të qytetit e të fshatit, ku të pasqyrohet lufta kundër vështirësive në të gjitha fushat e jetës për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste; le të bëhet ai tribunë ku të fshikullohet me ashpërsi çdo gjë që pengon ecjen përpara të shoqërisë sonë dhe ku të demaskohen pa mëshirë e të damkosen me turp armiqtë e vendit tonë, të socializmit, të paqes dhe lirisë — imperialistët dhe revizionistët modernë.

Në këtë luftë të madhe për çështjen e Partisë, të popullit e të marksizëm-leninizmit, le të pasqyrohen me forcë, gjithnjë më të madhe, vetitë komuniste të gazetarëve tanë, aftësia e tyre për t'i parë gjërat me syrin e Partisë, shpirti luftarak, zotësia për t'u lidhur sa më ngushtë me masat e për të shprehur aspiratat e tyre.

Gazetari i tipit leninist është njeri politik, zëdhënës i Partisë dhe i popullit, edukator i masave, mjeshër në kapjen e problemeve kyç, në interpretimin e zberthimin e thellë dhe në zgjidhjen krijuese të tyre. Ai, para së gjithash, di të përqendrohet në çështjet më të rëndësishme, t'i ngrejë ato në kohë dhe t'i shohë kurdoherë me syrin politik. Për shtypin tonë, pra, janë të huaja kotësia dhe sensacioni, sakrifikimi i përmbaj-

tjes për hir të formave «origjinale», prirja drejt gjërave të vogla dhe meskine. Gjithashtu ju e dini fare mirë se gazeta ose revista që merret «me të gjitha nga njëçikë», që mendon vetëm «të shuajë kureshtjen e lexuesve», që nuk mendon t'i bëjë ata njëkohësisht të djersinë, që vonohet në kapjen e problemeve jetike aktuale, ajo mbetet në bisht të masave dhe të situatës dhe, si e tillë, s'mund të luajë rolin e saj udhëheqës, të agjitorit, të propagandistit dhe të organizatorit kolektiv.

Por që shtypi të jetë sa më efektiv, krahas brendisë së lartë, ai duhet të ketë edhe paraqitje të mirë, gjuhë të pasur dhe të përdorë zhanre të ndryshme të publicistikës. Dihet se ideja e madhe i bën për vete masat, por ajo duhet t'u transmetohet atyre sa më e qartë dhe në formë tërheqëse që të mund të përvetësohet lehtë prej tyre. Prandaj shtypi ynë duhet të jetë sintezë e përmbajtjes së lartë, me shtjellimin sa më të thjeshtë dhe me format më të përshtatshme e interesante, në përputhje me kërkesat e natyrën e lexuesve shqiptarë. Çdo gjë në shtypin tonë duhet të ruajë unitetin e plotë të qëllimit, të brendisë dhe të bukurisë. Bile dhe faqosja e gazetave ose ndërtimi i emisioneve të radios duhet të bëhen duke u nisur nga kritere që përbëjnë shumimin e qëllimeve të Partisë për edukimin e shumanshëm të masave.

Por kuptohet, shokë, se të gjitha këto do të mund të bëhen nga dita në ditë më mirë, sa më shumë që gazetarët do të punojnë për ngritjen e nivelit të tyre ideopolitik, arsimor, kulturor e profesional, sa më shumë që ata do të perfeksionojnë mjeshtërinë e tyre si gazetarë. Në këtë drejtim duhet të luajë një rol gjithnjë e më

të madh organizata juaj — Bashkimi i Gazetarëve të Shqipërisë.

Partia dhe populli presin shumë nga ju. Ne sot jetojmë ngjarje të tilla, në të cilat fjala juaj, fjala e zjarrtë e Partisë sonë heroike dhe e popullit tonë revolucionar, duhet të buçasë gjithnjë e më fort në shtyp e në valët e eterit.

Le të qëndrojë penda juaj krah për krah kazmës dhe pushkës, duke nxitur mendimin krijues të masave, duke ndezur vazhdimisht zemrat e tyre për t'u hehur nga aksioni në aksion, duke përvëlur armiqtë imperialistë dhe veglat e tyre revizionistët modernë, duke kontribuar për ta ngritur lart e më lart lavdinë e Partisë e të popullit tonë të dashur!

Le t'ju udhëheqë kurdoherë në punën tuaj fisnike shembulli i publicistëve të mëdhenj — mësuesve tanë të pavdekshëm Marks, Engels, Lenin, Stalin!

Rroftë shtypi ynë popullor!

Rroftë PPSH — themeluesja e shtypit tonë të ri leninist!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Përshëndetje komuniste

*Enver Hoxha*

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 94 (4876), 19 prill 1964

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

## **T E L E G R A M**

### **KONGRESIT TË 1-RË TË FRONTIT TË ÇLIRIMIT KOMBËTAR TË ALGJERISË**

**A l g j e r**

**19 prill 1964**

Të dashur vëllezër algjerianë,

Në emër të popullit shqiptar, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë u dërgon përsëritje të zjarra revolucionare Kongresit të 1-rë të Frontit të Çlirimit Kombëtar të Algjerisë dhe, nëpërmjet tij, mbarë popullit trim, mik e vëlla algjerian.

Pas një lufte të gjatë heroike, populli vëlla algjerian, nën udhëheqjen e Frontit të Çlirimit Kombëtar, dëboi okupatorët imperialistë francezë nga vatra e tij, fitoi pavarësinë kombëtare dhe krijoi kushtet për ta kthyer Algjerinë në një vend të begatshëm e të lumtur. Lufta e armatosur e popullit heroik algjerian u bë, në të njëjtën kohë, një shembull i shkëlqyer për të gjithë popujt e botës, që vuajnë nën sundimin e egër të kolonializmit e të imperializmit, dhe demaskoi si tradhtarë të lirisë së popujve të gjithë ata që pengojnë luf-



tën, ose ngjallin iluzione ndaj imperializmit, duke predikuar se gjoja vetë shtypësit kolonialistë dhe imperialistë do t'u japin lirinë e pavarësinë popujve, që i mbajnë nën zgjedhën dhe kërbëçin e tyre.

Populli shqiptar, i cili, ashtu si edhe populli vëlla algjerian, ka bërë një luftë të gjatë e të vështirë kundër okupatorëve të huaj dhe reaksionarëve të brendshëm, e quan për nder që ka qëndruar kurdoherë në përkrahje të luftës suaj të armatosur heroike dhe fitimtare.

Me rastin e Kongresit tuaj të 1-rë, ne shprehim bindjen e thellë se populli liridashës dhe vëlla algjerian, me të cilin ne na lidh një miqësi e pathyeshme, do të dijë t'i mbrojë fitoret e revolucionit dhe do ta shpjerë atë më përpara, që jeta e popullit vëlla algjerian të bëhet akoma më e bukur dhe e lumtur, duke demaskuar dhe asgjësuar të gjitha komplotet e imperialistëve dhe të neokolonialistëve, si dhe të gjitha intrigat e agjentëve të tyre, revizionistëve modernë, që do të tentojnë të prekin lirinë, independencën dhe sovranitetin e Algjerisë heroike.

I urojmë Kongresit tuaj sukses të plotë!

Rroftë miqësia e pathyeshme midis popullit algjerian dhe popullit shqiptar!

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

Botuar për herë të parë në  
gazetën «Zëri i popullit»,  
Nr. 94 (4876), 19 prill 1964

Botohet sipas gazetës «Zëri  
i popullit», Nr. 94 (4876),  
19 prill 1964

## **GRUPI UDHËHEQËS I SOCIALISTËVE FRANCEZË, VRASËS I POPUJVE EGJIPTIAN E ALGJERIAN, KURDIS KOMPLOTE TË REJA ME KLIKËN TITISTE**

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

**25 prill 1964**

Në Beograd ndodhet për një vizitë zyrtare një delegacion i madh i Partisë Socialiste të Francës, i kryesuar nga Sekretari i saj i Përgjithshëm Gi Mole. Për kronikën e ngjarjeve të sotme ndërkombëtare, sigurisht, kjo vizitë nuk përbën asgjë sensacionale, por megjithatë ajo nuk mund të mos tërheqë vëmendje, aq më tepër tani, kur revizionistët modernë kanë ngritur çështjen e bashkëpunimit më të ngushtë me krerët e socialdemokracisë dhe kur socialistët francezë kërkojnë përkrahës në luftën e tyre për kryesinë e Republikës së Pestë Franceze. Regjimi i Beogradit ka mbështetur kurdoherë politikën dhe veprimtarinë e socialdemokratëve evropianë, sidomos në ato raste kur ndaj tyre drejtoheshin edhe simpatitë e veçanta të imperiaлизmit amerikan. Prandaj sot, kur N. Hrushovi ka dalë hapur për bashkëpunimin me krerët e djathtë të so-

cialdemokracisë tradhtare dhe kur midis krerëve të Partisë Socialiste të Francës dhe të Uashingtonit po nis një fazë e re idilësh politike dhe lëvdatash reciproke, që shprehet me preferencën e hapët të Shtëpisë së Bardhë për njerëzit e Gi Molesë, vizita e socialistëve francezë në Jugosllavi merr një karakter të veçantë.

Se kush janë Gi Moleja, Kristian Pinoja dhe bashkëpunëtorët e tjerë të tyre, që, siç njofton agjencia TANJUG, u pritën me shumë salltanet në Beograd, tanimë njihen mirë, jo vetëm në vendin e tyre, por në gjithë botën. Biografia e tyre përbën, ndoshta, modelin më të plotë të tradhtarit më të ulët të interesave të punonjësve dhe të shërbëtorit më të devotshëm të borgjezisë së madhe, të demagogut profesionist dhe të politikanit pa parim. Emri famëkeq i këtyre «kalorësve» të «socializmit dhe të demokracisë», siç kemi pasur rastin ta vëmë në dukje edhe herë tjetër, është i lidhur ngushtë me agresionin e Suezit më 1956 dhe me shtypjen e popullit të Algjerisë. Mbahet mend fort mirë se Gi Mole ishte kryeministër dhe Kristian Pino ministër i Jash-tëm kur shpërtheu agresioni kundër Suezit më 1956; se edhe pakti agresiv i NATO-s, edhe armatimi i Gjermanisë Perëndimore, kanë pasur kurdoherë aprovimin dhe bekimin e socialistëve francezë dhe se ishte pikërisht qeveria e Gi Molesë ajo që nënshkroi marrëveshjen për «Tregun e përbashkët» ose «Euratomin». Dihet gjithashtu se për të mbrojtur interesat e borgjezisë dhe të kapitalit monopolist, socialistët francezë shtypin me egërsi grevat e punëtorëve, pa ngurruar që të lëshojnë edhe qentë kundër tyre, luftuan kundër komunistëve dhe shkelmuan pa skrupull çdo të drejtë demokra-

tike të punonjësve. Me një aktiv të tillë të pasur tradhtie Gi Moleja nuk ka se si të mos gjejë një gjuhë të përbashkët me revizionistin Tito. Është tradhtia ndaj interesave të klasës punëtore, janë edhe qëllimet e njëjta në luftën kundër socializmit dhe lirisë së popujve, zelli për t'i shërbyer borgjezisë imperialiste që i bashkon.

Pse shkoi, pra, Gi Moleja në Beograd dhe pse ka zgjedhur pikërisht këtë kohë për të zhvilluar bisedime me klikën e Titos? Në deklaratën që Gi Moleja, në prag të vizitës së tij të tanishme në Jugosllavi, i bëri korrespondentit të TANJUG-ut, midis të tjerash, tha: «Fiks para 12 vjetëve shkua në Beograd për të vendosur kontaktet e para me Frontin socialist jugosllav. Pikëpamjet e shprehura me guxim në vitin 1948 mbi shumë rrugë të ecjes drejt socializmit dhe mbi bashkekzistencën paqësore e humbën karakterin e tyre heretik», sepse «edhe evolucioni i Bashkimit Sovjetik, zhvillimin e të cilit ne mundëm ta konstatojmë para disa muajve në Moskë, sot dëshmon dhe vërteton qëndrimin, që para dhjetë vjetësh na e shpjeguan me bindje dhe në mënyrë të qartë shoku Tito dhe bashkëpunëtorët e tjerë të tij». Më poshtë ai theksoi: «Një ndër qëllimet më aktuale të udhëtimit tonë është që të shqyrtojmë me shokët tanë jugosllavë perspektivat e reja që hapen përpara lëvizjes socialiste ndërkombëtare» dhe se delegacioni i Partisë Socialiste të Francës shkon në Jugosllavi «me dëshirën të përparojmë akoma më tepër në përcaktimin e rrugëve të përbashkëta, që përgatitin veprimet e ndërmarra për solidaritetin e lëvizjes punëtore ndërkombëtare».

Për Gi Molenë Jugosllavia është vendi model i de-

gjenerimit dhe i evolucionit paqësor nga socializmi në kapitalizëm, vendi i pasur në eksperiencë se si duhet të likuidohet partia komuniste, është pasqyra e qartë e rrugës në të cilën ecën sot Hrushovi dhe të gjithë aleatët e tij revizionistë modernë. Për çdo shërbëtor të borgjezisë kjo eksperiencë është e dobishme. Për Titon socialdemokracia është perspektiva, e ardhmja e grupit të Hrushovit dhe e të gjithë atyre që u venë pas, është rrugë për të kaluar në bashkëpunim të hapët me imperializmin. Ky është një rol i njohur i klikës titiste, e cila del përsëri në rolin e ndërmjetësit midis revizionistëve dhe socialdemokracisë për bashkimin e tyre, që duhet të shërbejë si një urë për integrimin në kapitalizëm të vendeve socialiste. Revizionistët modernë janë tani shumë të interesuar për këtë bashkim. Për këtë arsye klika e Titos nxitet për një ndërmjetësim të tillë, duke pasur të gjithë mbështetjen ideologjike, politike, morale dhe ekonomike të hrushovianëve. Prandaj edhe klika e Titos edhe ajo e Hrushovit po përdorin tani të gjitha mjetet për të arritur në një kohë sa më të shkurtër unifikimin ideologjik, politik dhe organizativ të revizionistëve modernë me socialdemokracinë. Dhe gjithë kjo u duhet atyre për krijimin e asaj aleance të përbashkët botërore të imperialistëve, socialdemokracisë dhe revizionizmit modern mbi bazën e një plani strategjik botëror, që drejtohet kundër komunizmit, kundër vendeve socialiste, kundër pavarësisë së popujve dhe kundër gjithë lëvizjeve revolucionare.

Nuk është pa kuptim edhe momenti që është zgjedhur për këtë vizitë të Gi Molesë në Beograd. Të gjithë

renegatët, tradhtarët e klasës punëtore — krerët e socialdemokracisë, klika e Titos dhe grupi i Hrushovit shpejtohen të koordinojnë planet dhe veprimtarinë në prag të dy ngjarjeve të rëndësishme që, sipas tyre, mund të ndikojnë seriozisht në kursin që do të marrin në të ardhmen ngjarjet politike në botën kapitaliste e revizioniste — zgjedhjes së dy presidentëve, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Francës. Imperialistët amerikanë, socialistët francezë, titistët dhe hrushovianët duket qartë se kanë interesa të njëjta dhe, në aleancë të ngushtë, po përgatiten të hedhin zaret, me shpresë që çdo gjë të zhvillohet në atë drejtim që u intereson atyre.

Edhe politika amerikane dhe ajo hrushoviane tani e kërkojnë që socialistëve francezë t'u bëhet reklamë dhe t'u jepet përkrahja më e madhe, t'u ngrihet kuota politike, të paraqiten si një forcë e rëndësishme brenda Francës dhe si një partnere shumë e dëshirueshme në bisedimet ndërkombëtare. Prandaj vizita e delegacionit të Partisë Socialiste të Francës në Beograd bëhet vetëm pak kohë pasi Gi Moleja u takua me N. Hrushovin dhe disa javë pasi kandidati për president, socialisti Defer, vizitoi Uashingtonin. Siç shprehej një gazetë amerikane, socialistët francezë, duke u ndodhur përpara zgjedhjeve presidenciale, kur përfaqësuesi i tyre është «i vetmi rival i Charl dë Golit», kërkojnë përkrahjen e Perëndimit e të Lindjes. Pritja që iu bë kryetarit të bashkisë së Marsejës, kandidatit socialist për postin e presidentit, Defer, në Uashington, ishte gati-gati sikur ai të qe me të vërtetë president i Francës. Gazeta «Lë mond» shkruante se «gjatë dy ditëve zoti

Defer u takua me gjithë personalitetet e rëndësishme të kryeqytetit federal». «Senati — vazhdonte gazeta — i bëri atij një pritje të ngrohtë. Kandidati i opozitës, i shoqëruar nga senatori Hemfri, u takua me senatorët Mensfeld, Fullbrajt e Xhavits. Në Pentagon ai takoi zotin Maknamara, në Departamentin e Shtetit Din Raskun, Ullt Rostovin e Uilliam Tejlorin. Më 24 mars ishte për darkë te zoti Artur Shlesing, në shoqëri të zotit Robert Kenedi dhe zonjës Xhon Kenedi. Do të ishte e tepruar t'u jepej një rëndësi historike këtyre bisedimeve — përfundonte gazeta — ashtu si edhe të reduktohej në minimum rëndësia e tyre».

Shpresat e imperialistëve amerikanë në politikën proamerikane të Deferit dhe të partisë së tij socialiste i shprehu edhe më qartë gazeta «Uashington post», e cila e quajti atë si njeriun që «ndezi në zemrat e amerikanëve flakën e dashurisë për Francën», «Është një kënaqësi të shikohet — theksonte gazeta — që tani ekziston një formë alternative për regjimin e Parisit. Vizita e tij ka shërbyer për të nxitur besimin tonë në stabilitetin e Francës».

Jo më të pakta janë dhe shpresat e revizionistëve hrushovianë. Ata kanë filluar të shfaqin haptazi simpatitë e tyre për zotin Defer, i cili kërkon «kthimin në një atlantizëm të pakondicionuar». Vetë vizita e Gi Molestë në Moskë dhe thirrjet e revizionistëve francezë për të bashkëpunuar me socialistët janë një përpjekje e hapët për të ngritur vlerën politike të socialistëve francezë në prag të zgjedhjeve.

Sigurisht, duke përkrahur socialistët në zgjedhjet e ardhshme presidenciale në Francë, imperialistët ame-

rikanë kërkojnë prej tyre shërbime të tjera kundër komunizmit, aq më tepër tani, kur revizionistët modernë kërkojnë bashkimin me çdo kusht me socialdemokracinë. Dhe pikërisht për të kryer këto shërbime në interes të padronit të tij amerikan, i është vënë punës Gi Moleja, këtij qëllimi i shërbeu vizita e tij në Moskë disa kohë më parë, këtij qëllimi i shërben edhe vizita e tij e tanishme në Beograd.

Kur revizionistët francezë filluan ta bënin të qartë se ata heqin dorë nga kërkesat revolucionare të klasës punëtore dhe se i nënshtroheshin verbërisht diktatit të N. Hrushovit, Gi Moleja vrapoi në Moskë për të biseduar dhe për të rënë dakord me N. Hrushovin mbi kushtet e bashkëpunimit midis socialistëve dhe revizionistëve. U gjet, pra, momenti, u gjet pikërisht ajo kohë kur oportunistët e të gjitha markave, antikomunistët e hapët e të fshehtë, duan të bashkohen në luftën kundër komunizmit, të përpunojnë edhe taktikat e metodat e luftës kundër marksizëm-leninizmit. Që nga Spaku tek Uilsoni, që nga Gi Moleja e deri te socialdemokratët skandinavë, me të cilët N. Hrushovi do të takohet gjatë këtij viti — të gjithë luajnë tani hapur me kartën e revizionizmit modern dhe të gjithë kërkojnë nga ata lëshime e kapitullime të reja. Këtë kërkoi edhe Gi Moleja nga N. Hrushovi. Interesant është fakti se socialistët francezë kërkuan nga N. Hrushovi që udhëheqësit e PK të Francës «të fshijnë 1920-ën» (viti kur në kongresin e Turit socialdemokratët mbetën në pakicë dhe u krijua PK e Francës). Me një fjalë, të bëhet bashkimi me komunistët, duke u nisur nga ajo pikë ku marksistë-leninistët u ndanë nga pasuesit e



Internacionales së Dytë. Në shkallë ndërkombëtare kjo do të thotë të hiqet dorë hapur nga leninizmi dhe të adoptohet oportunizmi. Siç duket, N. Hrushovi ra dakord me Gi Molenë, sepse, pa kaluar shumë kohë, udhëheqësit revizionistë të PK të Francës i shtuan thirrjet për bashkëpunim me socialistët. Kështu, organi teorik i PK të Francës «Kaje dy komunizmë», në mars të këtij viti shkruante: «Evolucioni i politikës franceze varret shumë nga raportet midis komunistëve e socialistëve. Kur këto raporte janë të rezervuara ose të tendosura, e ardhmja është e errët, kur bëhet ndonjë afrim, gjithçka sqarohet».

Grupi i Hrushovit, në bashkëpunim të ngushtë me klikën titiste, P. Toliatin, revizionistët francezë dhe grupin e Gi Molesë, u përgatit varrin Partisë Komuniste të Francës, popullit francez. Nuk ka dyshim se në bisedimet e tanishme të Beogradit Titoja do të përpiqet ta bindë Gi Molenë për singëritetin e revizionistëve francezë për t'u bashkuar me socialistët, do të përpiqet t'i bindë se fjala është për një nënshtrim të vërtetë të komunistëve ndaj socialdemokracisë. Përndryshe, në rast se PK e Francës nuk do t'u bindet urdhrave të N. Hrushovit, atëherë mbi të do të sulen të gjithë: edhe socialdemokratët francezë edhe reaksionit francez, edhe Hrushovi, Titoja e Toliati. Eksperienca titiste mbi metodat dhe masat e terrorit e të shtypjes, të përdorura për likuidimin e kuadrove dhe të komunistëve besnikë të marksizëm-leninizmit, mund t'u shërbejë socialistëve të tipit Gi Mole, në rast se paraqitet nevoja.

Komunistët revolucionarë francezë ndodhen përpara ngjarjesh vendimtare. Ata duhet të hapin sytë mirë

dhe të mos gënjehen nga demagogjia e revizionistëve tradhtarë të udhëheqjes së tyre. Reaksioni francez është edhe sot në fuqi, kjo është e vërtetë. Ky reaksion duhet luftuar dhe bile me vendosmëri. Por do të ishte një tradhti e pafalshme ndaj klasës punëtore dhe popullit francez të fshihet rreziku i madh që u turret botës dhe Francës nga imperializmi amerikan dhe agjentët e tij, dhe akoma më e rrezikshme të lidhesh e të bashkëpunosh me ta. Komunistët revolucionarë duhet të jenë gjithnjë parimorë. Duke luftuar kundër reaksionit në fuqi, kundër pushtetit personal, njëkohësisht duhet të luftojnë me vendosmëri edhe kundër imperializmit amerikan dhe shërbëtorëve të tij besnikë, të cilët përbëjnë një rrezik serioz për vetë popullin francez dhe për paqen në mbarë botën.

Si ekspertë të imperializmit për çështjen e Lindjes dhe të komunizmit ndërkombëtar, Titoja dhe Gi Moleja do të bisedojnë edhe për atë që duhet të bëjnë më tutje, ç'taktikë duhet ndjekur dhe ç'mjete duhen përdorur për të arritur përfundimisht në bashkimin e revizionistëve modernë me socialdemokratët në luftë kundër marksizëm-leninizmit dhe revolucionit. Ndosh-ta duhet mbajtur akoma një distancë formale, duhet bërë akoma një dallim sa për dukje, ndoshta për formë duhet polemizuar akoma për ndonjë çështje, ja çfarë mund të jetë nevoja të sqarojnë në mes tyre. Por që do të gjejnë gjuhën e njëri-tjetrit, për këtë s'ka asnjë dyshim. Socialistët francezë janë të bindur se ata do të gjejnë një përkrahje të plotë nga klika e Titos dhe do të arrijnë në një mirëkuptim reciprok në bisedimet e Beogradit. Tani është e njohur se Titoja, si pa-

rarendës i revizionizmit modern, është ndër «luftëtarët» më të rreptë «për ta spastruar» ideologjinë e klasës punëtore nga «stalinizmi», domethënë nga marksizëm-leninizmi. Qysh përpara Toliatit ai ka shpallur se socializmi mund të ndërtohet, bile se po ndërtohet, nën udhëheqjen e partive socialdemokrate; qysh përpara Torozit ai «ka zbuluar» në socialdemokratët një aleat për të shkuar në socializëm; qysh përpara Hrushovit në Kongresin e 20-të ai ka kërkuar bashkëpunimin me socialistët, si forcë kryesore e revolucionit në rrugë paqësore parlamentare. Tani që grupi i Hrushovit dhe pasuesit e tij erdhën plotësisht në pozitën e Titos, ky i fundit mund të bëjë hapa të tjerë përpara drejt kërre të socialdemokracisë, duke hequr pas qerres së tij edhe të tjerët. Nga çdo anë që ta shikosh, duket qartë se takimet e Beogradit midis socialistëve francezë dhe klikës titiste s'janë gjë tjetër veçse thurje komplotesh të reja të tradhtarëve të klasës punëtore, renegatëve revizionistë dhe agjentëve të imperializmit kundër marksizëm-leninizmit dhe të gjitha forcave revolucionare.

Duke folur për vizitën e Gi Molesë në Beograd, nuk mund të mos përmendësh edhe faktin se kjo vizitë është në të njëjtën kohë edhe një fyerje e rëndë që klika e Titos u bën ndjenjave të popujve arabë, kujtimit të mijëra e qindra mijërave dëshmorë të Egjiptit, Algjerisë e vendeve të tjera të Afrikës Veriore, që ranë në luftën heroike për çlirimin nga imperializmi francez. Klika titiste tregon kështu fytyrën e saj të vërtetë, qëndrimin armiqësor ndaj popujve arabë, kundër të cilëve ajo vepron me djallëzi, duke kurdisur komplete e diversione, duke mbështetur klika opozitare ndaj pu-

shtetit të ligjshëm, duke ndjekur një politikë grabitqare, kurdoherë për t'u siguruar fitime vetes dhe imperia-  
lizmit amerikan. Por klikës titiste tanimë i ka dalë boja. Popujt arabë nuk mund të gënjehen nga demagogjia e saj. Puthja e klikës titiste me gjakësorët e popujve arabë, Gi Mole e Kristian Pino, vërteton se titistët, kur flasin për miqësi me popujt arabë, në të vërtetë speku-  
lojnë me gjakun e popujve të Egjiptit dhe të Algjerisë.

Faktet janë ende të freskëta dhe popujt arabë nuk mund të harrojnë kurrë pabesinë dhe veprimet mon-  
struoze të socialistëve francezë, me Gi Molenë në krye.

Ishte koha kur populli egjiptian, pasi kishte për-  
mbysur monarkinë e urryer dhe kishte dobësuar ko-  
lonialistët anglezë, nën udhëheqjen e presidentit Naser,  
po ndërmerre një varg reformash demokratike, që sy-  
nonin në zhvillimin e ekonomisë e të bujqësisë dhe në  
demokratizimin e vendit. Por lufta e popullit egjiptian  
për lirinë e pavarësinë kombëtare dhe emancipimin e  
tij ndeshte në një pengesë të madhe, në mbeturinat  
e sundimit kolonialist, dhe në radhë të parë në «Shoqë-  
rinë e kanalit të Suezit» — një shtet brenda në shtet,  
që grabiste pasuritë e popullit. Atëherë qeveria egji-  
ptiane, duke hedhur poshtë me guxim kërcënimet e shan-  
tazhet e imperialistëve, vendosi ta shtetëzojë këtë sho-  
qëri, dhe t'u heqë kolonizatorëve çdo të drejtë e privi-  
legj në tokën e vet. Kolonializmi do të merrte një grusht  
shumë të rëndë. Egjipti dha një shembull të madh, ai  
tregoi se me kolonializmin e neokolonializmin nuk  
mund të ketë asnjë kompromis, se ata duhen shkukur  
nga rrënjët, se për ata s'ka më vend në shtetet e reja.  
Dhe ndodhi ajo që pritej. Kolonialistët e tërbuar e të

falimentuar, të cilëve populli egjiptian u preu thonjtë grabitqarë, u hodhën në një aventurë të dëshpëruar. Natën e 30 tetorit 1956, forcat e armatosura të Izraelit, në marrëveshje të plotë me fuqitë imperialiste, filluan sulmin kundër Egjiptit. Njëzet e katër orë më vonë, aviacioni bombardues anglo-francez filloi fluturimet mbi qytetet egjiptiane. U bombarduan Kajroja, Aleksandria, Suezi dhe shumë qendra të tjera të banuara, u vranë njerëz të pafajshëm, gra e fëmijë, u shkatërruan shumë shtëpi dhe objekte industriale e komunikacioni. Pas kësaj aventure, ushtritë anglo-franceze zbritën në tokën egjiptiane. Franca, Anglia dhe vegla e tyre, Izraeli, filluan agresionin e hapët kundër Egjiptit, për të mbrojtur interesat koloniale, për të mposhtur dëshirat dhe luftën e popullit egjiptian për liri e pavarësi.

Se si përfundoi aventura e kanalit të Suezit, dihet mirë nga të gjithë. Tani nga ajo ka mbetur mësimi i madh historik, se popujt që luftojnë kundër imperia- lizmit dhe kolonializmit, për lirinë e pavarësinë e tyre, janë të pamposhtur, se zhdukja e plotë dhe përfundimtare e kolonializmit është një gjë e pashmangshme. Por agresioni kundër Egjiptit tregoi edhe se kush ishin socialistët francezë, tregoi se ç'qëllime ndjekin ata në të vërtetë. U vërtetua në mënyrë të pakundërshtueshme përpara gjithë botës se socialistët francezë ishin jo vetëm oportunistë dhe shërbëtorë të thjeshtë të borgjezisë për diversion ideologjik e politik midis punonjësve, por edhe mbrojtësit më të zellshëm të kapitalit monopolist, të kolonializmit dhe përgjithësisht të reaksionit më ekstremist. Ata treguan se kur nuk shkojnë më fjalët, kur falimenton demagogjia, kur nuk ecin më

manovrat dhe dredhitë politike, nuk ngurrojnë të vënë në përdorim armët, të bëhen milicë vullnetarë të kapitalit, të vrasin popujt, të marrin nëpër këmbë dhe të shtypin me dhunë të drejtat e shteteve të tjera për liri e pavarësi.

Tani këtë Gi Mole dhe Kristian Pino, mbi ndërgjegjen e të cilëve rëndojnë shkatërrimet e qyteteve egjiptiane, krimet e rënda të kolonistëve francezë në Algjeri dhe vrasjet e patriotëve arabë, po i pret Titoja, i cili e heq veten si «mik i vendosur» i popujve arabë.

Sigurisht, këtu nuk ka ndonjë gjë të çuditshme. Si agjent i regjuri i imperializmit, ai duhet ta heqë veten edhe si mik i arabëve, edhe si komunist, edhe si marksist, edhe si antifashist, si t'ia dojë puna padronit. Mirëpo çdo gjë ka një kufi, arrin në ekstrem dhe pastaj kthehet kundër vetvetes. Sado që të përpiqen Gi Moleja me shokët e tij, klika e Titos dhe e Hrushovit, me ata që e pasojnë, për të fshehur tradhtinë e tyre, ajo nuk mbulohet. Bota e di tanimë se kush janë krerët e socialdemokracisë franceze, kush janë Titoja, Hrushovi e kompani. Ne e kemi thënë edhe më përpara se që nga Titoja e Hrushovi te Gi Moleja nuk është më larg se një hap, dhe prej këtej gjer tek imperialistët amerikanë rruga nuk është e gjatë. Revizionistët modernë kanë hedhur shumë hapa në këtë rrugë. Nga afrimi e bashkëpunimi me Titon ata kaluan në afrimin e bashkëpunimin me krerët e djathtë të socialdemokracisë tradhtarë dhe me imperializmin, në tradhti e kapitullim të hapët përpara armiqve më të egër të komunizmit dhe të të gjithë popujve. Komunistët revolucionarë e shohin këtë në mënyrë krejt të qartë. Atë e sho-

hin tani edhe masat e gjera të punonjësve, edhe popujt e botës, prandaj nuk do ta lënë veten të mashtrohen. Përkundrazi, ata i demaskojnë këto manovra e komplete që kurdisen në kurrizin e tyre, i demaskojnë Gi Molenë me shokë, klikën e Titos, grupin e Hrushovit, si tradhtarë e komplotistë në interes të imperialistëve dhe në dëm të popujve.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 99 (4881), 25 prill 1964*

*Botohet sipas gazetës «Zëri i popullit», Nr. 99 (4881), 25 prill 1964*

## VULLKANI QË KA SHIPËRTHYER KUNDËR REVIZIONISTËVE MODERNË NUK DO TË SHUHET KURRË

*Nga biseda me dy revolucionarë anglezë.*

3 maj 1964

*Në fillim, shoku Enver Hoxha përshëndetet në mënyrë të përzemërt me miqtë nga Anglia dhe pastaj bisedën me ta e nis nga libri «Çajld Harold» i shkrimtarit realist anglez, Bajronit.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Poema «Çajld Harold» e Bajronit është një vepër e shquar. Edhe për Shqipërinë ajo është një nga veprat më të bukura, sepse flet me dashuri dhe art për popullin shqiptar. Në këtë vepër Bajroni përshkruan me mjeshtëri natyrën e mrekullueshme të Shqipërisë, flet për përpjekjet e popullit shqiptar për liri dhe shpreh besimin që ka ai te shqiptarët.

Bajroni, duke shkruar për udhëtimin e tij nëpër Shqipëri, tregon se një ditë në udhë e sipër e zuri nata në Libohovë dhe shkoi në një shtëpi, ku i dhanë të hante e të pinte, e pritën me bujari. Kur Bajroni u ngrit në



mëngjes, nxori paratë për të paguar, por të zotët e «hotelit» i thanë se shqiptarët nuk duan para, por miqësinë.

Jua thashë këto për Bajronin, për të treguar se në Angli ka pasur dhe ka njerëz me zemër të madhe, që e kanë dashur dhe e duan popullin tonë, që kanë folur dhe flasin mirë për Shqipërinë. Kurse tani ju, revolucionarët anglezë, duke trashëguar traditat demokratike dhe idetë e shëndosha të njerëzve përparimtarë e duke i lidhur këto me ideologjinë marksiste-leniniste, luftoni për çështjen e madhe të përbashkët, kundër imperializmit dhe revizionizmit. Prandaj ne ju presim këtunë Shqipëri me zemër të hapët, sepse jemi shokë të një ideali. Ne, shqiptarët, kemi vuajtur nga imperializmi, por edhe populli anglez ka vuajtur e vuan nga shfrytëzimi kapitalist dhe imperialist. Po të lexosh veprat e Engelsit do të shikosh jo vetëm mjerimin, por edhe luftën e klasës punëtore dhe të popullit punonjës të Anglisë dhe të Irlandës kundër shfrytëzimit. Kjo luftë e popullit anglez kundër shtypjes e shfrytëzimit është forca që na bashkon.

Ne e kuptojmë që ju keni shumë vështirësi në punën tuaj, sepse keni të bëni me një armik që i është shtruar në vatër popullit anglez dhe që ka një eksperiencë e dinakëri të madhe. Por forca e imperializmit anglez ka qenë më e madhe në të kaluarën, kurse sot Anglia shkon në dekadencë. Në shekullin e kaluar çaristët u ngritën e luftuan kundër shfrytëzimit kapitalist, kurse lufta që bëni ju sot është edhe më e lavdishme, sepse ajo drejtohet jo vetëm kundër kapitalit, por edhe kundër revizionizmit. Ne jemi të gëzuar për luftën që bëni ju, sepse lufta e marksistë-leninistëve është

kudo një çështje e madhe, por, kur në vetë strofkën e imperializmit anglez dalin dhe luftojnë shokë marksistë-leninistë, kjo është një inkurajim i madh për lëvizjen tonë revolucionare.

Ju folët për mikpritjen bujare të shqiptarit. Kjo është e vërtetë. Ne shtëpitë nuk i kemi akoma të gjitha të mira, fabrika s'kemi shumë, por popullin e kemi të mirë, të ndershëm, revolucionar dhe mikpritës. Duke u mbështetur te populli ne do të çajmë gjithnjë përpara.

Sa ndryshim keni ju, marksistë-leninistët, që luftoni për çështjen e madhe dhe të përbashkët, nga reaksionarët anglezë!

Kur populli shqiptar, i udhëhequr nga Partia jonë Komuniste, bënte Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, kishim këtu edhe disa anglezë. Ata ishin oficerë të dërguar nga Komanda e Mesdheut, pra ishin njerëz të imperializmit, por ne i konsideronim si aleatë. Njëri prej tyre, gjenerali Dejvis, qëndronte pranë Shtabit tonë të Përgjithshëm. Ai ka shkruar edhe një libër, ku, veç të tjerash, përmend edhe momentin e rrethimit të Shtabit tonë të Përgjithshëm nga gjermanët dhe bashkëpunëtorët e tyre tradhtarë.

Është e vërtetë se ne në kulmin e Operacionit të Dimrit u ndodhëm për një moment të rrethuar. S'kishim shumë municion me vete, s'kishim as ç'të hanim, veçse dy kuti me qumësht dhe ishim 25 veta. Gjenerali anglez ishte së bashku me tre veta, midis të cilëve edhe koloneli Maklin. Atëherë ne nxorëm dy kutitë me qumësht, i hodhëm në një kusi me borë dhe u dërguam nga një gotë edhe gjeneralit e kolegëve të tij.

Ai, tek rrinte në një çadër aty pranë dhe pinte, më dërgoi fjalë se dëshironte të më takonte dhe unë i thashë të urdhërojë. Me të ardhur m'u drejtua me fjalët:

— Pse vazhdoni të luftoni, pse nuk dorëzoheni? Mos vallë me këtë kupë qumësht do të jetoni dhe me këta pak fishekë do të luftoni?

— Shqiptari nuk dorëzohet, iu përgjigja unë, ndaj ne do të luftojmë gjer në fund dhe do të fitojmë, por edhe ty ne nuk të lëmë që të dorëzohesh, se po u dorëzove, është turp për Anglinë. Prandaj eja të çajmë në sulm në mes të armiqve dhe të dalim në anën tjetër.

— Jo, m'u përgjigj — unë nuk vij — dhe vuri shiritin e oficerit të ushtrisë britanike.

Ne kundërsulmuam, çamë rrethimin dhe kaluam. Por me gjithë heroizmin e forcave tona, gjenerali Dejvis nuk mundi të qëndronte dhe u dorëzua te gjermanët.

Pasi u dorëzua gjenerali Dejvis, forcat tona partizane kapën 3 spiune gjermane. Ne u kërkuam gjermanëve t'u kthenim spiunet dhe ata të na dorëzonin gjeneralin Dejvis, por gjermanët u përgjigjën se gjenerali nuk pranon.

Populli shqiptar, (më falni që po flas kryesisht për popullin shqiptar, por këtë e njoh mirë) është me të vërtetë internacionalist. Ai është karakterizuar nga ky tipar jo tani, që Partia e ka edukuar me frymën e internacionalizmit, dhe e ka ngritur më lart, por qysh më parë. Kjo ka ndodhur sepse populli ynë ka qenë shumë i vuajtur, shumë i shtypur, atë e kanë sulmuar armiq nga më të ndryshmit dhe për këtë ai i urrente armiqtë e tij

dhe armiqtë e popujve të tjerë, duke bërë gjithnjë dallimin midis popullit dhe armiqve.

Gjatë kohës së luftës fashistët italianë vranë e prejnë dhe dogjën krahina të tëra në vendin tonë. Kur kapulloi Italia fashiste, ne i bëmë thirrje ushtrisë italiane të mos u dorëzohej nazistëve gjermanë. Atyre që dëshironin të luftonin kundër pushtuesve gjermanë u thamë të bashkoheshin me ne dhe me ta u krijua një batalion partizan. Për të tjerët, që nuk donin të luftonin, i thamë popullit t'i merrte në shtëpitë e tij dhe t'i ruante nga nazistët gjermanë. Populli i mori, i fshehu dhe ndau kafshatën e bukës me ta. Pasi u çlirua Shqipëria gjithë këta ushtarë italianë, që u strehuan në vatrata tona, u nisën për në Itali.

Me këtë dua të them se populli shqiptar di të bëjë dallimin midis popullit dhe reaksionarëve, mikut dhe armikut. Prandaj me popullin anglez ne jemi miq dhe të bijtë e tij marksistë-leninistë shikojmë përfaqësuesit e popullit anglez. Ne e konsiderojmë të rëndësishme ardhjen tuaj këtu, që të merrni kontakt me masat e popullit e realitetin tonë dhe pastaj të njihni me këto popullin anglez. Ju fola për fshatarin që strehoi Bajronin në kasolle e që në vend të shpërblimit i tha atij se «shqiptarët duan miqësinë». Kjo ka qenë dhe është një kërkesë e përhershme e popullit tonë. Kur ju t'i tregoni popullit tuaj të vërtetën mbi popullin shqiptar, e cila nuk është ashtu siç e kanë paraqitur reaksionarët, populli juaj do ta dojë edhe më shumë popullin tonë. Kjo është miqësi popujsh dhe zhvillohet në bazë të marksizmit.

Ne jemi një vend i demokracisë popullore, një vend socialist dhe ju i shikoni përparimet e Shqipërisë si marksistë. Sikur ta kishit parë vendin tonë para 20 vjetëve, atëherë do ta kishit më të qartë se sa shumë ka bërë Partia jonë. Pas Çlirimit të Shqipërisë të gjitha fshatrat ishin të djegura, fushat të zhuritura, rrugët dhe urat të shkatërruara, industria mungonte krejtësisht, populli vuante nga malarja e tuberkulozi; për shkollat as që mund të flitej. Kurse tani gjendja ka ndryshuar krejtësisht. Ne kemi akoma edhe shumë për të bërë, po, në saje të udhëheqjes së Partisë e të besnikërisë ndaj marksizëm-leninizmit, populli ynë do të ecë kurdoherë përpara.

Ne jemi në korent të punës dhe të përpjekjeve tuaja dhe ju urojmë suksese gjithnjë e më të mëdha në luftën që zhvillon kundër imperializmit dhe kundër revizionistëve. Këta të fundit janë grumbulluar në Partinë Komuniste të Anglisë dhe i binden N. Hrushovit, këtij renegati të ndyrë. Sukseset tuaja na kanë gëzuar shumë dhe kemi besim se puna juaj e drejtë do të përhapet edhe më tepër në të ardhmen, do të forcohet dhe do të kalitet.

Kështu e kanë filluar të gjithë. Kështu si ju kemi qenë të gjithë. Bile ne, para se të themelonim Partinë, dinim shumë më pak nga ato që dini ju në këtë moshë, por ne kishim besim të patundur në socializmin, te Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini, kishim besim në idealin tonë dhe çamë përpara. Me përpjekje krijuam partinë. Në fillim ne ishim të paktë, kishim shumë vështirësi, ishim të panjohur në popull. Por populli na njohu në aksionet që bëri Partia. U përpoqëm të bash-

kojmë popullin, sepse kishte edhe njerëz që mendonin ndryshe. Duhej të bashkonim të gjithë ata që ishin kundër fashizmit dhe t'i hidhnim në luftë. Në luftë e sipër u rrit e u kalit Partia, në luftë u shtuan dhe u rritën kuadrot.

Ju thatë qëparë «ne komunistët e rinj», por «vlera — thotë një poet i madh — nuk e njeh moshën». Të vjetrit natyrisht kanë eksperiencë të madhe, po marksizëm-leninizmi na mëson që eksperiencia duhet të bashkohet me hovin e ri revolucionar. Pastaj ajo fitohet më mirë në luftë, pse mund të ketë njerëz të vjetër që kanë eksperiencë, po e bëjnë, siç thotë një fjalë e urtë e popullit tonë, si ajo lopa që i bie kuisë së qumshtit dhe e derdh. Kështu po bëjnë sot Gollani<sup>1</sup> me shokë.

Kur ne e filluam luftën ishim të gjithë të rinj. A e dini se çfarë thoshin reaksionarët dhe «demokratët» për ne? Ata thoshin: «Ç'janë këta që bëjnë këto gjëra? Këta janë kalamanë!». Por kur filloi lufta, atëherë nisën të thoshin: «Vërtet kalamaj janë, por janë edhe trima».

Pastaj, kur u zgjerua lufta dhe u formua Ushtria Nacionalçlirimtare, kur po çliroheshin territore të tëra nga armiku dhe italianët e gjermanët po i vinim përpara, ata thanë: Po, nuk janë kalamanë këta! Më vonë, kur Partia mori fuqinë në dorë, ata u drodhën, por, nga ana tjetër, nisën të thoshin: «Këta mbaruan, nuk do të kalojnë as gjashtë muaj, se s'kanë eksperiencë as në punë të pushtetit, as në çështjet financiare!».

---

1 Në atë kohë Sekretar i Përgjithshëm i PK të Britanisë së Madhe.

Qysh nga ajo kohë kanë kaluar 20 vjet dhe tani ka shumë prej atyre që sot u kanë ardhur «trutë në kokë» dhe kanë ndërruar mendje. Ka prej tyre që kanë qenë shefa shtatmadhorie, gjeneralë dhe kanë mbaruar tri akademi (në Itali, në Gjermani dhe në Austri) dhe që pas Çlirimit u dënuan me burg për krimet që kishin bërë ndaj popullit. Një prej tyre, pasi kreu dënimin, shëtiti gjithë Shqipërinë, pa të gjitha ato që janë bërë dhe pastaj shkroi një letër ku tregon se si ka menduar më parë, se si gjatë kohës së kryerjes së dënimit filluan t'i vinin mendtë, se si doli e pa të gjitha ato që janë bërë në pushtetin popullor, se si tani mendon se këto gjëra vetëm komunistët mund t'i bëjnë, dhe siguron se sot është besnik ndaj pushtetit popullor, se e urren regjimin e kaluar, se është gati të vdesë për popullin.

Prandaj, për atë që thoni ju, se «jemi komunistë të rinj», mos u tutni. Në këtë luftë do të dalin patjetër njerëz të rinj. Komunisti francez Pol Vajan Kuturie ka thënë se «komunizmi është rinia e botës». Prandaj Partia jonë është e lumtur, se ka një rini luftarake dhe heroike.

Natyrisht ne e kuptojmë se ju keni e do t'ju lindin shumë vështirësi e pengesa në luftën tuaj. Por të gjitha këto janë të kapërcyeshme, para tyre s'duhet ndalur.

Ne e shikojmë çështjen kështu: duhet të ecet në përputhje me zhvillimin e situatës. Në qoftë se ne, komunistët shqiptarë, do të ecim në rrugën e disa ish-shokëve tanë, të cilët thoshin në fillim se nuk duhej të fillohej lufta, sepse «nuk jemi formuar akoma si marksistë», se në vendin tonë «nuk ka proletariat», se «nuk

mund të mbështetemi te fshatarësia», atëherë në Shqipëri do të ishte edhe sot në fuqi mbreti Zog. Këta «shokë» e gjykonin gabim situatën. Ne bëmë përpjekje t'i bindnim se ata e kishin gabim, se situata nuk lejonte që të prisnim, sepse vërtet që nuk kishim proletariat, por kishim një popull dhe një fshatarësi revolucionare, të cilat Partia, me punën dhe ideologjinë e saj, do t'i ngrinte në luftë. Kështu bëmë dhe fituam.

Partia e Punës e Shqipërisë në fillim u përpoq që divergjencat tona me N. Hrushovin të mos dilnin publikisht, kontradiktat me grupin e Hrushovit të zgjidheshin në rrugë partie. Por kur Hrushovi sulmoi hapur Partinë tonë dhe u duk qartë rruga kapitulluese e tij, atëherë do të ishte gabim dhe gabim i rëndë po të rrinim duarlidhur dhe të hanim grushtet e Hrushovit. Po të mendonim se si do t'ia dilnim kësaj pune, se ne jemi një parti e vogël, se ne jemi të rrethuar etj., atëherë nuk do të mendonim si marksistë. Prandaj ne menduam dhe mendojmë: Bjeri! Siç dihet ata nuk na mundën dhe s'na gjunjëzuan dot, sepse ne jemi në rrugën e drejtë marksiste-leniniste. Dy vjet e gjysmë të gjitha bateritë e Hrushovit u drejtuan botërisht mbi ne, por gjatë kësaj kohe ne u forcuam më shumë, parti të tjera bënë evolucion, shumë parti u rreshtuan në një radhë me ne.

Të themi se momenti nuk është për të luftuar revizionizmin, kjo nuk është e drejtë. Partia e Gollanit, për shembull, vetëquhet «marksiste» dhe thotë që duhet të kemi unitet me udhëheqjen revizioniste të Bashkimit Sovjetik. Në qoftë se do të rreshtoheshim me këta renegatë, kjo nuk do të ishte marksiste.



Ju jeni marksistë-leninistë, ju luftoni për çështjen e popullit, për çështjen e klasës punëtore, kurse ata që nuk janë marksistë-leninistë përpiqen t'ju poshtërojnë. Po ju çfarë duhet të bëni në këtë rast, t'u hiqni atyre kapelen? Jo. Në qoftë se ju do të bënit këtë gjë kjo nuk do të ishte marksiste-leniniste. Por ju, përkundrazi, luftoni si marksistë-leninistë. Çfarë duan të thonë disa të vetëquajtur «marksistë» me fjalët se «nuk duhet të dalim kundër partisë»? Për cilën parti flasin ata? Për partinë revizioniste. Mendimi ynë është që ju vepruat shumë mirë. Lufta juaj do të bëhet në forma të ndryshme. Kjo nuk është punë e një dite, por një luftë e gjatë dhe e vështirë. Sipas mendimit tonë, askush s'ka të drejtë t'ju thotë «mos dilni hapur» dhe t'ju quajë «aventurierë». Në rast se ju nuk do të dilnit hapur nuk do të kishte zë marksisti në Angli. Po të mos fliste në Evropë Shqipëria, këtu do të sundonte zëri i Hrushovit dhe i revizionistëve të tjerë. Siç e thashë përpara, edhe ne, kur e filluam luftën, na quanin «aventurierë», prandaj mos kini frikë që ju quajnë të tillë, sepse rruga juaj është e drejtë. Po meqë ju jeni në rrugë të drejtë, përpiquni t'i bindni ata. Logjika juaj është më e fortë se logjika e tyre. Në qoftë se ata janë me zemër të ndershëm, në mos sot, nesër do të vijnë me ju. Prandaj bëni përpjekje të bindni njerëzit dhe t'i afroni ata që janë brenda dhe jashtë partisë. Me përpjekjet tuaja të bëni që të diskreditohen e të dështojnë revizionistët. Ju ju përjash-tuan nga partia revizioniste dhe formuat grupin marksist-leninist.

Lufta kundër revizionizmit modern është e koklavitur. N. Hrushovi hiqet si marksist, kurse në realitet ai

është antimarksist me damkë dhe një komplotist i dorës së parë. Ai ka marrë përsipër të shkatërrojë socializmin e komunizmin dhe t'i shërbejë imperializmit amerikan. Ndaj vendit tonë ai ka bërë, si i thonë një fjale, edhe të pabërën. Na akuzoi për agjentë të imperializmit, kurse ne treguam dhe jeta e vërtetoi se kush ishte agjent i imperializmit dhe Shqipëria u bë kështu një grusht i fortë kundër Hrushovit. Po se mos ai i ka bërë vetëm kundër nesh këto! Akuza dhe komplete ai i ka bërë edhe në vende të tjera socialiste dhe dëshitimet e kanë ndjekur njëri pas tjetrit.

Sot pozitat e Hrushovit janë dobësuar krejtësisht dhe kjo nuk është vetëm për shkak të luftës që bën Partia e Punës e Shqipërisë, por edhe për shkak të luftës që bëjnë gjithë forcat marksiste-leniniste në botë.

Qëllimi i Hrushovit është që të dominojë në Evropë. Në fakt ai kërkon të dominojë në të gjithë botën, por veçanërisht në Evropë. Prandaj ai thotë se shqiptarët, ju dhe të gjithë revolucionarët e vërtetë që mbrojnë e zbatojnë marksizëm-leninizmin janë «renegatë». Ai përpiqet që ta shtypë këtë vullkan që ka shpërthyer kundër tij, por nuk do të mundë kurrë; kjo lëvizje do të zgjerohet, do të forcohet edhe më shumë, sepse fitorja i përket marksizëm-leninizmit. Prandaj bashkëpunimi ynë marksist-leninist ka rëndësi të madhe, se «bashkimi bën fuqinë». Për këtë unitet luftojmë ne. Ndërsa Hrushovi kërkon një unitet tjetër, unitet revizionist, që të tjerët t'i binden atij, t'i binden Titos dhe të ecet në rrugën e imperializmit dhe të socialdemokracisë, kundër klasës punëtore, kundër lirisë së popujve.

Uniteti ynë marksist-leninist ka rëndësi të jashtëzakonshme. Kundër këtij i drejton goditjet edhe Hrushovi, sepse ai e di se nga i vjen rreziku dhe përpiqet t'i dalë atij përpara. Por e ka kot, se ai nuk do të mundë ta pengojë atë. Ai sot ka akoma fuqinë ekonomike dhe ushtarake, bën demagogji duke shfrytëzuar prestigjin e Partisë së Leninit e të Stalinit dhe të Bashkimit Sovjetik, por të gjitha këto nesër do të kthehen kundër tij.

Ne jemi të gëzuar që ju erdhët këtu dhe ju ftojmë të vini përsëri, sepse kemi nevojë të njihemi, të bisedojmë. Bashkimi për ideale të larta bën të kapërcehen edhe malet.

Bëjuni shumë të fala shokëve tuaj të afërm, si dhe punëtorëve, njerëzve me të cilët do të merrni kontakt. U thoni se Shqipërinë e kanë një krah të fortë, Shqipëria është e vogël, por besnike, e vendosur ndaj marksizëm-leninizmit.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*

## MATEMATIKA ËSHTE ARMË E FUQISHIME E PROGRESIT

*Letër falënderimi dërguar profesorit të shkencave  
matematike Kristaq Fundos*

3 maj 1964

I dashur shoku Kristaq Fundo,

Ju falënderoj për letrën e ngrohtë që më dërguat dhe për veprën tuaj të çmuar «Studim i evolutave dhe i evolventeve të kurbave të hapësirës», që i dhuroni Partisë me rastin e 20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut.

Me kënaqësi të veçantë mora dijëni mbi vlerësimin që i ka bërë kësaj vepre Akademia e Shkencave të Çekosllovakisë.

Kjo vepër është një dëshmi tjetër që tregon mbi talentin tuaj si matematicien. Në të njëjtën kohë kjo vepër si dhe veprat tuaja të tjera, të vëna në dispozicion të studentëve të shkollave tona të larta: «Gjeometria plane» «Aritmetika racionale» (teorike dhe praktike), «Algjebra elementare», «Trigonometria plane», «Gjeometria analitike plane», «Gjeometria analitike me tri dimensione» etj., dëshmojnë si për vullnetin tuaj të madh

dhe pasionin e zjarrtë për matematikën, ashtu dhe për patriotizmin tuaj, për kontributin tuaj të vlefshëm në edukimin e brezit të ri, në përgatitjen e kuadrove të rinj shkencorë për atdheun tonë socialist. Për të gjitha këto ju përgëzoj nga zemra!

Në luftën që po bën gjithë populli, nën udhëheqjen e Partisë, për ndërtimin e bazës materialo-teknike të socializmit, një vend nderi zënë dhe punonjësit e kuadrot tanë të talentuar të shkencave të përpikta. Një meritë të veçantë këtu kanë dhe mësuesit, pedagogët dhe kuadrot e tjerë të lartë të matematikës, të cilët po ngrenë kulturën e masave dhe në këtë fushë, që ka një rëndësi shumë të madhe në epokën tonë. Matematika është bërë armë e fuqishme e progresit tekniko-shkencor të njerëzimit, ajo është jo vetëm kyç për shkencat e tjera të përpikta, por po futet dhe në shkencat humanitare, ajo po hap gjithnjë e më shumë dyert e kozmosit. Ja pse matematicienët po bëhen nga njerëzit më të respektuar e të dashur si në botë edhe në vendin tonë.

Uroj që rinia jonë shkollore e studenteske të frymëzohet gjithnjë nga shembulli, vullneti dhe pasioni i matematicienëve të mëdhenj të kohërave të mbarë botës dhe të matematicienëve tanë, ta dojë sa më shumë këtë shkencë, që i jep krah mendimit krijues të njeriut për të depërtuar me guxim drejt çdo të panjohure e për ta bërë zot mbi të fshehtat e natyrës, uroj nga zemra që të shtohen sa më shumë radhët e kësaj armate të re që krijoi Partia — të matematicienëve tanë popullorë!

Partia ju porositi, ju dhe kolegët tuaj, që të studioni

vazhdimisht, të jeni në korent të çdo realizimi botëror, në fushën e matematikës dhe të mos kënaqeni, me atë çka është arritur, por të përpiqeni kurdoherë të jepni kontributin tuaj sado modest në fushën e kësaj shkencë të madhe. Rritni dhe aftësitë tuaja pedagogjiko-metodike për t'ia hapur sa më shumë rrugën matematikës në brezin e ri.

Partia që udhëheq e frymëzon të gjithë popullin në luftën për një të ardhme sa më të ndritur, do të jetë, si kurdoherë, pranë jush, pranë matematicienëve dhe të gjithë dijetarëve të tjerë që u janë kushtuar shkencës, lumturisë njerëzore, lavdisë së atdheut të tyre, socializmit.

Edhe një herë urime e përshëndetje revolucionare juve dhe të gjithë kolegëve tuaj të nderuar!

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **METODËN TONË TË PUNËS, INFORMIMIN DHE UDHËZIMIN, T'I PRAKTIKOJMË MË NË RREGULL**

*Letër dërguar komiteteve të Partisë në rrethe*

**4 maj 1964**

Të dashur shokë,

Së bashku me këtë letër po ju dërgojmë një kopje të raportit «Të ngrihemi më me forcë kundër tendencave mikroborgjeze që vihen re në ndërgjegjen e punonjësve, të disa komunistëve dhe kuadrove», mbajtur më 20 prill 1964 në mbledhjen e plenumit të Komitetit të Partisë të Rrethit të Durrësit.

Byroja Politike këtë raport e ka parë shumë të drejtë dhe çështjet që ngrihen aty i shikon shumë të rëndësishme. Shokët e Durrësit jo vetëm i shtruan dhe i analizuan këto çështje në plenum nga pozita parimore partie, në mënyrë konkrete dhe në kohë, por kanë vendosur që ta punojnë raportin në të gjitha organizatat-bazë të Partisë dhe kanë marrë e po marrin masa të ndryshme, me qëllim që t'i shkohet punës deri në fund, të mësojë e tërë Partia dhe rezultatet të jenë sa

më efektive. Pra, ata kanë zgjedhur dhe një metodë të tyre të drejtë për këtë punë.

Byroja Politike jua dërgon raportin dhe ju rekomandon që këtë eksperiencë të Durrësit ta studioni kolektivisht në byrotë e komiteteve të Partisë të rretheve. Ju duhet të reflektoni thellë mbi të metat e këtij lloji në organizatat tuaja dhe të merrni masa partie për luftimin e shfaqjeve të tilla.

Mbi rëndësinë e këtij problemi është folur kaq herë që nga kongreset e plenumet e Komitetit Qendror të Partisë e deri në mbledhje të tjera e dokumente të ndryshme. Veçanërisht për të u fol në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë për çështjet organizative të dhjetorit 1963 dhe në letrën që u ka dërguar Komiteti Qendror mbi disa të meta serioze në metodën e punës së Komitetit të Partisë të Rrethit të Sarandës.

Prandaj nuk po rikthehemi dhe një herë në letrën mbi rëndësinë vendimtare të luftës së Partisë për të ruajtur gjithnjë të pastër figurën morale të komunistëve e të kuadrove, për rritjen e ndërgjegjes socialiste të komunistëve e të masave punonjëse, për triumfin e çështjes së madhe të socializmit e të komunizmit. Ju duhet të vazhdoni më tej punën tuaj në këtë drejtim, t'u futeni këtyre çështjeve akoma më thellë, më me energji e në mënyrë konkrete dhe të përpiqeni për rezultate sa më të mëdha.

Ne nuk ju rekomandojmë që për këto gjëra të bëni patjetër edhe ju plenum, ashtu siç bëri Durrësi. Për këtë ju vendosni vetë, format e punës i mendoni vetë dhe, siç e dini, të tilla forma ka shumë, kryesorja është që ato të mos i zbatoni shabllon, por në mënyrë të



drejtë e në frymë revolucionare, në përputhje me nevojat e kushtet e rrethit.

Nga ana tjetër, Byroja Politike dhe Sekretariati i Komitetit Qendror do të thërresin herë pas here, kur ta shohin të arsyeshme, sekretarët e parë të rretheve për të raportuar gojarisht mbi këto çështje. Në këto raste shokët që do thirren në raport të përgatiten për të informuar Byronë ose Sekretariatin mbi luftën kundër shfaqjeve negative, që prishin ndërgjegjen e njerëzve, shkaqet pse ndodhin, metoda dhe masat për t'i luftuar këto, për t'i edukuar njerëzit, dhe rezultatet e arritura, duke na paraqitur kështu një pasqyrë të qartë të kësaj gjendjeje në rreth. Kështu udhëheqja e Partisë do të jetë më mirë e informuar se si bëhet vlerësimi nga ju i këtyre problemeve të rëndësishme, se sa keni ditur t'i përdorni format e metodat e shumta të punës së Partisë në frymën revolucionare, se sa të drejtë dhe të shpejtë keni qenë në zbatimin e masave që lejojnë ligjet shtetërore për t'u vënë fre këtyre të këqijave.

Byroja Politike ka bindjen se ju do të dini të nxirrni mësimet e nevojshme për organizatën e rrethit tuaj.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## POPULLIN SHQIPTAR E LIDH NJË MIQËSI LUFTARAKE ME POPULLIN KOREAN

*Nga biseda me delegacionin e Federatës  
së Bashkimeve Profesionale të RPD të Koresë*

**7 maj 1964**

*Pasi takohet me miqtë në mënyrë të përzemërt, i  
fton të ulen dhe i pyet për shëndetin e tyre, shoku  
Enver Hoxha tha:*

Jemi të gëzuar që shokët e Federatës së Bashkimeve Profesionale të Koresë ju dërguan këtu, në Shqipëri, për të marrë pjesë në festën e 1 Majit. Gjatë këtyre ditëve ju patët mundësi ta shikonit pak Shqipërinë.

Ju vini për herë të parë në vendin tonë. Edhe unë vetëm një herë kam qenë në Kore. Kur të kemi mundësi, të shkojmë e të vijmë më shumë te njëri-tjetri.

Popullin tonë e lidh një miqësi luftarake me popullin korean. Unë ruaj përshtypjet më të mira nga Koreja. Vendi juaj më ka lënë mbresa jashtëzakonisht të mira, sepse kur e shikon me sy një vend është më mirë sesa të lexosh disa raporte mbi të. Me shokun

ambasador korean që ndodhet në vendin tonë, ne shihemi e bisedojmë, por ndryshe është kur i shikon gjërat me sy. Tani, duke qenë se ne ndjekim me vëmendje sukseset e shokëve koreanë dhe informohemi edhe nëpërmjet shokëve që vizitojnë Korenë, e imagjinoj se atje duhet të jenë arritur suksese të mëdha qysh nga koha që kam qenë unë.

Ne i kemi lexuar tezat e shokut Kim Ir Sen për çështjet e bujqësisë. Në to pasqyrohet drejt çështja e përparimit dhe e zhvillimit të mëtejshëm të saj. Nëpërmjet tyre shikohet se sa rëndësi të madhe i jep Partia e Punës e Koresë zhvillimit të bujqësisë.

Sipas mendimit tonë, për sa i përket zhvillimit të ekonomisë dhe veçanërisht të bujqësisë, duhet thënë se Republika Popullore Demokratike e Koresë ka ecur shumë përpara. Ne gëzohemi që Republika Popullore Demokratike e Koresë, pas luftës së madhe dhe shkatërrimeve të shumta që pati, ka arritur kaq rezultate të mira.

Qysh kur ishim në Kore, vumë re se atje tregohet një kujdes i madh për çështjet e bujqësisë dhe na bënë përshtypje investimet e mëdha për ujitjen, për shtimin e plehut kimik etj. Kurse Hrushovi ka pësuar disfata kolosale në bujqësi, ai kërkon ta kthejë bujqësinë sovjetike në një bujqësi kapitaliste, të krijojë polet në fshatarësinë, domethënë, nga një anë, fshatarësinë e pasur, borgjezinë fshatare, të përbërë nga kryetarët e kolkozeve e të sovkozeve, dhe, nga ana tjetër, fshatarësinë e varfër, pra të krijojë ato pole që Lenini i madh i likuido.

Ju jeni përpara gjithashtu edhe në industri, edhe

për sa i përket mbrojtjes. Unë thirra kryetarin e delegacionit të ushtrisë sonë që u kthye kohët e fundit nga Koreja. Ushtarakët tanë kanë mbetur të kënaqur nga pritja e përzemërt që u bënë kolegët e tyre koreanë. Ata mbetën gjithashtu mjaft të kënaqur dhe nga forca e ushtrisë koreane, nga edukimi i saj, nga armatimi dhe sigurimi i mbrojtjes së vendit.

Ju fituat kundër imperializmit amerikan dhe imperialistëve të tjerë. Ndërsa ju barrikadën e keni bërë në një drejtim, përpara paralelit 38 dhe bregdetit, ne duhet të bëjmë një të tillë në formë rrethore, në të gjitha anët, sepse Shqipëria është e rrethuar nga të katër anët me armiq të rrezikshëm. Megjithatë, vendi ynë reziston, ndërton socializmin dhe ka suksese. Komplotet e Hrushovit kundër nesh kanë dështuar e do të dështojnë kurdoherë.

N. Hrushovi dhe pasuesit e tij janë armiq të vendosur të revolucionit e të socializmit. Të gjithë këta organizojnë punën kundër marksizëm-leninizmit. Në këtë drejtim ata shkojnë drejt lidhjes së aleancave me imperializmin amerikan. Në rrugë shtetërore revizionistët do të lidhen në aleanca ekonomike, politike dhe ushtarake me imperializmin, por ata nuk do të kenë sukses. Çdo hap që bëjnë në këtë drejtim do të jetë shkatërrim për ta, si nga ana politike, ideologjike dhe ekonomike, shkatërrim nga të katër anët.

Te ne 1 Maji festohet me gëzim. Krejt ndryshe ndodh në vendet kapitaliste e revizioniste. Besoj se keni dëgjuar për demonstratat që u bënë më 1 Maj në Çekosllovakia. Atje u bënë edhe arrestime. Kriza të tilla ka

kudo në vendet revizioniste, si në Poloni, në Bullgari etj. Këto kriza janë ideologjike, politike dhe ekonomike. Trëndafilat që i bien fletët, në fund të fundit, do t'i mbeten vetëm gjambat.

Sot, përsëri Xhonsoni deklaroi se do të vazhdojë bllokadën ekonomike dhe vëzhgimin ajror kundër Kubës. Këtej ne mund të nxjerrim konkluzionin e sigurt që Hrushovi u ka bërë lëshime imperialistëve amerikanë. Në kohën e krizës së Karaibeve imperialistët do të kenë futur në dorë ndonjë dokument nga Hrushovi, në të cilin ai bën koncesione për Kubën. Pse e themi ne këtë gjë? Pse arrijmë ne në një konkluzion të tillë? Sepse imperialistët amerikanë kanë fituar disa pozita shumë të favorshme nga Hrushovi dhe, pasi nuk dëshirojnë t'i sjellin atij vështirësi në këtë situatë, nuk e zbulojnë dokumentin, por flasin e flasin për t'i bërë presion sa më shumë. Edhe kjo deklaratë e Xhonsonit bëhet pas deklaratës që shpalli Hrushovi kohët e fundit. Nga ana tjetër, sot, përsëri Maknamara deklaroi se shkon në Bon, se amerikanët dhe qeveria e Republikës Federale Gjermane e Erhardit janë plotësisht dakord që të bëjnë hapa të rinj drejt përmirësimit të marrëdhënieve dhe forcimit të miqësisë me Bashkimin Sovjetik. Pra, Hrushovi po kurdis plane në Evropë për të shitur Gjermaninë Demokratike. Ai dhe ata që e pasojnë janë tradhtarë me damkë dhe, si të tillë, popujt e tyre duhet t'i varin ata në shtyllat e telefonave dhe kjo ditë do të vijë, në mos sot, nesër. Partia jonë do të luftojë deri në fund kundër imperializmit dhe kundër revizionizmit.

Brenda vendit ne jemi mobilizuar të realizojmë

detyrat e planit. Në bujqësi sivjet mund të kemi një vit të mbarë. Punimet pranverore paraqiten mirë, mbjellja e panxharit mbaroi dhe këto ditë mund të mbarojmë me mbjelljen e pambukut. Me duhanin dhe misrin ecet mirë. Edhe grurin deri tani e kemi të mirë.

Po bëjmë një studim lidhur me zhvillimin e bujqësisë në zonat kodrinore e malore. Për këtë qëllim kemi krijuar ekiye me specialistë në çdo rreth dhe në fund të vitit ky studim do t'i paraqitet Plenumit të Komitetit Qendror së bashku me masat që duhet të marrim për shtimin e sipërfaqes së ujitshme, për investimet që do të bëhen për zgjerimin dhe sistemimin e kullotave, për krijimin e puseve të ujit për blegtorinë, për zhvillimin e mëtejshëm të vendeve kodrinore e malore. Kur të mbarojë ndërtimi i uzinës së plehrave kimike, atëherë edhe ne do të bëjmë një hap të madh përpara në drejtim të bujqësisë.

Por ne na kanë dëmtuar shumë sovjetikët, sidomos vitet e fundit, prandaj Komiteti Qendror i Partisë sonë mori vendim të rishikojë të gjitha studimet gjeologjike të bëra nga ekipet sovjetike që kishin ardhur në vendin tonë. Kështu jemi kthyer në të gjitha pikat e kërkimeve të mineraleve ku kishin punuar më parë specialistët sovjetikë. Për këto kemi harxhuar 700 deri 800 milionë lekë. Në raportet e studimit që kanë bërë specialistët sovjetikë thuhej se në këto ose ato zona s'ka asgjë, kurse tani specialistët tanë kanë bërë kërkime në të njëjtat zona dhe kanë zbuluar bakër, krom dhe mjaft minerale të tjera. Kjo do të thotë se specialistët sovjetikë kishin marrë direktiva nga Hrushovi që të bënin kërkime, të zbulonin minerale dhe të mos u thonin gjë

shqiptarëve, por të njoftonin vetëm Moskën. Këtë gjë e bënë me qëllim që, kur të vinte dita, të bënë presion ekonomik dhe të kurdisnin komplete kundër udhëheqjes shqiptare, të sillnin në fuqi Liri Belishovën dhe, kur të vinin sovjetikët për të na kolonizuar, të nxirrnin të gjitha këto minerale e të thoshnin se udhëheqja shqiptare është «dogmatike», «antimarksiste», «antishqiptare», prandaj «ne bëmë mirë që erdhëm».

*Pastaj kryetari i delegacionit të Bashkimeve Profesionale të RPD të Koresë shprehu kënaqësinë e madhe për vizitën që bënë në vendin tonë dhe për festën e 1 Majit.*

*Në përfundim, shoku Enver Hoxha i dha delegacionit shumë të fala për shokët e Bashkimeve Profesionale dhe e siguroi se në Partinë e Punës të Shqipërisë dhe në popullin shqiptar do të kenë miq deri në fund.*

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*

# MARKSISTË-LENINISTËT I BINDIN DHE I UDHËHEQIN MASAT NË RRUGËN E REVOLUCIONIT

*Nga biseda me dy miq francezë*

**9 maj 1964**

*Shoku Enver Hoxha, duke u përshëndetur për zemërsisht me miqtë francezë, u krijon atyre qysh në fillim të bisedës, e cila u zhvillua në frëngjisht, një atmosferë të ngrohtë.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Jemi shumë të gëzuar që ju erdhët në vendin tonë dhe që na jepet mundësia të takohemi së bashku. Këtu kanë ardhur edhe shokë të tjerë francezë, si militanti i shquar i PK të Francës, Marsel Kashen. Ai e ka dashur shumë Shqipërinë dhe e kuptonte mirë popullin tonë dhe Partinë e Punës të Shqipërisë. Kur u largua nga Shqipëria na premtoi se do të vinte përsëri, por më pas ai nuk pati mundësi të vinte. Edhe shoku i tij, militanti tjetër i PK të Francës, Gaston Monmuso, kur vizitoi vendin tonë, gjithashtu, mbeti mjaft i kënaqur. Kur iku këtej ai shkroi një



libër për vendin tonë me titullin «Baba Tomorri». Është fjala për atë malin e lartë me borë që patë gjatë vizitës suaj në Berat dhe në Qytetin Stalin. Por miq të popullit e të vendit tonë nuk kanë qenë vetëm këta dy militantë të shquar.

Në mënyrë të veçantë ne falënderojmë Shoqatën e Miqësisë Francë-Shqipëri për ndihmën që na jep. Ajo ka si qëllim që të njohë masat e popullit francez me realitetin shqiptar dhe me socializmin. Ne kemi konstatuar se në udhëheqjen e shoqatës kanë bërë pjesë njerëz të mirë me pikëpamje demokratike e progresive, të cilët, duke i vlerësuar realisht gjërat, e kanë çmuar dhe e kanë përkrahur rrugën tonë të drejtë. Po ju tregoj një rast:

Në mbledhjen ndërkombëtare të juristëve, që u bë kohët e fundit në Budapest, merrte pjesë edhe një delegacion i vendit tonë. Presidenti i kësaj mbledhjeje ishte juristi i mirënjohur francez, dashamirës i vendit tonë, Pjerr Kot. Në këtë mbledhje përfaqësuesi ynë mbajti një fjalim ku paraqiti pikëpamjet tona. Delegati sovjetik deshi të kundërshtonte, por Pjerr Kot i ra ziles dhe nuk e la sovjetikun të fliste, duke thënë se «jam unë president i mbledhjes». Në mbledhje u paraqitën mjaft rezoluta. Shokët e delegacionit tonë përgatitën gjithashtu një projekt dhe ia dorëzuan Pjerr Kotit. Ai u tha shokëve shqiptarë se ishte vështirë që projekti të paraqitej në mbledhje, pasi ishin dorëzuar 30 të tillë, dhe se ishte menduar që mbledhjes t'i paraqiteshin vetëm dy prej tyre. Kur Pjerr Kot bëri konkluzionet tha që «janë paraqitur 30 amendamente dhe unë mendoj që këto të mos i vë në dukje, por më le-

joni t'ju lexoj vetëm amendamentet e shokëve shqiptarë, të cilat janë mjaft të qarta».

Populli francez, bij të shquar të tij e kanë dashur dhe e kanë respektuar kurdoherë vendin tonë, historinë tonë të lavdishme. Këtë nuk e themi më kot. Të marrim Ronsarin tuaj të madh, ai ka shkruar edhe për Heroin tonë Kombëtar — Skënderbeun. Montenji, gjithashtu, në veprat e tij nuk shkruan vetëm për malet e Shqipërisë, por ai flet me dashuri për Skënderbeun dhe këtë e jep si shembull të një heroi të vërtetë. Ka një plejadë të tërë shkrimtarësh dhe poetësh të mëdhenj francezë që kanë shkruar për vendin tonë, për virytet e larta të popullit shqiptar, për trimërinë, guximin, besnikërinë dhe shpirtin e tij të lartë luftarak.

Neve na thonë se jemi luftëtarë. Por, ne kemi qenë dhe jemi të tillë. Një poet yni ka thënë se armiqtë e armatosur gjer në dhëmbë vinin ditën e hanin kufijtë, kurse shqiptarët ngriheshin natën dhe i matnin kufijtë; po me se? — Me metra, me jardë? — Jo, me pushkën e gjatë. Kurse tani revizionistët modernë na «këshillojnë»: «Hidhni armët tuaja sepse botën e ka mbuluar drejtësia, se imperializmi u bë dele, se ai nuk do të prekë të drejtat dhe lirinë tuaj, se ne duhet të bëjmë vëllazërim dhe të përqafohemi me njëri-tjetrin!». Dome thënë, sipas tyre, u dashka të hedhim poshtë marksizëm-leninizmin për të shkatërruar partitë tona revolucionare.

Ja, shokë, ju ndodhni në Shqipëri dhe e patë me sytë tuaj se populli ynë është për paqen, por ne jemi të detyruar të kemi edhe armët tona e t'i mbajmë ato

gati, pse kemi armiq që na kërcënojnë jetën dhe përparimin e vendit tonë.

Revolucionarët kanë vuajtur shumë në jetë, por ata nga luftërat e vuajtjet kanë mësuar shumë. Për popullin tuaj, për proletariatin e lavdishëm francez dhe gjer para disa vjetësh edhe për Partinë Komuniste të Francës ne kemi pasur një konsideratë të veçantë.

Populli francez është një popull me kulturë të pasur dhe me tradita të mëdha revolucionare. Revolucionari Francez, Komuna e Parisit dhe Revolucionari Socialist i Tetorit nuk janë tjetër veçse hallkat e një zinxhiri të vetëm, hallkat e revolucionit botëror. Këtë ne nuk e themi vetëm si marksistë-leninistë dhe internacionalistë, por edhe si komunistë shqiptarë. Populli shqiptar ka përfituar nga hovi revolucionar i popullit francez, jehona e të cilit ka ardhur deri te ne. Partia Komuniste e Francës ka përshkuar një rrugë të lavdishme revolucionare. Kuptohet se në punën revolucionare ajo ka pasur edhe gabimet e të metat e saj. S'ka parti revolucionare që të mos ketë pasur në ndonjë rast edhe gabime e të meta, por e rëndësishme është që këto gabime të njihen e të korrigjohen. Kurse tani që në arenë ka dalë grupi revizionist i Hrushovit, ne shikojmë se udhëheqja e Partisë Komuniste të Francës nuk u qëndroi konsekuente traditave të saj.

Marksizëm-leninizmi u godit rëndë nga veprimtaria tradhtarë e Hrushovit dhe lëvizja revolucionare u vu në një dilemë të vërtetë, që nuk mund të qëndronte gjatë pa u zgjidhur.

Merrni, për shembull, ato që ngjanë me Partinë tonë. N. Hrushovi është një komplotist i madh. Ata që

e ndjekin atë, ose ecin me sy mbyllur, ose janë tradhtarë si ai. Ai në çdo rast ka pasur në majë të gjuhës fjalën se shqiptarët janë «gjaknxehetë». Jo. Qëndrimet dhe veprimet e revizionistëve ne i kemi parë me shumë gjakftohtësi, bile kemi qenë shumë të rezervuar ndaj atyre që na ka bërë Hrushovi. Ne kemi ecur me vëmendje të madhe dhe me gjakftohtësi, por erdhi një kohë që nuk mund të prisnim më. Divergjencat tona me Hrushovin nuk fillojnë nga Kongresi i 20-të, por qysh me udhëtimin që ai bëri në Beograd dhe me vendimin që ai mori për rehabilitimin e klikës së Titos. Ky ishte për ne sinjalizimi i parë se N. Hrushovi dhe rrethi i tij nuk gjendeshin në pozita marksiste-leniniste. Në këtë rast Moris Torezi dhe shokët udhëheqës të Partisë Komuniste të Francës, duke u pajtuar me këtë veprim të Hrushovit, bënë gabimin e tyre të parë.

Partia jonë në atë kohë i drejtoi Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik një letër ku i thoshte se ne nuk jemi aspak dakord me pikëpamjen e Hrushovit për rehabilitimin e klikës renegate të Beogradit. Ne u thamë se një veprim i tillë nuk mund të pranohej, se më parë duhej të mbledheshin të gjitha ato parti komuniste e punçtore që bënin pjesë në Byronë Informative kur u dënua veprimtaria tradhtarë e klikës së Beogradit më 1948, për ta diskutuar këtë çështje dhe ato të merrnin vendimin përkatës. Në këtë rast ne do të kërkonim që edhe Partia jonë të merrte pjesë në këtë mbledhje, sepse ne kishim fjalën tonë për të thënë, jo vetëm për çështjet ideologjike, po edhe për politikën armiqësore të klikës së Beogradit, veçanërisht ndaj vendit tonë.

Para se të bëhej Mbledhja e Moskës Moris Torezi erdhi në Shqipëri. Ai u tregua shumë i gëzuar dhe i kënaqur që erdhi në vendin tonë. Ne e pritëm si mik duke pasur parasysh traditat e shquara të Partisë Komuniste të Francës. Gjatë bisedimeve që patëm, ne diskutuam, midis të tjerave, edhe për marrëdhëniet me sovjetikët. Ne i folëm hapur për veprimtarinë e dëmshme të N. Hrushovit dhe të të gjithë të dërguarve të tij që ndodheshin këtu, të cilët, veçanërisht pas Mbledhjes së Bukureshtit të qeshorit 1960, punonin për të rrëzuar udhëheqjen e Partisë dhe të shtetit tonë dhe të sillnin në fuqi njerëzit e tyre. Po kështu i folëm edhe për revizionistët jugosllavë.

Aty ai i pranoi mendimet tona dhe i quajti të gabuara veprimet e Hrushovit e të njerëzve të tij. Por më pas dihet qëndrimi i tij ndaj atyre që po ndodhnin në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Ai u bashkua plotësisht me pikëpamjet e Hrushovit, prandaj nuk mund ta quajmë komunist të vërtetë. Në rastin e deviacionit të djathtë që u shfaq kohë më parë në Partinë Komuniste të Francës, siç e dini, Torezi mbajti qëndrim të hapët të drejtë, duke deklaruar se në gjirin e partisë nuk duam kukulia, se njerëzit duhet të flasin dhe të shfaqin hapur pikëpamjet e tyre. Kurse ç'ngjjet tani me të? Tani Torezi thotë se njerëzit duhet të heshtin. Në qoftë se tani një shok shfaq mendimin e tij hapur, Torezi me njerëzit e tij i thonë: «mbyll gojën!» dhe nxjerrin lloj-lloj pretextesh, duke thënë se «këta shokë janë të rinj nga mosha ose me stazh të vogël në parti» dhe si të tillë nuk marrkan vesh, nuk i kuptojnë problemet etj., etj. Por pjekuria e ri-

nisë nuk matet nga numri i viteve të saj. Pjekuria matet me atë se sa e njeh, sa e zbaton dhe sa e mbron me konsekuencë marksizëm-leninizmin, teorinë tonë revolucionare. Dhe udhëheqësit revizionistë të Partisë Komuniste të Francës tremben nga këto pakënaqësi që po ndodhin në gjirin e saj, prandaj «këshillojnë» që secili të mbajë pikëpamjet e veta vetëm e vetëm që të ruhet «uniteti». Por ky është një unitet fals, një unitet që u intereson revizionistëve për të mbledhur forcat. Kjo do të thotë që forcat e vërteta marksiste-leniniste të mbajnë në heshtje pikëpamjet e tyre, gjersa revizionistët të marrin çekatin e t'ua përplasnin mbi kokë.

Rruga e lavdishme që ndoqën Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini na mësojnë se marksizëm-leninizmi do të fitojë me luftë e përpjekje të gjithanshme. Marksizmi na mëson që të vërtetën ta shikojmë në sy, të mos e humbasim perspektivën dhe të mos trembejmë nga fakti që sot jemi parti ose grupe të vogla, por të mendojmë se si të ngrihemi të organizuar kundër këtij organizimi të madh të armikut që ekziston. Në qoftë se forcat e reja marksiste-leniniste, këta luftëtarë të vërtetë, që luftojnë kundër reaksionit, kundër imperializmit dhe kundër revizionizmit, do të absolutizonin faktin që armiqtë e tyre revizionistë kanë në duar partinë dhe përkrahjen e policisë e të pushtetit borgjez, ç'do të ngjiste? Do të hidheshin në pasivitet. Por marksistë-leninistët, përkundrazi, nuk veprojnë e s'duhet të veprojnë kështu. Pavarësisht nga kushtet e vështira që kanë, ata i janë përveshur punës seriozisht.

Kur marksistë-leninistët e vërtetë e kanë të qartë se masat nuk mund të pranojnë të futen në rrugën e

tradhtisë, atëherë për ta bëhet e qartë se kjo e ashtuqajtur forcë e organizuar e armikut, që kanë përballë tyre, nuk ka taban të fortë, nuk ka të ardhme. Do të vijë dita që edhe masa e ndershme e partisë, që në këto momente për një sërë arsyesh qëndron akoma pasive, të sqarohet dhe patjetër do të shkëputet nga udhëheqja revizioniste e partisë. Por kush mund ta bëjë këtë? Këtë mund ta bëjë vetëm lufta e vërtetë e revolucionarëve konsekuentë. Është detyra e gjithë marksistë-leninistëve të vërtetë që t'i bindin dhe t'i udhëheqin masat në rrugën revolucionare marksiste-leniniste.

Kjo është një luftë e madhe dhe e vështirë që kërkon kurajë, gjakftohtësi dhe guxim. Po të mendojmë e të veprojmë si marksistë, atëherë duhet që secili të shfaqë pikëpamjen e tij me kurajë përpara partisë. Në rast se ai që shfaq pikëpamjen e tij do të përjashtohet prej grupit revizionist nga partia, ai është ballëhapur, sepse e di që ka luftuar për një kauzë të drejtë. Në këtë rast është e nevojshme që të fillohet puna nga jashtë partisë, por, nga ana tjetër, duhet menduar edhe për ata komunistë që janë në parti, të cilët janë të shumtë dhe nuk janë të gjithë dakord me udhëheqjen revizioniste, por qëndrojnë në parti për arsye se akoma s'janë të qartë, se i mbyt demagogjia revizioniste ose për arsye sentimentale, për lidhje jomarksiste. Ka të tjerë që shpresojnë dhe që thonë se duhet të presim që të dalë nga partia një njeri që të na udhëheqë. Këta njerëz, ndërsa flasin kundër kultit të personit, nga ana tjetër, në themel janë për kultin e personit, sepse presin që të dalë një person i tillë që të jetë flamuri udhëheqës.

Ka në ndonjë parti revizioniste edhe shokë të mirë revolucionarë, të cilët thonë se vija e partisë së tyre është një vijë jo marksiste-leniniste, se partia e tyre po shkon në greminë etj. Por kur vjen puna për të vepruar, thonë: «Duhet të presim». Po ku të shpie kjo punë? Kjo të shpie në frenimin e shokëve të tjerë, në frenimin e lëvizjes revolucionare. Prandaj lufta brenda dhe jashtë partisë është një problem me rëndësi. Marksistë-leninistët duhet të përpiqen që të mos u lënë armiqve as komunistin e fundit. Duke vepruar me konsekuencë e pa u përkulur, marksistë-leninistët do t'i demaskojnë e do t'i izolojnë revizionistët modernë. Bazat e këtyre janë të paqëndrueshme, ata i mban në këmbë demagogjia e madhe që përhapin.

Ku mbështetet N. Hrushovi? Ai mbështetet në prestigjin e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, të Partisë së Leninit. Po Torezi ku mbështetet? Në prestigjin e Partisë Komuniste të Francës. Por njerëzit duhet të gjykohen në bazë të veprimtarisë së tyre praktike, në bazë të faktit se sa ata u qëndrojnë besnikë traditave të mëparshme revolucionare të partive përkatëse, se sa ata në veprimet e tyre udhëhiqen nga marksizëm-leninizmi. Duke u nisur nga ky kriter e vërteta do të dalë patjetër në shesh një ditë, sepse ka edhe njerëz që i fshehin pikëpamjet e tyre trockiste për 5, 10 dhe 15 vjet, siç është rasti i Hrushovit. Ka mjaft gjëra që sot janë të fshehura, por do të vijë një ditë e çdo gjë do të dalë në shesh.

Tani puna jonë ndodhet në ngritje dhe sa më tepër kalojnë ditët aq më tepër revizionistët do të demaskohen. Ju e dini, ashtu sikurse edhe ne, se puna jonë nuk



është e izoluar, se kjo është një punë që duhet ta bëjmë së bashku me të gjitha forcat revolucionare në botë. Kjo luftë duhet të drejtohet frontalisht në të gjitha drejtimet, pra duhet të bashkohemi, se bashkimi bën fuqinë. Armiqtë janë të armatosur deri në dhëmbë, qëllimi i tyre është i qartë, prandaj ne duhet të rezistojmë ndaj tyre dhe jo vetëm të rezistojmë, por edhe t'i demaskojmë.

Sa më të mëdha të jenë lufta dhe vështirësitë aq më shumë një komunist duhet të jetë optimist dhe i vendosur për të ecur përpara. Është e qartë se pengesat janë të mëdha dhe këto shfaqen jo vetëm haptazi po edhe nën rrogëz. Dhe ato që janë nën rrogëz janë akoma edhe më të vështira. Por marksistë-leninistët do t'i kalojnë këto pengesa.

Marksistë-leninistët revolucionarë dallohen për përcaktimin e një vije të drejtë dhe për luftën që ata bëjnë për zbatimin e saj, prandaj puna me shokët e të gjitha grupeve duhet të bëhet në një mënyrë të atillë që ata jo vetëm të caktojnë një vijë të drejtë, por të kenë edhe një formë organizative të tillë, të aftë për ta vënë në jetë këtë vijë. Për zgjidhjen e këtyre detyrave një rol të rëndësishëm luan edhe shtypi marksist-leninist. Këtë e them në bazë të eksperiencës sonë. Kjo gazetë duhet të jetë e atillë që të mbrojë një vijë të drejtë marksiste-leniniste dhe të shprehë dëshirat dhe aspiratat e masave, që kur ta lexojnë masat të thonë: këta shokë kanë të drejtë! Kur një gazetë reflekton drejt aspiratat e popullit dhe luftën e tij, kthehet në një flamur të vërtetë. Natyrisht, edhe mbledhjet e konferencat kanë rëndësinë e tyre, por ato bëhen gjithnjë

me një rreth të kufizuar njerëzish, kurse gazeta është e të gjithëve.

Shokë, më lejoni t'ju them në emër të Komitetit Qendror të Partisë sonë dhe të popullit shqiptar se Partia dhe populli ynë kanë e do të kenë kurdoherë një dashuri të madhe dhe të sigurtë për revolucionarët e vërtetë, për popujt që luftojnë për lirinë e pavarësinë e tyre, për partitë dhe forcat marksiste-leniniste kudo në botë. Ne do të jemi përkrah tyre kurdoherë, në ditë të mira e të vështira, do t'i përkrahim e do t'i ndihmojmë me të gjitha forcat tona në çështjen e tyre të drejtë.

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura në këtë  
takim që gjenden në AQP*

## «NDIHMIA» E REVIZIONISTËVE SOVJETIKË NDAJ VENDEVE TË TJERA SJELL ME VETE ZINXHIRËT E SKLLAVËRISË

*Nga biseda me një mik cejlonez*

**11 maj 1964**

**SHOKU ENVER HOXHA:** Jam i gëzuar që kam rastin të takoj një shok të udhëheqjes të Partisë Komuniste të Cejlonit.

Ne jemi në dijeni për punën e komunistëve revolucionarë të vendit tuaj, të cilët krijuan Partinë Komuniste marksiste-leniniste të Cejlonit. Atë ditë që lexuam këtë njoftim nga agjencitë e lajmeve u gëzuam sepse populli heroik i Cejlonit ka tani udhëheqjen e tij, e cila, duke u qëndruar besnike parimeve të marksizëm-leninizmit, do të jetë në gjendje të luftojë me sukses kundër imperializmit, kolonializmit dhe kundër revizionizmit.

Ne s'kemi pasur lidhje më parë me Cejlonin. Por sado larg që jemi, na lidhin ndjenja të pastra me popullin tuaj, sepse ai ka një histori vuajtjesh, shtypjesh, shfrytëzimi dhe lufte, ashtu sikurse edhe populli shqiptar. Popullit tuaj i pinë gjakun anglezët dhe borgjezia

reaksionare, sikurse popullit tonë në të kaluarën ia kanë pirë gjakun pushtues të huaj dhe reaksionarë vendës. Por me luftë dhe me revolucion ne fituam; kështu do të fitoni edhe ju.

Populli ynë e bëri revolucionin i udhëhequr nga mësimet e marksizëm-leninizmit. Por edhe më parë, gjatë gjithë historisë së tij, populli ynë ka luftuar për të fituar lirinë. Fshatarësia jonë në luftëra e përpjekje të vazhdueshme kundër pushtuesve të huaj për liri e pavarësi është shquar për patriotizmin e saj të lartë, për shpirtin e paepur luftarak, për trimërinë dhe guximin e madh revolucionar. Ajo udhëhiqej në luftën e saj nga demokratë përparimtarë dhe nga fshatarë revolucionarë, që kishin në gji dashurinë për atdheun e lirinë, kishin zjarrin revolucionar. Edhe në situata shumë të komplikua, lufta e saj ka pasur në përgjithësi një vijë orientuese të drejtë. Por, sidoqoftë, këto ishin kryengritje fshatare. Elementët përparimtarë e demokratë, që shumë herë i udhëhiqnin këto lëvizje fshatare, shkonin gjer në njëfarë shkalle, por nuk ishin konsekuentë dhe e linin në mes të rrugës lëvizjen fshatare. Kështu që gjaku i derdhur nga fshatarësia jonë patriotike nuk i sillte asaj fitoren e dëshiruar.

Të tilla gjëra, sigurisht, ka edhe në historinë e popullit tuaj. Çdo popull ka historinë e tij të lavdishme, ka njerëzit e tij të lavdishëm, të cilët kanë bërë përpjekje, kanë pasur suksese, janë shtypur, por përsëri popujt janë ngritur në luftë për liri e pavarësi.

Por tani kohërat kanë ndryshuar. Imperializmi po kalbëzohet, proletariati ndërkombëtar ka fituar një eksperiencë të madhe luftërash e përpjekjesh, zinxhirët

e kolonializmit po copëtohen, popujt po zgjohen dita-ditës dhe po ngrihen në luftë e revolucion. Tani në shumë vende në krye të luftës qëndrojnë partitë marksiste-leniniste që dinë të organizojnë revolucionin, ta udhëheqin atë dhe të vendosin pushtetin e popullit. Partitë komuniste kanë në duart e tyre një shkencë dhe një busull të pagabueshme, marksizëm-leninizmin. Duke u udhëhequr nga kjo busull, Revolucioni Popullor që triumfoi në vendin tonë, në Shqipërinë e vogël, do të fitojë nesër edhe në Cejlonin tuaj. Natyrisht kushtet dhe situatat konkrete ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin, por një gjë është e njëllajtë: rruga revolucionare, idealet e mëdha të revolucionit, principet e mëdha revolucionare, të cilat i orientojnë komunistët në çdo situatë.

Para se vendi ynë të pushtohej nga fashistët italianë ne kishim në krye një mbret reaksionar, feudal dhe të shitur kokë e këmbë tek imperializmi. Politika e tij antikombëtare e kishte shtuar shumë shtypjen e shfrytëzimin e masave të gjera punonjëse e, për pasojë, urrejtja dhe revoltat e masave rriteshin përditë e më tepër. Pasi vendi ynë u pushtua nga fashistët italianë, urrejtja e masave kundër pushtuesit e tradhtarëve të vendit arriti kulmin dhe u krijua një situatë jashtëzakonisht revolucionare, të cilën diti ta shfrytëzojë shumë drejt Partia jonë e sapokrijuar. Ajo u vu në krye të masave dhe diti t'i udhëheqë me konsekuencë në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, në rrugën e revolucionit e të socializmit.

Shumë parti marksiste-leniniste tani veprojnë në vende që e kanë fituar pavarësinë politike, kanë he-

dhur poshtë zgjedhën politike të kolonizatorëve imperialistë, por që, natyrisht, këta akoma ruajnë bazat e tyre ekonomike dhe, në kundërshtim me interesat e vendit, shfrytëzojnë dhe u pijnë gjakun popujve. Në një pjesë të këtyre vendeve janë në fuqi qeveri përparimtare, por sidoqoftë ato janë përfaqësues të borgjezisë.

Komunistët e këtyre vendeve duhet t'i njohin mirë këto kushte konkrete dhe t'i vlerësojnë drejt në përcaktimin e taktikës dhe të strategjisë së tyre. Marksizëm-leninizmi na mëson se një qeveri borgjeze ose mikroborgjeze nuk mund të jetë revolucionare konsekuente, ajo revolucionin e lë në mes të rrugës. Prandaj në qoftë se komunistët e vendeve përkatëse kënaqen dhe lidhin duart, duke menduar se nuk duhet të bëjnë revolucion, se proletariati nuk duhet të marrë fuqinë në dorë për të vendosur diktaturën e vet, për arsye se ndodhet në krye një qeveri borgjeze pak a shumë përparimtare, këto nuk janë mendime marksiste-leniniste. Janë revizionistët modernë, me Hrushovin në krye, ata që propagandojnë e zhvillojnë një politikë të tillë antimarksiste e antirevolucionare. Hrushovi jo vetëm që i thotë këto për qeveritë borgjeze të vendeve në zhvillim, por ai bile deklaroi se këto qeveri ndërtojnë socializmin. Edhe revizionistët e vendeve ku janë në fuqi qeveri të tilla, duke hequr dorë nga rruga e revolucionit, janë bashkuar e do të bashkohen më ngushtë me partitë socialdemokrate për të mbështetur qeveritë borgjeze të vendeve përkatëse.

Kurse për marksistë-leninistët pikëpamje e veprimet e tilla kapitulluese duhet të jenë krejtësisht të papranueshme. Detyra e tyre është që të përgatitin par-

tinë dhe masat për rrugën e vështirë, por të lavdishme, të revolucionit, të bëjnë një luftë të papajtueshme me gjithë ato teori borgjeze e revizioniste që ngjallin frymën e nënshtrimit e të amullisë në radhët e klasës punëtore, të fshatarësisë e të mbarë masave punonjëse.

Një ndër gabimet e shumta që ka karakterizuar e karakterizon vijën e partive të sotme revizioniste në vendet me klasa shfrytëzuese, është përqendrimi i punës kryesisht në qytet dhe lënia pas dore e fshatit. Por ky gabim në vijë ka edhe një të mirë: fshatarësia nuk infektohet nga teoritë e nënshtrimit e të pajtimit me gjendjen ekzistuese, që, në një mënyrë ose në një tjetër, propagandojnë revizionistët. Partitë marksiste-leniniste, duke hartuar e duke zbatuar një vijë të drejtë revolucionare, dëhet t'i kenë parasysh të gjitha këto, me qëllim që ta koordinojnë drejt luftën për të bërë për vete klasën punëtore dhe fshatarësinë, të forcojnë aleancën e tyre revolucionare dhe të kombinojnë drejt kërkesat e tyre.

Një formë e mirë pune në këtë drejtim është edhe krijimi i komiteteve fshatare, të cilat, ashtu siç ka shkruar Stalini, të formulojnë kërkesat e drejta të fshatarësisë ndaj latifondistëve, bejlerëve, feudalëve dhe çifligarëve. Këtu nuk e kam fjalën për komitetet e fshatarëve të varfër që u krijuan te ne në kohën e zbatimit të Reformës Agrare. Këto janë forma të tjera, më të avancuara, që krijohen nën pushtetin e diktaturës së proletariatit. Kurse ajo që them unë ka të bëjë me vendet e paçliruara. Në këto vende, nëpërmjet komiteteve fshatare, partia mund të formulojë kërkesat e fshatarësisë dhe t'i koordinojë këto me kërkesat e punëto-

rëve të qytetit. Në këtë mënyrë partia do të hedhë bazat e celulave që do të bëhen drejtuese të këtyre komiteteve. Këto komitete, duke qenë nën drejtimin e organizatave të partisë në fshat, mundet që gjer në njëfarë shkalle të kufizojnë ose të mënjanojnë edhe ato kontradikta që lindin në vendet me klasa shfrytëzuese në mes klasës punëtore dhe fshatarësisë dhe të koordinojnë drejt kërkesat e klasës punëtore me kërkesat e fshatarësisë.

*Duke iu drejtuar mikut cejlonez, shoku Enver e pyet atë se ç'qëndrim mban Partia e re marksiste-leniniste e Cejlonit ndaj Frontit të Bashkuar, si janë lidhjet e Partisë me klasën punëtore e me fshatarësinë cejloneze, a është formuar në Cejlon gjuha kombëtare etj. Mysafiri, pasi e falënderoi shokun Enver Hoxha për këtë takim të rëndësishëm, iu përgjigj pyetjeve dhe foli për përpjekjet e PK të Cejlonit për të forcuar partinë në luftë kundër aleancës së reaksionit borgjez, revizionist, rrymave trockiste, nacionaliste borgjeze etj. Pastaj ai tha:*

Kisha edhe unë një pyetje për të bërë: Disa vende socialiste po u japin ndihmë qeverive nacionale borgjeze për t'i përdorur këto kundër imperializmit, ndërsa kjo ndihmë në fakt po përdoret kundër elementëve progresivë në këto vende. Ç'mendoni Ju për këtë?

**SHOKU ENVER HOXHA:** Në radhë të parë duhet që vendet socialiste të kenë një vijë me të vërtetë të drejtë. Aktualisht në shumicën e vendeve të ish-kampit socialist, si në Bashkimin Sovjetik, Poloni, Gjermani, Çekoslovakia, Bullgari etj. në krye kanë ardhur revizionistët, të cilët janë tradhtarë të marksizëm-leninizmit.



Kuptohet se tani këto vende nuk i ndihmojnë popujt e revolucionin në rrugën marksiste-leniniste, përkundrazi, ata ndihmojnë kundërrevolucionin, përpiqen të degjenerojnë socializmin në vendet e tyre dhe të pengojnë lëvizjen revolucionare e nacionalçlirimtare të botës.

Vendet e vërteta socialiste, që udhëhiqen nga partitë marksiste-leniniste, në ndihmën që u japin vendeve të tjera të çliuara ose që janë duke u çliruar duhet të kenë parasysh disa faktorë. Çështja kryesore këtu është që në radhë të parë të udhëhiqemi nga marksizëm-leninizmi dhe që çdo gjë t'i shërbejë triumfit të revolucionit. Kështu, të gjitha përpjekjet tona duhet të drejtohen në luftën kundër imperializmit, që është pengesa kryesore në rrugën e revolucionit, të çlirimit dhe të ardhjes së popullit në fuqi, si dhe kundër borgjezisë së madhe reaksionare, e cila është në aleancë me imperialistët.

Në vendet josocialiste që kanë fituar lirinë, ka ardhur në fuqi borgjezia e madhe. Këtu bëjnë pjesë gjithashtu edhe elementë të borgjezisë demokrate që mbajnë një qëndrim të lëkundshëm. Në disa raste këta kanë dhënë edhe disa liri demokratike. Por këta, megjithëse kanë luftuar me imperializmin, janë çliruar dhe kanë marrë në dorë pushtetin, prapëseprapë, siç thotë Lenini, janë gjithnjë pro imperializmit.

Si i ndihmonte Bashkimi Sovjetik këto vende në kohën e Stalinit? Ne mendojmë se ndihma e Bashkimit Sovjetik në atë kohë ishte ndihmë e një shteti socialist, ashtu siç e kërkonin interesat e socializmit.

Të marrim, për shembull, Indinë. Lenini dhe Stalini ishin për ta ndihmuar popullin indian që të çli-

rohej nga imperializmi anglez dhe e ndihmuan në këtë drejtim me peshën e shtetit të tyre të madh socialist në të gjitha manifestimet politike ndërkombëtare. Por në atë kohë ndihma politike dhe ideologjike e Bashkimit Sovjetik ishte kurdoherë internacionaliste dhe e bazuar në parimet. Në ç'drejtime bëhej kjo? Në përkrahjen ose jo të Partisë së Kongresit, të Gandit. Partia e Kongresit kishte anë të mira dhe anë jo të mira. Ana e mirë ishte bojkotimi që i bënin gandistët imperializmit anglez. Kurse ato forma dhe metoda të luftës së tyre që ishin reaksionare e antipopullore, Bashkimi Sovjetik jo vetëm nuk i përkëdhelte, por i denonconte dhe i tregonte popullit indian se lufta e tij nuk duhej të bëhej në mënyrë pasive, por në rrugë revolucionare. Në veprat e Stalinit gjen si përkrahjen për çlirimin e Indisë, ashtu edhe kritika për metodat reaksionare të luftës që përdorte borgjezia indiane. Nga ana tjetër, Bashkimi Sovjetik ndihmonte popullin dhe revolucionarët indianë për çlirimin e popullit indian.

Kurse Hrushovi çfarë bën? Ai bën të kundërtën, ndihmon kundërrevolucionin, mbështet qeverinë ultra-reaksionare indiane me në krye Nehrunë që është një agjenturë e imperializmit dhe që mbron interesat e borgjezisë së madhe indiane në dëm të popullit indian, në dëm të popujve të Azisë dhe të revolucionit. Prandaj këto ndihma nuk shkojnë aspak në favor të socializmit, ato janë ndihma të një klike borgjeze reaksionare, kundër popullit indian, kundër popujve të tjerë të Azisë. N. Hrushovi i jep armë Nehruit, i cili merr armë edhe nga amerikanët, për të shtypur revoltat dhe luftën e drejtë të popullit indian, si dhe për t'i përdorur

kundër revolucionit në Azi. Klika e Hrushovit jep kredi që klika e Nehruit të ndërtojë metalurgjinë e rëndë dhe fabrika armatimesh, gjë që do të thotë të financosh borgjezinë e madhe reaksionare indiane kundër revolucionit indian.

Hrushovianët thonë se këto ndihma që i japin Indisë shkojnë në dobi të popullit indian. Por kjo është njëlloj sikur të përpiqesh të forcosh ekonominë dhe ushrinë e imperializmit të SHBA-së dhe të thuash se ndihmon popullin amerikan. Natyrisht, këto populli një ditë prej ditësh do t'i marrë në dorë, por, për ta arritur këtë, ai duhet të bëjë revolucionin. Pa revolucion nuk u merr dot asgjë Nehruit dhe amerikanëve. Me anën e parlamentarizmit, që propagandon Hrushovi, populli nuk mund të fitojë asgjë. Prandaj kur Hrushovi i jep ndihma Nehruit nuk ndihmon popullin indian, por reaksionarët indianë. Pra, kjo ndihmë është reaksionare, kundër revolucionit, është ndihmë për të mbajtur në fuqi pushtetin reaksionar borgjez.

Të marrim një shembull tjetër, Egjiptin. A duhet ndihmuar Egjipti? Po, duhet ndihmuar. Por këtu duhen pasur kurdoherë parasysh ato pikëpamje që thashë në fillim. Egjipti duhej ndihmuar që të çlirohej nga imperializmi anglez dhe të mëkëmbej për të mos rënë përsëri në gjunjë përpara imperializmit. Një gjë e tillë është në interesin e përgjithshëm, sepse luftërat nacionalçlirimtare bëjnë pjesë në zinxhirin e revolucionit botëror, ato janë etapa të revolucionit socialist. Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe populli ynë, duke ndjekur kurdoherë një vijë të drejtë, e kanë përkrahur me të gjitha forcat luftën e drejtë të popu-

llit egjiptian për lirinë e pavarësinë kombëtare. Ne kemi pasur dhe kemi marrëdhënie të mira me RA të Bashkuar dhe përpiqemi t'i ruajmë këto marrëdhënie miqësore në kuadrin e bashkekzistencës paqësore, të bëjmë tregti dhe ta zhvillojmë këtë në interes të përbashkët, të kemi marrëdhënie kulturore, por duke ruajtur kurdoherë parimin që këto marrëdhënie të mira të jenë në favor të popujve tanë, në favor të revolucionit. Kurse «ndihma» e Hrushovit për vendet arabe nuk ka qëllime socialiste. Qëllimi i ndihmës së Hrushovit është, në radhë të parë, për t'i bërë qeveritë e këtyre vendeve aleate për të forcuar bllokun e tij hrushovian borgjez, ashtu siç përpiqet imperializmi amerikan për t'i futur vendet arabe në bllokun e tij. Domethënë se Hrushovi nuk e shikon ndihmën në frymën e revolucionit, të përkrahjes së proletariatit e të popullit, po në frymën e krijimit të aleancës me një vend borgjez, me një qeveri borgjeze, për të krijuar një kundërbalancim ndaj bllokut amerikan. Në radhë të dytë, qëllimi i ndihmës së Hrushovit është për të luftuar komunistët e vërtetë dhe influencën e marksizëm-leninizmit në të gjithë Afrikën.

Në Azi dhe në Afrikë zien revolucioni. Amerikanët dhe revizionistët hrushovianë kanë marrë përsipër që ta shuajnë këtë revolucion. Në mes të amerikanëve dhe të hrushovianëve ka akord dhe dizakord. Dizakordi qëndron në atë se kush do t'i fusë në kontroll këto zona, kush do të shtrijë më parë influencën e vet politike, ekonomike e ushtarake në to — amerikanët apo hrushovianët. Kjo është një luftë trustesh. Ndërsa akordi midis tyre qëndron në luftën e përbashkët kundër revolucio-

nit, kundër lëvizjes nacionalçlirimtare, kundër marksizëm-leninizmit. Amerikanët e bëjnë këtë luftë në formën e tyre imperialiste dhe kapitaliste, kurse Hrushovi, si shërbëtor i imperializmit, e zhvillon këtë të maskuar në formën revizioniste. Këtu ata janë në akord të plotë. Prandaj «ndihma» që u jep Hrushovi vendeve të çliaruara, ose të porsaçliaruara, është një ndihmë që ndjek po ato qëllime si edhe ndihma e imperializmit amerikan. Edhe në veprimet ideologjike dhe politike Hrushovi ndjek po ato qëllime.

Me bujë të madhe propagandon klika hrushoviane edhe «ndihmën» që u jep të ashtuquajturave «vende socialiste». Po cilat janë qëllimet e vërteta të kësaj «ndihme»? Ai e jep këtë ndihmë për t'i pasur këto vende nën drejtimin e tij politik dhe ekonomik dhe që të vendosë mbi to një hegjemoni revizioniste për t'i transformuar në shtete gubernu, ku të sundojë grupi i Hrushovit.

Si mendonte ta bënte këtë gjë N. Hrushovi? Ai mendonte që, në radhë të parë, të fuste nën hegjemoninë e tij vendet e demokracisë popullore të Evropës. Pasi t'ia arrinte këtij qëllimi, duke krijuar pushtetin e tij ekonomik, politik dhe ushtarak me anën e KNER-it dhe të Traktatit të Varshavës, të kalonte pastaj edhe në dominimin e Kinës, Koresë dhe të Vietnamit, sepse, siç dihet, në KNER e në Traktatin e Varshavës nuk bënin pjesë as Kina, as Koreja, as Vietnamit. Por përpjekjet skllavëruese të Hrushovit ishin të destinuara të dësh-tonin se Shqipëria në Evropë qëndroi e patundur në pozitë e saj marksiste-leniniste dhe jo vetëm që s'iu nënshtrua planeve hegjemoniste të Hrushovit, por i

goditi dhe i demaskoi ato si antisocialiste dhe skllavëruese.

Tani në KNER ka filluar grindja midis revizionistëve. Kjo do të ndodhte patjetër, sepse revizionizmi sjell me vete ligjin e xhunglës. Pra, plani i Hrushovit për të dominuar në lëvizjen komuniste ndërkombëtare nga ana ideologjike, politike dhe ekonomike nuk mund të realizohet.

Hrushovi synon që në planin ndërkombëtar të arrijë me SHBA-në një aleancë politike, ideologjike dhe ushtarake për dominimin e gjithë botës. Tani luftohet kush të dominojë në kontinentet e Afrikës, të Azisë dhe të Amerikës Latine. Pikërisht nga kjo ideologji e tij revizioniste niset Hrushovi me të ashtuquajturat «ndihma» që u jep vendeve të ndryshme. Nëpërmjet Naserit, Hrushovi përpiket të organizojë një bllok në Afrikë dhe në Azinë e Vogël, të cilin do ta financojë për ta pasur me vete.

Për të realizuar planin e tij djallëzor N. Hrushovit i duhet të mbështetë e të përkrahë të gjithë revizionistët që janë ose nuk janë në fuqi. Ai i financon revizionistët, që të propagandojnë vijën e tij tradhtarë, të bashkekzistencës paqësore, vijën e kundërrevolucionit, vijën e parlamentarizmit, vijën e reformave sociale. N. Hrushovi flet për «unitet», por kuptimi i unitetit për të do të thotë nënshtrimi i marksist-leninistëve ndaj kësaj vije tradhtarë. Kurse ne jemi për unitetin e vërtetë marksist-leninist, i cili nuk mund të arrihet me këta tradhtarë, por në luftë kundër tyre, kundër imperialistëve dhe reaksionit. Pajojë e vijës antimarksiste, oportuniste e tradhtarë të

Hrushovit është. likuidimi i partive komuniste të Afrikës e të Lindjes së Mesme. Në këto vende ai është përpjekur e do të përpiqet të frenojë lindjen dhe forcimin e partive marksiste-leniniste. Mirëpo, pavarësisht nga dëshirat dhe përpjekjet e Hrushovit me shokë, ato do të organizohen në luftë kundër imperializmit dhe revizionizmit.

Imperialistët dhe hrushovianët do të na luftojnë, do të na shajnë, do të na sulmojnë, do të na bëjnë presion, por ne do t'u bëjmë atyre ballë dhe do t'i demaskojmë. Nuk kemi frikë nga ata, përkundrazi, ata kanë frikë nga ne. Fuqia e tyre dobësohet çdo ditë, ata po demaskohen gjithnjë më shumë. Popujt çdo ditë dhe çdo muaj do të shikojnë fytyrën e tyre tradhtare, ata do të shikojnë se revizionistët modernë s'kanë asnjë ndryshim nga imperialistët, se edhe këta përpiqen një-lloj si imperialistët për sundimin e shfrytëzimin e botës. Ndaj proletariati dhe masat e ngritura në revolucion do t'i flakin tej me urrejtje e përbuzje, si imperialistët, ashtu edhe revizionistët.

Ne kemi admirim për ju, sepse, duke punuar brenda në parti dhe në sindikatat, ju krijuat partinë e re, e cila njihet tani si Partia marksiste-leniniste e Cejlonit.

U thoni shokëve të partisë suaj, se te Partia e Punës e Shqipërisë kanë një shok besnik të luftës, se dëshira jonë e zjarrtë është që t'i shtojmë lidhjet dhe marrëdhëniet me të gjitha partitë dhe forcat marksiste-leniniste që u qëndrojnë besnike çështjes së revolucionit dhe ideologjisë sonë fitimtare. Duke u lidhur më shumë me njëra-tjetrën, duke shkëmbyer eksperiencën, duke përkrahur me të gjitha forcat veprimet e drejta

të njëra-tjetrës, partitë marksiste-leniniste do të forcojnë më tepër unitetin e tyre në luftën tonë të madhe kundër imperializmit, revizionizmit modern dhe gjithë reaksionit.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*



**POPULLI YNË U ËSHTË MIRËNJOHËS BIJVE TË TIJ  
PATRIOTË JASHTË ATDHEUT, QË KANË QENË  
DHE JANË KURDOHERË PËRKRAH TIJ**

*Letër përshëndetjeje dërguar shoqatës patriotike  
«Skënderbeu» në Argjentinë me rastin e  
20-vjetorit të themelimit të saj*

**11 maj 1964**

Të dashur bashkatdhetarë,  
Vëllezër dhe motra,

Në emër të Partisë së Punës të Shqipërisë, të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të të gjithë popullit shqiptar, ju dërgoj përshëndetjet vëllazërore më të ngrohta dhe marr pjesë me gjithë zemër në gëzimin tuaj të madh, me rastin e 20-vjetorit të themelimit të shoqatës patriotike «Skënderbeu» të kolonisë shqiptare në Argjentinë.

Shoqata juaj patriotike «Skënderbeu», gjatë këtyre 20 vjetëve, ka zhvilluar një veprimtari të shquar patriotike, duke ruajtur dhe duke zhvilluar tek anëtarët e

saj ndjenjat e dashurisë për atdheun, gjuhën, zakonet fisnike të shqiptarit, dhe respektin e ligjshëm për fitoret e mëdha historike të arritura nga populli ynë në luftën e tij kundër pushtuesve nazifashistë dhe tradhtarëve të vendit si dhe në luftën për ndërtimin e jetës së re në Shqipëri. Shumë janë përpjekur dhe përpiqen armiqtë e të gjithë flamurëve për të përçarë shoqatën tuaj patriotike, për të prishur bashkimin dhe për të shkelur besën e dhënë për ruajtjen e nderit dhe të dinjitetit të popullit shqiptar. Por ata nuk ia kanë arritur qëllimit të tyre djallëzor dhe nuk do t'ia arrijnë kurrë, sepse shoqata juaj patriotike, që mban emrin e Heroit tonë Kombëtar, kryetrimt Skënderbe, ka ditur t'i bëjë pluhur e hi përpjekjet e armiqve dhe të gjithë shërbëtorëve të tyre, sa herë që ata kanë marrë guximin të veprojnë. Kështu, të gjithë ju, të dashur bashk-atdhetarë, keni treguar më së miri aty, larg mëmëdheut, tiparet më të larta të popullit shqiptar: besën, trimërinë, mprehtësinë dhe urtësinë.

Festa e 20-vjetorit të themelimit të shoqatës suaj bie në një vit me jubileun e madh të 20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut. Populli shqiptar, i cili në shekuj ka qenë i robëruar, i shfrytëzuar, por kurrë nuk u përkul dhe nuk i ktheu shpinën armikut, e fitoi lirinë dhe pavarësinë e vërtetë në nëntor të vitit 1944. Gjatë kësaj kohe populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë së tij të Punës dhe të pushtetit popullor, ka arritur suksese të papara në të gjitha drejtimet. Shqipëria, nga një vend i prapambetur që ishte në të kaluarën, tani ka një industri moderne, një bujqësi të zhvilluar, një kulturë të përparuar. Fëmijët e punëtorëve dhe të fshatarëve mbushin

të gjitha shkollat e Republikës deri në universitet. Më parë, shqiptari mërgonte në kurbet për të siguruar bukën. Tani, bijtë e Shqipërisë në vendin e tyre punojnë për begatinë dhe mirëqenien e popullit, për forcimin, zhvillimin e mëtejshëm e lulëzimin e atdheut, ata punojnë për vete dhe nuk i shfrytëzon njeri si më parë. Pushteti popullor vuri në vend nderin dhe dinjitetin e popullit shqiptar. Tani prestigji i Republikës Popullore të Shqipërisë në fushën ndërkombëtare është më i lartë se kurrë; atë s'ka armik që do të guxojë ta prekë, sepse ajo është e fortë si malet dhe ka kudo miq të fortë e besnikë.

Populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë së tij të Punës, duke mbajtur në një dorë kazmën e në tjetrën pushkën, do të vazhdojë me vendosmëri të patundur luftën për të ardhmen e lumtur, për çështjen e paqes, lirisë, demokracisë e të socializmit në botë, kundër imperialistëve, me ata të SHBA-së në krye dhe kundër agjentëve të tyre, revizionistëve Tito-Hrushov etj. Populli ynë u është mirënjohës bijve të tij jashtë atdheut, siç janë patriotët e shoqatës «Skënderbeu» të Argjentinës, të cilët kanë qenë dhe janë kurdoherë përkrah tij në këtë luftë fisnike.

Unë kam besim se shoqata patriotike «Skënderbeu», edhe në të ardhmen, do të vazhdojë në rrugën e saj patriotike, do të mbajë kurdoherë me nder emrin e Skënderbeut, nderin e të parëve dhe të partizanëve tanë të rënë për lirinë e Shqipërisë, duke mbajtur të fortë te çdo anëtar i saj ndjenjën e dashurisë dhe të respektit për atdheun tonë të lavdishëm, për Republikën Popullore të Shqipërisë.

Të gjithë bashkatdhetarëve patriotë të kolonisë shqiptare të Argjentinës u uroj shëndet, nder dhe gëzime!

Rroftë shoqata patriotike «Skënderbeu»!

Përshëndetje vëllazërore

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## NGA POLITIKA E HRUSHOVIT PËRFITOJNË VETËM BORGJEZIA DHE REAKSIONI

*Nga biseda me delegacionin e Ministrisë së  
Komunikacionit të RP të Kinës dhe  
delegacionin e Federatës Pankineze  
të Bashkimeve Profesionale*

**12 maj 1964**

*Miqtë përshëndeten ngrohtësisht, u urohet mirëse-  
ardhja dhe ftohen të ulen. Pastaj e merr fjalën*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Populli shqiptar, të dashur miq, ka një simpati e respekt të thellë për popullin kinez. Ne jemi të gëzuar kur shikojmë përparimet e mëdha të Republikës suaj Popullore, sukseset tuaja, kapërcimin e vështirësive të natyrës. Edhe populli shqiptar, i udhëhequr nga Partia e tij e Punës, ka arritur suksese të dukshme në zhvillimin dhe përparimin e atdheut socialist. Çdo gjë vjen me përpjekje dhe me luftë. Është e vërtetë që sukseset e arritura në vendin tonë nuk mund të krahasohen me të kaluarën, por ne kurrë s'kemi menduar se është arritur gjithçka. Ne kemi akoma shumë për të

bërë në çdo drejtim, në bujqësi dhe në industri. Por jemi të bindur se do të korrin vazhdimisht suksese, sepse Partia jonë është monolite, e vendosur, e lidhur ngushtë me popullin, se populli është i qartë politikisht, e kupton drejt dhe e zbaton mirë vijën e drejtë të Partisë. Populli ynë është si populli juaj, i thjeshtë, ai nuk rron me fantazi, është i ndërgjegjshëm se çdo gjë do të arrihet me luftë dhe me punë. Pretendimet e tij janë modeste dhe jo jashtë realitetit shqiptar. Dhe Partia ka meritën që ia ka bërë popullit të qartë perspektivën. Çështja e perspektivës ka rëndësi, pasi populli duhet të dijë se ç'është bënë, ku do të shkojë dhe si do të shkojë. Prandaj ne i themi atij se me përpjekje dhe me punë do të shkojmë përpara. Natyrisht vështirësi do të kemi, luftë do të bëjmë, sepse armiqtë janë të egër dhe na pengojnë, por ne do t'i thyejmë dhe do t'i mundim ata.

E gjithë veprimtaria armiqësore e revizionistëve modernë, të cilët ndihmohen nga imperializmi, kundër socializmit dhe lëvizjeve nacionalçlirimtare, është me pasoja të rënda për popujt e botës.

N. Hrushovi bën shumë intriga. Tani ai ka shkuar në Egjipt për të thurur plane djallëzore. Qysh nga fjallimi i parë që mbajti në Egjipt, duket se ai ka vajtur atje për të realizuar dëshirën e tij që të krijojë në Afrikë një grup aleat për të luftuar komunizmin, për të luftuar socializmin, për të shtypur lëvizjen nacionalçlirimtare. Ai dekoron krerë të vendeve ish-koloniale, duke u dhënë titullin e heroit të Bashkimit Sovjetik, kurse nesër ai mund t'ia japë këtë titull edhe ndonjë tjetri, që, nga njëra anë mund të pretendojë se

ndërton socializmin dhe, nga ana tjetër lufton komunistët dhe e nxjerr partinë komuniste në ilegalitet. Ne nuk mashtrohemi nga demagogjia e Hrushovit. Kur ai ngre në qiell krerë të reaksionit, do të thotë që ngre në qiell ata që kanë likuiduar komunistët në vendet arabe.

Ndryshime kolosale ka midis vijës së marksistë-leninistëve dhe vijës tradhtare të Hrushovit. Nga politika e tij përfitojnë borgjezia, qeveritë borgjeze, të cilat janë pro imperializmit. Natyrisht, edhe ne do të bëjmë politikë e do të kemi miqësi me vendet arabe, do t'i përkrahim përpjekjet e drejta për çlirim nga imperiaлизmi, për përparimin e këtyre popujve, por në të njëjtën kohë parimet duhen ruajtur.

Politika koniunkturale në dëm të parimeve që bëjnë revizionistët është e palejueshme. Ata nuk mund të kenë kurrë një politikë të drejtë. Si forca që luftojnë kundër marksizëm-leninizmit ata janë në mes të zjarrit tonë demaskues dhe presioneve të njëpasnjëshme të imperializmit. Revizionistët përpiqen të mbajnë maskën, kurse ne ua çjerrim. Nga ana e revizionistëve fryjnë erëra e furtuna, ka dallgë të mëdha. Hrushovi çfarë thotë sot nuk thotë nesër, sot thotë një gënjeshtër të madhe, kurse nesër një më të madhe.

Pas ardhjes në fuqi, qëllimi i tij i parë ishte që me intriga të vendoste në të gjithë të ashtuquajturin kamp socialist dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare hegjemoninë e tij, domethënë që të gjitha vendet socialiste dhe të gjitha partitë komuniste e punëtore t'i kishte në kthetrat e tij dhe t'i çonte drejt degjenerimit. Nga ana tjetër, synonte të sundonte botën bashkë me imperializmin amerikan. Natyrisht, ai u përpoq që këto

qëllime t'i realizojë në disa etapa, në fillim pjesërisht, më vonë tërësisht.

Hrushovi mbështeti shumë shpresa te KNER-i. Këtu bëjnë pjesë vetëm vendet ish-socialiste të Evropës. Me këtë ai mendoj që, pasi të lidhte pas vetes ideologjikisht e politikisht dhe të skllavëronte vendet e ish-demokracisë popullore të Evropës, të kalonte pastaj edhe në Republikën Popullore të Kinës, në Kore dhe në Vietnam. Ai kishte llogaritur që të rregullohej më parë Evropa, sepse kjo, sipas Hrushovit, mund të mbarsej më shpejt me revizionizëm e mund të binte më lehtë në duart e tij. Kështu ai filloi të punojë në Evropë brenda vendeve të Traktatit të Varshavës.

Pse u krijua Traktati i Varshavës? Ai ka kohë që është krijuar, qysh kur ishte Molotovi ministër i Punëve të Jashtme. Krijimi i këtij traktati kishte si qëllim mbrojtjen e vendeve tona kundër imperializmit. Kurse me ardhjen e Hrushovit në fuqi Traktati i Varshavës e ndryshoi qëllimin e tij, duke u kthyer në një organ dhune në duart e revizionistëve sovjetikë për të dominuar vendet e ish-demokracisë popullore të Evropës. Kjo shikohet nga fakti që rregullat e caktuara për funksionimin e këtij traktati nuk u zbatuan. Në shumë mbledhje të shtatmadhorisë së tij nuk është thirrur të marrë pjesë delegacioni shqiptar. Ne nuk dinim se ku do të luftonim në kohë rreziku, se cilën ushtri do të kishim në krah. Këto i dinin Hrushovi dhe Greçkoja.

Tani Hrushovi, si njeri antimarksist, si njeri që ndjek një politikë false, nuk di se çfarë të bëjë dhe hidhet sa andej-këtej. Tani ne shikojmë që brenda në kampin revizionist ka kontradikta, të cilat do të the-



llohen edhe më tepër. Hrushovi do të përpiqet t'i mbajë këto vende nën terror, nën presion dhe do të shkojë drejt lidhjeve sa më të ngushta politike me imperializmin amerikan.

Imperialistët dhe revizionistët kanë plane të fshehta kundër vendeve tona, prandaj duhet vigjilencë ndaj tyre. Kalaja e revizionistëve do të dobësohet nga brenda dhe Hrushovit nuk do t'i binden më edhe miqtë e tij. Gomulka, që është gjithashtu revizionist si Hrushovi, po drejtohet nga Amerika. Të tjerë aleatë të Hrushovit mbajnë qëndrime centriste, kanë dërguar edhe delegacione në SHBA dhe në Gjermaninë Perëndimore. Pra, imperializmi amerikan dhe Hrushovi po kombinojnë punën me aleatët e tyre. Por ata nuk mund t'i gënjejnë popujt dhe revolucionarët e vërtetë. Ka njerëz që mund të gabohen për një kohë, por jo të gjithë e përgjithnjë.

Revizionistët po përdorin tani në vendet e tyre një terror e demagogji të shfrenuar. Ata i kanë shkelur të gjitha normat e partisë. Partitë e tyre po i transformojnë në parti amorse dhe pa shpirt, gjersa një ditë t'i kthejnë në parti fashiste, siç është partia e Titos. Prandaj revolucionarët në Bashkimin Sovjetik dhe gjetkë kanë përgjegjësi të madhe që të mos e lënë Bashkimin Sovjetik të kthehet në një vend kapitalist dhe Partinë e Leninit të mos e lënë të kthehet në një parti fashiste. Ata duhet të dëgjojnë mirë ç'thonë partitë e tjera marksiste-leniniste dhe të mobilizohen në luftë, sepse, po të ulin kurrizin, do t'u kërcasë kërbaci në qafë, kurse, po ta mbajnë atë drejt, shkopi i dirigjentit do të thyhet.

N. Hrushovi, me paturpësinë më të madhe kërkon

të paguhen armatimet që u përdorën nga populli korean dhe populli kinez kundër imperializmit amerikan në Kore. Stalini, sikur të ishte gjallë nuk do të lejonte kurrë një skandal të tillë. Unë kam vajtur në Bashkimin Sovjetik që pas Çlirimit të Shqipërisë dhe kam biseduar me Stalinin për çështjen e armëve. Ai i pranoi menjëherë të gjitha kërkesat tona. Si zakonisht, ekspertët bënë llogaritë dhe dilte se nuk kushtonin pak. Në fund Stalini tha kështu: «I fshini të gjitha këto, se Shqipëria s'ka që të paguajë armë». Kurse Hrushovi, ky i poshtër, kërkon të paguhen armatimet e lara me gjakun e popullit korean dhe kinez. Një njeriu të ndershëm i rrëqethet mishtë kur i dëgjon këto. Edhe shtetet borgjeze në mes të tyre nuk veprojnë në këtë mënyrë, edhe Franca me Anglinë dhe Amerikën nuk i paguajnë njëri-tjetrit në kohë lufte. Kurse Hrushovi, po të jetë për borgjezinë, jep armë. Ne — bëri demagogji Hrushovi në Egjipt — u japim armë atyre që luftojnë kundër imperializmit e jo kundër popujve. Sa gënjeshtër e madhe! Me mitralozat dhe tanket sovjetike në Irak Arefi vret komunistët dhe kurdët. Ja, pra, se ku të çon politika e Hrushovit, ja ç'qëllime ka «ndihma» që ai reklamon aq shumë. Por kjo s'do të vazhdojë gjatë. Në saje të luftës së partive dhe forcave marksiste-leniniste sot ka ardhur dita që komunistët në të gjitha vendet të mos i besojnë më këtij renegati. Ai do të demaskohet gjithnjë e më shumë nga dita në ditë. Fitorja do të jetë me ne.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*

**DISA SHËNIME PËR MBLEDHIJET E BYROSE  
POLITIKE DHE TË SEKRETARIATIT TË  
KOMITETIT QENDROR TË PPSH**

**15 maj 1964**

1. Materialet për çdo mbledhje duhet të jenë gati 5 ditë përpara dhe t'u jenë shpërndarë shokëve që të kenë kohë të mjaftueshme t'i studiojnë dhe të përgatiten. Po kaloi afati, materiali s'duhet të pranohet dhe shoku sekretar do të përgjigjet përpara Sekretariatit ose Byrosë Politike për këtë vonesë.

2. Mbledhja e Sekretariatit të bëhet një ditë para asaj të Byrosë, prandaj për Sekretariatit mbeten katër ditë përgatitje, për Byronë pesë.

3. Raportet që i paraqiten Sekretariatit, nuk duhet t'i kalojnë 5 faqet maksimumi. Në to s'duhet të ketë asnjë fije propagande dhe agjitacioni. Të hyhet drejt në temë. Tema duhet të paraqitet në mënyrë koncize, të kapet problemi në brendësi, kontrolli i zbatimit të vendimit, kritika dhe përgjegjësia, të mirat dhe dëmet. Masat të formulohen në formë vendimi.

Shoku ose shokët përgjegjës për problemin që studihet duhet të lajmërohen me kohë për pjesëmarrjen në mbledhje. T'u bëhet e njohur përmbajtja e proble-

mit, ose t'u jepet për lexim raporti i Sekretariatit. Të porositen se për problemin ata do t'u përgjigjen të gjitha pyetjeve që do t'u bëhen, dhe pyetjet t'u bëhen pasi të kenë raportuar për problemin që janë përgjegjës (të instruktohen se si duhet të raportojnë, domethënë konkluzione shkencore të punës, llogari, kritikë, masat që mendojnë të marrin, kërkesat e tyre, deri në 20 minuta diskutim).

Çdo sektor duhet të dëgjojë me vëmendje arsyetimin e raportit me gojë, të bëjë vërejtjet e tij dhe të japë përgjigjen për kërkesat.

Sekretari që paraqet raportin ka prioritet.

4. Duhet të merren masat përgatitore me kohë, të mendohet mbi problemin, të caktohen tezat, të caktohen njerëzit, të caktohen konsultimet, të harmonizohen afatet e mbledhjes së materialit, e përpunimit, e përpilimit, e paraqitjes te sekretari definitivisht. Të hidhet jashtë çdo frazë e tepërt nga raporti, çdo shifër e panevojshme.

5. Në këtë formë duhet të jenë edhe raportet e Byrosë Politike. Ato duhet të jenë komplet, ana shtetërore dhe masat e Partisë. Prandaj duhet bashkëpunimi i sekretarëve përkatës dhe i shokëve të Qeverisë. Raportet për Byronë Politike mund të arrijnë deri në 6-7 faqe, maksimumi, vendimet në çdo raport të jenë të qarta e në formë ligji.

**Përpunimi i këtyre vendimeve u përket sekretarëve dhe Qeverisë.**

6. Asnjë material informativ nuk mund të futet në materialet e Sekretariatit e të Byrosë. Informacioni duhet të ndjekë rrugën e veçantë, kur paraqitet rasti,

qoftë me shkrim, kur është i rëndësishëm, qoftë gojariht, kur është më pak i rëndësishëm, por kurdoherë sekretari duhet të mendojë t'i shoshitë informacionet që jep, në ato që janë të nevojshme dhe të domosdoshme të informohen gjithë shokët sekretarë, ose një sekretar, ose s'është nevoja fare të informohen të tjerë.

7. Raportet që merr Sekretariati duhet t'u jepen për informacion, për të dhënë ndonjë këshillë, gjithë anëtarëve të Byrosë Politike po në ato data që u jepen sekretarëve.

8. Çdo sekretar, duhet të mendojë për problemet që ai do të këshillohet me mua, ose me një sekretar tjetër, ose me dy sekretarë së bashku. Ai duhet të mendojë për të raportuar tok unë zbatimin e vendimeve në praktikë të çështjeve kryesore, dhe këto shkurt, kryesoret, gjendjen, masat e marra dhe ato që do të merren.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# **TË PUNOJMË KURDOHERË PËR NGRITJEN E NIVELIT TË JETESËS SË FSHATARËSISË PUNONJËSE**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**20 maj 1964**

Kisha një këshillë për ju, shokë të Tropojës dhe të Dibrës: nuk duhet të harroni që rrethet tuaja janë kryesisht bujqësore. Kjo kërkon që pjesën më të madhe të kohës të preokupoheni për fshatin. Nuk dua të them se ju s'preokupoheni në këtë drejtim, por e kam fjalën që vëmendjen tuaj kryesore duhet ta drejtoni nga fshati.

Çështjet që studioni për fshatin kanë rëndësi të madhe, por të mbahet parasysh se për çdo gjë duhet të forcohet puna politike, ideologjike dhe ajo shtetërore.

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua mbi punën e komiteteve të Partisë të rretheve Dibër e Tropojë dhe të organizatave-bazë të kooperativave të konsumit për zbatimin e detyrave të Plenumit të Komitetit Qendror për fshatin.

Në qoftë se këto nuk përputhen me detyrat që shtrohen, atëherë diskreditohet direktiva e Partisë. Kështu detyrat që u shtruan nga Plenumi i Qershorit të vitit 1963 u pasuan edhe me masa shtetërore e shoqërore. Masat shoqërore janë të lidhura, në radhë të parë, me kooperativat e konsumit, të cilave nuk u lejohet të mos e realizojnë planin, përkundrazi, kur ka mundësi, ato duhet ta tejkalojnë atë. Mendoj se në Bashkimin Qendror të Kooperativave të Konsumit ka një punë rutinë dhe mungesa në organizimin e mirë të tregtisë. Ai duhet të tregojë kujdes jo vetëm për ta furnizuar fshatarësinë sipas shijes, por gjatë vitit dhe gjatë çdo tremujori të shikojë edhe mundësitë blerëse të cilitdo rreth, bile të çdo lokaliteti dhe jo të shkojë sipas ndarjes stereotipe të bërë më parë. Rrethi i Dibrës, për shembull, këtë vit ka pasur prodhime të mira bujqësore, kurse rrethi i Tropojës, jo. Në këtë rast, rrethi i Tropojës nuk duhet lënë pa furnizuar, por rrethi i Dibrës, që ka pasur prodhime më të mira bujqësore, duhet furnizuar me më shumë mallra, bile edhe mbi planin. Unë them se kjo ka mundësi të bëhet. Ne duhet të shikojmë edhe fuqinë blerëse të popullsisë. Nuk them që në rrethin e Tropojës të mos dërgojmë mallra të konsumit të gjerë, po të dërgojmë aq sa është fuqia blerëse dhe pjesën tjetër ta dërgojmë atje ku fuqia blerëse është më e madhe. Skrapari, për shembull, këtë vit mund të mos bëjë fare rrush, kurse planin e furnizimit ne e kemi bërë duke marrë parasysh që rrushi do të bëhet. Në këtë rast fuqia blerëse është më e vogël, prandaj mallrat e parashikuara duhet t'i lëvizim e t'i dërgojmë në ato vende ku prodhimi ka qenë më i madh. Kështu, duke u tre-

guar të zgjuar, zbatohen mirë edhe vendimet e Partisë dhe të Qeverisë.

Puna e Partisë do të ketë efekt atëherë kur ajo të shoqërohet edhe me masat e tjera që duhen marrë nga organet shtetërore. Në qoftë se ne flasim, për shembull, që të rregullohen dritaret në fshat, kjo duhet të shoqërohet edhe nga ana materiale, duke siguruar lëndën e drurit, xhamat, gozhdët etj., ndryshe çdo gjë është e kotë. Në qoftë se shtrojmë problemin që të fusim jetën e kulturuar në fshat, nuk është çështja për të numëruar pirunjtë dhe lugët, sepse edhe pa e thënë ju, ne e dimë që fshati ka nevojë për dhjetëra mijë pirunj, lugë, thika, krevatë dhe dyshekë. Prandaj nga organet shtetërore duhet të sigurohet realizimi i planeve në mënyrë ritmike, gjë që kërkon edhe punën politike dhe ideologjike të Partisë. Në qoftë se plani nuk realizohet, atëherë ku është efekti i punës ideopolitike të Partisë? Po të mendohet se «ne, njerëzit e Partisë, jemi vetëm për të bërë propagandë» kjo është e gabuar. Në këtë drejtim, ju sekretarët e komiteteve të Partisë keni për detyrë të bëni një propagandë dhe njëkohësisht të ndihmoni organet e pushtetit në rreth që të kryejnë si duhet detyrat e tyre. Edhe këta, që gjithashtu janë njerëz të Partisë, duhet t'i zbatojnë deri në fund të gjitha detyrat shtetërore.

Byroja e komitetit të Partisë në rreth është udhëheqja kolektive, që zbaton vendimet e Partisë dhe të Qeverisë. Drejtuesit e pushtetit dhe të ekonomisë janë përgjegjës për zbatimin e detyrave të tyre dhe, në radhë të parë, ata përgjigjen para Partisë, prandaj në kërki-



min e llogarisë të mos ketë lëshime, formalizëm dhe familjaritet.

Në përmirësimin e jetesës te ne janë arritur mjaft suksese. Partia dhe pushteti janë interesuar për këtë problem të rëndësishëm. Kjo është një kënaqësi e madhe, se vija e Partisë ka shkuar thellë edhe në fshatin më të largët dhe masat janë lidhur ngushtë me Partinë.

Në të ardhmen, puna për grumbullimin e prodhimeve dhe për furnizimin duhet të organizohet më mirë. Nuk duhet lejuar që në dyqanet e fshatit të mos ketë materiale ndërtimi. Po s'pati nga këto, atëherë ç'duhet të ketë atje? Po të jetë puna për beze, fshatari vjen edhe në qytet. Prandaj këto gjëra, ju, shokë të Bashkimit Qendror të Kooperativave të Konsumit, duhet t'i zgjidhni sa më parë. Këtu nuk është çështja për të zgjidhur vetëm nevojat e këtyre rretheve, por për të gjithë, sepse tani është sezoni i grumbullimit të prodhimeve. Leverdia duhet të jetë reciproke. Në qoftë se qytetarët kërkojnë nga fshatari, edhe ky ka plotësisht të drejtë të kërkojë ato që i duhen. Në tërë këtë punë, është e domosdoshme që sektori socialist i bujqësisë të shquhet në fushën e organizimit. Nuk është mirë që ndonjë ndërmarrje bujqësore të jetë më prapa nga sektori kooperativist. Ne shikojmë një gatishmëri të madhe nga fshatarësia për shlyerjen e detyrimeve dhe dorëzimin e tepricave, prandaj duhet t'i përgjigjemi më mirë furnizimit të saj me mallrat e konsumit të gjerë, për të cilat ajo ka nevojë. Për këto gjëra duhet të mendojnë jo vetëm qendra, por edhe rrethet. Me këtë nuk dua të them që ju, shokë të rretheve, të mos kërkonin nga qendra, por duhet që edhe në rreth puna të jetë më e or-

ganizuar. Për mallrat që janë caktuar në plan, ju duhet të kërkoni me insistim të madh që këto të realizohen.

Detyrat që ka shtruar Plenumi i Komitetit Qendror i Qershorit të vitit të kaluar janë të mëdha dhe të vazhdueshme. Ne gëzohemi për përparimet e mëdha që bëhen në fshat, po duhet të punojmë kurdoherë që ta përmirësojmë edhe më shumë jetesën në fshatin tonë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

**POPULLI KA NJË DASHURI TË MADHE PËR  
PARTINË — ARMIQTË E KLASËS LE TË  
TMERROHEN**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**20 maj 1964**

Mund të themi se te ne është krijuar një bashkëpunim shumë i mirë midis Ministrisë së Drejtësisë, Gjykatës së Lartë, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme. Një gjë e tillë ndodh se kuadrot tanë në këto institucione janë kuadro partie, kanë fituar një eksperiencë të madhe në punë dhe janë kualifikuar. Kjo është një siguri që në përgjithësi ligjet revolucionare në vendin tonë zbatohen drejt, pavarësisht se në gjykimin e kësaj ose asaj çështjeje mund të ketë edhe ndonjë gabim ose të metë dhe jo zbatim të njëlojtë të ligjeve nga ana e gjykatave. Ajo

---

<sup>1</sup> Një nga çështjet që u diskutua në këtë mbledhje ishte edhe ajo mbi gjendjen e krimeve kundër shtetit, të hetuara dhe të gjykuara në vitin 1963.

që ka rëndësi është se vendimet që merren nga gjykatat tona janë të drejta, se shokët përpiqen të jenë realistë dhe vendimet të kenë kurdoherë qëllim edukues.

Ka shumë rëndësi që lidhjet e organeve të diktaturës së proletariatit me Partinë të mos jenë formale. Në këtë drejtim ka përmirësime, po në të ardhmen kërkohet që këto lidhje të forcohen edhe më tepër. Nga ana e Partisë, nga gjykatat, prokuroria dhe shokët e Ministrisë së Punëve të Brendshme duhet të kihet parasysh se kuadrot që janë specialistë për çështje juridike nuk duhet të jenë vetëm teknikë, po të kenë edhe botëkuptimin e Partisë. Partia, nga ana e saj, duhet të punojë që ta mbështetë propagandën dhe agjitacionin e vet në vendimet dhe në konkluzionet e organeve të diktaturës. Plani që ka Partia për edukimin komunist duhet të koordinohet edhe me momentet e problemet kryesore që dalin nga vendimet e gjykatave dhe konkluzionet e prokurorisë. Për shembull, kur ngjet një krim dhe gjykohet ky akt, gjykatësit, si propagandistë dhe agjitorë të Partisë, dëgjojnë jo vetëm kriminelin që ndodhet në bankën e të akuzuarit, jo vetëm bashkëpunëtorët e tij, por edhe popullin. Prokurori, me fjalën e tij, është një propagandist i zjarrtë, që mbron interesat e popullit dhe vijën e Partisë. Fjala e prokurorit ka një jehonë të madhe.

Një çështje tjetër që del në materialin e paraqitur është se krime kundër shtetit bëjnë edhe njerëz të shtresave të varfëra. Kjo duhet ta preokupojë Partinë. Nuk është e thënë që nga shtresat e varfëra nuk mund të dalin njerëz të këqij, por në këtë drejtim duhet të shtojmë kujdesin e Partisë, që këta të jenë sa më pak.

Armiku mendon se po të vejë te kulaku, ky është i rrethuar nga populli, se atij nuk i besohet më etj., prandaj ai përpiqet të gjejë një njeri që mund t'i ecë fjala dhe, nga ana tjetër, kështu nuk i komprometohen edhe njerëzit e tij. Ne duhet të na preokupojë problemi që propagandën e Partisë ta bëjmë më efektive dhe konkrete, në mënyrë që armikut të mos i lëmë njerëz të shtresave të varfëra.

Të marrim çështjen e vrasjeve. Ne e pamë këtë problem për rrethin e Tiranës. Po ta krahasojmë gjendjen me të kaluarën, përmirësimet janë mjaft të mëdha në të gjithë vendin. Tani shikojmë rrethe, si Burreli e të tjera, ku më parë bëheshin shumë vrasje, tani s'ka më të tilla. Ky është një progres i madh. Këtu ne shohim një gjë pozitive: ligjet tona kanë hyrë kudo në masat e popullit, të cilat kanë besim në këto ligje dhe në vendimet e gjykatave tona. Kjo është një gjë shumë e mirë. Një gjë e tillë tregon se populli ka besim në mbrojtjen e interesave të tij nga ana e prokurorit.

Sigurisht, krime do të ketë, por puna është që këto të jenë sa më të kufizuara. Veprimtaria dhe propaganda e armikut janë të mëdha, por edhe vigjilenca dhe puna e Partisë është e madhe. Ministria e Punëve të Brendshme dhe Prokuroria duhet të jenë kurdoherë të kujdesshëm në punën e tyre. Fajtorin ta dënojmë sipas ligjit, duke provuar fajin e tij, kjo është një çështje e rëndësishme. Nga ana tjetër, kur gjykata shpall vendimin, Partia në atë rreth, ku ka ndodhur ngjarja, duhet të gjejë format e propagandës së vet për ta shtruar çështjen, në mënyrë që të nxjerrë përpara opinionit publik veprimtarinë e armikut në drejtim të

krimit që është kryer. Këtë moment, në mos gabohem, sot Partia nuk e vlerëson sa duhet.

Të gjitha çështjet që u diskutuan këtu kërkojnë një kuptim të drejtë. Ju, shokë të organeve të diktaturës, duhet të keni gjithnjë një bashkëpunim të ngushtë me njëri-tjetrin. Po kështu, bashkëpunim të mirë të keni me Partinë, në të gjithë punën tuaj, sipas rregullave që janë caktuar.

Ne nuk diskutojmë sot çështjen e vjedhjeve dhe të grabitjeve, por, meqë jemi këtu, doja të thosha se krahas armiqve që veprojnë kundër Partisë dhe shtetit, të mos harrohen vjedhësit, pse në këtë çështje armiku vepron për të komprometuar njerëz, prandaj të shtojmë vigjilencën ndaj vjedhësve. Duke qenë të edukuar me frymën e Partisë, ju duhet të shikoni se ku është rrezikshmëria më e madhe.

Mendoj se analizat që bëhen nga organet e diktaturës të ne janë të mira. Këto duhet të bëhen herë pas here edhe në të ardhmen, të nxirren detyra e konkluzione dhe të merren masa për të përmirësuar vazhdimisht punën. Është shumë inkurajues fakti që populli ka një dashuri të madhe për Partinë dhe pushtetin popullor, për këtë armiqtë e klasës le të tmerrohen!

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## TË PËRGATITIM NË MASË KUADRO TË MESËM

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

20 maj 1964

Edhe unë doja të thosha pak fjalë. Këtu kemi të bëjmë me dy çështje, që kanë lidhje me zbatimin e dy vendimeve të fundit të Byrosë Politike: çështja e lëvizjes së popullsisë nga fshati në qytet dhe ajo e përgatitjes së specialistëve. Duke parë këto dy rrethe, si dhe informacionet që kemi nga Durrësi dhe Elbasani, del se direktivat e Byrosë Politike për këto probleme po zbatohen mirë. Megjithatë disa çështje duhet t'i shohim më seriozisht.

Në radhë të parë është çështja e lehtësimit të qyteteve nga punëtorët e thjeshtë, që kanë ardhur nga fshati dhe që mund të zëvendësohen me forcat e lira të qytetit. Në këtë drejtim kohët e fundit qyteti i Tiranës

---

1 Një çështje tjetër që u diskutua në këtë mbledhje ishte edhe ajo mbi punën e organizatës së Partisë në qytetin e Tiranës dhe në rrethin e Gjirokastrës për përgatitjen e specialistëve të ndërtimit.

po bën një punë të mirë. Ajo që na gëzon më tepër është sidomos zëvendësimi me shoqe i atyre që largohen për në fshat, kështu do të kemi përfitime të mëdha. Këtë punë të mirë që keni filluar ju, shokë të Tiranës, duhet ta vazhdoni më tej.

Në kryeqytet dhe në disa rrethe ka mundësi që fuqia punëtore të sigurohet me forcat e lira të qytetit, pa tërhequr forca nga fshati. Por kjo s'do të thotë se qyteti nuk do të marrë punëtorë nga fshati, një gjë e tillë duhet bërë e organizuar mirë dhe sipas një plani. Në këtë rast punëtorët që do të tërhiqen nga fshati duhet të mbahen me pasaportizim të përkohshëm dhe familjet e tyre të qëndrojnë në fshat, duke zbatuar rregullat e caktuara. Ky pasaportizim provizor mund të jetë për tre vjet dhe në kurrë nuk duhet t'i krijojmë vetes probleme që të gjithë njerëzit e tyre të shpërngulen nga fshati dhe të vijnë në qytet.

Midis atyre që vijnë me pasaportizim të përkohshëm në qytete do të ketë edhe nga ata që do të bëhen specialistë, të cilët mund të qëndrojnë edhe në qytet, sepse për ta kemi nevojë. Po ta shikojmë drejt këtë çështje, në bazë të kriterëve të caktuara, atëherë këta njerëz duhet t'i zgjedhim, duke marrë vetëm djem të rinj. Pas ca kohësh mundet që ky djalë të martohet në qytet ose të sjellë bashkëshorten nga fshati dhe shteti ka detyrim t'i sigurojë strehim sipas rregullave. Po të jetë se këta punëtorë, me moshë të re, që bëhen specialistë, do t'i zgjedhim drejt dhe me kujdes, atëherë nuk do t'u themi pas 3-4 vjetëve «merr plaçkat e shko në fshat». Në qoftë se specialisti që kemi përgatitur pretendon që ka edhe pjesëtarë të tjerë të familjes në fshat,



të cilët do t'i sjellë në qytet, ne i themi që ata të qëndrojnë atje ku janë. Ai mund t'u dërgojë atyre një pjesë të të ardhurave të veta, kurse për t'i hequr nga fshati, duke krijuar vështirësi për pushtetin, kur një gjë e tillë nuk është e nevojshme, kjo nuk është e drejtë. Ata duhet të punojnë në fshat dhe nuk është nevojja të vijnë në qytet. Kështu, edhe patriarkalizmi zhduket në rrugë të drejtë.

Pra, punëtorët e thjeshtë mund t'i sigurojmë nga qyteti dhe nga fshati. Problemi është për specialistët. Ne nuk mund të themi se organizatat e Partisë në Tiranë, në Gjirokastër ose gjetkë s'bëjnë përpjekje për të mësuar njerëz në shkollat e kurset që kemi. Por a plotësohen kontingjentet? Jo, nuk plotësohen. Po pse? Sepse problemi nuk mund dhe nuk duhet zgjidhur me anë të mobilizimit, por me bindje, me dëshirë. Po si do të bëhet atëherë? Ky është një problem mjaft i madh, por jo i pazgjidhshëm.

Neve do të na duhen jo pak specialistë për të punuar në shumë drejtime. Këta duhet t'i përgatitim për të plotësuar jo vetëm nevojat e ndërmarrjeve nacionale, por edhe nevojat e komunales, të artizanatit, kërkesat e të gjithë popullit. Po t'u hedhim një sy nevojave që kemi për specialistë sot dhe në të ardhmen, do të arrijmë në përfundim se duhet të shikojmë metodën e përgatitjes së tyre. Një gjë e tillë duhet shikuar në drejtim që të përgatitim në masë kuadro të mesëm për industrinë, bujqësinë dhe ndërtimin. Prandaj të organizojmë drejt punën dhe të kthejmë sytë nga arsimit teknik.

Shkollat teknike, të bujqësisë dhe shkollat e rezer-

vave që kemi, janë në baza të shëndosha, por mua më duket se nuk mjaftojnë, sepse na duhen armata të tëra specialistësh. Në këto kushte nuk është e lejueshme që të mos plotësohet kontingjenti i këtyre shkollave dhe kurseve. Pavarësisht se Ministria e Ndërtimit nuk ka kontroll se ku ndodhen specialistët që kanë përgatitur shkollat përkatëse, dihet se këta specialistë nuk kanë humbur, por, siç u tha këtu, kanë vajtur e ndërtojnë në fshat, ose punojnë në komunale. Krahas sigurimit të specialistëve për ndërtimin e fabrikave dhe të apartamenteve, duhet të shikojmë po aq seriozisht edhe çështjen e mirëmbajtjes së godinave që ndërtojmë. Për këtë qëllim mund të na duhen edhe shumë më tepër specialistë nga ata që ndërtojnë. Mirëmbajtja e ndërtesave është një problem i madh, ku nuk mund të ecet me ato forca që kemi. Në këtë drejtim na duhen mijëra specialistë.

Jeta ka edhe nevoja të tjera, kështu, na duhen specialistë për furra, soba etj. Mijëra specialistë të tjerë na duhen për bujqësinë. Pra, specialistë do të kërkohen nga çdo anë. Por a mjafton ky sistem shkollor për nevojat që kemi? Jo. Kohët e fundit ne kemi vendosur që në shkollat tona të fusim edhe mësimin e punës. Ne gjithashtu duhet të krijojmë një rrjet shkollash të mesme me profil teknik e bujqësor se na duhen kuadro të mesëm shumë më tepër sesa kuadro të lartë.

Në kooperativat bujqësore ka tendencë të kërkojnë shkolla të mesme dhe të tilla janë hapur. Ne kemi vendosur arsimin 8-vjeçar të detyruar dhe shumë prej atyre që do të mbarojnë këto shkolla do të duan të vazhdojnë shkollat e mesme, por një pjesë e atyre që mbarojnë shkollën 8-vjeçare duhet të vazhdojnë një

shkollë bujqësore. Po në të gjitha fshatrat do ta bëjmë një gjë të tillë? Këtë duhet ta studiojmë. Ka mundësi që, në disa fshatra, ku është krijuar njëfarë tradite në një punë, si për shembull në Gollobordë ose Panarit, të krijojmë një ose dy shkolla për muratorë, ku të vazhdojnë shkollën një deri në dy vjet nxënësit që mbarojnë arsimin 8-vjeçar. Në disa rrethe të përpiqemi që këta specialistë t'i përgatitim ku me kurse e ku me mënyra të tjera. Një pjesë të fëmijëve që kanë prirje, mundet që shteti t'i dërgojë në shkollën e mesme me bursë, kurse të tjerët, që i kanë mundësitë, mund të vazhdojnë shkollën me shpenzimet e tyre.

Të vijmë në qytet. Puna praktike këtu nuk bëhet si duhet, sepse nuk ka mundësi që nxënësit të dërgohen në të gjitha ndërmarrjet, po shkojnë vetëm atje ku ka mundësi. Prandaj në qytet mund të krijohen disa shkolla të tilla ku pas 8-vjeçares fëmijët të specializohen dy vjet dhe të dalin elektrikistë ose specialistë të degëve të tjera, për të cilat ka nevojë ekonomia jonë në përgjithësi.

Të rinjtë që mbarojnë këto shkolla dyvjeçare profesionale mund të mos dinë mirë gjeografinë ose historinë, por ata do të dinë zanatin për të cilin përgatiten. Kështu, këto shkolla duhet t'i ndërtojmë jo mbi bazën e një programi të gjerë kulturor, po me një program të reduktuar kulturor, sepse do të kenë lëndë teknike, në mënyrë që kush të mbarojë këto shkolla, të jetë teknik. Kjo çështje është për t'u studiuar. Sot ne duhet të vazhdojmë me këto forma që kemi, por, sipas mendimit tim, ky është një problem i madh, sepse

në rininë tonë, në radhë të parë, duhet të hyjë dëshira për teknikën.

Natyrisht, për përgatitjen e teknikëve të rinj duhet parë gjithashtu edhe ana financiare, proporcioni i tyre, numri etj. Kjo nuk pengon format dhe ligjet që kemi tani. Këto do t'i kemi edhe në të ardhmen, bile mund edhe t'i shtojmë e t'i forcojmë. Në qoftë se ngrihet çështja nëse mund të hyjnë ose jo në universitet ata që mbarojnë këto shkolla një ose dyvjeçare profesionale, është e qartë se do të jepet shpjegimi që nuk mund të pranohen në universitet pa mbaruar shkollën e mesme. Ai që mbaron një shkollë dyvjeçare, pasi ka kryer 8-vjeçaren, ka fituar një specialitet.

Edhe në ushtri duhet punuar në mënyrë të tillë që të gjithë ta kuptojnë se ushtarët që mësojnë për shoferë ose mekanikë, përgatiten vetëm për ushtrinë dhe jo me të mbaruar shërbimin ushtarak të venë në terren e të thonë që duam të jemi shoferë, po të shkojnë e të punojnë në bujqësi, ku kanë qenë edhe më parë. Prandaj ushtarëve u duhet thënë se, kur të mbarojnë shërbimin ushtarak, nuk do të kërkojnë të punojnë si shoferë ose mekanikë në sektorë të ndryshëm, përveç rasteve kur ka nevojë shteti. Në rast se ka mundësi, ai që çmobilizohet nga ushtria mund të mësojë edhe një zanat të dytë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## TË ORGANIZOJMË MË MIRË STUDIMET SHKENCORE PËR NAFTËN

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**21 maj 1964**

Çështjet që ngriti shoku Haki [Toska] janë shumë të drejta, por dëshiroj të them edhe unë pak fjalë, të cilat mund të kihen parasysh në të ardhmen.

Problemi i naftës është mjaft i komplikuar, prandaj më duket se ka ardhur koha që çështjen e studimeve për këtë pasuri të madhe ta konkretizojmë më mirë. Është e vërtetë se tani bëhet njëfarë pune studimore, përgjithësohen shumë çështje, por mendoj se perspektivën e naftës, që është një problem kaq i madh, duhet ta qartësojmë. Shokët tanë specialistë, të cilët kanë tani një kapacitet shkencor për naftën, duhet t'i përqendrojnë aftësitë e tyre shkencore pikërisht në

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua mbi punën kërkimore të specialistëve të naftës për zhvillimin e fushave të reja naftëgaz-mbajtëse.

drejtim të studimit, që është bazë, domethënë të zbulojnë se ku është nafta, si është, dhe pastaj të nxjerrin konkluzione. Është fakt se specialistët tanë luftojnë dhe bëjnë përpjekje të mëdha, por duhet thënë se këta merren edhe me shumë çështje të vogla, të cilat duhet t'i bëjnë njerëzit e tjerë, që nuk janë specialistë. Këtu është puna si me kirurgun e aftë, që ka një eksperiencë të madhe, por që nuk mund t'i bëjë vetë të gjitha operacionet pa ndihmën e mjekëve të rinj, të cilëve t'u qëndrojnë mbi kokë dhe t'u hapë perspektivë e t'i ndihmojë të bëjnë operacione të mira. Kështu edhe specialistët e kualifikuar të industrisë së naftës, duhet të merren vetë me çështje të dorës së parë dhe njëkohësisht të drejtojnë të tjerët që puna të na japë rendimentin e duhur. Prandaj ne duhet të kërkojmë nga institutet e larta studime për çështjen e naftës, duke tërhequr edhe bashkëpunëtorë të tjerë, për t'i shpënë këto studime gjer në fund. Çështja është që studimet të konkretizohen bashkërisht në hollësitë më të mëdha. Gjithashtu nuk është fjala për të krijuar një bibliotekë teknike, ku njerëzit të vijnë e të studiojnë, dhe atje të gjejnë një njeri me të cilin të këshillohen, por kjo bibliotekë duhet të shërbejë për studime. Çështjen e studimeve shkencore të naftës mendoj se duhet ta organizojmë më mirë. Ne i japim sot sektorit të naftës mjaft inxhinierë, prandaj duhet që shokët e vjetër të bëjnë një punë më të kualifikuar dhe jo të shkojnë pus më pus. Natyrisht këta do të venë në puse, po kjo për qëllime studimi e prodhimi.

Mendoj që specialistët duhet të punojnë për të përcaktuar jo vetëm rezervat e naftës për pesëvjeçarin e

ardhshëm, por edhe për perspektivën. Te ne nuk shtrohet çështja që të kemi rezerva për një ose dy pesëvjeçarë, por zbulimi i rezervave për një perspektivë më të largët. Duke caktuar planin pesëvjeçar për shfrytëzimin e naftës, ne duhet t'i vëmë rëndësi të madhe punës kërkimore. Ka ardhur koha që çështjes së shpim-kërkimeve, në pesëvjeçarin e ardhshëm, t'i japim një rëndësi shumë më të madhe se deri sot. Për të bërë këtë, mendoj se duhen tri gjëra: sonda e makineri të tjera, studime shkencore dhe kuadro.

Këto gjëra kisha për perspektivën. Ju, shokë drejtues të naftës, duhet të luftoni për t'i eliminuar të metat që u thanë. Me siguri, plani i këtij viti në naftë do të realizohet dhe do të tejkalohet. Ju urojmë suksese në punën tuaj!

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

**PARTIA I DHA POPULLIT PUSHTETIN E TIJ  
DHE E UDHËHEQ NË RRUGËN  
E SOCIALIZMIT**

*Fjala e mbajtur në mbledhjen përkujtimore në  
sallën muze të Kongresit të Përmetit*

**24 maj 1964**

Të dashur shokë dhe shoqe, ish-delegatë në Kongresin e Përmetit,

Po e hap këtë mbledhje të shkurtër përkujtimore, të organizuar me rastin e 20-vjetorit të Kongresit historik të Përmetit. Në këto çaste zemrat tona, zemrat e të gjithë popullit shqiptar, gufojnë nga një gëzim i papërsHKruar dhe nga një besnikëri e pafund për Partinë tonë të lavdishme, që e udhëhoqi popullin nëpërmjet kaq furtunave të mëdha dhe e nxori në dritë, i dha popullit tonë të shumëvuajtur, heroik dhe të lavdishëm lirinë, pavarësinë, i dha në duar pushtetin, e udhëhoqi dhe e udhëheq atë në rrugën e ndritur të socializmit. Për Partinë tonë, që ka qenë, është dhe do të jetë truri dhe zemra e popullit shqiptar, për këtë Parti rreh sot dhe do të rrahë përgjithmonë zemra e gjithë popullit.



Ne u betohemi Partisë dhe popullit tonë se si kurdoherë do të jemi besnikë të tyre, se do të zbatojmë deri në fund dhe, po të jetë nevoja, deri në pikën e fundit të gjakut, udhëzimet e Partisë, urdhrat e saj, urdhrat e popullit, do të realizojmë dëshirat e saj, dëshirat e popullit, ashtu siç kemi bërë vazhdimisht.

Shokë,

Sot, me rastin e përvjetorit të kësaj ngjarjeje të madhe historike, ju ftoj të nderojmë kujtimin e gjyshërve dhe të stërgjyshërve tanë, që luftuan dhe ranë për t'i dhënë popullit pavarësinë, të nderojmë kujtimin e trimave të lavdishëm partizanë — dëshmorë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që, nën udhëheqjen e Partisë, bënë fli jetën e tyre për të mirën dhe të ardhmen e lulëzuar të popullit shqiptar; të nderojmë kujtimin e luftëtarëve të Ushtrisë Popullore dhe të rojeve heroike të kufirit që, nga Çlirimi e këtej, ranë dëshmorë duke mbrojtur jetën dhe punën paqësore të popullit tonë, kufijtë e shenjtë të atdheut kundër provokacioneve të panumërta të armiqve të jashtëm, titistëve jugosllavë, monarko-fashistëve grekë dhe neofashistëve italianë; të nderojmë kujtimin e heronjve të heshtur të Armës së Sigurimit të Shtetit, që tërë jetën e tyre janë përleshur dhe përleshën me armiqtë e klasës, me diversantët dhe agjentët e imperializmit të hedhur në vendin tonë nga toka, nga ajri dhe nga deti, për të rrezikuar pavarësinë e atdheut; të kujtojmë me nderim shokët tanë ish-delegatë të Kongresit të Përmetit, që dhanë jetën në krye të detyrës.

*Të pranishmit ngrihen në këmbë dhe qëndrojnë në heshtje.*

Lavdi të përjetshme dëshmorëve të popullit!

Me këtë rast dëshiroj gjithashtu t'ju transmetoj falënderimet dhe urimet më të nxehta revolucionare të Komitetit Qendror të Partisë, të Këshillit të Ministrave, të Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe të Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik, si edhe përshëndetjet e të gjithë Partisë, juve, shokë dhe shoqe të dashura, që keni punuar dhe punoni pa u lodhur për popullin dhe socializmin, që keni qëndruar, qëndroni dhe do të qëndroni kurdoherë konsekuentë në vijën e lavdishme marksiste-leniniste të Partisë! Njëzet vjet kaluan, shumë vetave prej nesh u janë zbardhur flokët, por megjithatë unë shoh se ne të gjithë jemi si kurdoherë të rinj.

Të rrojë Partia e Punës e Shqipërisë!

Të rrojë populli ynë i mrekullueshëm!

Me kaq, shokë, e mbyll këtë mbledhje përkujtimore.

Nga mot gëzuar!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**VENDIMET HISTORIKE TË KONGRESIT TË  
PËRMETIT DOLËN NGA GRYKA  
E PUSHKËS PARTIZANE**

*Fjala në pritjen e dhënë në Përmet me rastin e  
20-vjetorit të Kongresit të Parë Antifashist  
Nacionalçlirimtar*

**24 maj 1964**

Të dashur shokë e shoqe, ish-delegatë të Kongresit të Përmetit, të dashur miq dhe mysafirë,

Ju falënderoj në emër të Komitetit Qendror të Partisë, të Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe të Këshillit të Ministrave të RPSH për pjesëmarrjen tuaj në këtë pritje.

Shoku sekretar i parë i Komitetit të Partisë, shoku kryetar i komitetit ekzekutiv, ju falënderoj nga zemra në emër të ish-delegatëve të Kongresit të Përmetit e me këtë rast përshëndes gjithashtu popullin heroik të rrethit të Përmetit, të qytetit dhe të fshatrave, për mikpritjen e tij dhe për patriotizmin e madh që ka tre-guar gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare duke bërë sakrifica të mëdha dhe që, si dje në kohë lufte,

edhe tani lufton po me aq heroizëm për ndërtimin e socializmit.

Të dashur shokë,

Të flasësh për rëndësinë historike të Kongresit të Përmetit duhet të flasësh për luftën e popullit shqiptar, pasi ky Kongres ka qenë pjesë përbërëse e saj, kyç i Luftës së lavdishme Antifashiste Nacionalçlirimtare. Populli ynë, gjatë historisë së tij shekullore, ka bërë vazhdimisht luftëra të drejta, por Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, e cila ka qenë vazhdimi i tyre, ishte më e madhja dhe më e përgjakshmja, më e lavdishmja dhe më e koklavitura.

Burra të shquar ka lindur toka jonë, të pushkës dhe të pendës, populli ka nxjerrë luftëtarë dhe strategë, dijetarë, filozofë dhe politikanë, në gjirin e të cilëve ziente fryma revolucionare dhe që përpiqeshin me të gjitha mjetet të çlironin atdheun nga hordhitë e panurmërta të armiqve të jashtëm dhe të brendshëm. Këta njerëz, të dalë nga populli, luftuan tok me popullin, e çuan këtë në fitore, shumë herë pësuan disfatë, por populli kurrë s'u gjunjëzua. Ai, pas çdo disfate, ngrihej përsëri, prapë luftonte, gjakosej, digjej e kështu vazhdimisht.

Kohët ishin të vështira. Populli dhe njerëzit e tij besnikë që e çonin në kryengritje, përpiqeshin të gjenin miq jashtë për t'i përkrahur, përpiqeshin të krijonin aleanca në favor të çështjes së Shqipërisë. Por krerët e imperializmit botëror, qeveritë e shteteve të mëdha borgjeze, në aleancë me feudalët dhe me satrapët

e vendit tonë, ua shkatërronin këto përpjekje popullit dhe njerëzve përparimtarë që e udhëhiqnin atë. Imperialistët e kanë pasë konsideruar Shqipërinë vazhdimisht si një leckë, gjaku i shqiptarëve për ta s'kishte asnjë vlerë. Shqipëria për ta ishte një monedhë shkëmbimi. Kur lindte ndonjë rreze drite pas luftërave të përgjakshme, armiqtë e brendshëm, të lidhur me armiqtë e jashtëm, bënë një mijë e një dallavere në kurriz të popullit, shkelnin gjakun e tij, eshtrat e luftëtarëve. Ata i rrëmbenin popullit fitoren dhe me përbuzje i thonin: merr kërrabën e gunën dhe shko ruaj lopët, se shtetin e drejtojmë ne, për Shqipërinë mendojmë ne, se ne e kemi në gjak të komandojmë, të drejtojmë, të bëjmë politikën me kralët. Të tillë ishin feudalët dhe borgjezia e degjeneruar e vendit tonë.

Në këto rrethana të vështira populli nuk arrinte dot të krijonte një udhëheqje të vërtetë të tij, konsekuente dhe monolite. Për këtë arsye ai s'e fitoi dot pavarësinë e vërtetë, por nga vuajtjet, nga mjerimet, nga luftërat që bëri, ai fitoi një eksperiencë të pakufishme. Mizoritë dhe tradhtitë që u kryen në kurriz të tij, iu bënë popullit mësim. Prandaj populli dhe bijtë e tij thonin me bindje të plotë se do të vijë dita kur do të lachen hesapet me të gjithë armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm.

Mospërkulja, heroizmi dhe durimi kanë qenë kurdoherë veti të mëdha të popullit shqiptar. Populli ynë këtë eksperiencë të madhe e tregoi në Luftën e lavdishme Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe atë udhëheqje që ai ëndërronte, e krijoi vetë në zjarrin e kësaj lufte. Ai krijoi Partinë e tij heroike Komuniste Shqiptare, e

cila diti që gjithë këtë eksperiencë të popullit tonë ta grumbullonte dhe ta vinte në jetë si duhet.

Ne e kemi zakon dhe shpesh themi se Partia jonë ishte e re aso kohe nga mosha; ashtu ishte. Por në të njëjtën kohë ajo ishte e vjetër nga eksperiencia, se komunistët shqiptarë ishin bijtë e këtij populli të vuajtur, stërnipërit e Skënderbeut, stërnipërit e Frashërellinjve, stërnipërit e mijëra heronjve. Meritat nuk presin pleqërinë që të afirmohen. Kjo ngjau me Partinë tonë, pasi ajo ishte një parti marksiste-leniniste, që u lind në luftë, që u kalit në luftë, që përvetësoi ideologjinë marksiste-leniniste dhe mori përsipër barrën e rëndë dhe të lavdishme të udhëhiqte revolucionin.

Ne, komunistët e parë, nuk kishim dijeni të plota mbi teorinë marksiste-leniniste, por parimet e saj kryesore i dinim, ato i zhvilluam më tej, dhe sidomos nuk i harruam kurrë. Fakti është se komunistët shqiptarë dhe i gjithë populli ynë, luftëtar, në luftë, në punë, në përpjekje zbatuan me konsekuencë teorinë marksiste-leniniste. Fjala e Partisë sonë u bë flamur për popullin dhe ai e zbatoi në mënyrë të mahnitshme, sikur të kishte bërë një shkollë marksiste-leniniste. Kjo nuk duhet të na habitë, sepse vetë themeluesit e teorisë sonë të madhe, Marksisi, Engelsi, Lenini dhe Stalini, mësues patën popullin. Këta, eksperiencën e popujve, eksperiencën luftarake dhe revolucionare të proletariatit dhe të fshatarësisë, e ngritën në shkencë për drejtim, për veprim, për revolucion, për socializëm. Për këtë arsye Partia jonë e re, e armatosur me eksperiencën e madhe revolucionare të popullit tonë dhe e udhëhequr

nga teoria e pavdekshme e marksizëm-leninizmit, diti të brumosë të ardhmen e ndritur të Shqipërisë.

Por në të njëjtën kohë duhet të themi se një gjë e tillë nuk u arrit aq lehtë, se për këtë duheshin përpjekje, se lufta ishte e vështirë. Partia që në fillim u mendua fort dhe, kur e filloi luftën, veproi me vendosmëri, sipas mësimëve të marksizëm-leninizmit se, po e fillove revolucionin, duhet ta çosh deri në fund pa u ndalur, se po u ndale në rrugë, të pret disfata dhe dëmtove popullin. Këtë ndjenjë të lartë përgjegjësie për fatet e popullit tonë Partia e kishte parasysh që në hapat e parë. Ajo e dinte se do të kornte fitore, se do të kishte edhe disfata, por ishte e bindur se, në fund të fundit, fitorja do të ishte e popullit. Partia ishte e bindur se fjalën e saj populli do ta dëgjonte dhe do ta bënte flamur, sikundër e bëri.

Po shkohej në luftën më të vështirë kundër armiqve, nga më të egrit që kishte parë njerëzimi, prandaj Partia i peshoi mirë këto situata të rënda, mori parasysh rrethanat, forcat e brendshme e ato ndërkombëtare. Partia e kishte të qartë ku ishte baza e vërtetë e saj, në cilat shtresa të popullit duhej të mbështetej dhe kundër kujt duhej të luftonte. Partia mati dhe kishte kurdoherë parasysh forcat e mëdha të armikut që duhej t'u bënte ballë, kishte parasysh intrigat e tradhtarëve të vendit dhe aleancat që ata do të kurdisnin me okupatorët. Eksperienca e madhe e së kaluarës së popullit tonë, siç e thashë më parë, ishte për Partinë një thesar i madh. Partia në këtë luftë të madhe, për jetë a për vdekje, kishte gjithashtu të qartë cilët ishin aleatët e vërtetë të jashtëm të popullit të saj. Ajo, pra, që në

ditët e para të lindjes së saj, shtroi çështjen e luftës së armatosur dhe kjo luftë duhej të kombinohej me luftën e madhe politike të saj, me luftën ideologjike. Këtë kombinim, shokë dhe vëllezër, të gjithë së toku e kemi jetuar dhe e kemi pasur parasysh.

Ç'na mësonte marksizmi kur filluam luftën? Ai na mësonte se populli, për të fituar lirinë, për të këputur zinxhirët e robërisë, duhej të ngrihej në revolucion, me pushkë në dorë, t'i godiste pa mëshirë imperialistët dhe të gjithë ata që bënin kauzë të përbashkët me ta. Këtë mësim të madh të teorisë marksiste-leniniste populli ynë e kishte mësuar gjatë shekujve, të diktuar nga jeta dhe me intuitë të madhe e kishte zbatuar gjatë gjithë historisë së tij. Populli ynë brez pas brezi ka luftuar me pushkë në dorë dhe u ka bërë ballë valëve të panumërta të okupatorëve të ndryshëm dhe tërë tradhtarëve dhe shtypësve që përpiqeshin të pengonin lëvizjet e tij patriotike, lëvizjet fshatare, lëvizjet përparimtare intelektuale. Pra, këtë mësim të madh të popullit, këtë mësim të revolucionit që na mëson Marksi, Partia jonë e vuri në jetë, duke dhënë kushtimin e luftës deri në shkatërrimin e plotë të pushtuesve fashistë dhe të tradhtarëve të vendit.

Përse luftonin gjyshërit dhe stërgjyshërit tanë? Për të fituar lirinë dhe pavarësinë dhe për të marrë pushtetin në duart e tyre. Ç'na mëson marksizëm-leninizmi? Çështja e marrjes së pushtetit është çështja vendimtare; të hidhemi në revolucion dhe populli të marrë pushtetin në dorë; popullit i përket të drejtojë fatin e vet; në ballë të kësaj lufte të jetë klasa punëtore dhe, në aleancë me fshatarësinë revolucionare, të udhë-



heqë revolucionin deri në fund. Prandaj gjëja e parë e Partisë sonë ishte kushtrimi për kryengritje të armatosur, për të fituar lirinë, për të marrë pushtetin dhe për të vendosur diktaturën e proletariatit. Kryengritja e armatosur buçiti në vendin tonë si vullkan.

Që në fillim ne, komunistët e parë, thamë se këtë luftë kaq të përgjakshme me fashistët italianë, me nazistët gjermanë dhe me tradhtarët, do ta çojmë në fitore vetëm në qoftë se krijojmë një parti me të vërtetë revolucionare marksiste-leniniste, një parti të masave, jo një parti sektare prej pesë ose njëzet vetash, por një parti të lidhur si mishi me thoin me popullin, një parti të fortë, të çeliktë, të pastër, të përbërë nga mijëra e mijëra kuadro që të ishin në gjendje të udhëhiqnin në të gjitha drejtimet me sukses këtë luftë të madhe. Partia që në fillim tha se kuadrot do të dalin në luftë e sipër, se kuadro të tillë besnikë të revolucionit i nxjerrin vetëm lufta, përpjekjet, sakrificat. Dhe Partia pati plotësisht të drejtë që eci në këtë rrugë.

Për Partinë tonë çështja e luftës ishte vendimtare dhe sikur të mos e kishte kuptuar kështu, sot populli do të rronte në robëri. Populli u ngrit i gjithë në luftë me armë në dorë, krijoi çetat, batalionet, brigadat, divizionet, korparmatat, krijoi Ushtrinë tonë të lavdishme Nacionalçlirimtare. Me sakrificat dhe me heroizmatë mëdha populli iu ngjit së përpjetës, një rrugë të vështirë, duke kapërcyer pengesa kolosale.

Pse u kapërcyen këto pengesa kolosale? Pse Partia nuk harroi për asnjë minutë çështje të tjera, ndër të cilat punën e madhe sqaruese politike. Partia i vuri vetes si detyrë që popullin shqiptar ta ngrinte lart politi-

kisht, ta bënte me të vërtetë të ndërgjegjshëm për ditët e rënda, por të lavdishme, që po kalonin Shqipëria dhe gjithë bota. Partia zhvilloi në popull një punë politike të shumanshme, të drejtë, i bëri atij të qartë kushtet që e rrethonin, i bëri të qartë kush ishte fashizmi, kush ishte nazizmi gjerman. Nga ana tjetër, Partia ngjalli në popull një dashuri të madhe për Bashkimin Sovjetik, i bëri të qartë se kush ishin Stalini dhe Partia e bolshevikëve, që themeloi Lenini. Ajo i tha popullit se tani Shqipëria nuk ishte më vetëm si në kohët e kaluara, por kishte miq dhe aleatë besnikë në të katër anët e botës. Ajo i tha popullit se në Evropë, në Azi, në Afrikë dhe në Amerikë ishin ngritur në luftë miliona e miliona njerëz si dhe ne; i tha se në Lindjen e Largme luftonte një popull kolos, populli kinez, i tha popullit se luftonin vëllezërit koreanë, vietnamezë; i tha se tok me ne, gjithashtu, luftonin popujt e robëruar të Evropës — të Francës, të Italisë, të Spanjës, të Anglisë, popujt e Amerikës etj. Partia i tha popullit njëkohësisht që, pavarësisht se miqtë tanë janë të fortë, liria fitohet me luftë dhe nuk dhurohet; miqtë do të jenë me ne, ata do të na ndihmojnë, por në radhë të parë ne duhet të luftojmë vetë. Kështu Partia me një sqarim të tillë politik, grumbulloi rreth saj të gjithë popullin, kaliti bashkimin e tij, bashkim që ishte vendimtar. Kjo detyrë u krye me sukses të madh.

Për të arritur këtë bashkim të çeliktë të popullit neve na është dashur të luftojmë jo vetëm kundër okupatorit, por dhe kundër armiqve të brendshëm, armiqve të përhershëm të popullit — feudalëve, bejlerëve, zogistëve, politikanëve të shitur e shumë njerëzve të

këtyre kallëpeve, të cilët asgjë s'kishin harruar nga e kaluara dhe asgjë s'kishin mësuar prej saj. Ata dinin vetëm një gjë, të shtypnin dhe të shfrytëzonin popullin, të shiteshin tek okupatorët e ndryshëm dhe t'u shërbenin atyre. Mbështetja e këtyre klasave armike ishin okupatorët; mbështetja e Partisë ishte populli. Megjithatë, Partia bëri një politikë të drejtë, që e kërkoi rasti dhe situatat e rënda, ajo u bëri thirrje të gjithë njerëzve me vullnet të mirë, me parullën e Frontit Nacionalçlirimtar: «Pa dallim feje, krahine dhe ideje, hidhuni në luftë kundër pushtuesve fashistë!». Partia e kishte të qartë se shumë nga të lëkundurit do të bindeshin, por do të kishte edhe nga ata që, tok me imperialistët fashistë italianë e gjermanë, do të organizonin luftën e egër kundër popullit. Partia i bëri llogaritë dhe u përpoq të evitonte vëllavrasjen. Por asaj nuk do t'i dridhej as dora as zemra që, pasi t'i kishte bërë të gjitha përpjekjet, t'u jepte dërmën tradhtarëve dhe armiqve të popullit dhe t'i shfaroste ata deri në fund, sikundër i shfarosi. Kjo ishte logjika e luftës, logjika e drejtë e luftës së klasës. Duhej bërë diferencimi, duhej ndarë shapi nga sheqeri. Dy rrugë kishte: o me popullin, o kundër popullit.

Partia nuk harroi për asnjë çast se, që të zbatohet drejt dhe si duhej kjo politikë e saj, nevojitej që, në radhë të parë, si komunistët ashtu dhe simpatizantët e komunizmit, të pajiseshin me ideologjinë marksiste-leniniste, se vetëm kështu ata do të orientoheshin drejt në situata të koklavitura, ashtu siç bënë, pasi vetëm kështu do të zbatonin mirë politikën e Partisë, ashtu siç e zbatuan. Komunistët iu përveshën punës në këtë

drejtim: luftonin nëpër male, nëpër gërxhe, në llogore dhe, kur mbaronte përpjekja, hapnin librat e Leninit, të Stalinit, librat e patriotëve tanë demokratë e revolucionarë, në të cilët djemtë dhe vajzat e popullit mësonin teorinë, i hapnin vetes horizonte të gjera, lidheshin me realitetin e popullit tonë, gërshetonin të kaluarën dhe të tanishmen me teorinë marksiste-leniniste. Të tillë njerëz që kaliti Partia — dhe këta ishin me mijëra dhe dhjetëra mijëra — qenë një faktor vendimtar i fitores sonë; ata u bënë siguria, kolona vertebrale e unitetit të çeliktë të Partisë dhe të popullit; ata ngritën lart patriotizmin, e bënë popullin të patrembur, i hapën atij sytë të vepronte me iniciativë të madhe, e bënë popullin të mos kishte mëshirë për okupatorët dhe për tradhtarët. Këta njerëz u bënë të dashur për popullin, sepse ata ishin të sigurtë dhe të drejtë me të. Të tillë punë bëri Partia, të tillë ishin komunistët. Kurrë nuk do të harrojë populli shqiptar, brez pas brezi, këtë vepër të madhe të Partisë sonë.

Ne, shokë, të tërë kemi qenë në luftë, të tërë i kemi kaluar ato ditë të vështira dhe ato ditë entuziazmi të madh, të tërë kemi ditur, se na mësonte Partia, si t'i konsolidonim fitoret tona hap pas hapi, me pjekuri, me gjakftohtësi, të mos vepronim si në dasëm, të mos na dehnin sukseset, të mos na rritej mendja, të ishim të thjeshtë si populli ynë, të kujdesshëm si populli ynë, të durueshëm dhe trima si populli ynë, sepse armiqtë ishin të egër, ata kishin vendosur të masakronin popuj të tërë, të zhduknin socializmin që ishte ndërtuar me sukses në Bashkimin Sovjetik, ata kërkonin ta kthenin botën pas, në errësirë. Por armiqtë nuk ia arritën dot

qëllimit, sepse në botë ishte Bashkimi Sovjetik, i udhëhequr nga Partia Bolshevike dhe nga Stalini i madh. Më kot Nikita Hrushovi, tradhtari më i ndyrë që ka parë lëvizja komuniste ndërkombëtare, përpiqet të njoftosë udhëheqësin e madh të luftës patriotike, nxënësin besnik të Leninit, mësuesin e të gjithë proletariatit, Stalinin e madh.

Historia e popullit tonë, marksizëm-leninizmi na mësuon që, në këtë Luftë të madhe Nacionalçlirimtare, në këtë luftë të madhe botërore kundër fashizmit, duhet të kishim besim në aleancën antifashiste anglo-sovjeto-amerikane, por njëkohësisht duhej t'i kishim sytë kurdoherë hapur. Populli shqiptar kishte vuajtur shumë në të kaluarën e largët e të afërt nga intrigat e imperializmit amerikan, anglez, italian etj. E thashë edhe më lart se patriotët e mëdhenj të vendit tonë ishin përpjekur të ndërtonin aleancën me vendet e tjera, por shpresat e tyre u venitën dhe historia ka treguar një gjë, që s'mund të ishte ndryshe, se fuqitë e mëdha imperialiste kanë dashur, dhe i kanë bërë kurdoherë varrin Shqipërisë. Këtë ne, komunistët shqiptarë, nuk e harrojmë kurrë dhe e kishim mirë parasysht. Prandaj në aleancën e madhe antifashiste ne duhet të kishim besim, por njëkohësisht të ishim shumë vigjilentë kundër intrigave të imperialistëve amerikano-anglezë.

Ju e dini, shokë, se në kohën e luftës Partia ka kritikuar shokë, që tregoheshin sektarë dhe flisnin kundër kësaj aleance. Këtë gjë Partia e bënte duke u nisur nga vija e saj e drejtë; ajo i mësoi njerëzit që luftën e popullit tonë të mos e izolonin nga lufta e Bash-

kimit Sovjetik, me të cilën e gërshetuam luftën tonë deri në fund, por as nga lufta që bënëin popujt e Anglisë dhe të Amerikës; ajo i mësoi njerëzit që, krahas kësaj, të hapnin sytë ndaj qeverive të vendeve imperialiste, të cilat ëndërronin që në çastin e volitshëm për to, t'i hidhnin Shqipërisë lakun në grykë. Partia, pra, kurrrë s'e harroi historinë e popullit tonë, ajo e pati mirë parasysh atë dhe mësimet e jetës i lidhi me teorinë.

Ju e dini se në kohën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare erdhën në vendin tonë disa grupe oficerësh anglezë. Në fillim ata erdhën pa ftuar, nëpërmjet kufirit. Partizanët, komisarët dhe komandantët e një-sive tona, që Partia i kishte mësuar të ishin vigjilentë si shqiponja, lajmëruan menjëherë Këshillin e Përgjithshëm për hyrjen e misionit anglez ilegalisht në Shqipëri. Atëherë Komiteti Qendror i PKSH nëpërmjet Këshillit të Përgjithshëm dha urdhër që ky mision të bllokohej në një fshat të Jugut e të mos bënte këmbë më tutje në zonat e partizanëve. Dëshironim t'u mësonim aleatëve anglezë se këtu në Shqipëri udhëhiqte Partia Komuniste, se nuk ishte më koha e parë, se Shqipëria nuk ishte me dy porta ku ata mund të hynin dhe të dilnin si të donin. Vendi kishte zot popullin. Partia, duke pasur besim te populli dhe te luftëtarët, mendoi se vija e aleancës duhej ruajtur, por këta intrigantë që vinin si «miq» për të organizuar komplotin e shkatërrimit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, duheshin bllokuar me veprime të tilla. Drejtësia e këtij qëndrimi të Partisë u vërtetua: ata që kishin ardhur gjoja për të na ndihmuar, ndonëse, siç dihet, ndihmat e tyre ishin qesharake, kishin për qëllim të infiltroheshin në Ush-

trinë Nacionalçlirimtare për të sabotuar shpirtin luftarak dhe unitetin e saj. Duke parë se ata dështuan që në fillim në këtë veprimtari minuese, oficerë të tjerë anglezë kaluan në radhët e armiqve, në radhët e «Ballit Kombëtar», të «Legalitetit» etj.

Përse vajtën ata në radhët e tradhtarëve të popullit tonë që luftonin kundër Ushtrisë Nacionalçlirimtare? Është e kuptueshme se ata ishin aleatët e tyre. Ata vajtën të organizonin dhe të forconin reaksionin shqiptar, t'i armatosnin forcat e tyre, t'i ndërsonin akoma më shumë në luftë kundër Partisë dhe Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Por qëllimet e tyre ishin akoma më të gjera. Reaksioni anglez, duke forcuar reaksionin shqiptar që bashkëpunonte me gjermanët, dëshironte dhe mendonte t'i kishte këto forca për momentet vendimtare pasi gjatë kësaj kohe këta «aleatë» përpiqeshin të krijonin në Londër një qeveri reaksionare shqiptare në mërgim. Por Partia ua zbuloi kartërat dhe ua prishi planet. Partia zbuloi agjenturën e Inteligens Servisit në radhët e Frontit Nacionalçlirimtar dhe e pastroi atë. Atëherë oficerët anglezë, si e panë pisk, organizuan mbledhje me zogistët, mbledhje e cila kishte për qëllim të përgatiste ardhjen e Zogut në Shqipëri. Por edhe këto plane Partia jonë ua bëri shkrumb e hi. Megjithatë, imperialistët anglo-amerikanë s'i hodhën armët dhe, duke parë se lufta e popullit shqiptar po ngjitej, u përpoqën me çdo kusht të vepronin në dëm të saj.

Agjentura e tyre në Shqipëri kishte njoftim se po organizohej Kongresi në Përmet dhe për këtë qëllim imperialistët anglezë bënë çmos ta sabotonin atë deri

në ditën e hapjes së tij. Por përpjekjet e tyre vajtën kot, Partia që vigjilonte, e likuidoi me sukses dhe pa vësh-tirësi veprimtarinë e tyre minuese. Kështu Kongresi i Përmetit i zhvilloi punimet për mrekulli. Imperialistët anglo-amerikanë e mendonin rëndësinë historike të Kongresit të Përmetit dhe konsekuencat e tij: ky Kongres do të prishte të gjitha planet e tyre, prandaj ata s'lanë gjë pa bërë, por të tëra u dështuan.

Megjithatë agjentët e imperialistëve anglezë vazhduan më tej rrugën e tyre. Ata propozuan në mënyrë djallëzore që të organizonin gjoja forca partizane jashtë komandës së gjeneral Myslim Pezës, me qëllim që më vonë t'i kishin si mbështetje për të hedhur forca desante ajrore angleze dhe t'i përdornin në çastin vendimtar të çlirimit të Tiranës, në mbështetje të forcave balliste. Por Partia jonë e lavdishme këto «propozime» ua shkëlmoi që në vezë, duke u thënë shkurt se atje vepronte vetëm Ushtria Nacionalçlirimtare nën komandën e heroit Myslim Peza dhe s'do të lejonte asnjë veprim tjetër. Kështu dështuan edhe propozimet e panumërta dhe përpjekjet e mëvonshme të imperialistëve për të zbarkuar forcat e tyre në bregdetin tonë, që, tok me monarko-fashistët grekë, të komplikonin situatën në Shqipërinë e Jugut dhe të përgatitnin copëtimin e kësaj pjese të Shqipërisë në favor të monarko-fashistëve grekë.

Përse s'ua arritën dot këta «aleatë» qëllimeve të tyre? Për arsye të luftës së madhe, të revolucionit të madh të popullit tonë që e udhëhiqte Partia, për arsye të vijës së drejtë të Partisë sonë, e cila nuk u zbatua vetëm nga një e dy, por nga mijëra e dhjetëra mijëra veta.



Kongresi i Përmetit pati një rëndësi të jashtëzakonshme, që do të mbetet si një datë e shënuar në historinë e popullit tonë. Ai ishte një Kongres kushtetues. Ato rezultate që u arritën me aq gjak, me aq vuajtje, duhej të sanksionoheshin nga populli ynë heroik dhe sovran. Kongresi i Përmetit nuk ishte një ngjarje e rastit, por ishte një moment i menduar thellë nga Partia. Ai u bë në rrethana dhe në momente politike të caktuara, që Partia i studioi me pjekuri të madhe.

Cilat ishin këto momente e rrethana që Partia tha se ishin pjekur? Ushtria Sovjetike, e komanduar nga Stalini i madh, po ecte përpara ngadhënjimtare dhe forcat e nazizmit gjerman po thyheshin; brenda në vendin tonë ne kishim çliruar krahina të tëra, kishim shkatërruar pushtetin e vjetër të borgjezisë e të feudalëve, kishim vendosur pushtetin popullor — këshillat nacionalçlirimtarë; vendimet historike të Konferencës së Pezës ishin zbatuar nga Partia me sukses të madh; fashistët e tradhtarët ishin strukur në qytete; ushtria jonë kishte marrë forma të zgjeruara. Në këto rrethana Partia vendosi të thërriste Kongresin e Përmetit, të vinin delegatët e zgjedhur në mënyrë demokratike nga të katër anët e vendit dhe t'u parashtronte atyre këto probleme të rëndësishme, për të cilat ata duhej të vendosnin në mënyrë sovrane: të sanksionohej forma e pushtetit popullor, t'i pritej rruga kthimit të satrapit Ahmet Zog dhe njerëzve të tij, të bëheshin të pavlefshme të gjitha traktatet robëruese, të vazhdohej lufta akoma më me furi kundër nazistëve gjermanë deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë dhe të asgjësoheshin

manovrat diplomatike dhe ushtarake të «aleatëve» anglo-amerikanë në kurriz të Shqipërisë. Për këto arsye u thirr Kongresi i Përmetit.

Por pse të thërritej ky Kongres në Përmet dhe jo në një vend tjetër? Edhe kjo s'është bërë rastësisht. Mund të mblidheshim edhe në vende të tjera, ku mbrojtja e Kongresit mund të ishte edhe më e sigurt nga ana ushtarake, por Partia zgjodhi Përmetin për disa arsye:

Duke zgjedhur Përmetin, i cili mund të mbrohej nga ana strategjike, siç u mbrojt nga brigadat tona të lavdishme, duhej t'u tregohej popullit shqiptar dhe botës se lufta jonë kishte kaluar nga faza e luftës partizane në fazën e luftës me reparte të mëdha, në fazën e çlirimit të qyteteve, t'i tregohej popullit se fitorja ishte e afërt. Forcën e ushtrisë sonë s'kishte kush ta pengonte. Kjo ishte një arsye.

Arsyeja tjetër ishte se Partia, trashëgimtarja e të gjitha virtyeteve të larta të popullit tonë, të njerëzve luftëtarë, të njerëzve mendjemprehtë dhe zemërzjarrtë, duhej të nderonte kujtimin e tyre, të nderonte kujtimin e njerëzve të mëdhenj të Rilindjes, që lindën në tokën e Përmetit, poetin e madh Naimin, filozofin, dijetarin e statistin e shquar të Shqipërisë, Sami Frashërin, luftëtarin e madh Abdyl Frashërin. Të gjithë shokët e brezit tonë, kur ishim në bankat e shkollave, lexonim librin e Samiut «Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet». Unë e mbaja atë libër në çantën time të partizanit, e lexoja dhe e kuptoja tani me sy marksisti. Pra, duhej t'i nderonim këta luftëtarë të mëdhenj dhe t'i tregonim edhe një herë popullit se bijtë e denjë të tyre ishin partizanët, komunistët dhe jo tradhtarët, siç

ishin Lumo Skëndoja, Mehdi Frashëri, qofshin këta dhe nga gjaku i Frashërlinjve, Ali Këlcyra etj.

Siç e dini, në Kongresin e Përmetit u morën vendime që ishin baza e Kushtetutës sonë të re. Aty u vendos të shkatërrohej pushteti i vjetër dhe të sanksionohej pushteti i ri i popullit, ashtu siç e kishte ëndërruar populli, ashtu siç na mësonin Marks, Engelsi, Lenini dhe Stalini, në shembullin e Komunës së Parisit dhe të Sovjetëve në kushtet e Shqipërisë. Populli, zot i fateve të tij, mori vendime që të gjitha traktatet e dëmshme të së kaluarës të prisheshin.

Edhe në të kaluarën janë bërë kongrese në vendin tonë, kongrese të rëndësishme historike, si Kuvendi i Lezhës, Lidhja Shqiptare e Prizrenit ose Kongresi i Lushnjës. Në dokumentet e këtyre kongreseve patriotët tanë, të gjendur në pozita të vështira, kërkonin nga Fuqitë e Mëdha ta ndihmonin Shqipërinë. Por në rezolutat e Kongresit të Përmetit nuk ekzistojnë lutje të tilla, atje s'gjen lutje drejtuar Anglisë, Amerikës dhe askujt tjetër për të vendosur për të ardhmen e Shqipërisë. Armiqtë në të kaluarën e quanin Shqipërinë një hiç gjë, por këtë radhë Shqipëria, e udhëhequr nga Partia e saj e lavdishme, u tregoi atyre se ajo ishte e patundur dhe e patrembur në rrugën e saj të drejtë. Kongresi i Përmetit i paralajmëroi imperialistët se kohët e vjetra kishin kaluar përgjithmonë, se historia nuk do të përsëritej më, siç dëshironin ata, se Shqipëria s'bëhej më monedhë tregu, se delegatët shqiptarë nuk do të përbuzeshin më si dikur në Kongresin e Berlinit, nga Bismarku, Disraeli<sup>1</sup>,

<sup>1</sup> Lord Bikonstild (1804-1881) — kryeministër i Anglisë në vitet 1868, 1874-1880.

dhe më vonë nga pasardhësit e tyre, që i shkëputën Shqipërisë Kosovën dhe ua dhanë kralëve të Serbisë, se nuk do të lejohej më që ndokush të vepronte si dikur ministri i jashtëm i carit dhe që thoshte se Shkodra është një omlet për knjaz Nikollën e Malit të Zi. Kongresi i Përmetit u thoshte imperialistëve anglo-amerikanë se anijet e tyre nuk mund të zbarkonin më në Durrës mbretin Zog, siç bënë dikur Fuqitë e Mëdha me një princ gjerman<sup>1</sup>, se mbi Vlorë e Sazan do të valonte flamuri i Shqipërisë; ai u thoshte imperialistëve se kaloi koha kur dënoheshin me vdekje patriotët, kur ngrinin flamurin e Shqipërisë në Korçë, kurse në Gjirokastrë nuk do të ngrihej më flamuri i Shqipërisë nën druajtjen e bajonetave të gjeneral Piaçentinit dhe nën kërcënimin e venizelistëve. Këto i tha Kongresi i Përmetit botës së jashtme, këto u tha imperialistëve Shqipëria krenare, luftarake, revolucionare e udhëhequr nga Partia jonë e lavdishme.

Në Kongresin e Përmetit u firmos dhe iu dha urdhri Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare të marshonte përpara, të çlironte qytetet, të shkatërronte kudo armikun, duke përvëlur me zjarr dhe me hekur fashistët gjermanë dhe tradhtarët, të çlirohej plotësisht Shqipëria brenda datës së caktuar nga Komiteti Qendror dhe Komanda e Përgjithshme e forcat tona, në shenjë vëllazërimi internacionalist, të hidheshin përtej kufirit në ndihmë të popujve vëllezër të Jugosllavisë për çlirimin

---

1 Në mars 1914 Fuqitë e Mëdha, Austro-Hungaria, Anglia, Franca dhe Italia, sollën princin gjerman V. Vid për të qeverisur Shqipërinë, i cili, që në fillim, u bë lodër në duart e fuqive imperialiste.

e tyre. Partia i dha urdhër birit të saj të lavdishëm, gjeneralit të talentuar e legjendar, Mehmet Shehut, të marshonte e të çlironte Tiranën dhe forcat partizane vunë në vend fjalën e saj. Tirana u çlirua dhe më 29 Nëntor 1944 tërë Shqipëria u çlirua. Të gjitha forcat gjermane u shkatërruan, ballistët u shpartalluan dhe i dogji zjarri i ushtrisë sonë. Tradhtarët Lumo Skëndo, Mehdi Frashëri, Bazi i Canës, Muharrem Bajraktari, Ali Këlcyra dhe të tjerë ua mbathën këmbëve si lepujt, tradharët e tjerë kaluan në gjyqin e popullit dhe i paguan krimet e tyre. Ky është, shokë, kuptimi i madh historik i Kongresit të Përmetit, 20-vjetorin e të cilit ne e festojmë sot; kjo është një datë që do të mbetet e përjetshme në historinë legjendare të popullit tonë; ky është një mësim që do ta studiojnë dhe do ta zbatojnë brezat e ardhshëm të Shqipërisë.

Të gjitha këto i bëri Partia, prandaj, shokë, populli e do atë me gjithë shpirt dhe përgjërohet për të. Jetën e tij të re, socializmin dhe të ardhmen, komunizmin, populli i lidh me Partinë e tij, sepse Partia, çdo gjë që ka thënë, e ka bërë, dhe këtë ajo e ka treguar me fakte, me gjak dhe jo me fjalë, me zgjuarsinë e saj, me vendosmërinë e saj për ta bërë popullin të lumtur, për të bërë çdo gjë për popullin. Asgjë s'mund të vihet mbi popullin, asgjë s'mund të kryhet jashtë interesave të popullit. Komunistët si kurdoherë, derisa të vdesin, duhet dhe do t'i shërbejnë popullit, ata janë dhe do të jenë konsekuentë në rrugën e tyre, ata do të qëndrojnë kurdoherë revolucionarë dhe të gatshëm të bëjnë çdo sakrificë për popullin. Këtë ne, komunistët, do ta bëjmë derisa të kemi jetën, dhe brezat e ardhshëm të Shqi-

përisë që do të mbushin radhët e Partisë sonë të pavdekshme, luftën heroike të Partisë sonë do ta kenë kurdoherë mësim për veprim.

Partia, shokë, krijoi një mori kuadrosh të pajisur me virtyte të larta, me një ndërgjegje të re, i pajisi ata me një trimëri të rrallë dhe me një zotësi të shquar, me shkencë dhe me kulturë të gjerë, sepse ajo, ashtu sikundër parashikoi vështirësitë e luftës, parashikoi gjithashtu se pas luftës do të fillonte një betejë tjetër e madhe, ndërtimi i socializmit, i cili nuk do të ishte i lehtë, do të hasnim vështirësi të mëdha, vështirësi që nuk na trembnin dhe që do t'i kapërcenim, sikundër i kemi kapërcyer.

Ka njerëz, jashtë, që na duan të mirën, që kanë një respekt dhe admirim të madh për Partinë tonë, por që, nganjëherë, pyesin se si është e mundur që kjo Parti e re të mos ketë gabuar. Njerëzit mundet të gabojnë, edhe partitë mund të gabojnë, por nuk është e thënë që çdo njeri dhe çdo parti duhet të gabojë. Fakti është që Partia jonë nuk ka gabuar në vijën e saj të përgjithshme, dhe nuk ka gabuar jo për gjë tjetër, po për arsye se ajo ka qenë kurdoherë besnike ndaj popullit, se ajo nuk i lejoi kurrë vetes që, me veprimet e saj, të dëmtonte popullin, pasi ajo i ka hedhur hapat e saj me përgjegjësi dhe me kujdes të veçantë, pasi ajo ka përfitur nga eksperiencia e madhe revolucionare e popullit, nga vuajtjet dhe nga sakrificat e tij, pasi ajo ka mësuar nga intrigat e armiqve të popullit, t'u bënte atyre ballë dhe t'i shkatërronte, sikundër bëri, pasi Partia jonë i ka qëndruar dhe do t'i qëndrojë kurdoherë besnike e patundur teorisë marksiste-leniniste.

Të gjitha këto, shokë dhe shoqe, bënë që lufta të fitohej, që pushteti popullor të krijohet, të vendosej në vendin tonë diktatura e proletariatit, të arrihej me sukses rindërtimi i vendit tonë të shkatërruar dhe të djegur nga lufta, të ndërtohet me sukses socializmi.

Në rindërtimin e vendit ne kemi hasur shumë vësh-tirësi, por mobilizimi i popullit për zbatimin e vijës së Partisë ka qenë total. Në këtë rrugë ne kemi pasur ndihmën morale, ekonomike, politike dhe ideologjike të Bashkimit Sovjetik e të Stalinit, gjë që populli shqiptar nuk e harron kurrë. Në këtë rrugë na dolën përpara armiq të egër dhe me ta filluam një luftë tjetër; këta ishin tradhtarët titistë, shovinistë të tërbuar serbomë-dhenj, antimarksistë dhe agjentë të imperializmit, të cilët vepruan egërsisht të maskuar dhe hapur. Ata u përpoqën t'i bënin varrin popullit tonë, ata organizuan agjenturën e tyre brenda vendit me Koçi Xoxen dhe shokët e tij, ata grumbulluan rreth tyre në këtë komplot karrieristë dhe antimarksistë për të likuiduar fitoret e mëdha të Partisë dhe të popullit. Në pragun e fitores së çlirimit ata komplotuan në Plenumin e 2-të të Komitetit Qendror të PKSH, që u mbajt në nëntor 1944 në qytetin e Beratit, me qëllim që të likuidonin udhëheqjen, të diskreditonin Partinë, të merrnin në duart e tyre frenat, ta kthenin Shqipërinë në një vegël të Jugosllavisë, në një republikë të shtatë të saj. Mirëpo Partia reagoi dhe luftoi kundër tyre, sepse ishte e kalitur në sa e sa beteja e kurthe të armiqve, sepse i erdhi në ndihmë Bashkimi Sovjetik, Stalini, i cili u çorri maskën këtyre tradhtarëve. Jeta tregoi se sa të drejtë kishte Stalini, sa

të drejtë kishte Partia jonë që e filloi luftën dhe s'e ndërpreu atë kurrë kundër këtyre renegatëve të marksizëm-leninizmit, kundër këtyre agjentëve të imperia-lizmit, që me të gjitha mjetet kërkojnë të transformoj-në vendet socialiste në vende borgjeze kapitaliste, dhe t'i vënë ato nën thundrën e imperializmit amerikan. Lufta heroike e Partisë sonë bëri që të dështojnë pla-net djallëzore të klikës revizioniste të Beogradit dhe vendi të ecë me sukses përpara.

Më vonë dolën armiq të tjerë, po aq të tërbuar. Megjithatë, gjatë kësaj kohe, shokë dhe vëllezër, popu-lli dhe Partia jonë me punë, me djersë, bënë gjëra të mrekullueshme. Në vendin tonë ndërtohet me sukses socializmi, u krijua një klasë punëtore e shëndoshë, e fortë dhe e edukuar, u krijua industria socialiste, u krye revolucioni socialist në fshat, i cili u kolektivizua, lindi dhe lulëzoi jeta e re, filloi puna e përbashkët për të krijuar sa më shumë të mira për popullin, u thanë kë-neta e moçale, u sistemuan dhe u vaditën tokat, u ve-shën kodrat anembanë Shqipërisë me pemë, me ullinj e me vreshta, u hapën aq shkolla, në të katër anët e at-dheut, sa edhe Sami Frashëri, me imagjinatën e tij të madhe përparimtare, nuk mund t'i kishte parashikuar, u rrit inteligjencia popullore dhe e lidhur ngushtë me Partinë, e lidhur ngushtë e në shërbim të klasës sonë punëtore dhe të fshatarësisë revolucionare, u krijua një unitet i çeliktë parti-popull që s'është parë ndonjëhe-rë në vendin tonë, unitet, si një grusht i vetëm, për të shkuar përpara, për të përparuar, për të ndërtu-ar socializmin, unitet, si një grusht përpara armiqve



imperialistë, grusht, përpara revizionistëve modernë me Hrushovin e Titon në krye dhe të gjithë shërbëtorët e tyre.

Disa na qanin hallin duke thënë se si do të bënte kjo Shqipëri e vogël, e rrethuar nga shtete borgjeze, reaksionare, imperialiste dhe revizioniste. Por më kot shqetësoheshin ata, sepse Shqipëria s'ka mortje kurrë. Përpara qëndrimit të drejtë e të vendosur të Shqipërisë, të popullit dhe të Partisë sonë, çdo tentativë e armikut ka dështuar dhe do të dështojë edhe në të ardhmen. Kurrkush nuk guxon të prekë Shqipërinë. Dhe pse? Sepse në Shqipëri i bëhet varri. Armiku do që të zgjatë jetën e tij, prandaj përpiqet që atje ku i has sharra në gozhdë, të mos bëjë tentativa të tilla të rrezikshme. Megjithatë të marrët bëjnë edhe tentativa të tilla, prandaj kundrejt këtyre të marrëve Shqipëria qëndron vigjilente. Partia ka armatosur gjithë popullin, ajo ka krijuar një ushtri të çeliktë, të armatosur me të gjitha mjetet luftarake, të zonjën për t'i bërë ballë çdo rreziku, ajo mban gjallë dhe nuk e shuan luftën e klasave kundër armiqve të brendshëm të Shqipërisë, të cilët janë bërë si pulat. Partia ka krijuar një ekonomi të shëndoshë, që nuk njih kriza, por, përkundrazi, çdo vit ecën përpara dhe e bën jetën e popullit gjithnjë e më të begatshme. Mbi të gjitha, Partia ka krijuar atë unitet të çeliktë politik e ideologjik me popullin, për të cilin fola më parë, që s'ka forcë në botë ta çajë; dhe kjo u provua dhe provohet çdo ditë në luftën kundër armiqve të jashtëm dhe të brendshëm.

Shqipëria dhe Partia jonë treguan gjithashtu forcën dhe vitalitetin e tyre edhe në luftën heroike kundër

tradhtisë më të madhe që u është bërë marksizëm-leninizmit dhe popujve nga revizionisti me damkë Nikita Hrushov. Ai dhe pjesëtarët e bandës së tij janë kriminelë të vërtetë, ata janë komplotistë nga më të këqijtë, ata janë intrigantë dhe të pabesë, që kanë qëndruar të fshehtë gjatë gjithë kohës së ndërtimit të socializmit dhe tani ngritën krye. Këta janë ata komplotistë që kanë pasur paturpësinë të na thonë neve në sy, siç bëri A. Mikoiani, se ishin përgatitur për të vrarë Stalinin.

N. Hrushovi dhe banda e tij kanë marrë përsipër ta kthejnë Bashkimin Sovjetik në një vend borgjez kapitalist dhe ta lidhin në një aleancë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ata kanë në planet e tyre të futin në robëri të rëndë vendet e demokracisë popullore të Evropës. Në Bashkimin Sovjetik sundojnë terrori, vrasjet, burgimet, kampet e internimit. Në Bashkimin Sovjetik grupi i Hrushovit po organizon terrorin e zi, sipas shembullit të eserëve, të menshevikëve, të buharinistëve, të trockistëve, kundër marksistë-leninistëve dhe popujve sovjetikë.

Populli sovjetik dhe marksistë-leninistët e vërtetë sovjetikë që, nën udhëheqjen e Leninit dhe të Stalinin, bënë Revolucionin e Madh Socialist të Tetorit dhe ndër-tuan me sukses socializmin, duhet të shikojnë se në vendin e tyre banda e Hrushovit po kryen kundër-revolucionin. Ne kemi besimin e patundur se marksistë-leninistët e vërtetë sovjetikë do ta gjejnë rrugën e drejtë, pavarësisht se tani ata i ka pllakosur errësira; ne jemi të sigurt se ata do ta kuptojnë përgjegjësinë e tyre të madhe përpara popujve të botës.

Grupi i Hrushovit dhe pasuesit e tij na akuzojnë ne për terroristë dhe si të shitur tek imperialistët, por janë ata, dhe jo ne, që i kanë hapur dyert imperializmit amerikan, janë ata që po lidhen me imperialistët. Në vendet e tyre tani sundojnë intriga, ryshfeti; atje luftohet kush të vjedhë më shumë, kush të hajë e të rrojë më mirë, pa populli le të vuajë. Qëllimi i N. Hrushovit është i qartë për të gjithë, ai është një këlysh i imperializmit, një tradhtar i marksizëm-leninizmit, që kërkon të vendosë në Bashkimin Sovjetik një diktaturë borgjeze, të hedhë nën drejtimin e tij të gjitha vendet socialiste, të ketë nën urdhrat e tij të gjitha partitë marksiste-leniniste dhe tok me Shtetet e Bashkuara të Amerikës të ndajnë sferat e influencës në botë, të dominojnë dhe të shfrytëzojnë popujt, duke shuar revolucionin. Ky është qëllimi i imperializmit amerikan, i Nikita Hrushovit, i Titos dhe i të gjithë atyre që i pasojnë. Qëllimi tjetër i tyre është të përgatitin luftën kundër të gjithë atyre që u rezistojnë planeve të tyre djallëzore, dhe, në radhë të parë, kundër Kinës dhe kundër Shqipërisë.

Vendet që udhëhiqen nga partitë marksiste-leniniste dhe që ndërtojnë me sukses socializmin kanë ngritur lart flamurin luftarak të Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit, luftojnë për paqen botërore, luftojnë kundër imperializmit dhe kundër përgatitjeve të tij për të shpërthyer një luftë të re botërore, bëjnë një luftë të vendosur dhe me sukses kundër agjentëve të tyre tradhtarë të marksizëm-leninizmit, revizionistëve modernë. Partitë dhe shtetet tona ndihmojnë me të

gjitha forcat luftën nacionalçlirimtare të popujve, të cilët janë ngritur dhe ngrihen për të këputur zinxhirët e robërisë që u kanë hedhur imperializmi dhe neokolonializmi dhe që përpiqen t'ua shtrëngojnë me demagogji Nikita Hrushovi dhe pasuesit e tij. Kjo vijë e drejtë revolucionare marksiste-leniniste e Partisë sonë dhe e partive të tjera marksiste-leniniste do të triumfojë.

Kudo në botë komunistët e vërtetë marksistë-leninistë po luftojnë. Parti të reja marksiste-leniniste po krijohen, grupe revolucionare komunistësh po kalitin forcat e tyre në luftë kundër revizionizmit modern, në luftë kundër revizionistëve në vendet e tyre, në luftë kundër politikës së tyre përçarëse dhe kapitulluese ndaj imperializmit, në luftë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit. Revolucioni po ngjitet, imperializmi dridhet dhe revizionistëve modernë po u vjen fundi. Lufta revolucionare po merr proporcione gjithnjë më të gjera dhe po zhvillohet me sukses në të gjitha kontinentet dhe në vendet e botës, në Azi, në Amerikën Latine, në Afrikë dhe brenda në Evropën e mbarsur me revizionizëm. Po dështojnë gjithnjë e më shumë përpjekjet e vazhdueshme të Nikita Hrushovit dhe të pasuesve të tij për t'u imponuar me metodat më brutale dhe demagogjike partive komuniste dhe punëtore të vendeve të ndryshme vijën e tij tradhtarë dhe për t'i bërë ato që t'i binden në mënyrë të verbër shkopit të tij të dirigjentit në fushatën antikineze, antishqiptare, anti-marksisteleniniste. Pra, intrigat dhe planet e grupit të Nikita Hrushovit po pësojnë disfata. Vaporit i tij «Ball-

tika»<sup>1</sup> po fundoset dhe partnerët e tij kërkojnë të lënë vaporin.

Populli shqiptar është me gjithë shpirt me luftën heroike nacionalçlirimtare të popujve të shtypur, kundër imperializmit, kolonializmit dhe neokolonializmit, ai është krah për krah me popullin e lavdishëm të Vietnamit të Jugut, që, nën udhëheqjen e Frontit Nacionalçlirimtar, ua ka bërë imperializmit amerikan dhe veglave të tij ditën të errët si nata. Më kot imperialistët amerikanë derdhin në Vietnamin e Jugut miliona dhe miliarda dollarë, më kot ata dërgojnë atje armatime, ushtarë dhe personalitete të larta ushtarake dhe politike: lufta heroike e popullit të Vietnamit ata do t'i shpartallojë.

Populli shqiptar dhe Partia e tij janë solidarë me luftën e popullit vëlla kuban, kundër veprimeve agresive të Shteteve të Bashkuara të Amerikës; ata janë solidarë me luftën e popullit vëlla kongolez, që po ngrihet në këmbë për t'u dhënë fund ndërhyrjes së imperialistëve dhe veprimeve tradhtare të Nikita Hrushovit, që bënë të dështojnë përpjekjet revolucionare të patriotëve kongolezë të udhëhequr nga Patris Lumumba; ata janë solidarë me luftën e të gjithë popujve të tjerë të Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine. Demagogjia dhe aventurat e Nikita Hrushovit, kapitullimi dhe rublat e tij nuk do t'i gënjejnë popujt e Azisë, të Afrikës

---

<sup>1</sup> Me këtë vapor N. Hrushovi dhe disa lakej të tij — kryetarë qeverish të disa vendeve të ish-demokracisë popullore — në shtator 1960, për të troguar «unitetin», u nisën së bashku për në Nju-Jork, ku do të merrnin pjesë në Sesionin e 15-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.

dhe të Amerikës Latine, pasi Nikita Hrushovi e provoi se ai tradhtoi atdheun e tij, tradhtoi vendet socialiste, se ai gëzohet kur likuidohen parti marksiste-leniniste, se rublat dhe «ndihmat» e tij nuk janë përveçse lak rreth grykës së popujve, që kërkojnë të rrojnë të lirë.

Populli shqiptar dhe Partia jonë ushqejnë ndjenjat e miqësisë dhe të respektit të madh për popujt vëllezër të Republikës Arabe të Bashkuar, të Algjerisë, të Marokut, të Tunizisë, të Omanit, të Adenit etj., që kanë luftuar e luftojnë me heroizëm kundër imperializmit, për liri, pavarësi dhe për konsolidimin e fitoreve të tyre. Ata të jenë të sigurt se te populli shqiptar kanë një mik dhe vëlla besnik.

Planet e imperializmit dhe të hrushovianëve do të dështojnë me turp, popujt dhe marksizëm-leninizmi do të fitojnë.

Në këto situata Partia dhe populli ynë ecin përpara me vrull, me kurajë, të patrembur dhe plotësisht të bindur se kurdoherë do të fitojnë. Populli ynë shkon drejt realizimit me sukses të planit të tretë pesëvjeçar, i cili do t'i sjellë fabrika të reja, përmirësime akoma më të mëdha bujqësisë sonë dhe suksese akoma më të mëdha në drejtim të kulturës, të artit etj. Përpara nesh hapen perspektiva akoma më të shkëlqyera me planin e katërt pesëvjeçar. Ai do të jetë një plan real, gjatë realizimit të të cilit industria jonë do të fuqizohet akoma edhe më shumë dhe bujqësisë do t'i jepet një hov akoma më i madh. Që tani Komiteti Qendror i Partisë po studion çështjen për t'i ardhur akoma më shumë në ndihmë fshatarësisë në zonat malore, për t'i krijuar asaj mun-

dësi për një shtim më të madh të prodhimit dhe për përmirësimin e mëtejshëm të jetesës.

Pra, perspektiva jonë është e qartë dhe forcat tona janë në gjendje që këto fitore t'i arrijnë. Vështirësi do të kemi, por kurdoherë do t'i kapërcejmë.

Të dashur shokë,

Në këtë përvjetor të lavdishëm le t'i shumëfishojmë forcat tona, le të punojmë pa u lodhur, të shtrëngojmë akoma më shumë radhët rreth Partisë sonë të lavdishme, që na rriti dhe na mëson të ecim përpara me guxim në ndërtimin e plotë të socializmit, të jemi vigjilentë dhe të pamëshirshëm kundër çdo armiku imperialist që do të përpiqet të prekë, sadopak, fitoret tona, pavarësinë dhe lirinë tonë, të jemi të pamëshirshëm kundër tradhtarëve të marksizëm-leninizmit, revizionistëve modernë me Hrushovin në krye.

Rroftë Partia jonë heroike!

Rroftë populli i lavdishëm shqiptar!

*Botuar për herë të parë  
në gazetën «Zëri i popullit»,  
Nr 126 (4908), 27 maj 1964*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## TEATRI DUHET TË JETË SHKOLLA E MASAVE, KURSE ARTISTI — FRYMËZUESI I TYRE I DASHUR

*Përshëndetje drejtuar punonjësve të teatrit me rastin  
e 20-vjetorit të krijimit të Teatrit Popullor*

30 maj 1964

Të dashur shokë e shoqe,

Sot së bashku me ju, punonjësit e Teatrit Popullor, që festoni 20-vjetorin e krijimit të teatrit tuaj, janë të gëzuar dhe qindra e mijëra pjesëtarë të teatrove të tjerë profesionistë e amatorë, dramaturgët, kritikët e teatrit e spektatorët e panumërt të artit skenik. Të gjithë këta, nën udhëheqjen e Partisë sonë të Punës dhe duke vënë me besnikëri në jetë porositë e saj të çmuara, i kanë dhënë atdheut një nga tribunat më të vyera për edukimin e njeriut të epokës së socializmit e të komunizmit, teatrin tonë të ri. Prandaj më lejoni që, me këtë rast, t'u dërgoj të gjithëve përshëndetjet më të ngrohta të Partisë dhe të miat personalisht.

Populli ynë ka vuajtur shumë për të ruajtur ekzistencën e tij, për një jetë të lirë e të denjë njerëzore.



Ai ka luftuar për të ruajtur traditat fisnike dhe kulturën e tij të lashtë. Dallgët e pamëshirshme të jetës s'e thyen dot kurrë as vullnetin e tij të hekurt dhe optimizmin revolucionar, as humorin e tij të hollë e ndjenjën e së bukurës. Pushkën, këngën, vallen si dhe pasqyrimin skenik të fenomeneve të jetës shoqërore politike, qoftë dhe në format më të thjeshta, ai i ka gërshtuar me njëra-tjetrën, i ka bërë pjesë të pandara të jetës.

Në kohën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare këto karakteristika dhe armë të tij morën një zhvillim të paparë deri atëherë. Kujtoni se si, pas betejave të përgjakshme me armiqtë, partizanët çlodheshin, këndonin e jepnin shfaqje të shkurtra pranë zjarrit; se si në burgje, ku shokët tanë i torturonin, i vrisnin apo i varnin fashistët, zemrat e bijve të popullit rimerrnin zjarr akoma më me furi nga këngët dhe shfaqjet revolucionare të grupeve artistike amatore; se si ngrihej peshë populli i robëruar i lagjeve të qyteteve apo i fshatrave nga shfaqjet ilegale ku kumbonte zëri i Partisë! Atje, në luftë, Partia zbuloi në sytë e të gjithëve dhe futi thellë në ndërgjegjen e masave forcën e madhe transformuese të artit në përgjithësi, të artit teatral në veçanti.

Njëzet vjet po mbushen që kur Shqipëria e re nisi ekzistencën e vet me një flamur të madh të shpalosur — me flamurin e Partisë; që atëherë ajo qëndron kësh-tjellë graniti me të vërtetë e lirë, qëndron me kazmën në një dorë e pushkën në tjetrën; që atëherë ajo nisi marshimin e revolucionit të ri ekonomiko-shoqëror, duke ndërtuar bazën ekonomike të socializmit dhe, krenare

dhe e patundur, vazhdon luftën për ndërtimin e bazës materialo-teknike të socializmit; ajo nisi dhe vazhdon me sukses të plotë revolucionin e madh ideologjik e kulturor; ajo po thotë gjithnjë e më me forcë fjalën e saj, mendimin e saj në fushat më të ndryshme.

Teatri ynë, pjesë e pandarë e jetës së popullit, eci në një hap më të, duke i ngjitur një nga një, me luftë e përpjekje, shkallët e jetës së re socialiste. Dhe kjo ngjau sepse njerëzit e teatrit profesionist e amator, dramaturgët etj., të lidhur ngushtë me të, luftuan, nën udhëheqjen e Partisë, me shpirt e zemër, të ndërgjegjshëm për misionin e tyre të lartë.

Pra, lufta e Partisë, lufta e popullit, lufta e njerëzve të artit skenik e dramatik, kjo luftë e madhe, ka vënë vulën e saj në teatrin tonë dhe po kristalizon në një formë gjithnjë e më të plotë teatrin tonë kombëtar, socialist.

Shqiptari s'ka qenë kurrë soditës i thjeshtë i jetës, imitues i verbër, skllav i kulturës së të tjerëve. Përkundrazi, ai, duke mësuar nga eksperiencia e tij dhe e të tjerëve, gjithmonë ka qenë dhe, aq më tepër sot, është aktiv ndaj saj, është përpjekur dhe përpiqet të japë kontributin e tij sado modest në kulturën botërore. Kështu është puna dhe në teatrin tonë. Ne sot kemi aktorë të talentuar, kemi regjisorë e piktorë skene të zotë, kemi një dramaturgjë tonën që e ushqen gjithnjë e më shumë këtë teatër. Forcat e tyre janë përqendruar me sukses dhe do të përqendrohen akoma me shumë në të ardhmen, drejt një objektivit të përbashkët, drejt pasqyrimin të jetës sonë socialiste në zhvillimin e saj revolucionar.

Në të njëjtën kohë të bëhet zemra mal kur shikon se skena e teatrit shqiptar nuk është pronë vetëm e di-sa njerëzve, se në të hyjnë bijtë e talentuar të popullit, se aty është ngjitur punëtori e fshatari ynë i ri, që mi-shëron e pasqyron në artin skenik veçoritë e epokës së re historike!

Kështu, teatri ynë përshkohet nga fryma e një pa-triotizmi të thellë socialist. Por, veç kësaj, ai, duke qenë i lidhur ngushtë me popullin e Partinë, përshkohet po aq dhe nga fryma e internacionalizmit proletar. Në ske-nat e Teatrit Popullor e të teatrove të tjerë profesio-nistë e amatorë janë vënë me talent edhe mjaft vepra të huaja përparimtare, klasike e të sotme. Duke bërë një punë serioze në këtë drejtim, artistët dhe regjisorët tanë njëkohësisht i kanë prerë rrugën penetrimit të pjesëve dekadente, borgjeze e kundërrevolucionare të Perëndi-mit, që sot me aq zell përvetësohen dhe imitohen nga revizionistët modernë. Në këtë mënyrë, artistët dhe pu-nonjësit e tjerë të artit skenik marrin pjesë aktive në luftën e madhe politike e ideologjike që zhvillojnë Par-tia dhe populli ynë kundër imperializmit, me atë të SHBA-së në krye, dhe kundër revizionizmit modern, me tradhtarët Hrushov e Tito në krye, për triumfin e çështjes fisnike të paqes, lirisë, demokracisë e socializ-mit në botë. Artistët tanë, ashtu siç i mëson Partia, ush-qejnë veten dhe masat me idetë e pavdekshme të mar-ksizëm-leninizmit.

Por, natyrisht, të dashur shokë, neve të gjithëve na mbetet akoma shumë për të bërë në të gjitha fushat, pra dhe juve ju mbetet të bëni akoma më shumë për zhvillimin e mëtejshëm të teatrit tonë, që është pjesë e

rëndësishme e kulturës sonë kombëtare. Prandaj kurrë të mos deheni nga sukseset, por me kurajën që na mëson Partia të shihni dhe të metat e boshllëqet, si në çështjet e realizimit skenik të veprave ashtu dhe në pasqyrimin e saktë e të drejtë, në frymë kurdoherë revolucionare, të realitetit në dramaturgji. Sepse çështja e artit është nga çështjet më të vështira e të komplikuarra. Edhe kërkesat e masave ndaj tij janë rritur e rriten vazhdimisht në përputhje me ngritjen e nivelit të tyre të gjithanshëm.

Teatri, në përgjithësi, është kultivues i ndërgjegjes së masave. Teatri ynë, në veçanti, është kultivues i ndërgjegjes revolucionare të tyre; ai ka për mision të ndihmojë në formimin e forcimin e saj, në brumosjen e njerëzve me vetitë e moralit komunist. Ai duhet të pasqyrojë jetën në zhvillim, ndryshimet që ndodhin në shoqëri, aspiratat dhe luftën e popullit. Teatri, si çdo art tjetër yni i realizmit socialist, duhet të marrë pjesë në këtë luftë, duke i ushqyer masat me vijën e Partisë, me idetë e marksizëm-leninizmit, të edukojë patriotë të vërtetë e internacionalistë, njerëz me shpirt të madh, luftëtarë të patrembur për kauzën e popullit. Pra, teatri duhet të jetë shkollë e masave, kurse artisti frymëzues i tyre i dashur.

Por për të qenë kështu është e nevojshme që në radhë të parë artistët, regjisorët, dramaturgët të vënë në jetë, me forcë gjithnjë e më të madhe, vijën e Partisë, të njohin sa më mirë realitetin dhe estetikën marksiste, të pajisen me dituri të gjera. Dhe burimi i kësaj diturie janë populli, jeta dhe librat. Të gjithë artistët e mëdhenj i kanë pasur rrënjët te populli, kanë qenë të li-

dhur ngushtë me të dhe kanë mësuar nga gjenia e tij e pashtershme, nga kritikët e vërejtjet e tij; të gjithë ata kanë pasur miq të tyre më të ngushtë popullin dhe librin. Modestia, shkrirja me popullin dhe etja për dituri e kulturë janë, ashtu si për çdo punonjës tjetër, nga vetitë më të çmuara të një artisti të vërtetë.

Në të njëjtën kohë artistët, aktori apo regjisori, janë njerëz krijues. Ata duhet të fusin në rolet apo shfaqjet «të tyre», ta ngrenë realitetin në art me forcë krijuese dhe sa më emocionuese, se vetëm kështu heronjtë dhe rrethanat tipike do të paraqiten në zhvillimin e vet sa më të plota, dinamike, revolucionare. Por kjo arrihet duke bërë përpjekje për t'u ngritur sa më shumë e vazhdimisht nga ana profesionale. Nuk mjafton të jesh i talentuar për një çështje; talenti mund të shpërthejë me vrull vetëm po të mbështetet nga studimi e puna këmbëngulëse, ndryshe venitet e fishket.

Aktorët, regjisorët, piktorët e skenës, dramaturgët, kritikët etj., përbëjnë një detashment monolit. Ata janë të lidhur midis tyre në mënyrë të tillë që pa njëri-tjetrin s'bëjnë dot. Interesi i artit teatral, interesi i popullit, kërkon që në këtë detashment të sundojë sa më shumë motoja: «Një për të gjithë, të gjithë për një». Lavdia e atdheut, lavdia e artit, lavdia e kolektivit dhe ajo e individit janë një dhe të pandara. Prandaj është e nevojshme që midis aktorëve, regjisorëve, dramaturgëve etj., të sundojë kurdoherë ndjenja e harmonisë, e ndihmës reciproke dhe e kritikës parimore shoqërore. Kjo do të ndihmojë që arti ynë teatral të përparojë me shpejtësi.

Të dashur shokë e shoqe,

Teatri Popullor në këtë jubile sheh rrugën e tij të lavdishme 20-vjeçare, sheh dhe detyrat e mëdha që i dalin përpara. Ai është pionier i teatrit tonë të ri, ai ka mësuar të tjerët dhe ka mësuar nga të tjerët, ai i ka dhënë shumë popullit, por akoma më shumë duhet e do t'i japë në të ardhmen.

Le të bëhet teatri ynë gjithnjë më i afërt dhe i kuptueshëm për popullin, le të jetë për të kurdoherë një armë e fuqishme, për të çarë përpara drejt një të ardhmeje gjithnjë e më të lumtur! Le të mbushen rradhët e teatrove profesionistë me gjak të ri nga Shkolla e Lartë e Aktorëve, nga teatrot amatorë, nga bijtë e talentuar të popullit!

Le të udhëhiqeni në punën tuaj nga motivi: sa kënaqësi i jepni popullit, sa zjarr i jepni rinisë, sa bëni për edukimin e njeriut të ri. Si kurdoherë do të gjeni shpërblimin e madh të punës suaj të dashuria e paku-fishme e popullit tonë heroik dhe e Partisë sonë të lavdishme për ju.

Dalçi kurdoherë faqebardhë në misionin tuaj aq të bukur dhe fisnik!

*Enver Hoxha*

*Botuar për herë të parë  
në gazetën «Zëri i popullit»,  
Nr. 130 (4912), 31 maj 1964*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## L E N D A

PARATHËNJE PËR VËLLIMIN E 26-të ..... V—IX

### 1963

FORCIMI I PARTISË DUHET TË JETË NJË PREOKUPIM I PËRDITSHËM I TË GJITHË ANËTARËVE TË SAJ — Fjala e mbylljes në Plenumin e 11-të të KQ të PPSH (14 dhjetor 1963) ..... 1—34

PARTIA KA TË RINIA NJË MBËSHTETJE DHE FORCË KOLOSALE, BURIMIN E PASHTERSHËM TË RADHËVE TË SAJ — Nga biseda me delegacionin e rinisë dhe një piktor kinez (16 dhjetor 1963)..... 35—44

### 1964

ZGJIDHJA E PROBLEMEVE TË FUQISË PUNËTORE KËRKON NJË PUNË MË TË ORGANIZUAR — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (7 shkurt 1964) ..... 45—55

KUADRI DHE ORGANIZIMI I PUNËS LUAJNË ROL TË MADH NË ZHVILLIMIN E SHKENCËS — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (8 shkurt 1964) ..... 56—62

TE JETOJME MIRË ME SITUATAT, TË KUP- TOJME THELLË VËSHTIRËSITË DHE DETYRAT QË RRJEDHIN PREJ TYRE — Fjala e mbylljes në Plenumin e 12-të të KQ të PPSH (12 shkurt 1964) .....	63—83
PARAGJYKIMET FETARE JANË SI SËMUNDJET NGJITËSE — KUNDËR TYRE DUHET LUFTUAR VAZHDIMISHT — Diskutim në mbledhjen e Sekretaria- riatit të KQ të PPSH (14 shkurt 1964) .....	89—93
ANALIZA MJEKËSORE ËSHTË MJETI MË I SI- GURT PËR PËRCAKTIMIN E DIAGNOZËS SË SË- MUNDJES — Diskutim në mbledhjen e Sekretaria- tit të KQ të PPSH (14 shkurt 1964) .....	99—101
SOCIALIZMI NUK NDËRTOHET PA NJERËZ TË MËSUAR, LUFTARAKË DHE ENERGJIKË — Fja- la në Konferencën e 3-të të Partisë të rrethit të Kor- çës (1 mars 1964) .....	102—153
N. HRUSHOVI SHTRËMBËRON IDETË E LENINIT PËR T'Ë HAPUR RRUGË KURSIT TË VET PROIM- PERIALIST — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i po- pullit» (1 mars 1964) .....	159—171
PUNA E PARTISË NË LAGJE ËSHTË MJAFT IN- TERESANTE — Diskutim në mbledhjen e Sekretaria- riatit të KQ të PPSH (21 mars 1964) .....	172—174
PO TË PËRMIRËSOJMË METODËN E PUNËS, KRI- JOJMË REZERVA KOHE DHE KUADRI — Dis- kutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (21 mars 1964) .....	175—180
PUNA E PARTISË NË USHTRI LUAN NJË ROL VENDIMTAR — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Po- litike të KQ të PPSH (25 mars 1964) .....	181—184
PLANI PESËVJEÇAR TË MBËSHTETET NË RADHË TË PARË NË MUNDËSITË TONA TË BRENDSHME — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (25 mars 1964) .....	185—195



- FUSHATA E ZGJEDHJEVE PËR KËSHILLAT POPULLORË KA RËNDËSI POLITIKE, ORGANIZATIVE DHE EKONOMIKE — Fjala e mbylles në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë (30 mars 1964) ..... 196—203
- TESERA E PARTISË ËSHTË ME KAPAKË TË KUQ DHE ME DISA FLETË, POR SIMBOLIZON RRUGËN E LAVDISHME PËR NË KOMUNIZËM — Fjala me rastin e shpërndarjes së tescrave të reja të Partisë një grupi komunistësh të qytetit të Tiranës (6 prill 1964) ..... 204—226
- ARMIKUN E HAPUR E KEMI MERAK VETË — TË RUHEMI SIDOMOS NGA ARMIKU I FSHEHTË — Nga biseda me delegacionin e Bashkimeve Profesionale të RD të Vietnamit (7 prill 1964) ..... 227—236
- REVIZIONISTËT MODERNË NË RRUGËN E DEGENERIMIT SOCIALDEMOKRAT E TË SHKRIRJES ME SOCIALDEMOKRACINË — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (7 prill 1964) ..... 237—269
- ELEKTRIFIKIMI I VENDIT ËSHTË PROBLEM KYÇ — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (15 prill 1964) ..... 290—297
- PARTIA KËRKON NJË PUNË TË KUALIFIKUAR TEORIKE, TË LIDHUR NGUSHTË ME PRAKTIKËN KONKRETE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (16 prill 1964) ..... 298—304
- POPULLI E DO SHUMË ESTRADËN, TA FORCOJMË KËTË LLOJ TË BUKUR TË ARTIT — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (16 prill 1964) ..... 305—312
- LE TË QËNDROJË PENDA JUAJ PËRKRAH KAZMËS DHE PUSHKËS — Letër përshëndetjeje drejtuar Konferencës së 4-t Kombëtare të Gazetarëve të Shqipërisë (18 prill 1964) ..... 313—319

- TELEGRAM KONGRESIT TË 1-RË TË FRONTIT TË ÇLIRIMIT KOMBËTAR TË ALGJERISË (19 prill 1964) 320—321
- GRUPI UDHËHEQËS I SOCIALISTËVE FRANCEZË, VRASËS I POPUJVE EGJIPTIAN E ALGJERIAN, KURDIS KOMPLOTE TË REJA ME KLIKËN TITISTE — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (25 prill 1964) ..... 322—335
- VULLKANI QË KA SHPËRTHYER KUNDËR REVIZIONISTËVE MODERNË NUK DO TË SHUHET KURRË — Nga biseda me dy revolucionarë anglezë (3 maj 1964) ..... 336—347
- MATEMATIKA ËSHTË ARMË E FUQISHME E PROGRESIT — Letër falënderimi dërguar profesorit të shkencave matematike Kristaq Fundos (3 maj 1964) ..... 348—350
- METODËN TONË TË PUNËS, INFORMIMIN DHE UDHËZIMIN, TI PRAKTIKOJMË MË NË RREGULL — Letër dërguar komiteleve të Partisë në rrethe (4 maj 1964) ..... 351—353
- POPULLIN SHQIPTAR E LIDH NJË MIQËSI LUF-TARAKE ME POPULLIN KOREAN — Nga biseda me delegacionin e Federatës së Bashkimeve Profesionale të RPD të Koresë (7 maj 1964) ..... 354—359
- MARKSISTË-LENINISTËT I BINDIN DHE I UDHËHEQIN MASAT NË RRUGËN E REVOLUCIONIT — Nga biseda me dy miq francezë (9 maj 1964) ..... 360—370
- «NDIHMJA» E REVIZIONISTËVE SOVJETIKË NDAJ VENDEVE TË TJERA SJELL ME VETE ZINXHIRËT E SKLLAVËRISË — Nga biseda me një mik çeçlonez (11 maj 1964) ..... 371—384
- POPULLI YNË U ËSHTË MIRËNJOHËS BIJVE TË TIJ PATRIOTË JASHTË ATDHEUT, QË KANË QENË DHE JANË KURDOHERË PËRKRAH TIJ — Le-

tër përshëndetjeje dërguar shoqatës patriotike «Skënderbeu» në Argjentinë me rastin e 20-vjetorit të themelimit të saj (11 maj 1964) .....	385—388
NGA POLITIKA E HRUSHOVIT PËRFITOJNË VETËM BORGJEZIA DHE REAKSIONI — Nga biseda me delegacionin e Ministrisë së Komunikacionit të RP të Kinës dhe delegacionin e Federatës Pankincez të Bashkimeve Profesionale (12 maj 1964) .....	389—394
DISA SHËNIME PËR MBLEDHJET E BYROSË POLITIKE DHE TË SEKRETARIATIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH (15 maj 1964) .....	395—397
TË PUNOJMË KURDOHERË PËR NGRITJEN E NIVELIT TË JETESËS SË FSHATARËSISË PUNONJËSE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (20 maj 1964) .....	398—402
POPULLI KA NJË DASHURI TË MADHE PËR PARTINË — ARMIQTË E KLASËS LE TË TMERROHEN — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (20 maj 1964) .....	403—406
TË PËRGATITIM NË MASË KUADRO TË MESËM — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (20 maj 1964) .....	407—412
TË ORGANIZOJMË MË MIRË STUDIMET SHKENCORE PËR NAFTËN — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (21 maj 1964) .....	413—415
PARTIA I DHA POPULLIT PUSHTETIN E TIJ DHE E UDHËHEQ NË RRUGËN E SOCIALIZMIT — Fjala e mbajtur në mbledhjen përkujtimore në sallën muze të Kongresit të Përmetit (24 maj 1964) .....	416—418
VENDIMET HISTORIKE TË KONGRESIT TË PËRMETIT DOLËN NGA GRYKA E PUSHKËS PARTIZANE — Fjala në pritjen e dhënë në Përmet me rastin e 20-vjetorit të Kongresit të Parë Antifashist Nacionalçlirimtar (24 maj 1964) .....	419—417

TEATRI DUHET TË JETË SHKOLLA E MASAVE,  
KURSE ARTISTI — FRYMËZUESI I TYRE I DA-  
SHUR — Përshëndetje drejtuar punonjësve të teatrit  
me rastin e 20-vjetorit të krijimit të Teatrit Popullor  
(30 maj 1964) .....

443—154

---

Shtypur: Kombinati Poligrafik  
Shtypshkronja «Mihal Duri» — Tiranë, 1978